

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT (140 vjet mbas)

Konferencë shkencore ndërkombëtare
(8-9 qershor 2018)



KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVENSIS
SECTION OF SOCIAL SCIENCES

ALBANIAN LEAGUE OF PRIZREN (140 years later)

International Scientific Conference
(8-9 June 2018)

Editor: Correspondent member Justina Shiroka-Pula, Secretary of the Section of Social Sciences.



AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS
SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT (140 vjet mbas)

Konferencë shkencore ndërkombëtare
(8-9 qershor 2018)

Redaktor: Anëtare korresponente Justina Shiroka-Pula, Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore.



Copyright © ASHAK

KËSHILLI ORGANIZUES

Jusuf BAJRAKTARI, kryetar

Frashër DEMAJ, sekretar

Beqir META, anëtar

Shaban SINANI, anëtar

Nuri BEXHETI, anëtar

PËRMBAJTJA

Ksenofon Krisafi

E ARDHMJA POLITIKE E SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E
LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT.....7

Albana Velianj, Shaban Sinani

EPOKA E LIDHJES: NGA HISTORIA NË LETËRSI - RASTI
I *LAHUTËS SË MALCËS*.....43

Islam Lauka

INSTRUMENTALIZIMI RUS I KONCEPTIT “SHQIPËRIA E
MADHE”55

Fehari Ramadani

VEPRIMTARIA E LIDHJES SË PRIZRENIT PËR
MBROJTJEN E TOKAVE SHQIPTARE (QERSHOR -
KORRIK 1878).....69

Frashër Demaj

FONDE TË DOKUMENTEVE BRITANIKE PËR LSHP NË
“THE NATIONAL ARCHIVE”83

Alban Dobruna, Ilirjana Kaceli

Roli i Ahmet Koronicës në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit109

Martin Berishaj

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT NË SHTYPIN
SLLOVEN131

Oliver Schmitt

LIDHJA E PRIZRENIT, INTERPRETIMET E
KONSTATUARA AUSTRO-HUNGAREZE139

Esmeralda Osmani Kolaneci

ROLI I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT NË
NDËRKOMBËTARIZIMIN E ÇËSHTJES SHQIPTARE149

Mark Juncaj

MALËSIA E MADHE NË KOHËN E LIDHJES SHQIPTARE
TË PRIZRENIT165

Floresha Dado

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT NË PASQYRË TË
KËNGËVE POPULLORE.....181

Kujtim M. Shala

MËSIM LETRAR E HISTORI (*Fishta: Kangët e Lidhjes së
Prizrenit*)187

Ksenofon KRISAFI

E ARDHMJIA POLITIKE E SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Përmbledhje

Punimi nisët nga premisa se Lidhja Shqiptare e Prizrenit shpalli si kërkesa themelore dhe më imperative ruajtjen e tërësisë territoriale dhe sigurimin e autonomisë për vilajetet shqiptare të Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës, me synimin për t'i parë të bashkuara administrativisht si një njësi e vetme politiko-administrative, fillimisht me statusin e autonomisë dhe më pas në formën e një shteti të pavarur. Nëpërmjet programit dhe akteve të tjera të miratuara nga organet kryesore vendimmarrëse Lidhja formuloi dhe shprehu zyrtarisht aspiratën për të ardhmen politike të shqiptarëve, të cilën u përpoq ta realizonte në praktikë me veprimtarinë e vet gati trevjeçare.

Në vijim theksohet se veprimtaria e saj përkoi në kohë me mbajtjen e Kongresit të Berlinit nga i cili ajo kërkoi zyrtarisht marrjen në konsideratë të ekzistencës së çështjes shqiptare dhe domosdoshmërinë e gjetjes së një zgjidhjeje të përshtatshme.

Forma e organizimit politik dhe administrativ të trojeve shqiptare figuron e trajtuar gjerësisht në promemorien e një grupi patriotësh shkodranë, që njihet me emrin Përkujtesa e qytetarëve shkodranë, të cilët ia dërguan Lordit Bikonstfild, ministër i Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, më 13 qershor 1878. Disa prej ideve më kryesore gjenden edhe në Memorandumin e 20 qershorit 1878, që 11 personalitete shqiptare ia drejtonin Bismarkut, presidentit të Kongresit të Berlinit dhe përfaqësues i Gjermanisë në Kongres, kontit Andrashi, ministër i punëve të jashtme të Austro-Hungarisë dhe Vadingtonit, ministër i punëve të jashtme të Francës. Ata së bashku me përfaqësuesit e Anglisë, Rusisë dhe Italisë ishin mbledhur

ato ditë në Berlin në edicionin e radhës të Koncertit European të Fuqive të Mëdha. Përkujtesa e qytetarëve shkodranë, e përfshirë në programin dhe veprimtarinë e Lidhjes, përfaqëson një platformë programatike, ku trajtohet çështja shqiptare, vendi i saj në çështjen politike e diplomatike të kohës, elementët përbërës dhe disa nga alternativat më racionale, më të drejta dhe më të avancuara të zgjidhjes së saj. Atysh prehen në mënyrë të plotë e të qartë kërkesat e Lidhjes dhe në përgjithësi të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare ndaj faktorit ndërkombëtar. Shtrohet kërkesa e krijimit të një shteti shqiptar unitar, fillimisht nën condominiumin e Fuqive të Mëdha si vasal i tyre dhe më pas si shtet i pavarur. Ai do të kishte statusin e një shteti me neutralitet të njohur dhe të garantuar nga Fuqitë e Mëdha. Përkujtesa nuk e përjashtonte edhe mundësinë e përfshirjes në ndonjë konfederatë me shtetin grek, në varësi të interesit dhe të rrethanave që mund të krijoheshin.

Zhvillimet e ndodhura gjatë ekzistencës së Lidhjes provuan vendosmërinë e drejtuesve të saj për t'i vënë ato në jetë, por që për shkak të një vargu rrethanash të brendshme e të jashtme, Porta e Lartë i ndërpreu brutalisht me dhunë dhe Lidhjen, tentativën e shtetit të parë modern shqiptar e shtypi me gjak.

Fjalët çelës: Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Fuqitë e Mëdha, Kongresi i Berlinit, Përkujtesa e qytetarëve shkodranë.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Kongresi i Berlinit

Themelimi i Lidhjes përkoi me një ngjarje të rëndësishme politiko-diplomatike ndërkombëtare, me mbledhjen e Fuqive të Mëdha të kontinentit në forumin e radhës, në Kongresin e Berlinit (13 qershor - 13 korrik 1878). Ai do të linte gjurmën e vet në ëndrrën e madhe të shqiptarëve për t'u organizuar dhe për të ecur në një radhë me fqinjët. Kongresi sanksionoi zyrtarisht ambicjet e tyre aneksioniste ndaj tokave shqiptare, duke shkaktuar fatkeqësi të panumërta, dhimbje dhe zhgënjime. Ai edhe pse e ceku, nuk e trajtoi në tërësi dhe, doemos nuk e zgjidhi çështjen shqiptare. Historiani i madh shqiptar Aleks Buda është shprehur se ajo ishte produkt i natyrshëm i zhvillimit të

Lëvizjes Kombëtare Shqiptare (LKSh) gjatë gjithë shekullit XIX, veçanërisht pas gjysmës së dytë, ishte pjesë përbërëse dhe rrjedhim i një tërësie ngjarjesh dhe procesesh me të cilat qe ndërlidhur dhe ndërthurur.¹

Drejtuesit e LKSH-së dhe të LSHP-së mendonin seriozisht për të ardhmen politike të popullit të vet. Ajo përfshinte, ndër të tjera, çështjet që kishin të bënin me statusin juridiko-ndërkombëtar të Shqipërisë, me ruajtjen e tërësisë territoriale dhe vendosjen e kufijve kombëtarë, për të cilat Lidhja iu drejtua zyrtarisht Kongresit të Berlinit. Përfaqësues të LKSH-së vite më parë kishin ndërhyrë te fqinjët dhe Fuqitë e Mëdha për respektimin e të drejtave të popullit shqiptar dhe aspiratës së tij për të pasur shtetin e vet kombëtar. Në 1873, shkruante Jeronim De Rada, “unë pata thënë se Shqipëria nuk ka tjetër mjet mbrojtjeje për kombësinë e vet veçse bashkimin. Autonomia, pa bashkim vëllazëror, do ta ekspozonte ndaj lakmisë për pushtim...”² Këtë thirrje ai e përsëriti sërish në korrikun e vitit 1878, kur kërkoi pavarësinë e Shqipërisë dhe bashkimin e shqiptarëve.³ Gjatë kryengritjes së Mirditës, në vitet 1876-1877, një grup atdhetarësh shkodranë krijuan lidhje me bashkësi të tjera në Itali dhe në Mal të Zi, hodhën idenë e formimit të një principate shqiptare autonome nën suzerenitetin e Sulltanit dhe kërkuan bashkëpunim me forcat progresive të sllavëve të jugut për çlirimin e Shqipërisë nga

¹ Aleks Buda *Lidhja e Prizrenit dhe rrënjët e saj historike*, në *Konferenca Kombëtare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881*, Vëll. 1, Botim i Akademisë së Shkencave, Institutit të Historisë, Tiranë, 1979, fq. 14.

² G.de Rada, *Poesie albanesi, Scanderbeccu i pafaan, Storie del secolo XV*, libro IV, vol. V, Napoli 1877, f.156. Citohet nga Jup Kastrati, *Mbi rolin e arbëreshëve të Italisë në periudhën e Lidhjes Shqiptare*, në *Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881, (12-28 qershor 1978)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1979, f.196.

³ *L'unità Albanese domandata nel 1878*, Martocceco, 17.VI.1917, sipas G.Petrotta, *Popolo, lingua e letteratura Albanese*, Palermo, 1931, f. 151. Citohet nga Jup Kastrati, *Mbi rolin e arbëreshëve të Italisë në periudhën e Lidhjes Shqiptare*, në *Konferenca ... f. 198*.

shtypësi i përbashkët.⁴ Ndërkohë Komiteti i Janinës, nëpërmjet Abdyl Frashërit dhe Mehmet Vrionit nisi demarshet për krijimin e një aleance politiko-ushtarake shqiptaro-greke në ndonjë nga format e njohura të bashkimeve juridiko-ndërkombëtare. Athina pranoi të hynte në bisedime. Ato u zhvilluan në Janinë, Stamboll dhe Korfuz gjatë viteve 1877-1878.⁵ Abdyl Frashëri argumentoi interesin e të dyja palëve për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe njohjen e saj në kufijtë etnikë. Sipas tij, kështu do t'i shërbehej më mirë luftës kundër Perandorisë Osmane dhe kundër pansllavizmit carist.⁶ Pala greke nuk pranoi asnjë prej tyre, sepse pretendonte që Epiri, nga Semani deri në Prevezë, ishte grek dhe Shqipëria e Jugut duhet të bashkohej me Greqinë. Pjesa mbi lumin Seman duhet të kërkonte bashkimin me Greqinë në formën e një shteti dualist greko-shqiptar nën sovranitetin e mbretit të Greqisë.⁷ Abdyl Frashëri i hodhi poshtë, duke deklaruar se populli shqiptar po niste kryengritjen për të formuar shtetin e vet të pavarur dhe jo për të zëvendësuar zgjedhën osmane me robërinë greke, për të ruajtur tërësinë e vet territoriale dhe jo për ta ndarë atë në tokë greke dhe në tokë shqiptare. Ai, së bashku me drejtuesit e tjerë të LKSH-së, konstatuan se politika e fqinjëve kishte mbetur tipike ballkanike, refraktare ndaj koncepteve europiane për të drejtat e minoriteteve kombëtare, etnokulturore, gjuhësore e fetare, të shpalosura nga revolucionet francez dhe kushtetuta amerikane. Ndaj

⁴ Aleks Buda, *Shkrime historike*, 2, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë, 1986, f.105.

⁵ Bisedimet u zhvilluan në mënyrë të fshehtë ndërmjet Abdyl Frashërit, i cili shoqërohej nga Mehmet Ali Vrioni, nga njëra anë dhe Epaminonda Mavromatis, një funksionar i Ministrisë së Jashtme Greke dhe diplomatë të tjerë grekë, nga ana tjetër.

⁶ Pala shqiptare kërkoi nga Atina që të njihnte zyrtarisht formimin e principatës së pavarur shqiptare në kufijtë etnikë të Shqipërisë, duke përfshirë Kosovën në veri deri në Vranjë dhe Çamërinë në jug, deri në Prevezë. Pala greke e kundërshtoi idenë e një principate shqiptare të pavarur dhe ca më shumë përfshirjen në kufijtë e saj qoftë edhe të një pjese të vogël të të ashtuquajturit Epir. Sipas tezës së saj, krejt Epiri, që nga lumi Seman deri te gjiri i Prevezës ishte tokë greke.

⁷ Fournier, *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (Dokumente diplomatike frënge)*, përgatitur nga L.Mile, vëll. I, Tiranë, 1978, vëll.II, Tiranë, 1986. (SH./LSHP/DAF), f.220-221.

minoriteteve ata vazhdonin të ndiqnin politikat e mohimit dhe të shtypjes së çdo të drejte dhe lirie njerëzore, asimilimit të dhunshëm nëpërmjet eliminimit fizik, dëbimit e shpërnguljes nga territoret e tyre.

Projektet e bashkimeve eventule shqiptaro-greke fqinjët i shihnin si forma transitore të maskuara drejt aneksimit të territoreve, kurse shqiptarët i mendonin thjesht si mënyra dhe mundësi për realizimin e shkëputjes së butë nga Stambolli dhe krijimin e shtetit të tyre të pavarur.

Për trajtimin e aspekteve të të ardhmes politike të hapësirave shqiptare LKSH kishte përpunuar dhe përhapur idenë e nevojës së organizimit të veçantë politik e administrativ, që shkonte deri te shkëputja nga Perandoria Osmane.

Abdyl Frashëri me grupin e drejtuesve të tjerë të Komitetit të Stambollit kishin arritur në konkluzionin se realizimi i objektivit të LKSH, që ishte bashkimi politik dhe organizativ i gjithë shqiptarëve të shpërndarë në të katër vilajetet perëndimore të Gadishullit Ballkanik kërkonte krijimin e një forumi të posaçëm kombëtar. Komiteti i Stambollit kishte ndjesinë se Porta e Lartë nuk do t'i kundërvihej krijimit të organizatës mbarëshqiptare që do të udhëhiqte lëvizjen popullore. Shpresoj, sepse programi i ri e kishte përjashtuar konfliktin e armatosur shqiptaro-turk.

Për përgatitjen e projektit të këtij forumi, në fillimin e vitit 1878 u caktua një prej personaliteteve më në zë të Lëvizjes Kombëtare, Pashko Vasa, anëtar i Komitetit të Stambollit, i cili, mbante postin e këshilltarit të valiut të Kosovës. Ai, në krye të një komisioni të posaçëm, do të bënte përçapjet e duhura juridike e institucionale për të marrë lejen përkatëse nga Porta e Lartë për themelimin e organizatës mbarëshqiptare. Pashko Vasa i dërgoi Vezirit të madh (kryeministrit) osman një parashtresë, ku kërkohej lëshimi i lejes për krijimin e një organizate politiko - ushtarake për të mbrojtur tokat shqiptare nga

invazionet e serbëve, malazezëve dhe grekëve. Stambolli qëndroi reticent për një kohë të gjatë.⁸

Në vazhdim të përpjekjeve për të ndikuar te faktori ndërkombëtar, në mars 1878 Pashko Vasa i paraqiti ambasadorit britanik në Stamboll një promemorje në emër të popullit shqiptar, në të cilën lufta kundër copëtimit territorial të Shqipërisë lidhej organikisht me kërkesën për autonominë e saj administrative. Shqiptarët, shkruhej në të, janë të vendosur t'i këputin të gjitha lidhjet që i bashkojnë me Turqinë. Ata nuk duhet të përjashtohen nga ajo e drejtë që kanë popujt sllavë të Ballkanit për të formuar shtete të pavarura ose autonome.⁹

Në të njëjtën kohë, Abdyl Frashëri nëpërmjet disa shkrimeve të publikuara në *Messenger de Vienne* gjatë muajve prill dhe maj 1878 kontribuonte në sensibilizimin e qarqeve politike dhe opinionit publik në Europë rreth ekzistencës së çështjes shqiptare dhe domosdoshmërisë së zgjidhjes së saj. Shpallte se kombi shqiptar nuk aspirojnë asgjë tjetër veçse të jetojë i lirë, të dalë nga prapambetja dhe të zërë vendin që meriton në radhët e kombeve të qytetëruara të Evropës. Ai ishte një nga më të lashtët në Evropë, me gjuhë, territor, kulturë, ndërgjegje dhe histori mijëvjeçare. Në rast se Fuqitë e Mëdha do ta dënojnë të mbetet nën robëri dhe, ca më keq, të copëtohet ndërmjet shteteve fqinje, Gadishulli Ballkanik nuk do të ketë kurrë qetësi, sepse shqiptarët nuk do të pushojnë asnjëherë së luftuari për të fituar pavarësinë e tyre kombëtare. Përkundrazi, në rast se shqiptarëve do t'u njihen të drejtat e tyre kombëtare, Shqipëria do të bëhet faktor i paqes

⁸ Abdyl Frashëri, arkitekt i platformës politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, nga: prof. Izmi ZEKA, Citohej nga publikimi në <https://facebook.com>, 28 february 2013, si edhe www.bksh.al, botuar, 2007, V,55- Nr. 211, 7 gusht, 2007.

⁹ Public Record Office, London, F. O. 78/2784; The British Museum, London, Accounts and Papers (38) 1878 LXXXIII. 83. 298 - 301. Memorandumi i shqiptarëve kundër paqes së Shën Stefanit (1878), zot. Layard - Sekretarit shtetëror për punë të jashtme. - (marrë më 12 prill), Stamboll, më 1 prill 1878, Bashkangjitja Memorandumi, Stamboll, më 1 prill 1878, citohej nga *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet angleze*, 2, (Arkivi i Kosovës), përgatitur nga Skënder Rizaj, Prishtinë, 1978, f. 56-57.

dhe do të kthehet në një digë kundër ekspansionit carist, i cili rrezikon jo vetëm Gadishullin Ballkanik, por edhe kontinentin evropian.¹⁰

Zhvillimet e përgjithshme të Krizës Lindore, ballafaqimet ndërmjet interesave të pjesëtarëve të Koncertit European dhe, me sa duket presionet permanente të LKSH, bënë që çështja e të ardhmes politike të shqiptarëve të shtrohej për diskutim edhe me nismën e disa prej Fuqive të Mëdha.¹¹ Mund të përmenden negociatat e Raihshtadit¹² në qershor të vitit 1876 dhe të Budapestit¹³ në janar të vitit 1877, ose Traktati i Shën Stefanit¹⁴ i 3 marsit të vitit 1878, ku zhvillimet e ardhshme në Perandorinë Osmane e në Ballkan u llogaritën edhe mbi bazën e ndryshimeve eventuale në statusin e trojeve shqiptare. Marrëveshja e Budapestit ka rëndësi në historinë diplomatike të çështjes shqiptare. Ajo përfaqëson aktin e parë, ku parashikohet krijimi i shtetit shqiptar, i cili ishte projektuar me territore të zvogëluara, sepse një pjesë e tyre do t'iu kaloheshin Greqisë, Malit të Zi dhe Rumelisë, që ishte projektuar të themelohej krahas Bullgarisë dhe Shqipërisë mikroskopike.¹⁵

¹⁰ Citohet sipas Prof. Dr. Kristo Frashërit, *Trashëgimi dhe perspektiva shqiptare, në Kombi- Rrugët e bashkimit kombëtar*, New York, 1997, ff. 293-294.

¹¹ Në gazetën austriake, “*Die Debatte*”, në një shkrim të 19 shkurtit 1869, nr. 50. viti VI, thuhet ndër të tjera se “shqiptarët, apo siç i njohin në Turqi, “arnautët”... në kontekstin e “çështjes orientale”, marrin një peshë edhe më të madhe se sa malazezët dhe boshnjakët të marrë së bashku dhe, përballë armikut, janë më të respektuar se sa grekët...”

¹² Marrëveshja e Rajhshtadit u përfundua në një takim të fshehtë në këshjellën me të njëjtin emër, në Bohemi, më 8 korrik 1876, midis Carit rus, Aleksandrit II dhe Perandorit austro-hungarez, Franc Jozef. Aty përmendet për herë të parë ideja e një Shqipërie autonome, e një shteti shqiptar autonom, i cili do të krijohej nëse Turqia do të mundej në luftë. (*Istoria diplomatii, V.II*, Moskva, 1945, f. 23, 29). Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, Vëll.I,(1867-1912)*, Tiranë 1984, f. 103-113,

¹³ Ideja e një shteti shqiptar do të ritheksohej sërish nga Austro-Hungaria në Marrëveshjen e Budapestit të 15 janarit 1877. (Prof. Dr. Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 1878-1881*, botimet Toena, 1997, f. 119), Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, Vëll. I,(1867-1912)*, Tiranë 1984, f. 113-120.

¹⁴ Arben Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, Vëll. I, (1867-1912)*, Tiranë 1984, f. 120-138.

¹⁵ Po aty.

Në të njëjtën linjë ishin edhe njoftimet që përcillte ambasadori britanik në Perandorinë Osmane, George Goschen, i cili në vitin 1880 i shkruante qendrës së vet se kombësia shqiptare është një element, që nuk duhej injoruar në kombinacionet e ardhshme politike.¹⁶

Megjithatë, rezultatet nuk e tejkaluan kufirin e konstatimeve dhe në ndonjë rast të diskutimeve ose deklarimeve juridiko-ndërkombëtare me rëndësi relative. Prandaj ishin Programi i LSHP dhe veprimtaria esaj që do ta mbanin gjallë çështjen e të ardhmes politike të shqiptarëve. Ajo ua imponoi atë Fuqive Europiane, duke ua bërë të qartë se njohja e të drejtës së vetëvendosjes për popullin shqiptar për krijimin e shtetit të tij dhe daljen si subjekt i së drejtës ndërkombëtare do të ishin alternativa më optimale për stabilitetin dhe paqen në Ballkan. Idetë e veta për të ardhmen politike të shqiptarëve LSHP i konceptoi dhe i redakttoi në trajtën e disa dokumenteve me karakter juridik të miratuara nga organet kompetente të saj. Akte të tilla si Kararnameja, Talimati, kanuni i 2 korrikut 1878, vendimet e kuvendeve ose forumeve të tjerë të Lidhjes, së bashku edhe me memorandume, peticione, kërkesa, deklarime publike, letra ose shkrime të drejtuesve dhe ideologëve të Lidhjes përpunuan konceptin politiko-organizativ mbi të cilin do të mbështetej platforma e saj shtetërore. Përpunoi gjithashtu programin dhe skenarët për konkretizimin e projektit të shtetformimit të shqiptarëve.

Programi dëshmon kthjelltësinë e tyre për sa i përkiste formës, karakterit, shtrirjes, qëllimeve, objektivave dhe rolit që do të luante Lidhja. Ai u propagandua gjerësisht në mjediset shqiptare. U bë i njohur edhe në kancelaritë e Fuqive të Mëdha, nëpërmjet takimeve, bisedimeve diplomatike dhe dorëzimit të memorandumeve, peticioneve ose dokumenteve të tjera. Rëndësi pati udhëtimi i delegacionit të LSHP, i përbërë nga Abdyl Frashëri dhe Mehmet

¹⁶ Aleks Buda, *Shkrime historike*, 2, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë, 1986, f. 162-163.

Vrioni në kryeqytetet kryesore europiane dhe takimet e tij në nivelet më të larta shtetërore.

Përmbajtja, qëllimi dhe objektivat e Programit të Lidhjes do të plotësoheshin dhe konkretizoheshin më pas. Ai nisi të vihej në zbatim pa vonesë pothuajse në të gjitha hapësirat e banuara nga shqiptarët.

Organet e Lidhjes ishin ideuar që të funksiononin sipas koncepteve të filozofisë së Monteskjës,¹⁷ Lokut¹⁸ etj. për ndarjen e pushteteve. Organizimi i të ardhmes politike të vendit prirej drejt formës republikane. Shumica e drejtuesve të saj e donin Shqipërinë republikë edhe pse kishin vepruar ose kishin pasur funksione zyrtare në sistemin monarkik perandorak osman. Nuk ndikoi as fakti që Greqia, Serbia, Mali i Zi etj., që ndodheshin përreth territoreve shqiptare, kishin adoptuar sistemin monarkik. Duket se ata kishin përqafuar pa rezerva konceptin e Sami Frashërit, i cili, rreth 20 vjet më vonë do ta shprehte në një formë koherente dhe të argumentuar te manifesti politiko-kushtetues *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhetë*. Ai thoshte se Shqipërisë i duhej një shtet modern dhe jo një sulltanat. “Po ç'i duhetë Shqipërisë një njeri në krye të qeverisë? Një mbret a princ do të prishë më shumë se s'ia ka fuqinë vëndi ynë, do të na prishë edhe vëtiatë tona duke marrë ca nga na nënë sqetullë e duke ftohur të tjerët”.¹⁹

Europa sheh te LSHP-ja aspiratën shtetformuese të shqiptarëve

LSHP duhet parë si një realitet që mbante vulën e kohës, që kushtëzohej gjithashtu edhe nga vështirësitë e shumta të krijuara nga Porta e Lartë dhe fqinjët. Megjithatë ajo arriti të shfaqej si krijesë me

¹⁷ Charles-Louis de Secondat, Baron de La Brède et de Montesquieu, - *De l'esprit des lois*, 1748

¹⁸ John Locke, - *Two treatises on government*, 1690.

¹⁹ Frashëri, Sami, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhetë*, ed. 2013, DIJA, f. 70.

pretendime dhe me tipare shtetërore, çka u vu re edhe nga përfaqësuesit e huaj diplomatikë që ndodheshin në territoret shqiptare. Ata, duke vlerësuar strukturat e ngritura nga LSHP dhe veprimtarinë e tyre praktike, shpreheshin se Shqipëria dhe shqiptarët kishin krijuar një shtet të vetin që vepronte duke dubluar dhe duke anashkaluar intencionet perandorake.²⁰ “Ideja e pavarësisë shqiptare dhe e formimit të një shteti të ri janë një dëshirë e përgjithshme”,- shprehej në ato kohë një gazetar italian që kishte vizituar vendin.²¹ Konsulli grek në Shkodër E. Mavromatis i shkruante eprorit të vet A. Kontostavlos, më 5 tetor 1876 se koncepti i një shteti kombëtar të veçantë kishte filluar të fitonte terren te shqiptarët e shkolluar. Ishte kryesisht qëndrimi armiqësor i fuqive të huaja faktori kryesor që e pengonte dëshirën e shqiptarëve për një shtet të veçantë autonom.²² Konsulli i Rusisë në Shkodër, Jastrebov, thoshte se “përpara botës u ngrit tani çështja shqiptare”.²³ Po nga dokumentet ruse vjen një e dhënë tjetër, e cila ka të bëjë me objektivin themelor të LSHP për të ardhmen politike të shqiptarëve. Në vitin 1878, diku, midis muajve qershor-gusht, një përfaqësues i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, që mendohet se duhet të ketë qënë Jusuf Ali-beu, kajmekami i Dibrës,²⁴ u

²⁰ Në gusht 1880 konsulli rus në Janinë Trojanski, duke raportuar për gjendjen në Çamëri thoshte: “Qeverisja e vilajetit tani po kalon dalëngadalë në duart e shqiptarëve, të cilët përpiqen të largojnë që këtej të gjithë nëpunësit me origjinë joshqiptare dhe kanë pasur aq sukses në këtë punë, sa që në rrethet e Epirit Veriperëndimor Lidhja Shqiptare vepron pothuajse në mënyrë të pavarur”.

²¹ *La Guerra d'Oriente in Europa ed in Asia, 1877-1879. Cronaca illustrata dalla Conferenza di Costantinopoli fino al Trattato di Berlino*. Milano, Treves, 4 (1877) 35. Cit. nga Kristo Frashëri, *Lidhja...*, vep. cit. f.31,

²² E. Kofos, *Greek reaction to developments leading to the Albanian League of Prizren*, në *Balkan Studies*, vol. 23, nr. 2 Thessaloniki 1982). Cit. nga Kristo Frashëri, *Lidhja ...* vep.cit. f. 31.

²³ Aleks Buda, *Shkrime Historike*, 2, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë, 1986, f. 105.

²⁴ Sipas mendimit të Irina G.Senkivëçit për përcaktimin e emrit të këtij personi ndihmojnë dy dokumente nga arkivi personal i M.A. Hitrovos; ai me titull: “Akti për autorizimin gjeneral, lëshuar zotit Jusuf Ali-beut, kajmekamit të Dibrës...”. Ky akt autorizon Jusuf Ali-beun që të përfaqësojë interesat e shqiptarëve”. Dokumenti tjetër përshkruan situatën politike në krahinat shqiptare dhe caqet e veprimit të Lidhjes shqiptare. Dokumenti është përpiluar

prit në shtabin e përgjithshëm të ushtrisë ruse në Edrene.²⁵ Qëllimi i tij ishte të informohej nga burime të afërta me qarqet e larta ruse rreth qëndrimeve të Fuqive të Mëdha evropiane dhe të vetë Rusisë ndaj Lidhjes së Prizrenit dhe të njoftonte organet e saj drejtuese. Takimi dëshmohet në një dokument të zyrës diplomatike të komandës supreme të ushtrisë ruse, që vepronte në Edrene gjatë luftës ruso-turke (1877-1878). Ai flet për pritjen nga komandanti suprem, E.I.Totleban. Pyetjes së tij të drejtëpërdrejtë Jusuf Ali-beu iu përgjigj se “Shqiptarët dëshirojnë për veten asgjë më tepër se sa atë që është bërë për popujt e tjerë të Gadishullit Ballkanik – *pranimin e pavarësisë dhe të drejtën që të themelojnë principatën e tyre të veçantë* (kursivi i autorit)”²⁶. Deklarimi i mësipërm vërteton se brenda lëvizjes shqiptare, që nga fillimi i veprimtarisë së Lidhjes së Prizrenit, krahas programeve të tjera të moderuara, ekzistonte edhe programi për shkëputjen dhe daljen më vete të Shqipërisë.

Një opinion interesant për zgjidhjen dhe për të ardhmen e *çështjes shqiptare* shfaqte në ato kohë ambasadori francez në Stamboll, Furnie. Ai e trajtonte atë në korelacion me *çështjen greke*. Rrugët e zgjidhjes së çështjes shqiptare, thoshte ai, janë dy, - ajo e mohimit ose e pohimit të saj. Zgjidhja më e përshtatshme sipas tij, ishte ajo pohuese, të cilën e argumentonte nëpërmjet përgjigjes së një pyetjeje që e shtronte në formën e mëposhtme: a ka interes që kombësia shqiptare të shuhet apo të zhvillohet? Në qoftë se Greqia do të marrë copa nga tokat e Shqipërisë në një kohë kur Serbia dhe Mali i Zi po zhvatin copa të tjera prej saj dhe kur bullgarët e Maqedonisë gjithashtu po lakmojnë të shkëputin toka shqiptare, atëhere do të kemi si rezultat që Shqipëria do të katandiset në një “mbeturinë” dhe do të bëhet objekt i lakmive të mëtejshme të fqinjëve të saj, të cilët nuk do

në emër të parisë shqiptare – gegë, myslimanë dhe të krishterë nga Dibra, Mati, Malësia, Mirdita, Prizreni, Elbasani etj., të cilët ishin të gatshëm të mbronin lirinë e atdheut me armë në dorë pa kursyer flijesat. Irina G. Senkieviç, - *Albania v period Vostochnovo krizisa*, Moskva, 1965, f.121.

²⁵ I.G.Senkieviç, vep.cit. f. 122.

²⁶ Po aty, f.117.

ta ndërpresin luftën e tyre derisa ta asgjësojnë atë plotësisht. Duke e parë në këndvështrimin e Athinës, përfundonte se kjo zgjidhje nuk ishte në interesin e saj, sepse “në qoftë se duam t’i caktojmë Greqisë një rol të vërtetë duhet t’i përgatisim asaj edhe aleatë të lehtë, të cilët të jenë të prirë drejt saj, të kenë dobi nga afrimi me të dhe, duke u bashkuar me të, ta ruajnë plotësisht energjinë e personalitetit të tyre”²⁷.

Elementet e shtetshmërisë në strukturat organizative të LSHP-së

LKSH dhe LSHP, arkitektet e zhvillimeve politike progresive që kishin nisur në vend, donin t’i shihnin elementet e domosdoshme të shtetshmërisë të pranishme në shtetin shqiptar të projektuar prej tyre. Ato shfaqen në *Përkujtesën*, që një grup patriotësh shkodranë i dërguan më 13 qershor 1878 Lordit Bikonsfild, ministër i Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe. Ajo njihet me emrin *Përkujtesa e qytetarëve shkodranë*²⁸ dhe mund të cilësohet si një nga platformat strategjike, programatike më të spikatura të të ardhmes politike të shqiptarëve, organizimit administrativ të trojeve të tyre drejt një shteti autonom deri të pavarur. *Përkujtesa* trajton *çështjen shqiptare*, vendin

²⁷ Fournier, *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (Dokumente diplomatike frënge)*, përgatitur nga L. Mile, vëll. I, Tiranë, 1978, vëll. II, Tiranë, 1986. (SH./LSHP/DAF), f. 220-221.

²⁸ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë 1978, f. 27-50. Për më gjerë shih gjithashtu S. Pollo, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe lufta e saj për çlirimin dhe bashkimin kombëtar*, në *Konferenca Kombëtare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881*, Vëll. 1, Botim i Akademisë së Shkencave, Institutit të Historisë, Tiranë, 1979, fq. 39; S. Pulaha, *Programi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për krijimin e provincës autonome të Shqipërisë (qershor-nëntor 1878)*, po aty, fq. 166, 169; A. Puto, *Lidhja Shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të kombit të vet në vitet e Krizës Lindore*, në *Konferenca*,... vëll. 1, fq. 53 - 55; Th. Murzaku, *Traktati i Shën Stefanit dhe rrjedhimet e zbatimit të tij për Shqipërinë*, po aty, fq. 108; K. Krisafi, *Çështja Shqiptare në Kongresin e Berlinit dhe në forumet e tjera të diplomacisë së Fuqive të Mëdha*, në *Studime Historike*, 1-2/1998, fq. 159; etj.

e saj në karrierën politike e diplomatike të kohës, elementët përbërës, disa nga alternativat më racionale të zgjidhjes së saj dhe ia paraqet ato faktorit ndërkombëtar të kohës. Bën pjesë në një sistem dokumentesh juridiko-institucionale të miratuara nga forumet themelore të LSHP-së, të cilat ishin në fakt manifeste solemne të personifikimit të vullnetit të përbashkët të shqiptarëve për të ardhmen e tyre si një entitet politik i mëvetësuar.

Në *Përkujtesë* shtrohet kërkesa e krijimit të një shteti shqiptar dhe e njohjes së tij nga shtetet e tjerë. Është formuluar me një gjuhë shprehëse, me argumente të fuqishme të karakterit kombëtar, historik, etnik, gjeografik, politik, juridik, gjeopolitik etj. Pas një ekspozije gati analitike të situatave të zhvilluara në rajon nën veprimin e Traktatit të Shën Stafanit, *Përkujtesa* vë në dukje se zgjidhja e *Çështjes shqiptare* duhet të bëhej në bazë të parimit të kombësisë, që konsiderohej si “baza themelore e të drejtës publike evropiane”, sipas të cilit “çdo komb duhet të organizohej në shtetin e vet... Paqja nuk mund të jetë e qëndrueshme... në qoftë se shqiptarëve nuk u kthehet, nuk u konfirmohet dhe nuk u njihet pavarësia e tyre”.²⁹

Idetë qendrore të shprehura në *Përkujtesën e qytetarëve shkodranë*, të përfshira edhe në vendimin e Lidhjes të 15 qershorit 1878 u riprodhuan gjithashtu në aktet e miratuara nga disa prej degëve të Lidhjes, në krahinat e tjera të Shqipërisë. Qëllimi ishte që ato të merrnin formën e një kërkesë konsensuale të miratuar nga gjithë populli shqiptar. Kongresit iu dërguan p.sh. kërkesa zyrtare në emër të popullsisë së të gjitha krahinave të Shqipërisë së Mesme e Veriore përfshirë dhe Tivarin, Triepshin, Kuçin, Tuxhmilen etj. drejtuar nga Shkodra më datën 16 qershor, kërkesa në emër të degës së Lidhjes për Dibërën më 14 tetor 1878, nga Lidhja Shqiptare për Toskërinë po në atë muaj etj.

²⁹ Po aty.

Përkujtesa, që mund të cilësohet edhe si një ndër dokumentet vizionare dhe programatike më të rëndësishme të LKSH-së³⁰, përveç konsideratave dhe kërkesave me karakter politik përmbante pothuajse të gjithë elementët e domosdoshëm që shqiptarët do të donin t'i gjenin të pranishme në shtetin e tyre të ardhshëm.

Shteti unitar i Lidhjes

Drejtuesit e Lidhjes mendonin se zgjidhja më optimale do të ishte themelimi i një shteti unitar dhe jo parcelizimi i hapësirës së tyre shtetërore në formën e një federate ose konfederate, çka ua deklaronin edhe Fuqive të Mëdha. Ishin të vetëdijshëm se nëpërmjet shtetit unitar do ta kishin më të lehtë të përballonin synimet aneksioniste të fqinjëve ose eventualisht edhe të Fuqive të Mëdha.

Në pikat IV, VI dhe VII të *Përkujtesës së qytetarëve shkodranë*³¹ theksohet se Shqipëria si “një komb i vetëm për nga raca, gjuha, traditat, historia dhe nga të gjithë elementët përbërës të identitetit kombëtar, ka të drejtë të quhet, siç është në të vërtetë, një trup i vetëm dhe të organizohet në formë unitare nën një qeveri të vetme (kursivi i autorit)....Detyra e formimit të saj... duhet t'i besohet.... një komisioni

³⁰ Gazmend Shpuza, në *Konferenca Kombëtare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881*, Vëll. 1, Botim i Akademisë së Shkencave, Institutit të Historisë, Tiranë, 1979, f. 68.

³¹ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë 1978, f. 48-50. Për më gjerë, shih gjithashtu S. Pollo, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe lufta e saj për çlirimin dhe bashkimin kombëtar*, në *Konferenca Kombëtare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881*, Vëll. 1, Botim i Akademisë së Shkencave, Institutit të Historisë, Tiranë, 1979, fq. 39; S. Pulaha, *Programi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për krijimin e provincës autonome të Shqipërisë (qershor-nëntor 1878)*, po aty, fq. 166, 169; A. Puto, *Lidhja Shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të kombit të vet në vitet e Krizës Lindore*, në *Konferenca*,... vëll. 1, fq. 53 - 55; Th. Murzaku, *Traktati i Shën Stefanit dhe rrjedhimet e zbatimit të tij për Shqipërinë*, po aty, fq. 108; K. Krisafi, *Çështja Shqiptare në Kongresin e Berlinit dhe në forumet e tjera të diplomacisë së Fuqive të Mëdha*, në *Studime Historike*, 1-2/1998, fq. 159; etj.

të zgjedhur nga përfaqësuesit e fuqive evropiane... Ky shtet, ashtu si çdo shtet tjetër, që do të dalë nga gërmadhat e Perandorisë Osmane, të vihet nën mbrojtjen e Fuqive të Mëdha, (kursivi i autorit) me qëllim, që, në hapat e tij të parë të mund të gjejë tek ato këshilla miqësore dhe bujare, një udhëheqje të sigurt për të çarë rrugët e përparimit në kushte të reja, mbrojtjen dhe mbështetjen e tyre të përbashkët (kursivi i autorit) dhe pa interes për të mos pësuar gjë nga rreziqet dhe nga intrigat që mund të dëmtonin ekzistencën e tij...”³²

Megjithatë, të vetdijshtëm për ekzistencën e ajzbergëve politikë në skenën evropiane, që e rrezikonin vazhdimisht të ardhmen e tyre politike, nuk e përjashtonin *à priori* alternativën e krijimit *in extremis* të një shteti që mund të përfshihej në ndonjë konfederatë, federatë, union real ose personal. Këto ide u hodhën edhe në negociatat e zhvilluara nga Abdyl Frashëri me përfaqësuesit e shtetit grek gjatë viteve 1877-1878, të cilat u përmendën më lart.

Abdyl Frashëri, udhëheqës i shquar dhe ideolog eminent i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, duke folur për të ardhmen politike të Shqipërisë, shkruante: “Do të vijë dita kur *Europa do të bindet se shqiptarët i shërbejnë çështjes së njerëzimit dhe të qytetërimit më mirë se çdo popull tjetër i Lindjes...* (kursivi i autorit). Shqipëria meriton pavarësinë më tepër se asnjë kombësi tjetër e Ballkanit dhe ne shpresojmë se ajo do ta tregojë veten më të denjë për të gëzuar respektin e Evropës dhe më të aftë për të qeverisur vetveten”.³³ Ai iu përgjigjej në mënyrë të tërthortë edhe atyre që i padisnin shqiptarët si bashkëpunëtorë dhe kontribues të mbajtjes në këmbë të ngrehinës perandorake osmane. Abdyli arsyetonte se nuk duheshin ngatërruar qëndrime taktike të çastit me synimet strategjike dhe theksonte se “... populli shqiptar është i vetmi komb që ka zhvilluar prej

³² *Përkujtesa e qytetarëve shkodranë*, dërguar Kryeministrit anglez, Lordit Bikonfild, përfaqësues i Anglisë në Kongresin e Berlinit, me kërkesën për tërësinë territoriale dhe pavarësinë e Shqipërisë, në *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, vep.cit. f. 27-28

³³ Prof. Dr. Alfred Frashëri, *Shqipëria që të përparojë*, Gazeta DITA, 11 Korrik, 2013.

kohësh një rezistencë energjike kundër pushtuesve turq. Kjo rezistencë heroike ka vazhduar deri në ditët tona. Nëse shqiptarët, për hir të karakterit të tyre krenar e luftarak, nuk e kanë lënë veten të nënshtrohen aq ultësisht..., janë ata që e kanë ndjerë më tepër peshën e zgjedhës së huaj dhe janë ata që kanë vuajtur më shumë si pasojë e kryengritjeve të pandërprera që kanë qenë të detyruar të zhvillonin për të fituar pavarësinë e tyre... Si rrjedhim, *Shqipëria meriton pavarësinë më tepër se çdo kombësi tjetër e Ballkanit* (kursivi i autorit)....”³⁴

Suzereniteti i Fuqive të Mëdha ndaj shqiptarëve dhe neutraliteti i garantuar prej tyre

Edhe pse flitet për shtet të pavarur shqiptar³⁵, ideja e asaj kohe duket se kufizohej më shumë te krijimi i një shteti vasal, por jo nën suzerenitetin e Sulltanit, sepse ai konsiderohej i rrezikshëm dhe i padëshirueshëm. Në eventualitetin e pranimit të opsionit të autonomisë, për t’iu shmangur me elegancë imponimit të suzerenitetit turk, drejtuesit shqiptarë preferuan dhe propozuan varësinë e përbashkët nga fuqitë perëndimore. Suzereniteti i përbashkët i Fuqive të Mëdha mendohej se do të ishte një lloj *condominiumi sui generis*, asnjans, i parrezikshëm. Referimi që bëhej te shembulli i Bullgarisë

³⁴ Po aty.

³⁵ Është me interes dëshmia që vjen nga një shkrim i Arthur Evans, i cituar në librin *Nacionalizmi, Pavarësia dhe Lidhja Shqiptare*. Ai thotë se: “Këshilli i kombit shqiptar, mbledhur në Prizren ka vendosur për të hedhur jashtë çdo gjurmë të autoritetit të sulltanit në të gjithë Shqipërinë, në kuptimin më të gjerë, mbështetur në patriotizmin shqiptar... për herë të parë u bë e njohur se Këshilli kishte dekretuar atë që mendojnë të bëhet deri në shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë... Qytetet e Vilajetit të Kosovës, e Novi-Bazarit dhe gjithë Shqipërisë së Mesme u bashkuan në mënyrë unanime në një kërkesë për një Qeveri me shtetas të bashkuar të “Shqipërisë e Madhe”, nën drejtimin e një Valiu Skipëtar. Ajo është nga kufijtë e Bosnjës me ato të Maqedonisë dhe për ta sundimi i Osmanëve është shuar zyrtarisht”, - Sir Arthur Evans, *Nacionalizmi, Pavarësia dhe Lidhja Shqiptare* me redaktimin e studiuesit Bejtullah Destanit, Londër 2011, (*Albanian Letters: Nationalism, Independence and the Albanian League* – Arthur J. Evans, 2017, përgatitur nga Bejtullah Destani dhe Jason Tomes).

dhe i Kretës, për të cilat ishte propozuar organizimi në një formë të tillë vasaliteti, flet në dobi të kësaj teze.³⁶ Ai do të ishte i vlefshëm për një periudhë kalimtare. E vlerësuar nga pikëpamja juridiko-ndërkombëtare ky organizim shtetëror nuk mund të ishte veçse vasalitet, formë tipike e varësisë juridiko-ndërkombëtare, e aplikuar në jo pak raste në hapësirat perandorake osmane. Ajo nënkuptonte ekzistencën e një shteti vasal me organizim të brendshëm të vetin, por të varur dhe të kushtëzuar nga suzereni. Teorikisht, suzereni, në këtë rast *condominiumi* i përbashkët i fuqive, duhet të kufizohej në përcaktimin e drejtimeve kryesore në fushat e politikës së jashtme, të mbrojtjes e të financave të Shqipërisë.³⁷ Nëse kjo skemë do të pranohej dhe do të vihej në funksionim në të ardhmen, kishte shumë gjasa që Shqipëria të organizohej juridikisht në trajta shtetërore të mirëfillta.

Suzereniteti i Fuqive të Mëdha mendohej jo vetëm si një formë organizimi në interes të Shqipërisë, por edhe si një koncension që ajo iu akordonte “të mëdhenjve” për të qenë të pranishëm në trojet shqiptare, të cilat kishin rëndësi të posaçme gjeostrategjike në rajonin adriatiko-ballkanik dhe në përgjithësi në Europën Juglindore. Në këtë optikë do të ishin të mirëpritura ndikimet me karakter politik, investimet ekonomike për shfrytëzimin e pasurive natyrore të trojeve shqiptare ose edhe forma të tjera influence. Por fillimisht ato duhet ta pranonin Shqipërinë si shtet vasal në familjen e shteteve.

Rilindësit shqiptarë ishin të ndërgjegjshëm për rreziqet që iu kanoseshin tokave shqiptare nga lakmitë e fqinjëve, sepse strategjitë aneksioniste të fqinjëve, sikurse edhe imperializmi i fuqive, ishin qartësisht të lexueshme. Me kërkesën për *condominiumin* e Fuqive, në njëfarë mënyre “luhej” me politikën apo diplomacinë e “dyerve të

³⁶ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë 1978, f. 26.

³⁷ Charles Rousseau, *Droit International Public, Tome II*, Editons Syrey, 1974, f. 121.

hapura”, politikë aq shumë e preferuar në ato kohë prej tyre ndaj vendeve të tjera, veçanërisht ndaj kolonive. Abdyl Frashërin intuira politiko-diplomatike e tërhiqte drejt një politike të hapur, zbutëse, atraktive.

Paralel vinte edhe propozimi për konstituimin e Shqipërisë si shtet me neutralitet të përhershëm, të njohur dhe të garantuar nga Fuqitë e Mëdha.³⁸ Zgjedhja e LKSH-së u shfaq si alternativë origjinale dhe bëhet e qartë jo vetëm nga përmbajtja e pikave IV-VII, por edhe nga një referencë tjetër e drejtpërdrejtë e *Përkujtesës*, në të cilin thuhet shprehimisht: “Ashtu si *garancia evropiane* (kursivi i autorit) është quajtur e nevojshme për të mbrojtur principatat danubiane, *Zvicrën dhe Belgjikën*, po kështu është e nevojshme që një përkrahje e tillë t’u jepet shteteve të reja që do të lindin në bazë të marrëveshjes së Berlinit.”³⁹

Zvicra dhe Belgjika e asaj kohe gëzonin statusin e neutralitetit jo vetëm të shpallur e të njohur, por edhe të garantuar nga Fuqitë e Mëdha, çka lë të kuptohet se kërkesa e përfaqësuesve të LKSH-së identifikohet me kërkesën e të njëjtit status edhe për Shqipërinë.

Nëpërmjet statusit të tyre juridiko-ndërkombëtar neutral Belgjika dhe posaçërisht Zvicra iu ishin shmangur luftrave që zhvilloheshin kohë pas kohe përreth dhe u kishin shpëtuar tentativave për cenimin e territorit. Nën shembullin e tyre, Shqipëria, e paorganizuar siç duhet, e pakonsoliduar dhe tepër e brishtë, e lakmuar haptas nga fqinjët, do ta kishte shumë të vështirë të përballej me rreziqet. Pozita e neutralitetit, një zgjidhje e gjetur me kujdes, e përshtatshme dhe në dobi të saj, mund të shërbente si mburojë zyrtare. Ajo mund të ishte edhe një taktikë ose strategji për t’u pranuar nga të mëdhenjtë. Në hapat e parë shtetformues, Shqipëria mund ta siguronte më mirë ekzistencën e vet brenda hapësirave të të drejtës natyrore të

³⁸ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë 1978, f. 27.

³⁹ Po aty.

popujve dhe kombeve për liri, duke qenë nën proteksionin e Fuqive të Mëdha. Nga ana tjetër statusi i neutralitetit do të ishte njëlloj garancie edhe për vetë Fuqitë, sepse shqiptarët në këtë mënyrë ofronin siguri se nuk do të shkaktonin probleme dhe ngatërresa për ato vetë dhe për fqinjët.

Shqipëria neutrale, e vendosur nën suzerenitetin dhe njëkohësisht nën garancinë e Fuqive të Mëdha, do të realizonte edhe objektivin themelor të LKSH - ruajtjen e integritetit territorial dhe konsolidimit të një entiteti etnik në të gjitha trevat shqipfolëse, çka shtrohej si imperativ kategorik.

Në situatat që zhvilloheshin në atë kohë në rajon, Shqipërisë i duhej të vepronte sa më shpejt e sa më parë për të mbrojtur të drejtat e saj. Përndryshe si pjesë e shtetit osman, në përfundim të luftimeve që ai zhvillonte me të tjerët, ajo mund të përballej me pasoja të pamerituara. Mund të përdorej si pjesë e transaksioneve që zakonisht ndërmerren në këto raste. E drejta ndërkombëtare e kohës përmbante ende parimin e prevalencës së të drejtës së ngadhënjyesit në luftë, pavarësisht nga faji. Fajtor prezumohej i munduri. Në Ballkan, si në çdo hapësirë tjetër të kontinentit dhe të rruzullit, lufta ishte mjeti i zakonshëm për zgjidhjen e konflikteve. Kjo u vërtetua nga ngjarjet që përshkuan zhvillimet politike në këtë gadishull problematik. Psikoza e politikës ballkanase ishte sulmi nëpërmjet të cilit synohej zaptimi me luftë dhe vendosja në territorin e tjetërkujt. Ajo mbeti e tillë, shumë e fortë në mentalitetin politik dhe diplomacinë e mëvonshme të shteteve të Ballkanit.

Alternativa e neutralitetit, që erdhi si zgjedhje origjinale e vetë lëvizjes shqiptare, nuk gjeti zbatim. Kongresi i Berlinit e shpërfilli kërkesën themelore të shqiptarëve ndryshimin e statusit të trojeve të tyre, nga një provincë e zakonshme e Perandorisë, në një entitet që do të shfaqej në skenën botërore si gjithë të tjerët. Kur shqiptarët krijuan LSHP-në, Fuqitë mbajtën shënim çka po ndodhte, por nuk ndërmorrën

asnjë hap për njohjen e saj as *de facto* dhe as *de jure* dhe natyrisht nuk shtruan as çështjen e njohjes së pozitës së saj neutrale.

Neutraliteti do të preferohej edhe rreth 35 vjet më vonë, por kësaj here si vendim i Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, e cila në nenin 3 të vendimit të 29 korrikut 1913 njohu pavarësinë e Shqipërisë dhe i dha statusin e një shteti me neutralitet të njohur, të përhershëm dhe të garantuar nga 6 Fuqitë e Mëdha.⁴⁰

Shqipëria - element ekuilibri politik në rajon

Grupi i përfaqësuesve nga Shkodra, për të sensibilizuar një vëmendje të posaçme te Bikonsfildi dhe në përgjithësi te diplomacia europiane e kohës, theksonte se krijimi i një Shqipërie të lirë kërkohej për të përmbushur një aspiratë të ligjshme të shqiptarëve, por edhe “për të formuar murin kundrejt dyndjes sllave për mbrojtjen e Perëndimit të Evropës”.⁴¹ Në vijim të kësaj ideje nënvizohej se “Shqipëria e pavarur përveç se një mburojë kundër sllavizmit, do të ishte edhe një element ekuilibri politik e tregtar, sepse do të ndalonte epërsinë ekskluzive të çdo fuqie tjetër dhe do t’ua mbante të gjithëve hapur rrugën e Lindjes...”⁴²

Hartuesit e saj parashtronin edhe disa nga drejtimet kryesore të aleancave dhe partneriteteve politike të shtetit të ardhshëm shqiptar. Në këtë optikë vihej në dukje se Shqipëria nuk mund t’i bashkohej Greqisë për shkak të ndryshimeve të thella kombëtare, gjuhësore, zakonore dhe kulturore. Megjithatë, edhe pse kishin rezerva ndaj

⁴⁰ Sipas A.Puto, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit*, Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik, Vëll.II, (1912-1918), Tiranë,1987.

⁴¹ Memorandum dërguar Kryeministrit anglez, Lordit Bikonsfild, përfaqësues i Anglisë në Kongresin e Berlinit, me kërkesën për tërësinë territoriale dhe pavarësinë e Shqipërisë, në *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, vep.cit. f.27.

⁴² Po aty, f.25.

synimeve të saj aneksioniste, tregoheshin prudentë dhe realistë për nevojën e bashkëpunimit me Athinën dhe arsyetonin se "fuqia jonë mbrojtëse mund të dyfyshej nga një konfederatë dhe nga aleanca e natyrshme me Greqinë".⁴³ Lihej kështu e hapur rruga e bashkëpunimit institucional midis dy vendeve, në përputhje me standardet juridiko-ndërkombëtarë, sipas qëndrimit të mbajtur nga Abdyl Frashëri në negociatat e zhvilluara disa muaj më parë me përfaqësuesit e shtetit grek.

Italia konsiderohej fuqi mike dhe nuk i atribuohet asnjë ambicjeje ekspansioniste adriatiko-ballkanike. Ajo përmendet vetëm për "qëllimet e saj bujare", në zbatim të të cilave kufizohej të përhapte "parimin e kombësisë me shembullin dhe me masën që duhej".⁴⁴

Fqinji tjetër Mali i Zi akuzohej për synimet antishqiptare. Kjo ka të bëjë me sa duket me faktin se, siç thuhet edhe në *Përkujtesë*, politika dhe diplomacia ruse, nëpërmjet Traktatit të Shën Stefanit, kërkonin ta zmadhonin së tepërmi Malin e Zi duke e shtrirë deri në qendër të Shqipërisë, që të bëhej "një post i avancuar i Rusisë dhe një kryeurë për aneksione më të gjera", për të sunduar në Shqipëri dhe në Adriatik.⁴⁵ Lihej mënjatë Serbia, e cila nuk ishte më pak e rrezikshme dhe lakmitare ndaj territoreve shqiptare në Kosovë e gjetkë.

Këto mendime, koncepte e qëndrime me karakter strategjik janë befasuese jo vetëm për qartësinë dhe thellësinë e arsyetimeve politike, por edhe për saktësinë e formulimeve juridike. Ato shkojnë në të njëjtën linjë mendimi dhe fokusohen në gjetjen e mënyrave më të shpejta dhe më efikase për shkëputjen e Shqipërisë nga Perandoria Osmane.

Kundërshtimin e vendimeve të forumeve ndërkombëtare që sanksiononin copëtimin e trojeve shqiptare LKSH e kishte nisur

⁴³ *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë 1978, f. 25.

⁴⁴ Po aty, f. 22.

⁴⁵ Po aty, f. 22-24.

shumë kohë përpara formimit të LSHP-së. Përfaqësues të saj në kohën e zhvillimeve të Traktatit të Shën Stefanit, më 30 mars të vitit 1878, i drejtoheshin Anglisë, nëpërmjet një memorandumit. I formuluar gjithë urtësi ky dokument përfaqësonte një ndërhyrje energjike për të parandaluar rreziqet iminente e reale që i kanoseshin ekzistencës së kombit shqiptar. Në të thuhet ndër të tjera:

„... një çështje e re do të dalë në shesh nga këto komplikime të grumbulluara - çështja ... e Shqipërisë (...) Në qoftë se Evropa do ta miratojë vetëvendosjen e sllavëve në shtete të pavarura apo autonome, është e qartë se shqiptarët nuk mund t'i lejojnë vetvetes, me kënaqësi, një administrim aq të kalbur dhe të keq, siç ishte ai nën të cilin ishin deri sot. Ata janë të bindur (...) se qeveria osmane s'do dhe as që ka mundësi t'u japë atyre (shqiptarëve) një gjë (administrim) më të mirë (...). Shqiptarët, të cilët janë të vendosur t'i këputin zinxhirët që i kanë lidhur me Perandorinë Osmane, kërkojnë një qeveri të ndarë, e cila do të jetë më shumë në harmoni me kërkesat dhe traditat e tyre; ata kërkojnë të drejtën për të hyrë në gjirin e familjes së madhe evropiane, të cilës i përkasin për kah raca dhe farefisnia (..).”⁴⁶

Kërkesa e mësipërme do të përsëritej sërish nëpërmjet një tjetër peticioni të datës 28 prill 1878.⁴⁷ Ai mbështetej në idetë themelore të memorandumit që iu dërgua diplomatëve të qeverive të Fuqive të Mëdha të Evropës dhe qeverisë osmane pak ditë para ose pas datës 20 prill 1878. Hartuesit e tij, liderët e LKSH-së, kërkonin që në Kongresin e Berlinit të shqyrtohej edhe *çështja shqiptare* dhe të mos lejohej copëtimi i tokave shqiptare në interes të Serbisë, Malit të Zi, Bullgarisë dhe Greqisë. Qeverisë osmane i thuhej haptas që, nëse ajo nuk ishte në gjendje t'i mbronte nga agresioni i shteteve ballkanike, të paktën të mos i pengonte të organizoheshin për t'i mbrojtur vetë trojet e tyre etnike. Në të kundërtën, ata deklararin se do të kalonin në

⁴⁶ Public Record Office, London, F. O. 78/2784; 2 F. O. 78/2784; Accounts and Papers (38). LXXXIII. 83, 298-301. s F. O. 424/69; Cit. sipas Skënder Rizaj Lidhja Shqiptare e Prizrenit sipas dokumenteve angleze.

⁴⁷ Po aty.

rezistencë të armatosur për ruajtjen e tërësisë territoriale dhe sigurisë kombëtare. Në një njoftim, që konsulli britanik në Shkodër, Kirby Green i drejtonte Salisbërit më 11 nëntor të vitit 1878, i raportonte për bisedën që kishte pasur ato ditë “me disa nga anëtarët kryesorë të Lidhjes Shqiptare”. Ata i kishin pohuar se Lidhja “kishte vendosur të përballojë çdo sulm, që mund të vinte nga elementët e shumtë armiqësorë, të cilët e rrethojnë vendin e tyre - Shqipërinë”.⁴⁸ Vihet re vendosmëria e drejtuesve të Lidhjes që të mbrojnë atdheun, që, në tërësinë e vet njihej e thirrej nga gjithkush me emrin Shqipëri. Vihet re në vijim gjithashtu një pohim që flet për qartësinë, urtësinë, civilizimin dhe largpamësinë e tyre për të ardhmen e vendit. Ata i thanë konsullit britanik se “Lidhja nuk ka qëllim të luftojë as kundër Malit të Zi dhe as kundër Austrisë, Serbisë, Bullgarisë, Rosisë ose Greqisë, por dëshiron të njoftojë botën se Shqipëria është, në njëfarë mënyrë, tokë me trashëgimtarë dhe se Sulltani nuk mund të nxjerrë në treg asnjë pëllëmbë të saj pa marrë pëlqimin e trashëgimtarëve të vet legjitimë - të shqiptarëve”.⁴⁹

Riafirmimi i vendosmërisë për mbrojtjen e trojeve shqiptare

Një akt tjetër me rëndësi të posaçme është edhe një memorandum i firmosur nga Abdyl Frashëri, që iu nisej Fuqive të Mëdha nga Janina. Ai ekspozon gjerësisht platformën shtetformuese të LSHP-së dhe konceptet e drejtuesve të saj për afirmimin e *Çështjes shqiptare*, sigurimin e njohjes ndërkombëtare dhe mbështetjes nga ana e faktorit ndërkombëtar, për pozicionin dhe rolin e shqiptarëve në

⁴⁸ Public Record Office, London, F.O. 195/1186; The British Museum, London, *Account and Papers* (38). 1878-1879. LXXIX 79, 538-539. Citohet nga *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet angleze (1878-1881)*, Përgatitur nga Skënder Riza, Prishtinë, 1978, f.105.

⁴⁹ Po aty.

Ballkan e në kontinent, për raportet e tyre me fqinjët etj.⁵⁰ Atdheu ynë i trojeve shqiptare – përkatësisht Shqipëria, thuhej në të, është një pjesë e madhe e Ballkanit, mirëpo, politikanët, të cilët merren me çështje politike kinse nuk janë të informuar për këto gjëra. Ata orvaten të ndajnë Rumelinë - pjesën kontinentale të Evropës Osmane, në mes të sllavëve dhe grekëve, ndërsa ne shqiptarëve dëshirojnë të na konsiderojnë sikur nuk ekzistojmë fare në këtë pjesë të Ballkanit...⁵¹ Përsëritej se territoret shqiptare përfshinin një pjesë të madhe të bregdetit Adriatik, prej Dalmacisë dhe Bosnjës, kufijve të Malit të Zi dhe Serbisë Lindore deri në Vranjë, pastaj në jug në gjirin e Artës, në kufirin me Greqinë. Aty banonin më tepër se dy milion banorë, nga të cilët dy të tretat i takojnë besimit islam, kurse një e treta janë të krishterë, gjysma e tyre me besim katolik dhe gjysma me besim ortodoks. Nuk harrohej të theksohej se shqiptarët janë një trup, një gjak, s'ka dallim mes tyre, përveç aspektit fetar, i cili nuk bën përçarje kombëtare... Populli shqiptar nuk ka pasur asnjëherë në të kaluarën pretendime që të pushtonte territoret e huaja, por gjithmonë ka luftuar për të mbrojtur trojet e veta dhe lirinë e tij. Ai u bë shembull dhe rrëfyes për pasardhësit e vet për t'iu bërë ballë fuqive të huaja...⁵²

Memorandumi ishte në të vërtetë një abstrakt i historisë së Shqipërisë, prej gjenezës, lashtësisë iliro-shqiptare, që trajtonte gjuhën shqipe, traditat, të drejtën zakonore etj. në funksion të dallimeve kombëtare dhe specifikave etnopsikologjike me popujt e tjerë. Është për këtë arsye pse atë e kanë krahasuar me veprën *E vërteta mbi Shqipërinë dhe Shqiptarët*⁵³ të Pashko Vasës. Abdyl Frashëri jo pa qëllim i thurte himne dhe e vlerësonte maksimalisht vetëdijen kombëtare shqiptare, duke shkruar se “populli shqiptar gjithnjë ka luftuar për ta mbrojtur lirinë e vet, prandaj u bë shembull edhe për

⁵⁰ Iljaz Rexha,- *Memorandumi i Abdyl Frashërit kundër vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit*, botuar në revistën “URA”, nr. 2, Pranverë-Verë, Tiranë 2009, organ i “Qendrës Shqiptare për Studime Orientale”.

⁵¹ Po aty.

⁵² Po aty.

⁵³ Po aty.

pasardhësit e tij për t'u bërë ballë fuqive të huaja dhe armiqve të jashtëm”.⁵⁴

Dega e Toskërisë e LSHP-së, e ndodhur nën tryshninë e rrezikut të aneksimit grek të viseve jugore, i kishte përcjellë nga Preveza më 28 shkurt 1879 Salisbërit dhe Fuqive të tjera të Mëdha, një petition në të cilin flet gjatë për situatat që po kalonte vendi, për përpjekjet që po bëheshin për shpëtimin nga copëtimi, për kërkesat për ndihmë etj. Aty thuhej ndër të tjera se “Ngjarjet e fundit dhe rreziku i zhdukjes së kombësisë sonë e përforcoi dashurinë për atdheun aq shumë sa te të gjithë njerëzit e zakonshëm në malet tona zgjoi idetë e përparimit dhe të qytetërimit, të cilat një popull i dëshiron për ruajtjen e ekzistencën e së tij, dëshirë kjo që nuk mund t'i mohohet. Populli shqiptar, duke qenë i vetdijshëm në të drejtën e arsyes së vet, tani i drejtohet ndërgjegjes evropiane dhe i lutet principeve të mëdha të kombësive, të cilat vetë Greqisë ia sigurojnë ekzistencën, për t'i shtyrë burrat e shtetit, të cilët kanë në duart e veta fatin e botës që të mos lejojnë asgjësimin e racës shqiptare.”⁵⁵ Më 22 mars 1879, drejtuesit rajonalë të Lidhjes, nëpërmjet Vesel Beut, i dorëzuan zëvendëskonsullit britanik në Prevezë C. Blakeney një tjetër petition drejtuar Salisbërit.⁵⁶

Në të nënvizohej se shqiptarët – muslimanët dhe të krishterët – mendojnë se është më e drejtë që, përpara se të armatosen për mbrojtjen e vendit të vet, t'iu tregojnë Portës dhe kabinetëve të Evropës arsyet e ndryshme, të cilat, sipas mendimit të tyre, e bëjnë të pazbatueshme dëshirën e treguar nga Fuqitë në Protokollin 13 të

⁵⁴ Abdyl Frashëri, Yanyadan mektub, “Basiret” gazetesit, 21 prill 1878, nr. 122, Beledije Kütüphanesi, Istanbul, Citohej sipas Iljaz Rexha, vep.cit.

⁵⁵ Public Record Office, London, F.O. 78/1879; The British Museum, London, *Account and Papers* (36). 1878-1879. LXXVII 77, 345-348. Citohej nga *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet angleze (1878-1881)*, përgatitur nga Skënder Riza, Prishtinë, 1978, f.113.

⁵⁶ Public Record Office, London, F.O. 78/2936; The British Museum, London, *Account and Papers* (36). 1878-1879. LXXVII 77, 387-392. Citohej nga *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet angleze (1878-1881)*, përgatitur nga Skënder Riza, Prishtinë, 1978, f.250-255.

Traktatit të Berlinit, përse i përket Epirit. Përfaqësuesit e Lidhjes mundoheshin të ngjallnin te Salisbëri ndjenjat e dhënies së drejtësisë për një popull me merita dhe vlera historike. Sakrifikimi i vendit të tyre do t'i shtynte, sikurse shprehen, drejt “rezistencës më të dëshpërueshme të shënuar nga historia në këtë shekull.” Memorandumi evokonte figurat kombëtare dhe historike: Pirron, Skënderbeun dhe Ali Pashë Tepelenën, të cilat tregonin se si në kohërat e lashta, si në mesjetë ashtu edhe në kohët moderne, populli shqiptar ka qenë gjithmonë krenar për kombësinë e vet dhe kurrë nuk kishte pasur lidhje të njëgjakësisë me grekët.⁵⁷ Ai ndalej në një element spekulativ, i përdorur deri në abuzim ekstrem nga grekët, te çështja e përdorimit të gjuhës greke nga banorët e disa trojeve shqiptare. Vihej në dukje se “nuk është e mjaftueshme që t'i jepet Greqisë titulli i pronarit të këtyre territoreve, sepse nëse pranohet vetëm ky kriter, gati e tërë harta e Evropës do të duhej të ndryshohej.”⁵⁸ Kërkesa e aneksimit të trojeve shqiptare nga ana e Greqisë shihet “si krimi më i urryer dhe më i padrejtë që është bërë në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Feja u shkel me këmbë, paqja e vendit në çdo mënyrë u cenua, helenizmi u imponua me çdo mjet të mundshëm, duke mos i përfillur as edhe ndjenjat më të shenjta dhe më me sedër, sepse fanatizmi ortodoks është sajuar në një sistem të qeverisë për t'i zhdukur të gjitha gjurmët e kombësisë shqiptare; me një fjalë, të tilla janë principet e shpallura me të cilat Greqia donte të qytetëronte popullin. Ndërkaq, kundër këtij krimi është rezistenca ndaj pushtetit të helenizimit, sepse në këtë mënyrë do të mbrohet nga çdo fatkeqësi emri i Shqipërisë së panjollësuar.”⁵⁹

Në vijim autorët e memorandumit hyjnë në thelbin e çështjes dhe përpiqen t'i shpjegojnë dhe t'i argumentojnë shefit të Forin Ofisit padrejtësinë që ishte sanksionuar në Protokollin 13 të Kongresit të Berlinit. Në territoret që janë caktuar për t'iu dorëzuar Greqisë, thonë

⁵⁷ Po aty.

⁵⁸ Po aty.

⁵⁹ Po aty.

ata, ishte përfshirë i tërë bregdeti nga burimi i Kalamas gjer në Prevezë, ku elementi shqiptar përbën shumicën, veçanërisht në kufirin e Epirit. Ky bregdet përfshin tokën më pjellore në tërë Shqipërinë, si dhe portet më të mira, si ata të Murtosit, Pargës, Prevezës dhe të Sallahorës në gjirin e Artës. Dorëzimi i tyre Greqisë do të krijonte probleme serioze të natyrës strategjike, tregtare dhe bujqësore jo vetëm për zonën përkatëse, por për gjithë Shqipërinë, sepse ajo do të mbetet pa kufij strategjikë.⁶⁰

Lidhja Shqiptare e Prizrenit do t'i drejtohej sërish Fuqive më 9 korrik 1879 të atij viti, tashmë nga Stambolli, duke protestuar kundër pretendimeve greke ndaj Shqipërisë së Jugut. Me këtë rast u përsëritej Fuqive të Mëdha se shumëherë të tjera më parë, nga anë të ndryshme të Shqipërisë u ishin përcjellë telegrame, parashtresa, memorandume dhe letra, me synimin që “të njihen të drejtat tona kundër lakmisë së fqinjëve dhe për të bërë që të respektojnë tërësinë e atdheut tonë e të shqyrtojnë nevojat tona, që kështu të na jepet një ligj organik i përshtatshëm për karakterin e popullit tone”.⁶¹

Kur vendimet e Fuqive të Mëdha për copëtimin e Shqipërisë u qartësuan, organet drejtuese të Lëvizjes Kombëtare u përfshinë në veprimtari intensive për kundërshtimin e institucionalizuar të vendimeve të Berlinit, për t'i bërë të qartë Evropës se Shqipëria ndjehej e tëra bashkë, një vend e një popull i veçantë nga grekët, serbët e malazeztë, që dëshironte dhe meritonte të kishte shtetin e vet.

Kjo shprehej publikisht në protestat që popullsia e krahinave të ndryshme i drejtoi Kongresit të Berlinit dhe kancelarive europiane. “Ashtu sikurse nuk jemi dhe nuk duam të jemi turq, po ashtu do të luftojmë me të gjitha forcat tona kundër cilitdo që do të kërkonte të na

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ Sipas Gazmend Shpuza, *Programi politik i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare*, në “*Studime historike*”, nr.1-2/2007, f. 63.

bënte sllavë, austriakë ose grekë”, thuhej, ndër të tjera, në *Përkujtesën* e lartpërmendur të qytetarëve shkodranë.⁶²

LSHP - paradigmë e shtetformimit të shtetit modern shqiptar

Një çështje veçanërisht interesante është ajo që ka të bëjë me vlerësimin e LSHP-së nga pikëpamja juridiko-konstitucionale dhe juridiko-ndërkombëtare. Çështja shtrohet nëse ishte ajo shtet në kuptimin e mirëfilltë të fjalës apo jo. Disa studiues shqiptarë hezitojnë të shprehen, të tjerë flasin me terma të rrumbullakosur. Për këtë dilemë gjendet një përgjigje nga konstitucionalisti i shquar, prof. Luan Omari. Ai thotë se duhet pasur parasysh që shteti si organizatë politike nënkupton një tërësi organesh pushteti me një unitet të brendshëm në kuadrin e një sistemi politik të caktuar. Krijimi i qeverisë ose i një organi të njëvlefshëm me të, jashtë sistemit tërësor të organeve shtetërore, nuk shënon ende krijimin e shtetit, sado që është një hap shumë i rëndësishëm në këtë rrugë. Shteti ekziston kur, të paktën në vija të përgjithshme, është përcaktuar ndërtimi i sistemit të organeve shtetërore, ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore. Për një gjë të tillë s’mund të bëhet fjalë në rastin e Lidhjes së Prizrenit. Komitetet e Lidhjes, duke përfshirë edhe Komitetin drejtues që u shndërrua në Qeveri të përkohshme, nuk përbënin ende një shtet. Ato mbetën gjymtyra të një organizmi politik që nuk arriti të konstituohet si shtet, sepse u shtyp me forcën e armëve.⁶³

Pa e kundërshtuar në thelb prof. Omarin, mendoj se Lidhja ishte një paradigmë e shtetformimit, hyrje dhe realitet fillestar i shtetit embrional modern shqiptar, që u krijua dhe ekzistoi në fakt, edhe pse

⁶² *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë 1978, f. 26.

⁶³ Luan Omari, - *Mbi problemin e autonomisë dhe të qeverisë së përkohshme në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881, I*, Tiranë, 1979, f. 137.

pa pëlqimin e Sulltanit dhe pa njohjen e faktorit ndërkombëtar. Kur flitet për tiparet e shtetit të LSHP-së, nuk mund të operohet në mënyrë shabllone me skemat tipike klasike. Duhet mbajtur parasysh se rilindësit shqiptarë, të frymëzuar nga detyra sublime e krijimit të shtetit shqiptar, vepruan për ta ngritur atë mbi rrënojat e Perandorisë Osmane, duke përballuar gjithashtu kthetrat gllabëruese të fqinjëve, që donin ta zhduknin Shqipërinë madje edhe si toponim. Ata kapërcyen edhe problemet “brenda vetes”, të krijuara nga fraksione që nuk vepronin në interes të shqiptarëve, por të të tjerëve dhe gjetën alternativat më të përshtatshme. Siç u tha më sipër, fillimisht hodhën idenë dhe punuan për krijimin e një Shqipërie autonome nën suzerenitetin e Sulltanit, të cilën, në varësi të zhvillimeve e modifikuan më pas në kërkesën për një Shqipëri nën *condominium* e Fuqive të Mëdha, për të kaluar në forumin e Gjirokastrës të shteti autonom shqiptar. Ecuria e shpejtë e procesit të shtetformimit të ndërmarrë nga LSHP tregon evoluimin dhe konkretizimin e idesë shtetformuese të drejtuesve të saj kryesorë. Menjëherë pas themelimit ajo formoi organet e veta qendrore e vendore për mbrojtjen e tërësisë territoriale të atdheut dhe për realizimin e aspiratave vetëqeverisëse të shqiptarëve. Lidhja mori përsipër dhe realizoi në praktikë në mënyrë të qartë dhe konkrete prerogativa të rëndësishme në fushën administrative dhe atë gjyqësore.

Në konstalacionin politiko-organizativ të Lidhjes, në etapa të caktuara të zhvillimit të saj, u shfaqën kryetari i shtetit, parlamenti me emërtimin Këshilli i Përgjithshëm, qeveria e thirrur në fillim Komiteti Qendror i Lidhjes dhe i përbërë nga tri komisione⁶⁴, e quajtur më pas edhe Kuvëri e Përdorme. Lidhja krijoi gjithashtu sistemin gjyqësor të veçantë, paralel ose në zëvendësim të atij osman, emëroi prokurorin e përgjithshëm, kryetarin e gjykatës së lartë, krijoi ushtrinë e cila mund të thërriste nën armë deri në 190 mijë shqiptarë nga të gjitha

⁶⁴ Komisionet e punëve të jashtme, punëve të brendshme dhe të ardhurave financiare të kryesuar përkatësisht nga Abdyl Frashëri, Haxhi Shabani dhe Sulejman Vokshi janë konsideruar edhe si ministritë e Lidhjes.

trojet, përgatiti legjislacionin etj. Të gjitha këto zhvillime dhe realitete, të vlerësuara nga një optikë pozitive, mund të çojnë në konkluzionin se Lidhja Shqiptare e Prizrenit ishte shteti i parë modern shqiptar, së paku në një tentativë të përkohshme që zgjati dy-tre vjet.

Në shkurt 1881, sipas burimeve angleze, Lidhja Shqiptare e Prizrenit njoftonte Shkodrën se ishte e detyruar të formonte *shtetin autonom shqiptar*. Kuvendi i Gjirokastrës, 23 korrik 1880, e shpalli institucionalisht formimin e tij, duke e shndërruar Lidhjen në qeveri të përkohshme. Pavarësia e Shqipërisë pritej si një ndodhi e pandalshme edhe nga faktori ndërkombëtar. Në majin e vitit 1880, gazeta ruse *Novoje Vremja* shkruante se “Lidhja përgatitet haptas për krijimin e Shqipërisë së pavarur.”⁶⁵

Për afirmimin e çështjes shqiptare vend të posaçëm zinte sigurimi i njohjes dhe i mbështetjes nga faktori ndërkombëtar. Megjithë përpjekjet energjike, vështruar nën prizmin e së drejtës ndërkombëtare, Lidhja nuk i përmbushi të gjitha kushtet për të qenë palë më vete në marrëdhëniet e jashtme. Asaj nuk iu akordua njohja *de facto* apo *de jure* qoftë edhe një nga format e ndërmjetme që t’i mundësonte hyrjen në disa marrëdhënie zyrtare me pjesëtarët e tjerë të bashkësisë ndërkombëtare. Duke iu referuar teorisë deklarative të njohjes ndërkombëtare, nisur nga prirja për ta parë LSHP-në maksimalisht në prizmin pozitiv, mund ta cilësojmë subjekt të së drejtës ndërkombëtare edhe pse me një ekzistencë të përkohshme. Njohja shërbente si mjet i preferuar në arsenalin diplomatik të Fuqive për të inkurajuar zhvillime në interes të tyre ose për të bllokuar ndryshime të papëlqyera të *status quo*-s politike e juridike që mund të çonin në prishje të “ekuilibrit të forcave”. Prandaj mbetën pa vijim demarshet e Lidhjes për vendosjen e marrëdhënieve zyrtare me Fuqitë e Mëdha. Diplomacia evropiane që nuk e njihte as formalisht

⁶⁵ Sipas I.G.Senkieviç, *Albania v period Vostochnovo krizisa*, Moskva, 1965, f. 146, Cit. nga Shukri Rahimi, - *Rritja e rrymës autonomiste në gjirin e Lidhjes së Prizrenit*, në “*Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881*, Vol. I, Tiranë, 1979, f. 228.

ekzistencën e një *çështjeje shqiptare* nuk mund të njihte në çfarëdolloj forme vetë Lidhjen si bartëse dhe shprehëse e saj zyrtare.

Stambolli e shtypi me egërsi LSHP-në, duke vrarë, burgosur dhe internuar udhëheqësit e saj.⁶⁶ Por Kuverta e Përdorme mbeti në histori si qeveria e parë shqiptare e kohës së Rilindjes, ndoshta edhe e gjithë periudhës pas epokës së Skënderbeut, nëse lëmë jashtë gjykimit organizimet e pashallëqeve të mëdha të Shkodrës e të Janinës.

Lidhja e Prizrenit ishte një organizatë politike-ushtarake, e cila në evolucionin e vet arriti të fitonte dhe të manifestonte attribute qeverisëse dhe të ushtronte funksione pushteti. Ajo tregoi se shoqëria shqiptare e asaj kohe kishte arritur një nivel pjekurie politike e sociale të krahasueshëm me atë të fqinjëve të vet. Ishte kristalizuar dhe ishte prezantuar në skenën ndërkombëtare si strukturë institucionale e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, e organizuar dhe e pajisur me program dhe mendim politik për ta udhëhequr popullin e vet drejt krijimit të shtetit të mirëfilltë shqiptar. Edhe pse në kushte jashtëzakonisht të vështira për shkak të qëndrimeve antishqiptare të fqinjëve, të Portës së Lartë dhe Fuqive të Mëdha, programi politik i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit u përmbush në shkallë të gjerë. Ajo mundi të realizonte bashkimin politik e ushtarak të popullit shqiptar dhe e udhëhoqi atë në luftë për unitetin dhe integritetin territorial të vendit. Lidhja mbetet një përvojë pozitive që demonstroi aftësitë organizative, politike e shtetformuese të shqiptareve dhe shërbeu për të përgënjeshtuar opinionin fiktiv të krijuar qëllimisht nga qarqe antishqiptare që i vinte ato në pikëpyetje.

LSHP është konsideruar si revolucioni i parë nacional i epokës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare.⁶⁷ Ajo ishte ngjarja më e madhe dhe

⁶⁶ F.O. 195/ 1367; S. Kulçe, *Osmanli Tarihinde Arnavutluk*, Izmir, 1944, 267. Sipas S.Rizaj, vep.cit, f.216.

⁶⁷ Ligor Mile, në *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë 1978, f. 239.

më përfaqësuese në rrugën e zhvillimit të LKSH-së, ishte paradigma e shtetformimit dhe realiteti fillestar i shtetit embrional modern shqiptar. Ishte prova e aftësive shtetformuese të shqiptarëve, e dëshirës dhe e vendosmërisë për të jetuar më vete në shtetin e tyre, të cilat u përpoqën t'i vinin në zbatim në vitet 1878-1881, kur strukturat shtetërore që ndërtuan shërbyen si precedent për përpjekjet e mëvonshme. Ajo tregoi se Lidhja Kombëtare Shqiptare zhvillohej sipas një platforme strategjike përgjithësisht të qartë. Shqipëria “e lirë dhe e mosvarme”, të cilën Ismail Qemali ua prezantoi Fuqive të Mëdha, Portës së Lartë dhe fqinjëve më 28 dhe 29 nëntor 1912, ishte ngritur duke pasur parasysh “shtetin e Lidhjes”, konceptet, organet, institucionet, legjislacionin dhe arritjet e tij pozitive.

Bibliografi

- Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë 1978.
- Buda, Aleks, *Lidhja e Prizrenit dhe rrënjët e saj historike*, në *Konferenca Kombëtare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881*, vëll. 1, botim i Akademisë së Shkencave, Institutit të Historisë, Tiranë, 1979.
- Buda, Aleks, *Shkrime historike*, 2, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë, 1986.
- Charles - Louis de Secondat, Baron de La Brède et de Montesquieu,- *De l'esprit des lois*, 1748.
- De Rada, G. *Poesie albanesi, Scanderbeccu i pafaan, Storie del secolo XV*, libro IV, vol. V, Napoli 1877.
- Evans, Arthur, *Nacionalizmi, Pavarësia dhe Lidhja Shqiptare* me redaktimin e studiuesit Bejtullah Destanit, Londër 2011, (*Albanian Letters: Nationalism, Independence and the Albanian League* – Arthur J. Evans, 2017, përgatitur nga Bejtullah Destani dhe Jason Tomes).
- Frashëri, Abdyl, - Yanyadan mektub, “Basiret” gazetesi, 21 prill 1878, nr. 122, Beledije Kütüphanesi, Istanbul, (Cituar nga Rizaj, Skënder, - *Lidhja Shqiptare e Prizrenit sipas dokumenteve angleze, (1878-1881)*, - Prishtinë, 1978).
- Frashëri, Alfred, *Shqipëria që të përparojë*, në gazeta “DITA”, 11 korrik, 2013.
- Frashëri, Kristo, *Trashëgimi dhe perspektiva shqiptare*, në “*Kombi*”- *Rrugët e bashkimit kombëtar*, New York, 1997.
- Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit, 1878-1881*, botimet “Toena”, 1997.
- Frashëri, Sami, *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhetë*, ed. 2013, “DIJA”.
- Istoria diplomatii, V.II*, Moskva, 1945.
- Kastrati, Jup, *Mbi rolin e arbëreshëve të Italisë në periudhën e Lidhjes Shqiptare*, në *Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881, (12-28 qershor 1978)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë 1979.

Kofos, E. - *Greek reaction to developments leading to the Albanian League of Prizren*, në *Balkan Studies*, vol. 23, nr. 2 Thessaloniki 1982).

“Kombi”, *Rrugët e bashkimit kombëtar*, New York, 1997.

Konferenca Kombëtare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881, vëll. 1, Botim i Akademisë së Shkencave, Institutit të Historisë, Tiranë, 1979.

Krisafi, K., *Çështja shqiptare në Kongresin e Berlinit dhe në forumet e tjera të diplomacisë së Fuqive të Mëdha*, në *Studime historike*, 1-2/ 1998.

La Guerra d'Oriente in Europa ed in Asia, 1877-1879. Cronaca illustrata dalla Conferenza di Costantinopoli fino al Trattato di Berlino, Milano, Treves, 4 (1877).

Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet angleze, 2, (Arkivi i Kosovës), përgatitur nga Skënder Rizaj, Prishtinë, 1978.

Locke, John, *Two treatises on government*, 1690.

Mile, Ligor, *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, 1878-1912*, Botim i Institutit të Historisë të Akademisë së Shkencave, përgatitur nga Stefanaq Pollo dhe Selami Pulaha, Tiranë 1978, f. 239.

Mile, Ligor K. *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dokumente arkivash franceze*, botuar nga Akademia e Shkencave, V.1: 1876-1879 Tiranë, 1978. V.2: 1880-1881 Tiranë 1986.

Murzaku, Th., *Traktati i Shën Stefanit dhe rrjedhimet e zbatimit të tij për Shqipërinë*, në *Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881, I*, Tiranë, 1979

Omari, Luan, *Mbi problemin e autonomisë dhe të qeverisë së përkohshme në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, në *Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881, I*, Tiranë, 1979.

Petrotta, G.- *Popolo, lingua e letteratura Albanese*, Palermo, 1931, *Përkujtesa e qytetarëve shkodranë dërguar Kryeministrit anglez, Lordit Bikonstild*, në *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912*.

Pollo, S., *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe lufta e saj për çlirimin dhe bashkimin kombëtar*, në *Konferenca Kombëtare për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881*, vëll. 1, botim i Akademisë së Shkencave, Institutit të Historisë, Tiranë, 1979.

- Pulaha, S., *Programi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për krijimin e provincës autonome të Shqipërisë (qershor-nëntor 1878)*.
- Puto, Arben, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik, vëll. I, (1867-1912), Tiranë 1984.*
- Puto, Arben, - *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit, përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik, vëll. II, (1912-1918), Tiranë, 1987.*
- Puto, Arben, *Lidhja Shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të kombit të vet në vitet e Krizës Lindore, - në Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881, I, Tiranë, 1979.*
- Rexha, Iljaz, *Memorandumi i Abdyl Frashërit kundër vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit*, botuar në revistën “URA”, nr. 2, pranverë-verë, Tiranë 2009, organ i “Qendrës Shqiptare për Studime Orientale”.
- Rizaj, Skënder, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit sipas dokumenteve angleze (1878-1881)*, Prishtinë, 1978.
- Rousseau, Charles, *Droit International Public, Tome II*, Editons Syrey, 1974.
- Senkieviç, Irina, G. *Albania v period Vostochnovo krizisa*, Moskva, 1965. (Cituar nga Shukri Rahimi, *Rritja e rrymës autonomiste në gjirin e Lidhjes së Prizrenit, në “Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881, vëll. I, Tiranë, 1979)*.
- Shpuza, Gazmend – *Programi politik i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në “Studime historike”, nr.1-2/2007.*
- ZEKA, Izmi, *Abdyl Frashëri, arkitekt i platformës politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, (<https://facebook.com>, 28 february 2013, si edhe www.bksh.al, botuar, 2007, V,55- nr. 211, 7 gusht, 2007).
- Die Debatte*, Gazetë austriake e 19 shkurtit 1869, nr. 50, viti VI, F.O. 195/ 1367; S. Kulçe, *Osmanli Tarihinde Arnavutluk*, Izmir, 1944, 267. Cituar nga S. Rizaj...).
- Public Record Office, London...; The British Museum, London, *Accounts and Papers...*, (Cituar nga Rizaj, Skënder, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit sipas dokumenteve angleze (1878-1881)*, Prishtinë, 1978).

Albana VELIANJ
Shaban SINANI

EPOKA E LIDHJES: NGA HISTORIA NË LETËRSI - RASTI I LAHUTËS SË MALCÌS

Përmbledhje

Përveç rëndësisë politike, si ngjarje që krijoi epokë, duke i dhënë për herë të parë karakter panshqiptar e të programuar mendimit dhe përpjekjeve kombëtare, Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka një rol kthese historike që asnjë ngjarje e mëparshme nuk ia kishte mundur historisë së letërsisë shqipe.

Qysh prej fillimeve të saj si letërsi humaniste, në të njëjtën udhë me letërsinë heroike të Rilindjes Europiane e deri në fundin e shekullit XX letërsia shqipe nuk arriti të bashkohej me kohën, t'i afrohej bashkëkohësisë.

Deri në themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit zor se mund të gjenden shenja që të dëshmojnë se letërsia shqipe po provonte të kthente kryet nga koha e vet dhe të ndahej nga moti i madh, ku kishte mbetur e gozhduar dhe e kryqëzuar.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit arriti t'i ofrojë letërsisë një mundësi tjetër për të shkuar tek lexuesi si letërsi kombëtare. Në këtë kuptim Lidhja është për historinë e letërsisë shqipe një kufi ndarës midis dy kohëve, madje mund të quhet i vetmi kufi ndarës i kohëve të saj gjatë disa shekujve me radhë. Sido që të periudhizohet e kurdo që të periudhizohet, për historinë e letërsisë shqipe Lidhja Shqiptare e Prizrenit do të jetë një limitus prius quam non, një ngjarje referenciale para së cilës letërsia shqipe nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimin sinkronik. Shpërngulja e vëmendjes së saj prej qendresës së arbërve në shekullin XV te kuvendi historik i Prizrenit dhe qerthulli i ngjarjeve të lidhura me të është meritë themelore e kësaj ngjarjeje.

Çdo vlerësim që është bërë për poemën Lahuta e Malcis, për mitet shqiptare të pranishme në epet e saj, për rolin motivues atdhetar dhe për shumë cilësi të tjera ka vendin e vet. Por merita më e madhe e kësaj poeme dhe e autorit të saj, të cilit për përfundimin e saj iu deshën plot 25 vjet, është pikërisht se u dëshmoi shqiptarëve se tashmë kishin në historinë e tyre edhe një ngjarje të dytë, përveç qendresës së epokës së Skënderbeut, me të cilën mund të identifikoheshin dhe kjo ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Dhe kështu, kjo poemë vuri kufirin e fillimit të një letërsie që jetonte me bashkëkohësinë.

Lahuta e Malcis mund të quhet pothuajse në tërësinë e vet poema e Lidhjes. Me Lahutën e Malcis Atë Gjergj Fishta e historizoi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit para se të ishte historizuar në tekste shkencore. Historizimi i ngjarjeve sinkronike është ndryshimi më i madh që solli kjo vepër në traditën letrare shqiptare.

Roli i Lahutës së Malcis si një poemë që emancipoi letërsinë shqipe duke ia ndërruar kohën do të errësohej nëse historiciteti do të kërkohej me prova, duke gjetur dëshmi gojore ose arkivore. Historiciteti ka të bëjë me thelbin, jo me detajet. Duke qenë një poemë që u shkrua për mision, në variantin e botuar vit pas viti nëpër të përkohshme gjatë periudhës 1905-1930 Atë Gjergj Fishta mban shumë shpresa tek Austria dhe nuk ngurron ta shfaqë simpatinë ndaj perandorisë biqefale. Por kur e ribotoi të plotë veprën e tij simpatia e Fishtës mërgoi prej andej për shkak të zhgënjimeve dhe u orientua nga Roma, ku rilidhi shpresat e tij për ndryshimin për së mbari të zhvillimit në vendin e tij. Kemi të bëjmë në këtë rast me dy histori simpatie brenda një vepre, por këto histori janë me interes për studime krahasuese tekstore jo për të provuar se si Lahuta e Malcis e ktheu Lidhjen Shqiptare të Prizrenit nga epope historike në epope letrare.

Fjalët çelës: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Rilindja Europiane, Lahuta e Malcis, At Gjergj Fishta*

I

Përveç rëndësisë politike, si ngjarje që krijoi epokë, duke u dhënë për herë të parë karakter panshqiptar dhe të programuar

mendimit dhe përpjekjeve kombëtare, Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka një *rol kthese historike* që asnjë ngjarje e mëparshme nuk ia kishte mundur historisë së letërsisë shqipe.

Qysh prej fillimeve të saj si *letërsi humaniste*, në të njëjtën udhë me letërsinë heroike të Rilindjes Europiane, deri në fundin e shekullit XX, letërsia shqipe *nuk arriti të bashkohej me kohën*, t'i afrohej bashkëkohësisë, të sinkronizohej me të tashmen. Ajo lindi dhe mbeti për mbi katër shekuj letërsi e shekullit të lavdisë së *Arbërit mesjetar*, letërsi e *Motit të madh* tek arbëreshët, letërsi e mitit të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut. Që nga Barleti deri te Bogdani; që nga Jeronim de Rada deri te Naimi, letërsia shqipe nuk pati tentuar ndonjëherë të ndahej nga epoka e lavdisë mesjetare e qendresës së parë antiosmane. Tradita gojore kishte tentuar të kalonte prej legjendaritetit në histori me ciklin e betejës së Fushë-Kosovës dhe kishte ndjekur të njëjtën rrugë si letërsia.

Nuk mund t'i mbetet gjithë përgjegjësia letërsisë shqipe për këtë dukuri të *mbetjes me kokën prapa*. Gjatë afro katër shekujve vetë historia e shqiptarëve nuk kishte prodhuar ndonjë ngjarje madhore për të larguar vëmendjen e saj nga e shkuara dhe për t'i ofruar një tjetër zhvillim përbashkues. Vetëm një tronditje e madhe historike, një kthesë e vërtetë në fatin e popullit mund ta sillte ndryshimin.

Kryengritja e dytë panballkanike në krye të së cilës ishte arkipeshkvi shqiptar Pjetër Bogdani, që shpërtheu pikërisht në 300-vjetorin e betejës së Fushë-Kosovës (1689), duke përfutur edhe prej dobësimit të perandorisë për shkak të luftës austro-turke, megjithëse ngjarje e rëndësishme parësore, nuk la gjurmë në letrat shqipe, madje as në shkrimet e vetë Bogdanit. Dinastët Qyprillinj, reformatorë të mëdhenj të perandorisë, komandantë ushtarakë dhe grand-vezirë të shquar, ndonëse me origjinë shqiptare, gjurmën e lanë në eposin e boshnjakëve. Me të drejtë shkrimtari I. Kadare në romanin e tij *Nëpunësi i pallatit të ëndrrave* rapsodët e ftuar në oborrin e Kurt Qyprilliut i paraqet si guslarë bosnjakë. Një shekull më vonë këngët

popullore për Ali pashë Tepelenën dhe ato për bushatllinj të mbetën cikle të mbyllura. Këto kanë qenë *këngë shpate* dhe jo *këngë shqiptarie*. Në ato pak këngë që u janë kushtuar bëmave e gjëmave të Ali pashë Tepelenës ka dhe të tilla që bëjnë fjalë për *gegë e dibranë* që luftojnë kundër toskëve.

Deri në themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit zor se mund të gjenden shenja që të dëshmojnë se letërsia shqipe *po provonte të kthente kryet nga koha e vet* dhe të ndahej nga *Moti i madh*, ku kishte mbetur e gozhduar dhe e kryqëzuar. Shekujt po kalonin dhe kjo e shkuar po bëhej gjithnjë e më e largët kronologjikisht. Poetët romantikë shqiptarë nuk kishin zgjidhje tjetër. Është e mirënjohur se *midis letërsisë dhe zhvillimit historik ka një kushtëzim relativ*. Shkrimtarëve romantikë, si atyre të *degës perëndimore* me De Radën në krye dhe atyre të *degës lindore* me Naimin kryesues, historia shqiptare nuk u kishte bërë ndonjë ofertë as frymëzuese, as tronditëse për të ndërruar zgjedhjen epokale. Prej Skënderbeut deri në kohën kur ata shkruan poemat e mëdha epike dhe epiko-lirike nuk kishin arritur të gjenin asgjë tjetër më të denjë për t'ua kushtuar artin e tyre.

Lidhja Shqiptare e Prizrenit arriti t'i ofrojë letërsisë një mundësi tjetër, *një alternativë* për të shkuar tek lexuesi si letërsi kombëtare. Në këtë kuptim, Lidhja është për historinë e letërsisë shqipe një *kufi ndarës* midis dy kohëve, madje mund të quhet *i vetmi kufi ndarës i kohëve të saj* gjatë disa shekujve me radhë.

Sido që të periudhizohet e kurdo që të riperiudhizohet, për historinë e letërsisë shqipe Lidhja Shqiptare e Prizrenit do të jetë një *limitus prius quam non*, një *kufi para të cilit nuk mund të ketë*, një ngjarje referenciale para së cilës *letërsia shqipe nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë me zhvillimin sinkronik*. Shpërngulja e vëmendjes së saj prej qendresës së arbërve në shekullin XV te Kuvendi historik i Prizrenit dhe qerthulli i ngjarjeve të lidhura me të është meritë themelore e kësaj ngjarjeje.

Duke iu referuar rolit që luajti Lidhja Shqiptare e Prizrenit për t'i krijuar letërsisë shqipe një stacion të ri kronologjik, mund të pohohet se deri në fundin e shekullit XIX ajo *u ka shkuar pas ngjarjeve të historisë*. Madje edhe kur rifilloi të jetojë me të tashmen, sërish mbeti për një kohë të gjatë një *letërsi aposteriorike*.

II

Kënga e parë e *Lahutës së Malcës* e Atë Gjergj Fishtës, e para *poemë-epope* që madhështoi dhe monumentalizoi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, me titullin *Te ura e Rzhanicës*, u botua në vitin 1905, më shumë se një çerek shekulli pasi Lidhja e kishte kryer misionin e vet dhe tashmë shqiptarët kishin provuar të ngriheshin në kryengritje të përgjithshme. Ishte Faik Konica ai që ia mundësoi Fishtës botimin.

Shumë është shkruar për *Lahutën e Malcës* në gjysmën e parë të shekullit XX; më pas edhe në revistën *Shêjzat* dhe në tribuna të tjera të mendimit letrar shqiptar në Perëndim, si *Buletini Katolik Shqiptar* (që botohej në vitet 1970-1980 në San Francisco, SHBA). Albanologu i mirënjohur gjerman Maximillian Lambertz, megjithëse një njohës i shkëlqyer i epikës heroike legjendare shqiptare, i këngëve të kreshnikëve, të cilave u kushtoi një studim monografik të plotë, *Lahutën e Malcës* e quante *eposi i madh i shqiptarëve*, duke e konsideruar eposin heroik të trashëguar nga kohë të mjegullta të fillimit të mijëvjeçarit të dytë të mesjetës si *epopenë e vogël* të tyre. Ndërsa E. Çabej e quante *Lahutën e Malcës në një farë kuptimi epos ballkanik*.

Çdo vlerësim që është bërë për këtë poemë, në tri periudha receptimi: për mitet shqiptare e ato religjioze të pranishme në epet e saj, për rolin motivues atdhetar dhe për shumë cilësi të tjera ka vendin e vet. Por merita më e madhe e kësaj poeme dhe e autorit të vet, të cilit, për përfundimin e saj, iu deshën plot 25 vjet, është pikërisht se u dëshmoi shqiptarëve se tashmë kishin në historinë e tyre edhe një

ngjarje të dytë, përveç qëndresës së epokës së Skënderbeut, me të cilën mund të identifikoheshin dhe kjo ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Dhe kështu, kjo poemë vuri kufirin e fillimit të një letërsie që jetonte me bashkëkohësinë.

Lahuta e Malcìs, pavarësisht shtresave e nënshtresave klasike (jo rastësisht Fishta zgjodhi të shënjojte në incipit të epit të vet vargun e Horacit: *Tyrtaeus - que - mares animos ad martiabella Verbus exacuit / Tirteu, me vargjet e tij, i përflaku zemrat e guximshme kah lufta e Marsitj*), mitologjike dhe fetare, mund të quhet pothuajse në tërësinë e vet poema e Lidhjes. Në këtë kuptim, përcaktimet që i janë bërë asaj si *nji koleksion kangësh lahute* (Àtë Danjel Gjeçaj), për më tepër pohimet se *në të, endë i rí, Fishta nisi të këndojë si mâ i miri rapsod i maleve ... trimnitë e kombit, herojtë e tij dhe luftat që këta banorë të Jutbinës shqiptare zhvilluen* (Àtë Danjel Gjeçaj), duhen marrë më shumë si shprehje entuziazmi dhe figurshmërie. Me poemën e tij Àtë Gjergj Fishta nuk krijoi *heronj kulturorë*, si *30 agt e Jutbinës* në eposin heroik, por *heronj historikë*, të identifikuar qartë në kohë e në hapësirë, të gjithë rreth e qark një strumbullari - Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Në poemën e Àtë Gjergj Fishtës nuk ka *Jutbinë dhe kreshnikë*, sikundër është pohuar ndonjëherë; nuk ka *patria poesis*, por protagonistë të vërtetë të historisë, të një historie që po zhvillohej në sytë e atyre që i dëgjonin këngët e *Lahutës së Malcìs*. Zgjedhja e *tetërrokëshit*, vargut popullor të këngëve historike, jo e *dhjetërrokëshit* të njohur të këngëve legjendare; *prozodia*, *izoritmia*, *izometria*, *monostrofizmi*; prania e miteve të trashëguara në traditën veriore dhe karakteri rrëfimtar shpjegohen me qëllimin e autorit për të kërkuar receptim të shpejtë prej lexuesit, ose më saktë prej dëgjuesit, sepse *Lahuta e Malcìs* është një poemë e shkruar për t'u shijuar para së gjithash me dëgjim. Mjafton të përmendim faktin që disa pjesë të poemës, më të hershmet, u botuan në Zarë të Arbëneshëve, prej nga nuk kishte thujse kurrfarë mundësie për të ardhur te lexuesi thujse

analfabet në Shqipëri si tekst për t'u lexuar. Poema u shkrua për t'u shijuar si rapsodi, sepse koha nuk priste derisa të kultivohej *lexuesi i shkolluar*; për më tepër derisa të kapërcehej gjendja kaotike e *multialfabetizmit* për të cilin autori kishte ironizuar me këto vargje:

Për çdo kaçubë na bijnë nga një letrar,

Qi, ethun trûsh me prralla e me gazeta,

Përfton mâ n'fund e pjell një Abecedár.

Me sa duket, edhe Ernest Koliqi e kuptoi si dytësor rolin misionar të *Lahutës së Malcís*, si poema që krijoi të dytin mot të madh në histori, epokën e Lidhjes. I entuziazmuar prej vargut epik të poemës dhe prej ngjashmërisë me eposin heroik legjendar, ai do të shkruante plot admirim:

Tue lexue "Lahutën" e Fishtës përplot me teprica kangësh rapsodike të pa-emën, të duket se jë tue veshtrue popullin shqiptar kah i këndon vedvedit, me fjalët e Fishtës, mâ të kulluetën kangë, e cila shpërthen nga një gjak misterioz që rrjedhë në zemër të tij ilire.

Me *Lahutën e Malcís* Atë Gjergj Fishta e historizoi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit madje më parë se kjo ngjarje të ishte historizuar në tekste shkencore. *Historizimi i ngjarjeve sinkronike* është ndryshimi më i madh që solli kjo vepër në traditën letrare shqiptare. Edhe vetë traktati ideologjik i shqiptarëve, vepra e Sami Frashërit *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë*, e botuar në vitin 1898, inkurajimin e shqiptarëve e kërkonte përmes evokimit nostalgjik të lashtësisë pellazge dhe trimërive të Skënderbeut, ose duke propozuar një utopi të shkëlqim të për të ardhmen. E tashmja nuk kishte asgjë krenare.

Para *Lahutës* nuk kishte ndodhur ndonjëherë që protagonistët e këngës të ishin njëherësh edhe pjesë e audiencës së tyre. Këngët historike popullore, të mbushura me trimëri vetjake, me heronj krye më vete, që mbrojnë kullat e kullotat, nderin e familjes dhe të fisit; që marrin gjak dhe bëjnë vetë drejtësi, nuk mund të jetonin në të njëjtën

kohë me protagonistët e tyre. Me heronjtë e *Lahutës së Malcis* ndodh ndryshe. Për herë të parë historia bëhet tani, kënga krijohet e këndohet tani: në të tashmen, në të tashmen e për të tashmen, sipas një përcaktimi të njohur, në një sinkroni të tillë që edhe protagonist i ta dëgjojë vetë atë, madje dhe të pyetet që të jep mendim. Kjo ndodhi sepse Lidhja e Prizrenit krijoi kauzë dhe kauza e shndërruar në vepër letrare i shpërfillte kanonet e mëparshme, duke përfshirë kanonin që kënga historike duhej të ishte *doemos postume*, për pas vdekjes. Po i referohemi një të dhëne që e ka paraqitur Atë Daniel Gjeçaj në parathënen e botimit të *Lahutës*:

E pëvetën me sherrë Marash Ucin, plakun e Traboinit, mbasi ia lexuen kangët e parat të “Lahutës”, që flitshin për të e për shokë të tij luftëtarë - “Te Ura e Rrzhanicës”: “Si të duket, Marash, a janë të vërteta shka ka shkruar Fishta për jù?” E ai, me urtinë e maleve, që kur duen të thonë sentenca lapidare shtojnë “po, na jemi të pa shkollë, more zotni, e s’dijmë mâ gjatë”, përgjegji lakonisht: “Të gjitha janë të vërteta, edhe pse pak të zbukurime”.

Është e vërtetë që në *Lahutën e Malcis* ka edhe zbukurime, siç ndodh në të gjitha letërsitë romantike. Por me thelbin e saj poema-epope e Fishtës i kumtonte - më shumë dëgjuesit se lexuesit - se *po bëhet Shqipëri*, dhe *po bëhet sot*, prej shqiptarëve, prej toskëve e gegëve, prej bashkëkohësve. Poeti që me një fuqi mendimi emancipues e rrotulloi historinë shqiptare jo vetëm në kronologji, në rendin kohor, me një guxim kopernikan - sepse nuk ishte e kollajtë të sfidoje tre shekuj histori letërsie skënderbegocentriste, duke krijuar një traditë të re, një vatërzim të ri - po dhe në tipologjinë e heronjve, do të shprehej përmes *alter egos*, Patër Gjonit, me këto vargje:

Bini toskë, ju n’pikë të vrapit,

Mos t’u ndalin mal as záll:

Naim Frashëri i rá Qitapit

Mos m’e lshue Shqypnin per t’gjáll.

Historiciteti i *Lahutës së Malcís* shumë shpesh ose është nënçmuar, duke krijuar një qendër vëmendjeje më të fuqishme tek mitologjia dhe vlerat tradicionale shqiptare (nderi, besa, burrëria, mikpritja); ose është kuptuar shkëputur prej logjikës së një veprë letrare dhe pavarësisë relative që ajo ka ndaj asaj që ndodh, ndaj ngjarjes edhe kur ngjarja historike është e rendit madhor. Duke qenë e bashkëlidhur në pandashmëri me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, epope e saj, *Lahuta e Malcís* në të njëjtën kohë është një vepër letrare, që e hyjnizon epokën në frymë e në ansambël, jo si një kronikë riprodhuese.

Atë Zef Pllumbi, në parathënien e botimit jubilar të *Lahutës së Malcís*, në 100-vjetorin e botimit të këngës *Te ura e Rzhanicës* evokon një debat të hershëm midis Mehdi bej Frashërit dhe Atë Gjergj Fishtës për paraqitjen e pavërtetë të veprimtarëve të Lidhjes së Prizrenit, si të ishte një bashkim folklorik malsorësh shqiptarë për rasa të jashtëzakonshme, ku kryet e vendit e xen Ali pashë Gucia e fjalimin kryesor e mban Abdyl Frashëri “me kallçikë e me fistan”. Fishta, shton me të drejtë Atë Zef Pllumbi, u përgjegj flakë për flakë në “*Hyllin e Dritës*”, tue spjegue se poemi kishte për qëllim jo me tregue të vertetën siç ish, por të vertetën ideale. Mirëpo vetë Atë Zef Pllumbi më pas merret me arratisjet e mëdha të Fishtës prej historisë, duke filluar me figurën e Oso Kukës, të cilin e konsideron një mercenar shkodran në shërbim të Turqisë; më pas duke e gjetur krejt të gabuar vënien e Ali pashë Gucisë në qendër, pse ky ishte një boshnjak i martuem me një vashë shqiptare; dhe më pas duke shtyrë më tutje jo vetëm Haxhi Zekën, por dhe figurën e Abdyl Frashërit për t’ia lënë vendin Abedin pashë Dinos. Sa lidhje ka “*Lahuta e Malcís*” me realitetin historik? - pyet veten Atë Zef Pllumbi. Dhe përgjigjet: *Pothuej asgja!* Kënga e njohur me titullin *Tringa* nuk është gjë tjetër veçse një krijim në stilin e rapsodive heroike, thotë meshtari dëshmitar i historisë së gjysmës së dytë të shekullit XX: *Kam pyetë e stërpyetë mbi kët episod heroik aq të bukur, por kurr nuk kam marrë përgjegjen*

as po as jo. Ndoshta ndoshta krejt ky cikël është ndërtue nga poeti në ngjasim të legjendës madhshtore të motrës së Gjergj Elez Alisë, për me u tregue shqiptarëve se nderi personal është nderi i fisit e i kombit, shkruan Atë Zef Pllumbi. Edhe për Marash Ucin e Uc Sokolit Atë Zef Pllumbi ka dyshimet e veta, duke saktësuar se ai ishte edhe korrjer i konsullatës austriake në Shkodër për malsorët e Malsisë së Madhe dhe kjo nënkuptohet edhe prej katër vargjeve që gjenden në epin kushtuar trimërive të tij:

Kam kenë n' Shkoder, mbram kam ardhë,

Ke qaj miku faqe-bardhë;

E atij mikut, iu ngjatët jeta!

Thuej t'a qesë një shkrolë n' gazeta.

Roli i *Lahutës së Malcís* si një poemë që emancipoi letërsinë shqipe duke ia ndërruar kohën do të errësohej nëse historiciteti do të kërkohej me prova, duke gjetur dëshmi gojore ose arkivore. Historiciteti ka të bëjë me thelbin, jo me detajet. Duke qenë një poemë që u shkrua për mision, në variantin e botuar vit pas viti nëpër të përkohshme gjatë periudhës 1905-1930 Atë Gjergj Fishta mban shumë shpresa tek Austria dhe nuk ngurron ta shfaqë simpatinë ndaj perandorisë biqefale. Por kur e ribotoi të plotë veprën e tij simpatia e Fishtës mërgoi prej andej për shkak të zhgënjimeve dhe u orientua nga Roma, ku rilidhi shpresat e tij për ndryshimin për së mbari të zhvillimit në vendin e tij. Kemi të bëjmë në këtë rast me dy histori simpatie brenda një vepre, por këto histori janë me interes për studime krahasuese tekstore, jo për të provuar se si *Lahuta e Malcís* e ktheu Lidhjen Shqiptare të Prizrenit nga epope historike në epope letrare. Siç shprehej Eqrem Çabej, Atë Gjergj Fishta zë fill me njësinë e vogël të fisit për të mbaruar te njësia më e madhe e kombit, ia fillon me bariun e moçëm Marash Ucin dhe mbërrin te Abdyl Frashëri në Lidhjen e Prizrenit.

Bibliografi

- Àt Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcìs*, Shkodër, 1937.
- Àt Gjergj Fishta, *Te ura e Rrzhanitsees*, Zadar, 1905.
- Àt Zef Pllumi, *Parathanje e "Lahutës së Malcìs"*, botim jubilar, Shkodër, 2005.
- Benedikt Dema (nën kujdesin e), *Biobibliografia e Àt Gjergj Fishtës*, Tiranë 1943.
- Engjëll Sedaj, *Gjergj Fishta dhe vepra letrare e tij*, në "Hylli i dritës", nr. i posaçëm, Shkodër, 1996.
- Eqrem Çabej, *Elemente të gjuhës e të literaturës shqipe*, Tiranë, 1936.
- Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore*, vëll. V, bot. "Rilindja", Prishtinë, 1975.
- Ernest Koliqi, *Genesi del poema "Il Liuto delle Montagne" di Giorgio Fishta*, edizione universitaria, Roma, s. a.
- Ernest Koliqi, *Fishta interpret i shpirtit shqiptar*, Gjakovë, 1997.
- Fulvio Cordignano, *Epopeja komtare e popullit shqyptar*, Shkodër, 1925.
- Fulvio Cordignano, *Giorgio Fishta e l'epopea nazionale del popolo albanese*, në *Nuova antologia*, Roma, 1943.
- Giuseppe Ferrari, *Giorgio Fishta: Lahuta e Malcìs*, introduzione, Bari, 1973.
- Injac Zamputi, *Fishta - koha, njeriu, vepra*, Tiranë, 1993.
- Maximillian Lambertz, *Die Volksepik der Albaner*, Leipzig, 1958.
- Pal Duka-Gjini (Àt Daniel Gjeçaj), *Jeta dhe vepra e Gjergj Fishtës*, ediz. Asizi, 1992.

INSTRUMENTALIZIMI RUS I KONCEPTIT “SHQIPËRIA E MADHE”

Përmbledhje

“Shqipëria e Madhe” është një ndër instrumentet që ka shfrytëzuar dhe e shfrytëzon politika dhe diplomacia ruse që nga themelimi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për demonizimin e shqiptarëve, pavarësisht se kush ka sunduar dhe sundon në Shën Petërburg a Moskë: carët, diktatorët komunistët apo presidentët e “zgjedhur”.

Në këtë kumtesë bëhen përpjekje për të zbuluar qëllimin e instrumentalizimit të këtij koncepti nga ana e Rusisë. Në thelb ai ka të bëjë me paraqitjen e shqiptarëve si rrënues të paqes, sigurisë dhe stabilitetit në Ballkan dhe më gjerë, të cilët, sipas Moskës, kërkojnë ta realizojnë me dhunë e terror bashkimin e territoreve aktualisht pjesë të Serbisë, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Greqisë, në të ashtuquajturën “Shqipëri të Madhe”. Qëllimi i kësaj propagande keqdashëse është “argumentimi” i domosdoshmërisë së pranisë ruse në rajon si i vetmi faktor i aftë për të përballuar “rrezikun” shqiptar.

Në kumtesë jepen disa sugjerime për institucionet e Kosovës dhe të Shqipërisë lidhur me kundërvënien tonë ndaj luftës informative ruse.

Literatura e shfrytëzuar në pjesën më të madhe të saj është me burime ruse.

Fjalët çelës: *“Shqipëri e Madhe”, instrumentalizim, demonizim, luftë informative, prani ruse.*

Falsifikimi rus i përmbajtjes së çështjes shqiptare

Çështja shqiptare hyri në axhendën e qendrave vendimmarrëse kryesore europiane në çerekun e fundit të shekullit 19-të, si pjesë përbërëse e krizës lindore.

Në kuadër të “koncertit europian” dhe në varësi të interesave specifike si fuqi të mëdha, secila qendër vendimmarrëse e kohës përaktoi qëndrimin e vet ndaj çështjes shqiptare. Midis tyre spikat qëndrimi rus, i cili, pavarësisht se ishte thujtse në të njëjtën linjë me qasjen e Fuqive të tjera të Mëdha për ruajtjen e statuskuosë, në kuptimin që, në të ardhmen e afërt, të mos ndërmerrej ndonjë hap që do të cenonte legjitimitetin e sundimit turk në pjesën më të madhe të atyre që njiheshin si toka shqiptare, kishte edhe dallime thelbësore me to. Qasja ruse, krahasuar me Fuqitë e tjera të Mëdha ishte shumë më radikale. Shën Petërburgu mohonte ekzistencën e kombësisë shqiptare, për pasojë, subjektivitetin politik të shqiptarëve¹. Politika dhe diplomacia cariste jo vetëm i konsideronin ata si turq, por turq rebelë, plaçkitës, anarkistë, dhunues.

Në logjikën e këtij qëndrimi, kur çështja shqiptare u shtrua për zgjidhje në fillim të shekullit 20 Rusia e klasifikoi shtetin e ri që po lindte si “një Turqi e Vogël”, një anomali dhe anakronizëm në Ballkan².

Rreth 120 vjet pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, luftën e UÇK-së dhe të popullit të Kosovës për liri e pavarësi, Moska e trajtoi si shfaqje të konfliktit të qytetërimeve³, një luftë mbi baza fetare, si kundërvënje midis islamizmit dhe krishtëritimit, ndërsa Kosovën e pavarur e klasifikoi si “shtet taleban”.⁴

Në të njëjtën linjë fetare Moska e trajton edhe lëvizjen e shqiptarëve të Maqedonisë, të Luginës së Preshevës dhe të Malit të Zi, për më shumë të drejta njerëzore, kombëtare dhe shoqërore.

Absurditeti i falsifikimit rus arrin deri aty sa ta identifikojë çështjen shqiptare si pjesë të përpjekjeve ekstremiste e fundamentaliste për krijimin e kalifatit islam botëror. Sipas analistit rus A.Venediktov, Presidenti Vladimir Putin ka ngritur shqetësimin e kërcënimit të lindjes së këtij kalifati nga Indonezia deri në Kosovë⁵. Ndërkaq, bashkëpunëtorët e Institutit të Sllavistikës në Moskë, Elena Guskova, Ana Filimonova dhe Peter Iskenderov “zbulojnë” se qëllimi i shqiptarëve është krijimi i kalifatit euraziatik.⁶ Përballë këtyre zhvillimeve apokaliptike, analistja e portalit rus “inosmi.ru”, Nana Jakovenko shtron pyetjen: “A nuk mjafton shteti islam, pa krijuar edhe një të dytë, si “Shqipëria e Madhe”?⁷

Paraqitja e kauzës fetare si kauzë themelore e shqiptarëve dhe injorimi ose mohimi i kauzës së tyre kombëtare përbën një ndër falsifikimet më të rrezikshme të çështjes shqiptare nga ana e Rosisë. Qëllimi i saj kryesor është armiqësimi i botës së krishterë dhe i Perëndimit me shqiptarët.

Kjo nuk e pengon aspak Rusinë që, kur ia do interesi, t’i akuzojë shqiptarët për të kundërtën. Teza e vjetër se “ekstremet puqen” gjen konfirmimin e radhës në qëndrimin rus ndaj çështjes shqiptare. “Luftëtarët shqiptarë të kalifatit islam” në vlerësimin e Moskës janë edhe mbështetës të ideve revolucionare perëndimore të drejtuara kundër statukuosë në Europë, e edhe bashkëpunëtorë dhe servilë të Perëndimit. Konsulli rus në Prizren I.S.Jastrebov e pati quajtur Lidhjen si “Komuna e Prizrenit”⁸ për analogji me komunën e Parisit. Shtetin e ri shqiptar të krijuar me 1912 Shën Petërburgu e pati cilësuar si “kopil të diplomacisë austriake”⁹ dhe kukull të Vjenës. Në vitin 1960 Nikita Hrushovi e pati akuzuar Shqipërinë se “u shit për 30 aspra” tek imperializmi (kupto, tek Perëndimi). Shtetin e ri të Kosovës të shpallur me 2008 Moska e etiketoi si “kukull të Shteteve të Bashkuara të Amerikës” dhe “shtet bandit të krijuar nga NATO”¹⁰. Nuk kanë munguar as etiketime të tjera si “shqiptarët – agjentë të Perëndimit, të Vatikanit”, etj. Me këtë tezë Rusia kërkon të armiqësojë

atë që në literaturën politike të viteve të fundit njihet si “bota joperëndimore” (bota arabe, një numër i vendeve aziatike, afrikane dhe latinoamerikane) me shqiptarët.

Paraqitja e çështjes shqiptare si variabël e interesave të fuqive të huaja, qofshin ato edhe perëndimore dhe jo konstante e interesit kombëtar shqiptar, përbën falsifikimin e dytë të rrezikshëm të kësaj çështjeje nga ana e Moskës.

Falsifikimi i tretë ka të bëjë me metodat e luftës së shqiptarëve për zgjidhjen e çështjes së tyre kombëtare. Sipas pikëpamjes ruse, ata nuk i njohin metodat paqësore të dialogut, të kompromisit dhe të marrëveshjeve dy a shumëpalëshe. Ata njohin veç metodat e luftës së armatosur, të dhunës dhe terrorit. Ndërkohë që heshtet për rezistencën paqësore të shqiptarëve në vitet '90 nën udhëheqjen e Rugovës, lufta e UÇK-së në vitet 1998-1999 klasifikohet si terroriste. Lufta e shqiptarëve të Maqedonisë dhe e atyre të Luginës së Preshevës në vitin 2001 gjithashtu klasifikohen si terroriste. Për Kremlinin, ato ishin pasojë e drejtpërdrejtë e ndikimit të “precedentit Kosovë” dhe pjesëmarrjes së “ekstremistëve të dhunshëm kosovarë” në veprimet luftarake.

Paralajmerimi ogurzi që Moska u dërgon fqinjëve të shqiptarëve, miqve, por edhe kundërshtarëve të tyre është ky: Paqja, siguria dhe stabiliteti në rajon dhe në Europë kërcënohen seriozisht nga lufta e armatosur, dhuna dhe terrori që shqiptarët planifikojnë të ushtrojnë për shkëputjen e territoreve, aktualisht, pjese përbërëse e Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë për t'u bashkuar në “Shqiperinë e Madhe”.

Në bazë të kësaj pikëpamjeje qëndron i ashtuquajtimi determinizëm kulturor. Sipas bashkëpunëtorit të vjetër shkencor të Institutit të Europës pranë Akademisë së Shkencave të Rusisë, Pavel Kandel shqiptarët, ndryshe nga popujt e tjerë ballkanikë, janë ende të etur për luftë¹¹. Këtë etje ata e shuajnë nëpërmjet ekspansionit ndaj fqinjëve, jashtë vendit, si dhe brenda tij nëpërmjet dëbimit me dhunë

të pëfaqësuesve të kombeve të tjera në tokat e tyre. Vetorganizimi shoqëror arkaik, besnikëria ndaj fisit, klanet, “të drejtat zakonore”, etj. favorizojnë mobilizimin etnik të tyre, por shërbejnë edhe si matricë ideale për çdo bashkësi kriminale. Ata, thekson më tej Kandel, jetojnë në një kohë tjetër historike. Edhe kushtet ekonomiko-shoqërore në të cilat jetojnë shqiptarët, sipas tij, bëjnë që protesta e tyre te ketë karakter radikal islamik. Por meqenëse midis tyre ka katolikë dhe ortodoksë, analogjitë me Sicilinë janë më me vend, përfundon analizën e tij eklektike mbi shqiptarët studiuesi Pavel Kandel.¹²

Falsifikimi i radhës i çështjes shqiptare lidhet me vetë termin “Shqipëri e Madhe”, të cilit Moska i referohet pa kufizim në diskursin e vet politik, diplomatik dhe “shkencor”. Lidhja Shqiptare e Prizrenit ka folur për mbrojtjen e tokave shqiptare, por në asnjë rast nuk e ka përdorur termin “Shqipëri e Madhe”. Me 28 nëntor 1912 u shpall Shqipëria e mosvarme dhe me këtë kuptohej përfshirja në shtetin e ri e të gjitha territoreve me shumicë shqiptare. Për etërit themelues të shtetit shqiptar, kjo nuk ishte as nuk mund të ishte “Shqipëri e Madhe”.

Termi “Shqipëri e Madhe” është shfaqur në periudha të mëvonshme, gjatë Luftës së Dytë Botërore, nga propaganda nazifashiste¹³ dhe pas kësaj lufte në Beograd e Moskë, për t’u aktivizuar më me forcë në ditët tona jo nga faktorë shqiptarë¹⁴, por pikërisht nga këto dy kryeqytete, në funksion të interesave të tyre gjeopolitike.

Përpjekjet ruse për modelimin e çështjes shqiptare

Falsifikimi i përmbajtjes dhe metodës për zgjidhjen e çështjes shqiptare ka si qëllim kryesor krijimin e terrenit të favorshëm për formatimin e kësaj çështjeje sipas kritereve dhe standardeve ruse. Këto përpjekje zënë fill që në vitin 1869, kur sulltani Abdyl Mexhiti II nënshkroi fermanin për përfshirjen e territoreve shqiptare në një vilajet

(pa Janinën), por që e shfuqizoi pas presionit të Perandorisë Ruse.¹⁵ Të njëjtin fat pësoi edhe kërkesa e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për krijimin e një vilajeti të tillë. Nga 6 Fuqitë pjesëmarrëse në Komisionin e Rumelisë (1880), 5 prej tyre u shprehën se nuk do të ishin kundër në qoftë se Porta e Lartë do ta quante me vend që t’i bashkonte trevat shqiptare në një vilajet të vetëm. Kundër ishte vetëm Rusia¹⁶. Nga 4 projekte që iu paraqitën Ministrit të Jashtëm Rus, Gorçakovit, në vitin 1877 për rregullimin e Ballkanit, vetëm në njërin prej tyre përmendej Shqipëria¹⁷ jo për ndonjë zgjidhje, siç po veprohej për fqinjët e saj, por për zhvillim reformash, krahas Epirit, Thesalisë dhe Kretës.

Në Konferencën e Londrës (1913) midis projekteve të shumta që u paraqitën për kufijtë e ardhshëm të shtetit shqiptar, ai i Ruisë ishte varianti më restriktiv¹⁸. Përfaqësuesi rus në këtë konferencë, ambasadori Bekendorf paraqiti projektin për krijimin e një “Shqipërie myslimane” në një rrip bregdetar të cunguar.¹⁹

Sa herë që është diskutuar problematika ballkanike deri në fillim të Luftës së Parë Botërore, Rusia është paraqitur me projekte që zmadhonin dhe fuqizonin fqinjët e Shqipërisë: me Projektin për Greqinë e Madhe, në kohen e Ekaterinës II; të Bullgarisë së Madhe me Traktatin e Shën Stefanit²⁰, të Malit të Zi të Madh po me këtë traktat dhe të Serbisë së Madhe gjatë luftërave ballkanike. Ndërkaq, për Shqipërinë të gjitha projektet e saj parashikonin një shtet të gjymtuar, xhuxh, të ndërtuar jo si fqinjët tanë mbi një kompleks kryeresh: etnike, fetare, historike, ekonomike, gjeografike a sigurie, por ekskluzivisht fetare, me synim që në momentin e përshtatshëm edhe kjo krijesë e brishtë të copëtohej në favor të klientelës së saj ballkanike. Kufijtë e sotëm të Shqipërisë, siç dihet, janë pasojë kryesisht e kompromisit midis formatit restriktiv rus dhe atij austro-hungarez.

Ishte fat për shqiptarët që konflikti i Kosovës e gjeti Rusinë pothuaj në komë gjeopolitike. Megjithatë, edhe në atë situatë të rëndë,

ajo arriti që të fiksojë qëndrimin e saj antishqiptar në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit nr.1244, sidomos në pikën që sanksionon Kosovën në përbërje të Jugosllavisë. Sa herë që sot flitet për Kosovën, Rusia i referohet kësaj Rezolute. Për Kremlinin, edhe dialogu Kosovë – Serbi duhet të formatohet në përshtatje me këtë Rezolutë dhe zgjidhja e konfliktit të modelohet po sipas saj.

Rusia nuk e ka pranuar planin Ahtisari dhe e ka kundërshtuar ashpër pavarësinë e Kosovës. E bindur që, megjithatë, nuk ka kthim prapa, Moska po përpiqet të modelojë një zgjidhje tjetër – ndarjen e Kosovës. Skenari i zbatuar në veriun e Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë së saj, është shumë i ngjashëm me atë që Rusia ka zbatuar e po zbaton në ish-hapësirën sovjetike. Shefi i Misionit Rus në OKB, ambasadori i ndjerë Vitali Çurkin, në mbledhjet periodike të Këshillit të Sigurimit për Kosovën kërkonte me këmbëngulje që, “vendimet për Kosovën Veriore të marrin në konsideratë vullnetin e popullsisë serbe”²¹, formulim që në përmbajtje nuk ndryshon nga ai që Rusia përdori në rastin e pushtimit të territoreve gjeorgjiane (Abhazi dhe Oseti e Jugut), si dhe atë të aneksimit të Krimesë. Studiuesi Pavel Kandel shprehet hapur që ndarja e veriut, “fillimisht, nëpërmjet krijimit të faktit në terren, pastaj edhe juridikisht, është kompromisi i vetëm i mundshëm”, mbi bazën e të cilit Serbia të njohë pavarësinë e Kosovës.²²

Tezat e Vuçiçit se nuk është reale që Kosova të marrë gjithçka, Serbia asgjë; se nuk do ta japim atë që kemi; se nuk do të ketë kompromis nëse Serbisë nuk i ofrohet diçka, në këmbim,²³ duket se i referohen skenarit rus të ndarjes së Kosovës.

Sa u takon shqiptarëve të Maqedonisë, Rusia është shprehur kundër koalicionit të Partisë Socialdemokrate me shqiptarët dhe kundër ligjit “Mbi përdorimin e gjuhëve”. Nga ana tjetër, ajo mbështet qëndrimin antikushtetues të Presidentit Ivanov, i cili nuk po e dekreton këtë ligj. Ndihmën e Shqipërisë për faktorin shqiptar në

Maqedoni e konsideron pjesë të projektit të “Shqipërisë së Madhe” që, gjoja, po zbatohet në bazë të “platformës së urryer të Tiranës”.²⁴

Modeli rus i ofruar për shqiptarët e Maqedonisë është ai i një pakice etnike me të drejta shumë të kufizuara për të mos rrezikuar, siç shprehet Moska, themelet e Maqedonisë si shtet.

Luginën e Preshevës Rusia e sheh si bazë të terroristëve që vijnë nga lindja e afërt për në Europë dhe si territor që pretendohet nga Prishtina, në kuadrin e të ashtuquajturës “Kosovë e Madhe”.

Modeli rus i ofruar për Luginën e Preshevës është ai i një territori të pushtuar nga ushtria e policia serbe dhe të vëzhguar me kujdes nga baza ushtarake ruse e Nishit.

Instrumentalizimi i konceptit “Shqipëri e Madhe” dhe interesat ruse në Ballkan

Qëndrimet e Rusisë ndaj çështjes shqiptare formësohen, duke kaluar nëpër tre filtra interesash: interesat e saj në raport me Fuqitë e Mëdha; interesat e veçanta të saj në raport me fqinjët e Shqipërisë; interesat e saj të drejtpërdrejta gjeopolitike dhe gjeoekonomike në Ballkan. Këto të fundit janë përcaktuese. Në varësi të këtyre interesave Rusia përcakton kundërshtarët dhe partnerët e saj strategjikë në rajon.

Përvoja historike dhe realiteti i sotëm dëshmojnë se Rusia, si rregull, nuk i ka parë as nuk i sheh shqiptarët si partnerë të saj në Ballkan. Përkundrazi, për Kremlinin, shqiptarët përfaqësojnë “tjetrin”, “të huajin”, “kundërshtarin”. Ndërsa “tanët” për rusët janë sllavo-ortodoksët.

Mëgjithatë, në shekullin e 20-të, në dy raste, Moska ka shfaqur interes për faktorin shqiptar në Ballkan. I pari ka të bëjë me ndihëm simbolike për Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”²⁵ në fillim të viteve ’20-të, ndërsa i dyti, me “mbështetjen” e Shqipërisë nga

Stalini në konfliktin me Jugosllavinë në fund të viteve të 40-ta. Të dyja këto përjashtime vetëm sa konfirmojnë rregullin: jo miqësia e simpatia për këtë a atë popull ballkanik, por interesat e fuqisë së madhe vënë në lëvizje politikën dhe diplomacinë e Moskës.

Si kundërshtar i sistemit të Versajës, pjellë e së cilës ishte edhe Jugosllavia, Bashkimi Sovjetik mbështeste çdo lëvizje dhe çdo forcë politike që mund t'i kontribuonte shkatërrimit të atij sistemi. Ndihma sovjetike për Komitetin "Mbrotja Kombëtare e Kosovës" nuk del jashtë kësaj kornize, pra është në funksion të interesave gjeopolitike të Moskës. E njëjta logjikë interesash funksionon edhe në rastin e konfliktit me Titon. Me largimin e Jugosllavisë nga blloku sovjetik, e vetmja mundësi që u mbeti Moskës dhe Traktatit të Varshavës për një pikëmbështetje në Adriatik dhe, nëpërmjet tij, në Mesdhe ishte Shqipëria. Ky interes i drejtpërdrejtë gjeostrategjik i Kremilinit në rajon dhe jo "simpatia e thellë për popullin tonë"²⁶ e shtyu Stalinin të afrohej me Shqipërinë. Me krijimin e mundësive të reja, në vitet '60 nëpërmjet shfrytëzimit të porteve siriane dhe egjiptiane, Shqipëria jo vetëm u braktis, por për shkak të mosmarrëveshjeve ideologjike me Moskën iu nënshtrua bllokadës së egër sovjetike.

Pas Luftës së Ftohtë, Rusia rizbuloi, më saktë sajoi konceptin e Shqipërisë së Madhe, si pjesë të luftës informative për realizmin e objektivave të politikës së saj të jashtme në Ballkan.

Duke qenë se kërcënimi nga "Shqipëria e Madhe" është një koncept i fabrikuar nga teknologjia politike ruse, kuptohet që Moska nuk ia ka frikën atij. Ajo e di mirë që aktualisht "Shqipëria e Madhe" nuk ka bazë reale për t'u krijuar. Një popull që për shkak të varfërisë, papunësisë, korrupsionit, krimit të organizuar, etj. në mënyrë masive kërkon të largohet nga trojet e veta në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Luginë të Preshevës dhe Mal të Zi, për t'u bërë diasporë²⁷, vështirë të mobilizohet për realizim "megaprojektsh" shoviniste, siç propagandon Kremlini. "Mobilizimi etnik" i shqiptarëve, për të cilin flasin pseudoshkencëtarët rusë, po bëhet për braktisjen e vendit të tyre. Gjithashtu, pavarësisht akuzave ndaj Edi Ramës dhe Hashim Thacit,

që marrin shkas nga disa deklarata të tyre të pamenduara “pseudopatriotike” për bashkimin e Kosovës me Shqipërinë²⁸, si alternativë ndaj mungesës së perspektivës për integrim në BE, Moska është e vetëdijshme që klasa politike shqiptare, në të dy anët e kufirit, është kundër bashkimit të shqiptarëve. Dihet etja e pashuar për pushtet e sundimtarëve tanë. Një Shqipëri e bashkuar do të thoshte fund i barjaqeve dhe feudeve të pushtetarëve, fund i paradës së qeverive të fryra me shumë ministri, komitete dhe agjenci, me nga 5-6 zëvendëskryeministra dhe mbi 70 zëvendësministra, secila.

Atëherë përse gjithë kjo infozhurmë* ruse për “Shqipërinë e Madhe”?

Së pari, kjo ka të bëjë me rivalitetin në Ballkan midis Rusisë dhe Perëndimit në përgjithësi dhe Rusisë e SHBA, në veçanti. Për Moskën shqiptarët janë kontigjent i amerikanëve dhe vetë projekti i “Shqipërisë së Madhe” është një projekt amerikan. Analisti Konstantin Kaçalin, në një shkrim të tij në portalin “Fondi i kulturës strategjike”, datë 28 shkurt 2018, vë në dukje se drejtori i CIA-s Majk Pompeo dhe Këshilltari i Presidentit për Çështje të Sigurisë Kombëtare Herbert Makmaster janë marrë vesh me udhëheqjen e Kosovës për realizimin e planit për krijimin e “Shqipërisë së Madhe.”²⁹ Ndërsa, Agjencia ruse e lajmeve alternative “Sputnik News” jep alarmin se shqiptarët etnikë në Ballkan mund të grumbullojnë (pa Shqipërinë) 160 mijë vetë për një luftë të re³⁰ dhe se SHBA po e shfrytëzojnë gatishmërinë e tyre për t’u bashkuar në funksion të axhendave politike në rajon.³¹

Këto axhenda, sipas Kremlinit, nëpërkëmbin interesat e serbëve, të maqedonasve dhe të malazezëve.³² Mesazhi i tij për serbët, maqedonasit dhe popujt e tjerë sllavoortodoksë është ky: nëse doni që të mos nëpërkëmbeni, duhet t’i drejtoheni Rusisë për ndihmë dhe të refuzoni bashkëpunimin me amerikanët. Beogradit i kërkohet që të mbajë “të ngrirë” çështjen e Kosovës, duke i premtuar ndihmë reale për realizimin e kësaj strategjie.

**Infozhurmë, nga rusishtja infoshum, që do të thotë zhurmë informative. Termi i shkurtuar në rusisht është ruajtur edhe në shqip për të qenë sa më afër origjinalit.*

“Përmbyllja” e saj, sipas Ana Filimonovës, nxjerr në skenë ekspansionin agresiv shqiptar që kërcënon hapur shkatërrimin e formacioneve shtetërore ekzistuese në Ballkan. Prandaj, porositi Filimonova, nëse doni të frenoni “Shqipërinë e Madhe”, bllokoni Kosovën³³. Kolegia e saj, Elena Guskova pati paralajmëruar para disa kohësh fillimin e pushtimit të vendeve me kulturë ortodokse nga ana e ekstremistëve shqiptarë.³⁴ Ndërkaq, Shkupit i kërkohet të jetë shumë syçelët, sepse “Shqipëria e Madhe” fillon me vdekjen e Maqedonisë së Vogël³⁵. Sipas Moskës, as integrimi europian nuk i shpëton popujt sllavë nga “Shqipëria e Madhe”, sepse ajo do të krijohet në gjirin e BE-së, me ndihmën e vetë vendeve europiane.³⁶

Duke i trembur popujt e Ballkanit me gogolin e “Shqipërisë së Madhe”, Kremli nxit albanofobinë midis tyre dhe, njëkohësisht, vetofrohet si shpëtimtar i vetëm nga “grushti sulmues mysliman”³⁷, me kusht që sllavoortodoksët të jenë të gatshëm për rritjen e pranisë ruse në këtë rajon dhe forcimin e bashkëpunimit me të.

Së dyti, pavarësisht se Ballkani nuk ka ndonjë peshë në totalin e marrëdhënieve ekonomike-tregtare të Rusisë me jashtë, në fushën e transportit të naftës dhe gazit drejt Europës, ky rajon merr rëndësi kritike sidomos pas konfliktit me Ukrainën, të cilën Moska kërkon ta anashkalojë me tubacionet e saj energjitike.

Në projektet ruse për furnizimin me naftë dhe gaz të Europës Jugore dhe Qendrore, vendet ballkanike kanë rol të rëndësishëm tranziti.³⁸ Duke mbrojtur ish-kryeministrin Gruesvki gjatë traizrave që përfshinë Maqedoninë në pranverë të vitit 2015, ministri i Jashtëm i Rusisë Sergei Lavrov akuzoi Perëndimin se po ushtron presion ndaj kryeministrit maqedonas për shkak të mbështjetjes që ai i kishtë dhënë gazsjellësit “Rrjedha e Jugut” dhe shprehu brengosjen e tij që “për minimin e qeverisë Gruesvski po përpiqen të shfrytëzojnë faktorin shqiptar”. Sipas studiuesit Peter Iskenderov, aktualisht po zhvillohet konkurrenca midis Korridorit Jugor të Gazit, ku bën pjesë edhe Tubacioni Transadriatik (TAP) që kalon nëpër Shqipëri dhe furnizohet me gaz nga Azerbajxhani dhe projekteve ruse, si “Rrjedha Turke”.³⁹

Në kuadrin e politikave perëndimore për diversifikimin e furnizimit me gaz e naftë dhe uljen e varësisë nga Rusia për këto produkte, Shqipëria dhe shqiptarët janë rreshtuar në krah të BE-së dhe SHBA-së. Ky është shqetësimi i vërtetë gjeoekonomik i Moskës dhe jo fantazma e “Shqipërisë së Madhe”.

Përfundim

- “Shqipëria e Madhe” është një kërcënim imagjinar, i sajuar nga Rusia, si pjesë e strategjisë propagandistike dhe luftës së saj çinformative.

- Sajimi i këtij kërcënimi nga ana e Moskës ka si qëllim përdorimin e tij si një instrument për shtrirjen e ndikimit dhe forcimin e pranisë ruse në Ballkan, në rivalitet me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, NATO-n dhe BE-në.

- Rusia i konsideron shqiptarët si kundërshtarë të politikave të saj në Ballkan. Me fabrikimin e kërcënimit të “Shqipërisë së Madhe”, ajo synon që t’i neutralizojë ata si faktor në këtë rajon, duke i nxitur fqinjët kundër tyre dhe duke u përpjekur të fusë pyka midis tyre dhe perëndimorëve.

- Politika dhe diplomacia shqiptare, institucionet tona kërkimore-shkencore duhet të marrin masa konkrete, të shumanshme dhe shumënivelshe për t’iu kundërpërgjigjur luftës çinformative të Rusisë, pjesë përbërëse e së cilës është propaganda mbi kërcënimin e “Shqipërisë së Madhe”. Para se gjithash ata duhet të demaskojnë thelbin antishqiptar të sajimit mbi “kërcënimin” shqiptaromadh, por, nga ana tjetër, duhet të bëjnë gjithçka që është e mundur për ruajtjen e pastërtisë së vizionit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për mbrojtjen e tokave shqiptare dhe bashkimin kombëtar.

Bibliografi

- N. D. Smirnova, "Dokumenti AVPR o Prizrenkoy Lige", në "Balkanskiye Narody i Yevropeyskiye Pravitelstva v XVIII- nachalye XX vv", vypusk 8 (Dokumenty i isledovaniya), M. 1982, s. 224-226; K. Frashëri "Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881", Tiranë, 2012, f. 171; F. Rifati, "Traktati i Shën Stefanit dhe reagimet e shqiptarëve", në revistën "Kosova", nr. 35/36, 2011-2012, Prishtinë 2012, f. 161.
- Th. Murzaku, "Politika ballkanike e Rusisë dhe çështja shqiptare", Tiranë 1999, f. 59/60.
- Nikolay Rizhkov, Vyacheslav Tyetyokin, "Yugoslavskaya golgofa", M.2002, S.16
- Yelena Ponomaryova, "Priestupnyj kriminal v tsyentrye Yevropy", M. 2014, s. 23
- A. Venediktov, interv'yu S. Lavrova, Ekho Moskvyy, www.echo.msk.ru, 2.3.2011
- P. Iskenderov, "Kosovo kak faktor bor'by za vsyemirnyj khalifat", www.fondsk.ru, 27.2.2013.
- Nana Yakovenko, "Makedoniya: yeshchyo odin majdan?", www.inosmi.ru, 25.05.2015; Vladimir Rukavishnikov, "Khollodnaya voyna, khollodnyj mir", M. 2005, s. 718.
- N. D. Smirnova, "Dokumenti AVPR o Prizrenkoy Lige", op. Cit.
- Kostë Çekrezi, "Shqipëria, e shkuara dhe e tashmja", Tiranë 2012, f. 115.
- Yelena Ponomaryova, op.cit, s. 16, 176-198.
- Pavel Kandel, "Rossiya i Yugovostochnaya Yevropa: myezhdu istoriyey, ekonomikoy i politikoy", në "Yugovostochnaya Yevropa v epohu kardinal'nykh pyeryemyen", M. 2007, s. 327.
- P. Kandel, "Balkanizatsiya Yevropy vs yevropeizatsii Ballkan", www.globalaffairs.ru, 15.6.2008.
- G. Shpuza, "Si lindi ideja e "Shqipërisë së Madhe", www.gsh.al, 29.4.2018.
- Paskal Milo, "Greater Albania" between fiction and reality", Tiranë, 2001, p. 47.
- Kristo Frashëri, op.cit, f. 127.
- Arben Puto, "Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926", Tiranë, 2010, f. 33-34.
- "Russko-turyetskaya voyna 1877-1878 gg i Ballkany", Ballkanskiye issledovaniya, vyp. 4, Izd. Nauka, M. 1978, s. 33-34.
- Arben Puto, "Rusia rikthehet te tradita cariste", Gazeta Shqiptare, 31.7.2007.
- Nicola Guy, "Lindja e Shqipërisë", Tiranë 2012. f. 66.
- "Russko-turyetskaya voyna 1877-1878 gg i Ballkany", op.cit, s.75.
- "Vystuplyeniye postoyannogo predstavityelya RF pri OON, V.I. Churkina na zasyedanii Sovyeta Byezopasnosti OON po kosovskomu uryegulirovani", www.russian.ru, 22.3.2013.

- P. Kandel, “Balkanizatsiya Yevropy vs yevropeizatsii Ballkan”, op.cit.
- Shaun Walker, “Now is chance for Kosovo deal, says Serbian president-but at what cost?”, www.theguardian.com, 26.4.2018; “Deal with albanians in Serbia’s interest, President says”, www.rsn1info.com, 30.5.2018.
- Comment by the Information and Press Department on the growing tensions in the Republic of Masedonia, www.mid.ru/en/, 2.3.2017.
- “Natsional’nyj vopros na Ballkanakh chyeryez prizmu mirovoy revolyutsii”, chast’ I, M. 2000, s. 149-150, 190; “Natsional’nyj vopros na Ballkanakh chyeryez prizmu mirovoy revolyutsii”, chast’ II, M. 2003, s. 163-167, 252-253.
- Enver Hoxha, “Me Stalinin”, Tiranë, 1979, f. 54, 212-213.
- Veton Surroi, “Aspiratori i madh”, www.balkanweb.com, 18.6.2018.
- Maja Poznatov, “Greater Albania”, statement awakens old ghosts in Balkans”, www.euractiv.com, 08.09.2016; “Deklarata për bashkim kombëtar, BE “shuplakë” Ramës dhe Thaçit: Të papranueshme”, www.balkanweb.com, 24.4.2017; Albulenë Muji, “Bashkimi kombëtar për marketing të Edi Ramës dhe Hashim Thaçit”, www.botasot.info, 26.4.2017.
- Konstantin Kachalin, “Kak Belgrad sklonyayut k “kompromissu” po Kosovo”, www.fondsk.ru, 28.2.2018.
- “Sleepless in Kosovo: a new Balkan war in the making?”, www.sputniknews.com, 1.4.2018; Yelena Ponomaryova, op.cit, s. 269.
- Kommentariy Departamenta Informatsii i Pyechat’i MID Rossii v svyazi s vyskazyvanyami prem’ier-ministra Albanii E. Ramy otnosityel’no prinyatiya Sobraniyem Respubliki Makedonii zakona “Ob ispol’zovaniy yazzykov”, www.mid.ru, 17.1.2018.
- D. Bechev, “Rival power, Russia in Southeast Europe”, Yale University Press, 2017, p. 244.
- Anna Filimonova, “Granitsa, Eulex i albanskiy dvuglavyj oryol”, www.fondsk.ru, 4.12.2012.
- E. Guskova, “Islamskoye gosudarstvo” na Balkanakh”, www.fondsk.ru, 7.7.2015.
- I. Pshenychnyi, “Velikaya albaniya nachnyotsya so smyerti malyen’koy Makedonii”, www.ria.ru, 28.4.2017.
- Yuliya Petrovskaya, “Russia’s Kosovo fixation”, www.intersectionproject.eu, 30.10.2017.
- Nina Vasilyeva, Viktor Gavrilov, “Balkanskiy Tupik”, M. 2000, s. 444.
- Pavel Kandel, “Rossiya i Yugovostochnaya Yevropa: op.cit, s. 328-331.
- P. Iskenderov, “Balkany i Rossiya za gazovoy shakhmatnoy doskoy”, www.fondsk.ru, 2.6.2018.

Fehari RAMADANI

VEPRIMTARIA E LIDHJES SË PRIZRENIT PËR
MBROJTJEN E TOKAVE SHQIPTARE
(QERSHOR - KORRIK 1878)

Përmbledhje

Vendimi i Traktatit të Shën Stefanit për dhënien e tokave shqiptare shteteve ballkanike shqetësoi atdhetarët shqiptarë. Por vendimi i Fuqive të Mëdha për mbajtjen e Kongresit të Berlinit për rishikimin e vendimeve të Traktatit ruso-osman ngjalli shpresat se këto vendime mund të korrigjoheshin dhe se territoret shqiptare nuk do të prekeshin nga ndryshimet e reja territoriale në Gadishullin Ballkanik. Për këtë arsye atdhetarët shqiptarë të krahinave të ndryshme u dërguan telegrame përfaqësuesve diplomatikë të Fuqive të Mëdha të cilët shërbenin në shtetin osman, duke kërkuar nga ata që të mos lejonin copëtimin e territoreve shqiptare.

Krahas telegrameve, lutjeve, protestave drejtuar shteteve evropiane, shqiptarët u përgatitën që nëse Fuqitë e Mëdha nuk do të merrnin parasysh kërkesat e tyre, atëherë ata do të organizonin kryengritje të armatosur për të kundërshtuar çdo vendim i cili do të ishte në kundërshtim me interesat kombëtare.

Pjesë e gjithë veprimtarisë në mbrojtje të tokave shqiptare nga copëtimi ishin shqiptarët e krahinave dhe besimeve të ndryshme fetare. Në telegramet drejtuar diplomatëve evropianë nënshkrues ishin krahas përfaqësuesve të shqiptarëve myslimanë edhe shqiptarët e krishterë. Të gjithë bashkërisht kundërshtonin pushtimin e tokave shqiptare nga shtetet e krishtera ballkanike.

Fjalët çelës: Lidhja e Prizrenit, tokat shqiptare, mbrojtja e atdheut, diplomatët evropianë.

Traktati i Shën Stefanit i 3 marsit 1878, që iu imponua Perandorisë Osmane nga Perandoria Ruse jo vetëm që nuk përmendte fare shqiptarët, por për më tepër vendimet e tij cenonin rëndë tërësinë tokësore të tyre. Sipas vendimeve të tij, gati gjysma e territoreve shqiptare u jepej shteteve sllave të Ballkanit. Kjo shkaktoi zemërim të thellë të shqiptarëve dhe, nga ana tjetër, u hapi rrugë sulmeve dhe terrorit të ushtrive serbe dhe malazeze mbi popullsinë shqiptare të territoreve të pushtuara.

Që në prill të vitit 1878 opinionin shqiptar u informua nga shtypi ndërkombëtar mbi pakënaqësinë që vendimet e Shën Stefanit kishin shkaktuar te Fuqitë e Mëdha të kohës, të cilat shqetësoheshin posaçërisht nga rritja e madhe dhe e shpejtë e ndikimit rus në Gadishullin Ballkanik. Pezullimi i vendimeve të Traktatit në fjalë deri në mbajtjen e Kongresit të Berlinit u dha mundësi shqiptarëve që të organizonin më mirë qëndresën politike dhe ushtarake për mbrojtjen e tokave shqiptare.

Kundërshtimi i vendimeve të Shën Stefanit filloi që në mars të vitit 1878 dhe u zhvillua pa ndërprerë gjatë gjithë periudhës në vazhdim. Më 14 mars të atij viti, shqiptarët e Shkupit, myslimanë dhe të krishterë, me të cilët u bashkuan edhe pjesëtarë të popullsisë sllave dhe hebraike të sanxhakut të Shkupit, i dërgonin një peticion, që nuk bëhet e qartë se kujt i drejtohet, por, duke marrë parasysh përmbajtjen e tij, mund të mendohet se ai u ishte adresuar ambasadorëve të Fuqive të Mëdha në Stamboll për të kundërshtuar vendimet e Traktatit të Shën Stefanit. Ata shpreheshin se do të kundërshtonin çdo përpjekje të Bullgarisë për të vendosur pushtetin e saj në atë territor dhe se do të luftonin për të pamundësuar realizimin e këtij traktati¹.

Në një memorandum tjetër që i drejtohej ambasadorit britanik në Stamboll A. H. Layard në prill 1878, kërkohej që shqiptarëve t'u njihej autonomia, pasi ajo u ishte njohur popujve të tjerë të Ballkanit.

¹ *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumente angleze (1878-1881)*. Përgatitur nga Skender Rizaj. Prishtinë - Priština: Arkivi i Kosovës, 1878, f. 54.

Sipas nënshkruesve të memorandumit ishte e padrejtë që shqiptarëve t'u kërkohej të mbeteshin nën sundimin osman ose, edhe më keq, që pjesë të territorit shqiptar t'u jepeshin shteteve fqinje. Në memorandum potencohet se popullsia e Shqipërisë kapte shifrën e 2 milion banorëve, nga e cila 1 milion ishin myslimanë, 750 mijë ortodoks dhe 250 mijë katolikë. Kjo popullsi jetonte brenda territoreve që bënin pjesë brenda vijës Shkodër – Triepsh – Grudë – Hot – Kelmend – Shkrel – Kastrat – Shalë – Shosh – Pejë – Prishtinë – Gjilan – Shkup – Prilep – Manastir – Follorinë – Kostur – Mecovë – Kalaritë – Artë – Prevezë. Shkëputja e ndonjë pjese të territoreve brenda kësaj vije do të shkaktonte pakënaqësi të madhe te shqiptarët dhe do të bëhej burim konfliktesh. Njohja e autonomisë së Shqipërisë konsiderohej nga nënshkruesit e memorandumit si mundësia më e mirë për t'u dhënë fund të gjitha padrejtësive dhe të gjitha armiqësive midis popujve ballkanikë. Ata vlerësonin se Perandoria Osmane ishte e paaftë që të realizonte reformat e nevojshme në pjesën evropiane të saj. Këtë paaftësi ajo e kishte dëshmuar në vazhdimësi që nga viti 1856², prandaj, kërkohej mbështetja britanike për realizimin e autonomisë së Shqipërisë, e cila do të shërbente si faktor stabiliteti për të ardhmen e popujve të Ballkanit.

Kundërshtimi i vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit nga shqiptarët e besimeve të ndryshme u përshkallëzua gjatë gjithë periudhës në vazhdim. Më 22 maj të vitit 1878 banorët shqiptarë të Tetovës, myslimanë dhe të krishterë, i dërguan një telegram ambasadorit të Francës në Stamboll Furnié, me të cilin kundërshtonin vendimin e Traktatit të Shën Stefanit për dhënien e territoreve shqiptare Bullgarisë. Telegrami ishte nënshkruar nga 459 shqiptarë, të cilët, në emër të 30.000 myslimanëve dhe rreth 7.500 të krishterëve kërkonin kryerjen e reformave nga qeveria osmane dhe shpreheshin se

² *Po aty*, f. 54-58.

do t'u kundërviheshin përpjekjeve për krijimin e Bullgarisë së Madhe, e cila “do të ishte shkatërrim për atdheun” e tyre³.

Telegrame të ngjashme kundër aneksimit të territoreve shqiptare nga Serbia, Mali i Zi dhe Bullgaria, ambasadorit francez i dërguan edhe paria e Prizrenit më 24 dhe 26 maj. Nëpërmjet telegrameve ata shpreheshin se të gjithë shqiptarët e Prizrenit: myslimanë, katolikë dhe ortodoksë ishin të gatshëm të sakrifikonin gjithçka për të kundërshtuar çdo përpjekje të popujve fqinj për pushtimin e territoreve shqiptare. Gjithashtu delegatët e Senicës, Novi Pazarit dhe Novi Varoshit i drejtoheshin me një telegram ambasadorit Furnié, duke kërkuar nga ai që në emër të drejtësisë të kundërshtonte vendimin e Traktatit të Shën Stefanit për pushtimin e tokave shqiptare nga shtetet fqinje. Sipas delegatëve të këtyre sanxhaqeve mbi gjysma e popullsisë së tyre ishte myslimane, kurse të krishterët ortodoksë flisnin shqip, prandaj ishte e padrejtë që ato të bashkoheshin me vendet sllave. “*Ne nuk kemi pra as nga gjuha, as nga raca [kombësia], as nga besimi, asnjë ngjasim me sllavët*”⁴. Me këtë ata kundërshtonin përpjekjet e Perandorisë Ruse për pushtimin e trojeve të tyre nga shtetet sllave ballkanike. Rrjedhimisht, ata kërkonin që tokat e tyre të mos shkëputeshin nga trangu kombëtar.

Në një telegram që përfaqësues të Shqipërisë së Sipërme (Prishtinë, Vushtrri, Mitrovicë, Pejë, Gjilan, Vranjë) i dërgonin ambasadës franceze në Stamboll më 3 qershor 1878, protestohej kundër vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit për aneksimin e territoreve shqiptare nga Bullgaria dhe Serbia. Sipas nënshkruesve të telegramit, 2/3 e banorëve të territoreve të mësipërme e përbënte popullsia myslimane, kurse pjesa tjetër që përbëhej nga të krishterët ishin gjithashtu shqiptarë. Sipas tyre “*bashkatdhetarët tanë të krishterë, nga feja janë latinë [katolikë] ose grekë [ortodoksë] por flasin shqip*”, prandaj kërkonin nga ambasadori i sipërpërmendur që

³ *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I (1876-1879)*. Përgatitur nga Ligor Mile. Tiranë: ASHRPSSH, 1978, f. 153-154.

⁴ *Po aty*, f. 154-156.

lutjen e tyre t'ia transmetonin qeverisë franceze për të penguar një padrejtësi të tillë. Ata shpreheshin se kishin besim në qeveritë e qytetëruara se do të mbanin qëndrim të drejt në lidhje me kërkesën e shqiptarëve.⁵

Sipas një njoftimi të konsullatës së Francës në Shqipëri (fillimi i qershorit 1878), myslimanët dhe katolikët *“kanë rënë në ujdi që t'i shtynjë sllavët, por katolikët dëshirojnë posaçërisht një autonomi që u siguron ekzistencë që ka të bëjë me qytetërim dhe përparim”*.⁶ Krahas memorandumeve dhe protestave që u dërgoheshin përfaqësuesve diplomatikë të akredituar në territoret shqiptare dhe në vetë kryeqytetin e Perandorisë Osmane, shqiptarët njëkohësisht u organizuan për t'i kundërshtuar edhe me armë përpjekjet e qeverisë malazeze për pushtimin e territoreve shqiptare. Më 5 qershor, princ Nikolla i ankohej konsullatës franceze në Shkodër se qëndresa e malësorëve të Veriut në mbrojtje të tokave shqiptare po zgjerohej. Banorët e Gucisë, Plavës, Hotit, Grudës, Kelmendit dhe viseve të tjera provokonin malazezët me qëllim që të shkactohej konflikt, të cilin qeveria e Cetinës përpiqej vazhdimisht ta evitonte derisa të mblidhej Kongresi dhe të merrej vendimi përfundimtar.⁷

Vendosmërinë e tyre për të kundërshtuar çdo përpjekje të shteteve fqinje për pushtimin e territoreve të tyre, shqiptarët ia bënë të njohur edhe vetë qeverisë osmane. Më 12 qershor krerët e malësive si dhe banorët e Podgoricës dhe disa mirditas i dërguan telegram Vezirit të Madh me anë të të cilit e njoftonin atë se ata ishin të vendosur për të kundërshtuar çdo përpjekje për *“lëshim të territorit shqiptar dhe se do ta kundërshtojnë këtë me armë”*. Ata u bënë thirrje bashkëkombësve të tyre të krahinave të tjera që të bashkoheshin me Lidhjen. Gjithashtu

⁵ Po aty, f. 163-164.

⁶ Shehu, Gjyltekin. 2010. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet diplomatike franceze (1878-1881)*. Prishtinë: IH & ASHAK, f. 26.

⁷ *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I (1876-1879)...*, 1978, f. 164.

ata ishin duke përgatitur një protestë të re e cila do t'i drejtohej Kongresit të Berlinit.⁸

Nëpërmjet një depeshe telegrafike të datës 11 qershor, Pons e njoftonte nga Shkodra Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës se malësorët shqiptarë dhe banorët e Podgoricës, nëpërmjet një telegrami që i dërgonin Vezirit të Madh e njoftonin atë se ata “[...] *nuk pranojnë kurrfarë shkëputje të territorit shqiptar në favor të Malit të Zi*”. Gjithashtu u bënë thirrje edhe banorëve të zonave të tjera që të bashkoheshin me Lidhjen. Ata ishin duke përgatitur një protestë e cila do t'i dërgohej Kongresit të Berlinit⁹. Aty nga mesi i qershorit, në emër të popullit shqiptar i dërgohej nga Shkodra një memorandum lordit Bikonsfild (Beaconsfield), nga i cili kërkonin të mbronte të drejtat e tyre kombëtare.¹⁰

Pushtimin e territoreve të tyre nga ushtria malazeze shqiptarët u përpoqën ta çlironin me luftë. Pas pushtimit të Krajës nga Mali i Zi, rreth 200 vullnetarë shqiptarë nga mesi i qershorit bënë përpjekje për ta çliruar këtë territor. Sipas një depeshe telegrafike të konsullit G. Pons për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës të datës 15 qershor, në luftimet e armatosura midis vullnetarëve shqiptarë dhe rojeve ushtarake malazeze mbetën 20 të vrarë dhe të plagosur, si dhe 50 vullnetarë shqiptarë u rrethuan nga forcat malazeze.¹¹

Sipas konsullit austro-hungarez, organizatorët e Kuvendit themelues të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit planifikonin që nëse do të ishte e nevojshme do të organizonin kryengritje të armatosur të të gjithë muhamedanëve të aftë për armë. Gjithashtu, edhe të krishterët do të detyroheshin t'i bashkoheshin kryengritjes. Qëllimi i kryengritjes ishte që të rimerrnin territoret e pushtuara nga serbët dhe

⁸ Po aty, f. 167-168.

⁹ Shehu, Gjyltekin, *vep. e përm.*, f. 27, 28.

¹⁰ Sëire, Joseph. 2005. *Shqipëria - ngritja e një mbretërie*. Tiranë, “Dituria”, f. 60; Skendi, Stavro. 2000. *Zgjidhimi kombëtar shqiptar 1878-1912*. Tiranë: Shtëpia e librit dhe e komunikimit, f. 50; Bozborra, Nuray. 2002. *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Tiranë, “Dituria”, f. 169.

¹¹ Shehu, Gjyltekin, *vep. e përm.*, f. 29.

rusët, por që banoheshin nga popullsia myslimane. Sipas informacioneve që kishte siguruar konsulli, përgatitjet tashmë ishin bërë dhe se ishte siguruar armatim i mjaftueshëm.¹²

Sipas gazetës osmane “*Tarcuman-ı Şark*”*, të datës 15 qershor, që në Kuvendin Themelues, Lidhja Shqiptare kishte shprehur kërkesën e saj për bashkimin e të gjitha territoreve shqiptare në një “*Vilajet Autonom të Shqipërisë*”¹³. Po atë ditë në emër të Lidhjes i dërgohej një telegram Portës së Lartë, në të cilin theksohej se “*ne kemi vendosur në Lidhjen tonë të shpallim se jemi shqiptarë dhe se besimi fetar nuk ka rëndësi*”.¹⁴

Më 15 qershor përfaqësuesit e Shqipërisë së Sipërme (Dibra e Sipërme, Dibra e Poshtme, Tetova, Shkupi, Prishtina, Gjilani, Jeni Pazari, Mitrovica, Peja, Gucia, Senica, Tashllixha, Luma, si dhe katolikët e Prizrenit, Pejës dhe të Gjilanit) i dërgonin një telegram ambasadorit francez në Stamboll Furnié me të cilin kundërshtonin vendimet e Shën Stefanit. Ata vlerësonin se Porta e Lartë kishte qenë e detyruar të nënshkruante traktatin në fjalë, i cili në vetvete përmbante shumë padrejtësi. Këta përfaqësues i luteshin ambasadorit që qeveria e tij t’i parashtronte kërkesat e tyre në Kongresin e Berlinit.¹⁵ Po atë ditë konsulli francez në Shkodër Pons njoftonte Ministrinë e tij të Punëve të Jashtme se banorët e Krajës ishin

¹² *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878), vëllimi I*. 2008. Përgatitur nga Beqir Meta, Ferit Duka, Marenglen Verli. Tiranë-Prishtinë: Albanica. (AIH, Vj. 30-2-213. Relacion i konsullit Chiari për eprorët me të cilin njofton përgatitjet dhe gatishmërinë e shqiptarëve për të mbrojtur interesat e tyre. Selanik, më 14 qershor 1878), f. 130.

* Sipas profesor Iljaz Rexhës, nga 10 qershori i vitit 1878 kryeredaktor i kësaj gazete ishte Sami Frashëri.

¹³ Rexha, Iljaz. 2014. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Porta e Lartë*. Prishtinë: IA, f. 234; Shih dhe: Bozborra, Nuray, vep. e përm., f. 169; Jelavich, Barbara. 1999. *Historia e Ballkanit-Shekulli i tetëmbëdhjetë dhe nëntëmbëdhjetë- Volumi I*. Tiranë: Botime përpjekja, f. 336; Jelavich, Charls dhe Baraba. 2004. Themelimi i shteteve kombëtare në Ballkan. Tiranë, “Dituria”, f. 207-208; Clayer, Nathalie. 2009. *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar-Lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë*, Tiranë, botime “Përpjekja”, f. 230-231.

¹⁴ Skendi, Stavro, vep. e përm., f. 52.

¹⁵ *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I (1876-1879)...*, 1978, f. 168.

armatosur dhe se mëngjesin e asaj dite ata kishin sulmuar postën malazeze në Zogaj, duke i detyruar malazezët të tërhiqeshin.¹⁶

Sipas një relacioni të konsullit austro-hungarez në Shkodër, Lippich, situata në kufirin me Malin e Zi ishte tepër e acaruar dhe se të dyja palët ishin të gatshme për të filluar konfliktin midis tyre. Ato ditë ishte zhvilluar në Shkodër një “*miting krejt nacional*”, ku kishin marrë pjesë myslimanë e katolikë dhe ishte kërkuar që Malit të Zi të mos i jepej asnjë pjesë e territorit shqiptar¹⁷. Më 16 qershor Pons njoftonte Ministrinë e tij se myslimanët dhe katolikët e Shkodrës ishin të vendosur për “*t’i zmbropsur sllavët*” dhe se ata dëshironin autonomi.¹⁸

Në një relacioni të konsullit austro-hungarez në Prizren Jelinek, të cilin ia drejtonte konsullit të përgjithshëm Lippich, thuhej se krerët shqiptarë të mbledhur në Prizren më 10 qershor kishin vendosur që ta shpallnin Shqipërinë principatë, nëse Kongresi i Berlinit vendoste që të largonte pushtetin osman nga territoret shqiptare. Gjithashtu, sipas konsullit shqiptarët ishin të vendosur që me armë të mbronin tokat e tyre duke luftuar kundër Serbisë dhe Malit të Zi.¹⁹

Më 17 qershor, shqiptarët e Shqipërisë së Sipërme i dërgonin një protestë Kongresit të Berlinit nga i cili kërkonin të rishikonte vendimet e Traktatit të Shën Stefanit lidhur me dorëzimin e tokave shqiptare Malit të Zi, siç ishin portet e Tivarit dhe të Ulqinit në Adriatik, si dhe disa pika strategjike në Podgoricë dhe Shkup. Nënshkruesit e protestës deklarorin se shqiptarët qoftë të besimit myslimanë, qoftë të atij katolikë ishin tërësisht të ndryshëm nga

¹⁶ Po aty, f. 169; Shih dhe: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878)*, vëllimi I..., (AIH, Vj. 30-83. Telegram i konsullit Lippich për reagimin e shqiptarëve ndaj vendimeve të Kongresit të Berlinit. Shkodër, më 15 qershor 1878), f. 130-131.

¹⁷ *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878)*, vëllimi I..., (AIH, Vj. 30-83. Relacion i konsullit Lippich drejtuar kontit Andrassy. Shkodër, më 15 qershor 1878), f. 132.

¹⁸ *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I (1876-1879)*..., f. 170.

¹⁹ *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878)*, vëllimi I..., (AIH, Vj. 30-1-187. Relacion i konsullit Jelinek për konsullin e përgjithshëm në Shkodër, Lippich. Prizren, më 18 qershor 1878), f. 141.

sllavët, prandaj ishin të vendosur ta kundërshtonin një vendim të tillë. Ata kërkonin nga përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha të mbledhur në Berlin që ta anulonin këtë vendim, sepse çdo gjë që cenonte tërësinë territoriale shqiptare do të ishte shkak për zhvillimin e konflikteve të armatosura²⁰ dhe faktorë që do të pengonte zhvillimin e qytetërimit në këtë pjesë të Evropës.

Më 20 qershor disa personalitete shqiptare, si: Sami Frashëri, Pashko Vasa, Seid Toptani, Zenel Abedin Dino, Omer Vrioni etj., i dërguan një letër Kongresit të Berlinit nga i cili kërkonin të merrte në konsideratë kërkesat dhe të drejtat e kombit shqiptar. Ata theksonin se nga vendimet e tij varej jeta dhe vdekja e kombësive të ndryshme të Perandorisë Osmane dhe se nëse shqiptarët nuk do të protestonin kundër vendimeve të padrejta, ata do të bënin vetëvrasje. Sipas tyre, kufijtë e Shqipërisë fillonin nga Tivari e Shkodra, duke përfshirë edhe viset e banuara nga popullsia katolike, dhe vazhdonin me Pejën, Kurshumlinë, Prishtinën, Vranjën, Shkupin, Përlepin, Manastirin, Follorinën, Kosturin, Grebenenë, Pindin, Kalarimin, Nartën dhe përfundojnë në gjirin e Ambrakisë. Këto vendbanime, duke përfshirë dhe ato që shtriheshin brenda kësaj vije, përbënin historikisht, gjeografikisht dhe etnografikisht Shqipërinë, dhe se shekuj me radhë kishin qenë shqiptare. Ata, në emër të popullit shqiptar, protestonin pranë Kongresit të Berlinit dhe kërkonin që përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha të merrnin vendime të drejta në lidhje me të ardhmen e territoreve shqiptare. Në të kundërtën, ata shpreheshin se shqiptarët do të detyroheshin që vetë të mbronin tokat e tyre²¹.

Në një telegram që i dërgohej përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha, i cili ishte nënshkruar në emër të popullit shqiptar, ndër të tjera vihej në dukje se “[...] kombi shqiptar, qoftë myslimanë e qoftë

²⁰ *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I (1876-1879)*..., f. 171-172; *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet austro-hungareze (1878)*, vëllimi I..., (AIH, Vj. 30-2-286. Telegram i krerëve shqiptarë drejtuar përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Kongresin e Berlinit. 1878), f. 136-137.

²¹ *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I (1876-1879)*..., f. 172-173.

katolikë nga raca e nga feja, krejtësisht dallohen nga sllavët, është unanimit në vendimin e tij që ta mbrojë atdheun e vet kundër ndarjes territoriale, që e kanë projektuar në kundërshtim me historinë, interesat dhe dëshirat e tij". Rrjedhimisht, ata kërkonin nga Fuqitë e Mëdha që të mbronin integritetin kombëtar dhe territorial të shqiptarëve, ku midis të tjerave thuhej *"të na kurseni nga konfliktet e kobshme të cilat do të shpërthejnë nëse do të bënin aneksimin që e prekin Shqipërinë, të na hapni rrugë të zhvillimit të cilën e dëshirojmë dhe të na bëni që ta ndiejmë influencën e kënaqshme të civilizimit"*.²²

Mbledhja e përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha në Berlin nuk u jepte shpresa të mëdha shqiptarëve se kërkesat e tyre do të merreshin parasysh dhe se të drejtat e tyre do të respektoheshin. Në atë kohë asnjëra nga shtetet vendimmarrëse të kohës nuk kishte interesa në Shqipëri dhe për rrjedhojë atdhetarët shqiptarët nuk mund të shpresonin shumë se ata do të korrigjonin vendimet e padrejta të Shën Stefanit. Prandaj ata vendosën që të kërkonin nga qeveria osmane që në rast se Kongresi do të merrte ndonjë vendim të padrejtë, atëherë shteti osman ta refuzonte realizimin e tij. Abdyl Frashëri dhe Mehmet Vrioni, më 23 qershor i dërguan një peticion sulltanit, me të cilin i kërkonin që të mos pranonte zbatimin e vendimeve të Kongresit të Berlinit për dorëzimin e territoreve shqiptare shteteve ballkanike.²³

Në rrethanat kur Fuqitë e Mëdha të kohës ishin mbledhur në Berlin dhe diskutonin të ardhmen e territoreve të Ballkanit, shqiptarët e krahinave të ndryshme i shpeshtuan kërkesat e tyre për autonomi. Më 24 qershor udhëheqësit e Mirditës, Ohrit, Pukës, Malësisë së Lezhës etj., i dorëzuan trupit konsullor në Shkodër një dokument, të cilin duhej t'ua përcillnin përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha të mbledhur në Berlin. Në dokument kërkohej që Kongresi i Berlinit të njohte autonominë e krahinave të sipërpërmendura, të cilat do të

²² Shehu, Gjyltekin, *vep. e përm.*, f. 31.

²³ Rexha, Iljaz, *vep. e përm.*, f. 121.

bashkoheshin në një provincë të vetme, “nën autoritetin e Prenk Dodës, udhëheqësit tonë trashëgues”.²⁴

Menjëherë pas themelimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, njëri ndër personalitetet më të shquara shqiptare të kohës Abdyl Frashëri, i shoqëruar edhe nga Jani Vreto në emër të popullit shqiptar zhvilloi misionin diplomatik në Berlin, ku u takuan me kancelarin gjerman Oto von Bismark. Nga drejtuesi i Kongresit ai kërkoi që të mos copëtoheshin territoret shqiptare, por kërkesa e tij nuk gjeti mbështetje.²⁵

Për mbrojtjen e territoreve shqiptare nga pushtimi i vendeve fqinje, më 2 korrik Lidhja Shqiptare miratoi një dekretligj mbi formimin dhe organizmin e ushtrisë shqiptare.²⁶ Parashikohej të rekrutoheshin të gjithë njerëzit e aftë për luftë, me përjashtim të një burri për familje²⁷. Me këtë vendim Lidhja tregonte se shqiptarët do të vepronin në mënyrë të pavarur nga Porta e Lartë.

Në fillim të korrikut gazetata osmane të kohës informonin se shqiptarët ishin të vendosur për të kundërshtuar çdo përpjekje të Serbisë, Greqisë dhe Malit të Zi për të pushtuar territore shqiptare. Ata e kishin njoftuar Kongresin e Berlinit se ishin bashkuar të gjithë, pa dallim feje për të mbrojtur tokat e tyre. Gazeta “*Zemân*” më 6 korrik shkruante se në Gegëri ishin regjistruar 17 mijë luftëtarë, duke shtuar se në “*Arnautlluk mund të rekrutoheshin mbi 100 mijë ushtarë*”.²⁸

Sipas një njoftimi të konsullit francez në Shkodër Pons të 7 korrikut 1878, sanxhaqet e Shkodrës, Ohrit, Matit dhe të Dibrës ishin të vendosura për të kundërshtuar dhënien e territoreve shqiptare Malit të Zi. Sipas konsullit të sipërpërmendur, kushdo që nuk do t'i

²⁴ Shehu, Gjyltekin, *vep. e përm.*, f. 32.

²⁵ Frashëri, Kristo. 2013. *Abdyl Frashëri - Jeta, veprimtaria dhe shkrimet (1839-1892)*, Tiranë, Botimet M&B, f. 146-150; Frashëri, Kristo. 1997. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*, Tiranë, “Toena”, f. 118.

²⁶ Rexha, Ilijaz, *vep. e përm.*, f. 26-30; Shih dhe: Sëire, Joseph, *vep. e përm.*, f. 60-61; Bozborra, Nuray, *vep. e përm.*, f. 171.

²⁷ Skendi, Stavro, *vep. e përm.*, f. 45.

²⁸ Rexha, Ilijaz. 1978, *vep. e përm.*, f. 30-31.

përgjigjej thirrjes për të luftuar kundër pushtuesve malazezë do të pushkatohej menjëherë. Njëkohësisht, konsulli e njoftonte Ministrinë e Punëve të Jashtme se në Shkodër çdo ditë arrinin sasi të mëdha ushqimesh dhe municionesh. Shqiptarët kundërshtonin pushtimin e tokave shqiptare nga Serbia dhe Mali i Zi, por nëse ndonjë Fuqi e Madhe evropiane do të vinte për të pushtuar krahinën shqiptare të pretenduar nga Mali i Zi nuk do të zhvillohej kurrfarë rezistence.²⁹

Në një letër që Veziri i Madh Safet Pasha u dërgonte në fillim të korrikut ambasadorëve osmanë që ndodheshin në shtete të ndryshme, shprehej se jo vetëm shqiptarët e viseve të aneksuara nga Serbia dhe Mali i Zi, por edhe popullsia myslimane dhe e krishterë e Novi Pazarit, Senicës, Dibrës, Tashllixhës, Prishtinës, Mitrovicës, Pejës, Gjakovës, Tetovës, Lumës etj., kanë vendosur që me armë ta kundërshtojnë pushtimin e territoreve të tyre nga shtetet fqinje dhe se Perandoria Osmane ishte e pazonja të pengonte një gjë të tillë. Ai kërkonte nga ambasadorët e tij që t'i njoftonin qeveritë përkatëse për pasojat që do të kishte aneksimi i territoreve shqiptare dhe se shteti i tij nuk do të mbante përgjegjësi për veprimet e popullsisë shqiptare.³⁰

Në një letër që Pons i drejtonte ministrit të Punëve të Jashtme të Francës më 14 korrik, e njoftonte atë se Komiteti Kombëtar Shqiptar, i mbledhur në Prizren në fillim të atij muaji, kishte vendosur që selia e Komitetit të ishte në Prizren dhe ai ishte i ngarkuar me detyrën e kontrollit të nënkomiteteve, të cilat do të ngriheshin në çdo kryeqendër të sanxhaqeve të Shqipërisë. Nënkomitetet do të kishin për detyrë që të mobilizonin njerëz, të mblidhnin të dhjetat, të siguronin ushqime dhe të shpërndanin armë dhe municione. Komiteti Qendror kishte vendosur që të gjithë burrat e aftë, me përjashtim të një burri për familje, të merrnin armët për të mbrojtur tokat shqiptare nga ndonjë pushtim i mundshëm. Parashikohej që 30 mijë burra nga Tirana, Elbasani, Ohri, Mati dhe Dibra të shkonin në Shkodër për të

²⁹ Shehu, Gjyltekin, *vep. e për.*, f. 34, 35.

³⁰ *Shqipëria në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I (1876-1879)...*, f. 176-177.

formuar një korpus. Krahas Shkodrës, pika të tjera për grumbullimin e korpuseve do të ishin Prizreni, Peja, Kosova dhe Novi Pazari. Në varësi të vendimeve të Kongresit të Berlinit do të vepronte edhe Lidhja Shqiptare. Nëse Kongresi vendoste që Serbisë dhe Malit të Zi t'i jepte territore shqiptare, atëherë shqiptarët do t'u kundërviheshin me armë atyre. Çdokush që do të refuzonte t'i përgjigjej thirrjes së nënkomiteteve për t'u mobilizuar do të dënohej me vdekje.³¹

Kongresi i Berlinit jo vetëm që nuk e përmirësoi gjendjen e shqiptarëve, të cilëve nuk u njohu asnjë të drejtë politike, por për më tepër vendosi që territore shqiptare t'u jepeshin shteteve fqinje. Vendimet e tij i vunë shqiptarët përballë shteteve fqinje dhe ndikuan për acarimin e mëtejshëm të raporteve të tyre me shtetin osman.³²

Përfundim

Vendimi i Traktatit të Shën Stefanit për dhënien e tokave shqiptare shteteve ballkanike shqetësoi atdhetarët shqiptarë. Sapo vendimet e tij u bënë të njohura, filloi dhe reagimi i shqiptarëve kundër tyre. Por vendimi i Fuqive të Mëdha për mbajtjen e Kongresit të Berlinit, i cili do të rishikonte vendimet e Traktatit ruso-osman, ngjalli shpresat se këto padrejtësi mund të korrigjoheshin dhe se territoret shqiptare nuk do të prekeshin nga ndryshimet e reja territoriale në Gadishullin Ballkanik. Për këtë arsye atdhetarët shqiptarë të krahinave të ndryshme u dërguan telegrame përfaqësuesve diplomatikë të Fuqive të Mëdha, të cilët shërbenin në shtetin osman, duke kërkuar nga ata që të mos lejonin copëtimin e territoreve shqiptare. Atdhetarët shqiptarë bënë përpjekje që të bindnin diplomatët evropianë se ata nuk do të pranonin asnjë vendim të tyre i cili do të cenonte tërësinë tokësore shqiptare.

³¹ *Po aty*, f. 181.

³² Shih: Frashëri, Kristo, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881...*, f. 124-126.

Në telegramet drejtuar diplomatëve evropianë nënshkrues ishin krahas përfaqësuesve të shqiptarëve myslimanë edhe shqiptarët e krishterë. Të gjithë bashkërisht kundërshtonin pushtimin e tokave shqiptare nga shtetet e krishtera ballkanike. Krahas telegrameve, lutjeve, protestave drejtuar shteteve evropiane, shqiptarët u përgatitën që nëse Fuqitë e Mëdha nuk do të merrnin parasysh kërkesat e tyre, atëherë ata të organizonin kryengritje të armatosur për të kundërshtuar çdo vendim i cili do të ishte në kundërshtim me interesat kombëtare. Madje, para dhe gjatë mbajtjes së Kongresit të Berlinit, shqiptarët në mënyrë të pavarur nga Porta e Lartë organizuan rezistencë të armatosur kundër përpjekjeve pushtuese të Malit të Zi.

Rezistenca e filluar në mesin e vitit 1878 vazhdoi pa ndërprerë gjatë gjithë veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Megjithëse nuk arriti të kundërshtonte tërësisht vendimet e shteteve evropiane për shkëputjen e disa territoreve shqiptare nga trugu etnik, ajo ndikoi fuqishëm në forcimin e ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar.

Frashër DEMAJ

FONDE TË DOKUMENTEVE BRITANIKE PËR LSHP NË “THE NATIONAL ARCHIVE”

Përmbledhje

Periodha e Lidhjes Shqiptare e Prizrenit konsiderohet si faza e parë e formimit të shtetit nacional të shqiptarëve. Duke qenë një lëvizje politike e ushtarake e rëndësishme që funksionoi rreth tri vjet (1878-1881) tërhoqi edhe vëmendjen e politikës dhe diplomacisë së shteteve ballkanike e në veçanti shteteve që përbënin grupin e Fuqive të Mëdha. Britania e Madhe si njëra nga këto fuqi duke pasur interesat e veta në rajon kishte përcjellë me vëmendje çdo lëvizje politike dhe kryengritëse e ushtarake në rajonin e Ballkanit. Vëmendja e Londrës zyrtare kishte ndërruar formë dhe përmbajtje sidomos nga shfaqja në hapësirat ballkanike e Krizës Lindore më 1875, kryengritjes së Bosnjë e Hercegovinës, Luftës së Serbisë dhe Malit të Zi kundër Perandorisë Osmane më 1877 dhe luftës ruso-turke, Traktatit të Shën Stefanit (3 mars 1878), Lidhjes së Prizrenit dhe Kongresit të Berlinit (13 qershor 1878).

Interesimi i diplomacisë britanike për shqiptarët dhe lëvizjet në Ballkan gjatë viteve 1875-1881 përbën numër të madh të dokumenteve të ruajtura në mijëra vëllime në “The National Archives” në Londër. Në mesin e fondeve të dokumenteve diplomatike që trajtojnë çështjen shqiptare që po dilte në sipërfaqe dhe po ndërkombëtarizohej gjatë viteve 1878-1881 janë: Fondet Albania; Albania and Montenegro; Europe and Russia; Serbia; Greece etj. Pjesa më e madhe e këtyre fondeve dokumentare janë korrespondenca diplomatike të qeverisë britanike me përfaqësitë diplomatike të saj në rajonin e Ballkanit. Në dokumentet që ruhen në The National Archives në Londër, që për temë trajtimi kanë çështjen shqiptare brenda

kuadrit kohor 1878-1881 janë raporte të përditshme të nënkonsujve, konsujve, ambasadorëve dhe nëpunësve tjerë diplomatik të ngarkuar nga qeveria britanike. Edhe raportet e konsullatave britanike në Prizren, Shkodër, Selanik... dhe ambasadat në Stamboll e në vende të tjera të rajonit dërguar Foreign Office në Londër përbëjnë vëllim shumëfaqësh të dokumenteve diplomatike britanike për shqiptarët dhe rajonin që ruhen në The National Archives. Ndër fondet që kam arritur t'i hulumtoj deri më tani që kanë për temë-trajtim Lidhjen Shqiptare të Prizrenit janë: FO 195/139 viti 1877 Albania; FO 195/139 viti 1877 Montenegro; FO 195, E 258; 1367; FO 195/1303 1880 Albania and Montenegro; FO 195/2406; FO 372/2/1 Albania; FO 83/1655, viti 1878, Kongres of Berlin; FO 194/1367, Albania viti 1881; FO 195/1476 viti 1884 Albania; FO 881/4335, viti 1880 Dulcigno (Ulqini); FO 195/1304 1880 Albania and Montenegro; FO 195/1444 Albania Vol.II; FO ref PRO 30/29/317 Montenegro, etj

Fjalët çelës: Lidhja Shqiptare e Prizrenit, The National Archives, diplomatike, Foreign Office, konsujt, ambasadorët, fondet etj.

Fillimet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1875-1878 dhe emancipimi politik i shqiptarëve ishin rrjedhojë e ndryshimeve ekonomiko-shoqërore, e krijimit dhe avancimit të një vetëdijeje politike e kombëtare të ndikuar nga idetë përparimtare të Evropës Perëndimore.¹ Procesi i emancipimit politik e kombëtar i shqiptarëve lindi dhe u zhvillua në rrethana të reja socioekonomike në kushtet e shthurjes së feudalizmit dhe të lindjes e zhvillimit të kapitalizmit² në tokat e pushtuara nga Perandoria Osmane. Për dallim nga vendet evropiane Perandoria Osmane kishte ngelur një vend, i pa zhvilluar

¹ Zija Xholi, “Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare në vitet 30-70 të shekullit XIX”, Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881, Tiranë, 1979, f. 83.

² Ali Hadri, “Rëndësia historike e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878-1881”, Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881, Tiranë, 1979, f. 138.

dhe i prapambetur, pa ia arritur që të realizonte me sukses reformat e nisura që nga periudha e Tanzimatit.

Emancipimi kombëtar i shqiptarëve filloi përmes një lëvizje të gjerë kulturore, bartës të së cilës ishin një elitë intelektuale e vogël në numër të cilët kishin ndjekur shkolla dhe universitete në vende të ndryshe evropiane. Mendimi politik e përparimtar që pasqyronte tendencat e zhvillimit historik të Shqipërisë e të popullit shqiptar dëshmonte për karakterin kombëtar të lëvizjes dhe koncepteve politike që u parashtruan në shumë dokumente të kohës, siç ishin dokumentet programatike të Lidhjes Shqiptare, memorandumet e protestat e shumta dërguar Portës së Lartë dhe qeverive të Fuqive të Mëdha nga të katër anët e Shqipërisë.³ Konceptet politike të elitës dhe drejtuesve kryesorë të Lidhjes Shqiptare mbështeteshin në logjikën politike përparimtare të kohës të modeluar nga shtete të përparuara të kohës. Në këtë logjikë dhe parime politike ishin mbështetur vite me radhë lëvizjet e mëdha e të fuqishme nacionale e demokratike të popujve të Evropës për krijimin e shteteve kombëtare dhe për demokratizimin e jetës brenda tyre.⁴

Përpjekjet politike, programi dhe platforma politike e Lidhjes synonin shtetin autonom shqiptar, i cili do të përfshinte vilajetet e banuara me shumicë nga shqiptarët.⁵ Lidhja kishte një strukturë organizative me një hierarki vertikale nga Këshilli Qendror e deri te degët dhe nëndegët, bashkë me strukturën e forcave kryengritëse dhe shtrihej gati në gjithë hapësirën etnike shqiptare në të katër vilajetet. Prandaj nuk ka asnjë dilemë se kjo periudhë e rëndësishme e historisë

³ Skender Rizaj, *Dokumente angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe fillimin e copëtimit të Ballkanit (1877-1885)*, Prishtinë 1996, f. 59.

⁴ Shyqri Ballvora, *“Koncepti i territorit në Programin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”*, Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881, Tiranë 1979, f. 153.

⁵ Frasher Demaj, *Britania e Madhe dhe çështja shqiptare 1875-1913*, Prishtinë 2017, f. 84.

së shqiptarëve quhet Epoka e Lidhjes Shqiptare.⁶ Organizimi politik dhe kundërshtimi me forcë i regjimit osman pati jehonë të fuqishme jo vetëm në Ballkan, por edhe më gjerë. Lëvizja Kombëtare Shqiptare në këtë periudhë shërbeu si një argument i qëndrueshëm që kundërshtonte pretendimet e popujve fqinj për pushtimin e tokave shqiptare dhe demantonte idenë se shqiptarët ishin shërbëtor të Perandorisë Osmane.⁷ Aktivitetet e Lidhjes vunë në lëvizje edhe diplomacinë e Fuqive të Mëdha e cila u bind se lëvizja kombëtare shqiptare mund të ishte në fazën e parë të zhvillimit të saj, e brishtë, me potenciale të kufizuara politike, ushtarake e diplomatike e ndodhur përballë sfidave organizative, përballë qeverisë osmane dhe vendeve ballkanike, por e bindur në realizimin e pretendimeve të saj për të jetuar të lirë e të pavarur dhe për të mbrojtur territoret e veta etnike.

Bazuar në argumentet historike, periudha e Lidhjes Shqiptare e Prizrenit konsiderohet si faza e parë e formimit të shtetit nacional të shqiptarëve në kohën kur shumica e shteteve evropiane dhe ballkanike kishin formësuar procesin e formimit të shteteve të tyre kombëtare. Lidhja ishte një lëvizje politike e ushtarake që funksionoi rreth tri vjet (1878-1881) dhe tërhoqi vëmendjen e politikës dhe diplomacisë së shteteve që përbënin grupin e Fuqive të Mëdha. Britania e Madhe si njëra nga këto fuqi duke pasur interesat e veta në rajon kishte përcjellë me vëmendje çdo lëvizje politike, kryengritëse dhe ushtarake në rajonin e Ballkanit. Vëmendja e Londrës zyrtare kishte ndërruar formë dhe përmbajtje sidomos nga shfaqja në hapësirat ballkanike e Krizës Lindore më 1875, kryengritjes së Bosnjë Hercegovinës, Luftës së Serbisë dhe Malit të Zi kundër Perandorisë Osmane 1877 dhe luftës ruso-turke 1878, Traktatit të Shën Stefanit (3 mars 1878), Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Kongresit të Berlinit (13 qershor 1878).

⁶ Ramiz Abdyli, *Lufta shqiptaro-malazeze dhe Fuqitë e Mëdha* (mars- qershor 1880), (Dokumente të reja për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit).

⁷ Po aty.

Interesimi i diplomacisë britanike për shqiptarët dhe lëvizjet në Ballkan gjatë viteve 1875-1881 përbën numër të madh të dokumenteve të ruajtura në mijëra vëllime në “The National Archives” në Londër. Në mesin e fondeve të dokumenteve diplomatike që trajtojnë çështjen shqiptare që po dilte në sipërfaqe dhe po ndërkombëtarizohej gjatë viteve 1878-1881 janë: Fondet Albania; Albania and Montenegro; Europe and Russia; Serbia; Greece; Otoman Empire e herë Turkey etj. Pjesa më e madhe e këtyre fondeve arkivore janë korrespondenca diplomatike të qeverisë britanike me përfaqësitë diplomatike të saj në rajonin e Ballkanit, por edhe korrespondenca dhe informacione të ndërsjella të përfaqësive diplomatike të Britanisë së Madhe në vende të ndryshme evropiane dhe më gjerë. Në dokumentet që ruhen në The National Archives në Londër që për temë trajtimi kanë çështjen shqiptare brenda kuadrit kohor 1878-1881 janë: shkresa, njoftime, informata, raporte të përditshme për ngjarje ditore, harta të ndryshme dhe propozime për kufijtë që u hapen si temë diskutimi përgjatë zhvillimeve sa zgjati Kongresi i Berlinit dhe materiale tjera që përbëjnë bazë të rëndësishme për studime të thelluara historike, diplomatike, ushtarake etj. Hartat dhe propozimet për kufijtë e ri në Ballkan prekin më së shumti gjeografinë shqiptare në kufijtë e Perandorisë Osmane me Serbinë, Malin e Zi Bullgarinë dhe Greqinë. Një vend të posaçëm të fondeve dokumentare diplomatike zënë edhe raportet e konsullatave britanike në territoret shqiptare si në Prizren, Shkodër, Selanik etj.

Në këtë punim do të paraqiten disa prej fondeve të dokumenteve diplomatike të Britanisë së Madhe që për temë trajtimi kanë çështjen shqiptare e në veçanti periudhën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Është me rëndësi të thuhet se një pjesë e konsiderueshme kanë qenë konfidenciale dhe nën sanksione, pra të mbyllura (closed) deri në vitin 1967. Për korrektësi shkencore po i japim të plotë në gjuhën origjinale dokumentet të shoqëruar pjesërisht me përkthim.

Albania (Scutari). Shqipëri (Shkodër)

Foreign Office: Embassy and Consulates, Turkey (formerly Ottoman Empire): General Correspondence. Albania (Scutari).

Ministria e Jashtme: Ambasada dhe Konsullatat, Turqia (dikur Perandoria Otomane): Korrespondenca e Përgjithshme. Shqipëria (Shkodër).

Held by:	The National Archives - Foreign Office
Date:	1878
Reference:	FO 195/1186
Subjects:	Europe and Russia International Middle East

•

Foreign Office: Confidential Print South-East Europe

Foreign Office: Confidential Print South-East Europe. This series contains confidential print relating to South-East Europe. It comprises selected correspondence and papers relating to Albania, Bulgaria, Crete, Cyprus, Greece, Montenegro, Rumania

Location: Albania

Ministria e Jashtme: Konfidenciale Evropa Juglindore. Kjo seri përmban printime konfidenciale në lidhje me Evropën Juglindore. Përmban një korrespondencë të përzgjedhur dhe dokumente që kanë të bëjnë me Shqipërinë, Bullgarinë, Kretën, Qipron, Greqinë, Malin e Zi dhe Rumaninë.

Held by:	The National Archives, Kew - Foreign Office
Date:	1812 – 1975

Reference: FO 421

•

Ottoman Empire, Greece. Six sheets of the Austrian Staff Map joined: ['Arta', 'Berat', 'Kastoria', 'Salonik'...

Public Record Office: Maps and plans extracted to rolled storage from various series of records. 11 items, formerly part of WO 78/1009. Maps of Ottoman... Albania), and Ierissos, Chalcis (Chalkida) and Preveza (all now in Greece). [Printed in 1878]. Coloured MS additions show the Turco-Greek frontier as existing and as proposed at Berlin, 28 June 1880, and a

Perandoria Osmane, Greqi. Gjashtë fletët e hartave të Shtabit Austriak u bashkuan: ['Arta', 'Berat', 'Kastoria', 'Salonik' ...]

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra nga seritë e ndryshme të regjistrimeve. 11 artikuj, më parë pjesë e WO 78/1009. Hartat e Otomanëve ... Shqipëria), dhe Ierissos, Chalcis (Chalkida) dhe Preveza (të gjitha tani në Greqi). [Shtypur në 1878]. Shtesat me ngjyrë MS tregojnë kufirin turko-grek si ekzistues dhe të propozuar në Berlin, 28 qershor 1880.

Held by: The National Archives - Maps and plans extracted to rolled storage from various departments

Date: 1878 – 1880

Reference: MR 1/1889/6

Subjects: Archives and libraries | Europe and Russia | Maps and plans | Middle East

•

Ottoman Empire, Greece. Map comprising six joined sheets: four sheets of the Austrian Staff Map...

Public Record Office: Maps and plans extracted to rolled storage from various series of records. 11 items, formerly part of WO 78/1009. Maps of Ottoman... from sheets of the Austrian Staff Map; the combined map covering the area between Fier (now in Albania), and Ierissos, Chalcis (Chalkida) and Preveza (all now in Greece). Reference table to pronunciation

Perandoria Osmane, Greqi. Hartë e përbërë nga gjashtë fletë të bashkuara: katër fletë të hartave të Shtabit Austriak ...

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra nga seritë e ndryshme të regjistrimeve. 11 artikuj, më parë pjesë e WO 78/1009. Hartat e osmanëve ... nga fletët e hartave të Shtabit Austriak; hartën e kombinuar që mbulon zonën midis Fierit (tani në Shqipëri), dhe Ierissos, Chalcis (Chalkida) dhe Preveza (të gjitha tani në Greqi). Tabela e referencës për shqiptimin.

Held by:	The National Archives - Maps and plans extracted to rolled storage from various departments
Date:	1878 – 1880
Reference:	MR 1/1889/8
Subjects:	Archives and libraries Europe and Russia Maps and plans Middle East

•

2 items extracted from FO 103/13. Yugoslavia. (1) Admiralty chart 1588. 'Adriatic Dulcigno [now Ulcinj]...

Public Record Office: Maps and plans extracted to flat storage from various series of records held at the Public Record Office, Kew, from 1977. Cooper Key. The chart covers part of the Adriatic sea and the Ulcinj area of Serbia and Montenegro. (2) 'Outline Map Giving the

various proposed boundaries between Montenegro and Albania From the Adriatic.

2 artikuj të nxjerrë nga FO 103/13. Jugosllavia. (1) Tabela e admiralitetit 1588. 'Adriatiku Dulcigno [tash Ulqini] ...

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra nga magazina e sheshtë nga seritë e ndryshme të regjistrimeve të mbajtura në Zyrën e Regjistrimit Publik. Grafiku mbulon një pjesë të detit Adriatik dhe zonën e Ulqinit. Kufijtë e propozuar ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë.

Held by:	The National Archives - Maps and plans extracted to flat storage from various departments held at the Public Record Office, Kew
Date:	1822 – 1880
Reference:	MFQ 1/246
Subjects:	Archives and libraries Armed Forces (General Administration) Army Europe and Russia International Maps and plans Navy

•

Europe: Balkans. 'Map of Turkey, by [Heinrich] Kiepert': sheets 14 and 15 only of a...

Public Record Office: Maps and plans extracted to rolled storage from various series of records. 2 items extracted from FO 78/2894. Detailed descriptions are given... Europe: Balkans. 'Map of Turkey, by [Heinrich] Kiepert': sheets 14 and 15 only of a map on multiple sheets, joined to form a map of the area (now in Albania and Greece) between Corfu (Kerkyra) in the

Evropa: Ballkani. 'Harta e Turqisë nga [Heinrich] Kiepert': fletët 14 dhe 15 vetëm të një ...

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra nga seritë e ndryshme të regjistrimeve. 2 artikuj të nxjerrë nga FO 78/2894.

Held by:	The National Archives - Maps and plans extracted to rolled storage from various departments
Date:	1876 - 1878
Reference:	MR 1/422/2
Subjects:	Archives and libraries Armed Forces (General Administration) Army Europe and Russia Maps and plans Middle East Operations, battles and campaigns

•

4 items (originally enclosed in Count Schouvaloff's letter of 11 / 23 March 1878) extracted...

Public Record Office: Maps and plans extracted to flat storage from various series of records of the Foreign Office. boundaries according to the Treaty of San Stefano, 19 February / 3 March 1878. (1) Showing the area between Ulcinj, Scutari (now Shkodër, Albania), Prijeplje and Foca, with the boundary, between Turkish

4 artikuj (të mbyllur fillimisht në letrën e kontit Schouvaloff të 11/23 mars 1878) nxjerrë ...

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra në ruajtjen e sheshtë nga seritë e ndryshme të të dhënave të Ministrisë së Jashtme. Kufijtë sipas Traktatit të Shën Stefanit, 19 shkurt / 3 mars 1878. (1) Duke treguar zonën midis Ulqinit, Shkodrës (tani Shkodrës, Shqipërisë), Prijepljes dhe Foçës, me kufirin midis Turqisë.

Held by:	The National Archives - Foreign Office: maps and plans extracted to flat strage
Date:	1878
Reference:	MPK 1/470
Subjects:	Archives and libraries Asia Europe and Russia International Maps and plans Middle East Official publications Treaties and alliances

Albania (Scutari, Prisrend).

Foreign Office: Embassy and Consulates, Turkey (formerly Ottoman Empire): General Correspondence. Albania (Scutari, Prisrend).

Shqipëria (Shkodër, Prizren).

Ministria e Jashtme: Ambasada dhe Konsullatat, Turqia (dikur Perandoria Otomane): Korrespondenca e Përgjithshme. Shqipëria (Shkodër, Prizren).

Held by:	The National Archives - Foreign Office
Date:	1879
Reference:	FO 195/1236
Subjects:	Europe and Russia International Middle East

•

FOREIGN OFFICE: EMBASSIES AND CONSULATES:
Consul appointed for 1 year at Prisrend, Albania

Treasury: Treasury Board Papers and In-Letters. Papers registered during the period 1879-1883. FOREIGN OFFICE: EMBASSIES AND CONSULATES: Consul appointed for 1 year at Prisrend, Albania.

MINISTRIA E JASHTME: AMBASADAT DHE KONSULATAT: Konsulli i emëruar për 1 vit në Prizren, Shqipëri
Thesari: Letrat e Bordit të Thesarit dhe In-Letrat. Letrat e regjistruara gjatë periudhës 1879-1883.

Held by: The National Archives - HM Treasury
Date: 1879
Reference: T 1/16398
Subjects: Europe and Russia | Government finances | International

Europe: Balkans. 'Positions of Ottoman Forces in Thessaly and Epirus, 26 August 1879': map showing...

Public Record Office: Maps and plans extracted to flat storage from various series of records of the Foreign Office. 23 items (originally among the papers... Europe: Balkans. 'Positions of Ottoman Forces in Thessaly and Epirus, 26 August 1879': map showing rivers, towns and roads; (the area shown is now in Albania and Greece). Reference table to corps

Evropa: Ballkani. 'Pozicionet e forcave otomane në Thesalinë dhe Epirin, 26 gusht 1879'

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra në ruajtjen e sheshtë nga seritë e ndryshme të të dhënave të Ministrisë së Jashtme. Harta që tregon lumenjtë, qytetet dhe rrugët (zona e treguar tani është në Shqipëri dhe Greqi).

Held by: The National Archives - Foreign Office: maps and plans extracted to flat strage
Date: 1879
Reference: MPK 1/434/18

Subjects: Air Force | Archives and libraries | Europe and Russia | International | Maps and plans

1 item extracted from FO 881/4264. Yugoslavia: Montenegro: 'Sketch illustrating the Proposition for an Exchange...

Public Record Office: Maps and plans extracted to flat storage from various series of records held at the Public Record Office, Kew, from 1977. '. The map also shows the Treaty [of Berlin] frontier. No scale shown. Signed by M T Sale, 18 February 1880. Lithographed by Harrison & Sons. The area shown is now in Serbia and Montenegro and Albania.

Ministria e Jashtme FO 881/4264. Mali i Zi: 'Skica që ilustron propozimin për një shkëmbim ... Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra në ruajtjen e sheshtë nga seritë e ndryshme të regjistrimeve të mbajtura në Zyrën e Regjistrimit Publik. Harta gjithashtu tregon kufirin e Traktatit [të Berlinit].

Held by: The National Archives - Maps and plans extracted to flat storage from various departments held at the Public Record Office, Kew

Date: 1879 – 1880

Reference: MFQ 1/244

Subjects: Archives and libraries | Europe and Russia | Maps and plans | Treaties and alliances

•

Ottoman Empire, Greece. Six sheets of the Austrian Staff Map joined: ['Arta', 'Berat', 'Kastoria', 'Salonik'...

Public Record Office: Maps and plans extracted to rolled storage from various series of records. 11 items, formerly part of WO 78/1009. Maps of Ottoman... Albania), and Ierissos, Chalcis (Chalkida) and Preveza (all now in Greece). [?Printed in 1878]. Coloured MS additions show the Turco-Greek frontier as existing and as proposed at Berlin, 28 June 1880, and a

Perandoria Osmane, Greqi. Gjashtë fletët e hartave të Shtabit Austriak u bashkuan: ['Arta', 'Berat', 'Kastoria', 'Salonik' ...]

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra për ruajtjen e ruajtjes nga seritë e ndryshme të regjistrimeve. 11 artikuj, më parë pjesë e WO 78/1009. Hartat e otomanëve ... Shqipëria), dhe Ierissos, Chalcis (Chalkida) dhe Preveza (të gjitha tani në Greqi). [Shtypur në 1878]. Shtesat me ngjyrë MS tregojnë kufirin turko-grek si ekzistues dhe të propozuar në Berlin, 28 qershor 1880.

Held by:	The National Archives - Maps and plans extracted to rolled storage from various departments
Date:	1878 – 1880
Reference:	MR 1/1889/6
Subjects:	Archives and libraries Europe and Russia Maps and plans Middle East

2 items extracted from FO 78/3061. The Balkans. (1) Map of part of south-western Montenegro...

Public Record Office: Maps and plans extracted to flat storage from various series of records held at the Public Record Office, Kew, from 1977. Intelligence Branch, Quarter Master General's Department. (2) 'Diagram' (sketch map) of area between Scutari (now

Shkoder, Albania), Ipec [Pécc] and Podgorica (Montenegro), showing new frontier area of Kucka

Ministria e Jashtme FO 78/3061. Ballkani. (1) Harta e pjesës së Malit të Zi jug-perëndimor ...

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra nga magazina e sheshtë nga seritë e ndryshme të regjistrimeve të mbajtura në Zyrën e Regjistrimit Publik. Dega e Inteligjencës, Departamenti i Përgjithshëm (2) 'Diagrami' (skema e skemës) e zonës ndërmjet Shkodrës (tani Shkodër, Shqipëri), Ipec [Pejë] dhe Podgoricë (Mali i Zi), duke treguar zonën e re kufitare të Kuçit.

Held by: The National Archives - Maps and plans extracted to flat storage from various departments held at the Public Record Office, Kew

Date: 1879

Reference: MFQ 1/36

Subjects: Archives and libraries | Army | Asia | Europe and Russia | International | Maps and plans | Middle East | Treaties and alliances

•

Albania and Montenegro.

Foreign Office: Embassy and Consulates, Turkey (formerly Ottoman Empire): General Correspondence. Albania and Montenegro.

Shqipëria dhe Mali i Zi.

Ministria e Jashtme: Ambasada dhe Konsullatat, Turqia (dikur Perandoria Otomane): Korrespondenca e përgjithshme. Shqipëria dhe Mali i Zi.

Held by:	The National Archives - Foreign Office
Date:	1880
Reference:	FO 195/1304
Subjects:	Europe and Russia International Middle East
Held by:	The National Archives - Foreign Office
Date:	1880
Reference:	FO 925/3127
Subjects:	Europe and Russia International Maps and plans

•

Albania and Greece. Map of an area between Berat, Salonica, Prevesa and the Gulf of ...

Public Record Office: Maps and plans extracted to extra large flat storage from various series of records of departments not assigned an individual map extract... Albania and Greece. Map of an area between Berat, Salonica, Prevesa and the Gulf of Volo. Reference table to boundaries.

Shqipëria dhe Greqia. Harta e një zone midis Beratit, Selanikut, Prevezës dhe Gjirit të Ambrakisë.

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra në ruajtje të sheshtë shtesë nga seritë e ndryshme të dosjeve.

Shqipëria dhe Greqia. Harta e një zone midis Beratit, Selanikut, Prevezës dhe Gjirit Volo. Tabela e referencës në kufijtë.

Held by:	The National Archives - Maps and plans extracted to extra large flat storage from records of departments not assigned an
-----------------	--

individual map prefix

Date: 1880

Reference: MPII 1/86/8

Subjects: Archives and libraries | Europe and Russia | Maps and plans | Middle East | Treaties and alliances

•

Albania and Greece. 'Map of the Turco-Greek Frontier Reduced and Compiled from the Austrian Staff ...

Public Record Office: Maps and plans extracted to extra large flat storage from various series of records of departments not assigned an individual map extract... Albania and Greece. 'Map of the Turco-Greek Frontier Reduced and Compiled from the Austrian Staff and Kiepert's maps' showing the 'Old Frontier' [1832] and the Berlin Conference boundary of 1880

Shqipëria dhe Greqia. 'Harta e Kufirit Turqo-Grek të reduktuar dhe hartuar nga Shtabi Austriak dhe hartat e Kiepert' duke treguar 'kufirin e vjetër' [1832] dhe kufiri i Konferencës së Berlinit të vitit 1880.

Held by: The National Archives - Maps and plans extracted to extra large flat storage from records of departments not assigned an individual map prefix

Date: 1880

Reference: MPII 1/86/9

Subjects: Archives and libraries | Europe and Russia | Maps and plans | Treaties and alliances

•

1 item extracted from FO 97/532. Montenegro (now in Serbia and Montenegro); Albania. 'Outline map. ...

Public Record Office: Maps and plans extracted to flat storage from various series of records held at the Public Record Office, Kew, from 1977. 1 item extracted from FO 97/532. Montenegro; Albania. 'Outline map. Giving the various proposed boundaries between Montenegro and Albania.

Ministria e Jashtme, FO 97/532. Mali i Zi; Albania. Hartat dhe planet e nxjerra nga magazina e sheshtë nga seritë e ndryshme të regjistrimeve të mbajtura në Zyrën e Regjistrimit Publik, Kew, nga viti 1977. Kufijtë e propozuar ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë.

Held by:	The National Archives - Maps and plans extracted to flat storage from various departments held at the Public Record Office, Kew
Date:	1880
Reference:	MFQ 1/46
Subjects:	Archives and libraries Communications Europe and Russia International Maps and plans Treaties and alliances

•

Two maps of Greece, first showing revision of northern frontier with Albania and Macedonia in 1880, second showing ethnological make up of Greece, Bulgaria and Turkey

PENNINGTON FAMILY OF MUNCASTER. Maps. Europe. Two maps of Greece, first showing revision of northern frontier with Albania and Macedonia in 1880, second showing ethnological make up of Greece, Bulgaria and Turkey

Dy harta të Greqisë, që fillimisht tregonin rishikimin e kufirit verior me Shqipërinë dhe Maqedoninë në vitin 1880, duke treguar etnologjinë e dytë të Greqisë, Bullgarisë dhe Turqisë.

Held by: Cumbria Archive and Local Studies Centre, Whitehaven

Date: 1880 – 1919

Reference: D PEN/Maps/23

•

Map showing the southern boundary of Montenegro according to the Treaty of Berlin, including the...

Foreign Office: Library: Maps and Plans. Map showing the southern boundary of Montenegro according to the Treaty of Berlin, including the Vilaget of Scutari and northern and central Albania. 1:300,000. Austrian Staff.

Ministria e Jashtme: Biblioteka: Hartat dhe Planet. Harta që tregon kufirin jugor të Malit të Zi sipas Traktatit të Berlinit, duke përfshirë Vilajetin e Shkodrës dhe Shqipërisë Veriore dhe Qendrore. 1: 300,000. Stafi austriak.

Held by: The National Archives - Foreign Office

Date: 1880

Reference: FO 925/3252

Subjects: Europe and Russia | International | Maps and plans | Treaties and alliances

1 item (referring to a boundary proposal for Turkey, discussed in a memorandum of Sir...

Public Record Office: Maps and plans extracted to flat storage from various series of records of the Foreign Office. the area between

Berat (now in Albania), and Preveza, the Gulf of Vólos and Salonica (now Thessaloníki) (all now in Greece). Reference table. Lithographed at the Intelligence Branch, Quartermaster

Ministria e Jashtme

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra në ruajtjen e sheshtë nga seritë e ndryshme të të dhënave të Ministrisë së Jashtme. Zona midis Beratit (tani në Shqipëri) dhe Prevezës, Gjirit të Volos dhe Salonit (tani Selanikut) (të gjitha tani në Greqi). Tabela e referencës. Lithographed në Degën e Inteligjencës (britanike).

Held by:	The National Archives - Foreign Office: maps and plans extracted to flat strage
Date:	1880
Reference:	MPK 1/517
Subjects:	Archives and libraries Europe and Russia International Maps and plans Middle East

•

1 item extracted from FO 78/3169. Ottoman Empire, Greece. 'Turco-Greek Frontier': map of the area...

Public Record Office: Maps and plans extracted to flat storage from various series of records held at the Public Record Office, Kew, from 1977. 1 item extracted from FO 78/3169. Ottoman Empire, Greece. 'Turco-Greek Frontier': map of the area between Berat (now in Albania) and Salonica (now Thessaloniki), Preveza and the Gulf of Volos (all

Ministria e Jashtme FO 78/3169. Perandoria Osmane, Greqi. 'Kufiri turko-grek': harta e zonës midis Beratit (tani në Shqipëri) dhe Selanikut (tani Selanikut), Prevezës dhe Gjirit të Volosit (Greqi)

Held by:	The National Archives - Maps and plans extracted to flat storage from various departments held at the Public Record Office, Kew
Date:	1880 – 1881
Reference:	MFQ 1/334
Subjects:	Archives and libraries Europe and Russia Food and drink Maps and plans Middle East Treaties and alliances

'Turco-Greek Frontier Austrian map reduced one half': map showing the area between Berat (now in...

Public Record Office: Maps and plans extracted to flat storage from various series of records of the Foreign Office. 3 items extracted from FO 83/619.... 'Turco-Greek Frontier Austrian map reduced one half': map showing the area between Berat (now in Albania), Salonica (now Thessaloníki, Greece), Preveza (now in Greece) and the Gulf of Volo (now Vólos

'Historia Austro-Greke kufitare austriake u reduktua gjysmën': hartë që tregon zonën midis Beratit (tani në Shqipëri).

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra në ruajtjen e sheshtë nga seritë e ndryshme të të dhënave të Ministrisë së Jashtme. 3 objekte të nxjerra nga FO 83/619 "Hartë Austro-Greke Kufi Austriake reduktuar gjysmën": hartë që tregon zonën midis Beratit (tani në Shqipëri), Selanikut (tani Thessaloniki, Greqi), Prevezës (tani në Greqi) dhe Gjirin e Volo (tani Vólos).

Held by:	The National Archives – Foreign Office: maps and plans extracted to flat strage
-----------------	---

Date: 1880
Reference: MPK 1/378/2
Subjects: Archives and libraries | Europe and Russia | International | Maps and plans | Middle East | Treaties and alliances

Ottoman Empire, Greece. 'Turco-Greek Frontier': three copies of a map of the area between Berat...

Public Record Office: Maps and plans extracted to rolled storage from various series of records. 11 items, formerly part of WO 78/1009. Maps of Ottoman... Ottoman Empire, Greece. 'Turco-Greek Frontier': three copies of a map of the area between Berat (now in Albania) and Salonica (now Thessaloniki), the Gulf of Volos and Preveza (all now in Greece

Perandoria Osmane, Greqi. 'Turqia dhe kufiri grek': tre kopje të një hartë të zonës midis Beratit ...

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra për ruajtjen nga seritë e ndryshme të regjistrimeve. 11 artikuj, më parë pjesë e WO 78/1009. Hartat e Perandorisë Otomane, Greqi. 'Kufiri turko-grek': tri kopje të një harte të zonës midis Beratit (tani në Shqipëri) dhe Selanikut (tani Selanikut), Gjirit të Volos dhe Prevezës (të gjitha tani në Greqi).

Held by: The National Archives - Maps and plans extracted to rolled storage from various departments
Date: 1880
Reference: MR 1/1889/1-3

Subjects: Archives and libraries | Asia | Europe and Russia | Maps and plans | Middle East | Treaties and alliances

Albania.

Foreign Office: Embassy and Consulates, Turkey (formerly Ottoman Empire): General Correspondence. Albania.

Shqipëri

Zyra e Jashtme: Ambasada dhe Konsullatat, Turqia (dikur Perandoria Otomane): Korrespondenca e përgjithshme. Shqipëri.

Held by: The National Archives - Foreign Office

Date: 1881

Reference: FO 195/1367

Subjects: Europe and Russia | International | Middle East

Albania and Greece. Map showing the new Greek boundary on 27 November 1881. Insets show ...

Public Record Office: Maps and plans extracted to extra large flat storage from various series of records of departments not assigned an individual map extract... Albania and Greece. Map showing the new Greek boundary on 27 November 1881. Insets show (i) proposals for the boundary in 1828 and (ii) boundaries in 1832 and 1881.

Shqipëria dhe Greqia. Hartë që tregon kufirin e ri grek më 27 nëntor 1881.

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra në ruajtje të sheshtë shtesë nga seritë e ndryshme të dosjeve të departamenteve që nuk janë caktuar për një hartë individuale të hartës ... Shqipëria dhe

Greqia. Harta tregon kufirin e ri grek më 27 nëntor 1881. Inset tregojnë (i) propozimet për kufirin në 1828 dhe (ii) kufijtë në 1832 dhe 1881.

Held by:	The National Archives - Maps and plans extracted to extra large flat storage from records of departments not assigned an individual map prefix
Date:	1881 – 1882
Reference:	MPII 1/86/14
Subjects:	Archives and libraries Europe and Russia Maps and plans

•

Outline map giving the various proposed boundaries between Montenegro and Albania from the Adriatic Sea ...

Foreign Office: Library: Maps and Plans. Outline map giving the various proposed boundaries between Montenegro and Albania from the Adriatic Sea to near Gusinji. 1:150,000. Inclosed in Capt Sale's despatch 18 of 12 March 1881.

Ministria e Jashtme: Hartë: kufijtë e propozuar midis Malit të Zi dhe Shqipërisë

nga deti Adriatik deri në Gusi. 1: 150.000. E mbyllur në dorëzimin e kapitullit të 18 të 12 marsit 1881.

Held by:	The National Archives - Foreign Office
Date:	1881
Reference:	FO 925/3139
Subjects:	Europe and Russia International Maps and plans

Europe: Balkans. Map to accompany memorandum on the Turco-Greek Frontier 1881: showing rivers, towns and...

Public Record Office: Maps and plans extracted to flat storage from various series of records of the Foreign Office. 23 items (originally among the papers... is now in Albania and Greece). Reference table to boundaries. Scale: 3.25 inches to 40 miles. Published by Stanford's Geographical Establishment, London. Originally part of a Foreign Office

Evropa: Ballkani. 'Harta për të shoqëruar memorandumin mbi kufirin turko-grek 1881': duke treguar lumenj, qytete dhe ...

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra në ruajtjen e sheshtë nga seritë e ndryshme të të dhënave të Ministrisë së Jashtme. 23 artikuj (fillimisht në mesin e letrave ... tani është në Shqipëri dhe Greqi). Tabela e referencës në kufijtë. Shkalla: 3.25 inç në 40 milje. Publikuar nga Krijimi Gjeografik i Stanfordit, Londër. Pjesë e Zyrës së Jashtme.

Held by:	The National Archives - Foreign Office: maps and plans extracted to flat strage
Date:	1881
Reference:	MPK 1/434/17
Subjects:	Archives and libraries Europe and Russia International Maps and plans Official publications

•

Ottoman Empire, Greece. 'Map of the Turco-Greek Frontier Reduced and Compiled from the Austrian Staff...

Public Record Office: Maps and plans extracted to rolled storage from various series of records. 11 items, formerly part of WO 78/1009. Maps of Ottoman... Ottoman Empire, Greece. 'Map of the

Turco-Greek Frontier Reduced and Compiled from the Austrian Staff and Kiepert's maps': covering the area between Berat (now in Albania), and Salonica (now in Greece)

Perandoria Osmane, Greqi. 'Harta e kufirit turko-grek të reduktuar dhe hartuar nga Shtabi Austriak ...

Zyra e Regjistrimit Publik: Hartat dhe planet e nxjerra për ruajtjen e ruajtjes nga seritë e ndryshme të regjistrimeve. 11 artikuj, më parë pjesë e WO 78/1009. Hartat e Perandorisë Otomane, Greqi. 'Harta e kufirit turko-grek e reduktuar dhe e hartuar nga Shtabi Austriak dhe hartat e Kiepert': duke mbuluar zonën midis Beratit (tani në Shqipëri) dhe Selanikut (tani në Greqi).

Held by:	The National Archives - Maps and plans extracted to rolled storage from various departments
Date:	1880 – 1881
Reference:	MR 1/1889/4
Subjects:	Archives and libraries Europe and Russia Maps and plans Middle East

Këto fonde arkivore dhe shumë vëllime me dokumente diplomatike, të cilat për temë kanë çështjen shqiptare në përgjithësi dhe periudhën e LSHP-së në veçanti, që gjenden në The National Archives, janë shumë të rëndësishme për të kompletuar studimet e gjithanshme historike, politike, diplomatike, ushtarake dhe ekonomike të gjeografisë shqiptare dhe të rrjedhave historike në Ballkan.

Alban Dobruna
Ilirjana Kaceli

ROLI I AHMET KORONICËS NË LIDHJEN SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Përmbledhje

Ahmet Koronica, patriot dhe veprimtar i dalluar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, gjyqtar (kadi) me origjinë nga Gjakova përfaqësoi Rrafshin e Dukagjinit në Komitetin Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare në Stamboll. Dha një ndihmesë të rëndësishme në themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe që një nga anëtarët më aktivë në Degën e Gjakovës. U shqua në organizimin dhe drejtimin e aksionit të armatosur që u zhvillua në Gjakovë në ditët e para të shtatorit 1878 kundër Mehmet Ali pashës dhe Abdulla pashë Drenit. Pas aksionit të Gjakovës kërkoi që Lidhja t'u kundërvihet njëherësh si monarkive fqinje, ashtue dhe Portës së Lartë për të siguruar përfundimisht tërësinë dhe autonominë e Shqipërisë. Me këtë ra nëkonflikt me udhëheqësit e tjerë të Lidhjes, të cilët ishin për një ngritje shkallë-shkallë të Lëvizjes Kombëtare. Pas vjeshtës së vitit 1878, kur u largua nga Gjakova dhe u vendos si kadi në Manastir, gjurmët e tij pothuajse humbin krejtësisht.

Fjalët çelës: Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Ahmet Koronica, Rrafshi i Dukagjinit, Gjakova, Manastiri.

Ahmet ef. Koronica, ndër personalitetet e shquara të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si patriot, kadi dhe myderriz¹, veprimtar i dalluar i

¹ Myfta Memia, *Ahmet Koronica*, Fjalor enciklopedik shqiptar 2, Tiranë, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2008, f. 1291; Nuredin Ahmeti, *Krerët*

degës (i komitetit) të Lidhjes në Gjakovë² rridhte nga një familje e vjetër aristokrate nga Gjakova, e cila pas shtrirjes së Perandorisë Osmane, për hir të ruajtjes së pronave dhe pozitës në shoqëri ndër të paret kaluan në fenë islame. Këtë e bënë me që u bindën se për një kohë të gjatë do të vazhdojë euforia e Perandorisë Osmane në trevat shqiptare dhe atyre ballkanike. Mbiemri Koronica si shumë familje në Gjakovë mbajnë emra të fshatrave nga kanë ardhur si: Kusari, Doli, Ponosheci, Raça, Perteshoni (nga fshati Pjetërshan), Sheremeti etj. Është karakteristikë për t'u përmendur se fshatrat e lartpërmendura sot janë të banuar kryesisht nga popullsi shqiptare të besimit të krishterë, por të gjithë pjesëtarët e atyre familjeve që kanë ardhur nga ato fshatra dhe jetojnë në Gjakovë duke bartur atë patronim sot i takojnë besimit islam. Siç duket konvertimi fetar është bërë që prej kohës kur kanë ardhur në qytet, asnjë pjesëtar i këtyre familjeve që jetojnë në Gjakovë nuk i takon besimit të krishterë, por këto fshatra pothuajse janë të banuar nga shqiptarë të besimit të krishter-katolik³. Mirëpo vitet që do të pasonin brenda familjes Koronica në fillet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare përherë është përcjellur ndjenja kombëtare nëpër gjenerata dhe është shprehur tendenca që edhe te të tjerët të ruhet tradita shqiptare. Më të kaluar në fenë islame pjesëtarë të familjes Koronica u inkuadruan në administratën perandorake nëpër poste të ndryshme në të gjitha viset e Shqipërisë, Bosnjës, në territoret e e Maqedonisë së sotme dhe Bullgarisë.

Në Gjakovë familja Koronica mbanin nën përkujdesje komunën dhe kishin ndikim vendimtar në politikat që udhëhiqte ajo. Kështu Ahmet Koronica shpesh ndërronte komandantët e garnizonit osman dhe qeveritarët perandorak në qytetet e Gjakovës. Ai komunikonte me qarqet vendimarrëse në Stamboll, të cilave u ankohej

fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në Vilajetin e Kosovës (1878-1912), Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011, f. 56.

² Ramiz Abdyli & Abdurraman Zylfiu, *Fjalor historik ngjarje, personalitete dhe shprehje*, Shkup-Preshevë, 2009, f. 20.

³ Migena Arllati & Muhamet Rogova, *Patronimet në Gjakovë, mbiemrat, emrat, familjarë*, Gjakovë: Shtëpia botuese: Shoqata e Intelektualëve "Jakova", 2015, f. 49.

për punën jokorrokete të tyre dhe kërkonte që ata të transferohen pasi iu kishte kurdisur kurtha të ndryshme, dhe pas kësaj vinte fermani për transerimin e tyre nga postet në Gjakovë. Ahmet Koronica si njeri i ngritur e bënte këtë që të mos lejonte komandantët ushtarakë dhe qeveritarët perandorakë të qëndrojnë gjatë në Gjakovë nga vetë fakti që ata të mos lëshojnë rrënjë në qytet dhe mos të lidhen me njerëzit që kishin influenë, që ata të mos i ndjeknin prirjet servile ndaj këtyre pushtetarëve që vinin e shkonin dhe forcimin e pozitës së tyre në shoqëri dhe për përfitime materiale.

Familja Koronica mbante një numër të konsiderushëm të njerëzve të armatosur. Përveç kësaj veçanërisht ai kishte lidhje dhe besë me shumë bajraktarë të malsive shqiptare, kështu që në rast nevoje mund të mbledhte një ushtri të konsiderueshme për një kohë të shkurtër. Këtë ia mundësonte edhe pasuria familjare, sepse disa nga bajraktarët i mbante lojalë nga veti edhe me dhurata e para. Familja sipas tradites shqiptare kishte dy oda burrash. Përveç ithtarëve dhe bashkëmendimtarëve të familjes, që ishin prezent çdo here, aty vinin edhe persona të viseve të ndryshme të cilët vinin enkas për qëllime të ndryshme në Gjakovë. Dominonin temat për pozitën shoqërore, politike, çështje të traditës kombëtare, të arsimimit dhe zhvillimit të saj etj., prandaj odën e familjes Koronica e frekuentonin personat më të ngritur dhe më të arsimuar të kësaj trëveve. Kështu, gjithmonë ishin prezentë njerëzit e familjeve Ferizi, Binishi, Buza, Morina, Olloni, Kusari etj. Aty shpesh strehoheshin edhe njerëzit të cilët i ndiqte pushteti për arsye politike. Falë fuqisë familjare, të tillë njerëz gëzonin njëfarë azili, sepse pushteti me t'u njoftuar për strehimin e personave në kërkim në familjen Koronica, përkohësisht e ndërprente ndjekjen për të mos u ngatërruar më thellë.

Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare i njohur më shumë me emrin Komiteti i Stambollit⁴ u

⁴ Komiteti i Stambollit ishte vazhdimi i Komitetit të Janinës. U krijua në maj 1877, i cili shërbeu si qendra drejtuese e këtyre rretheve. Në përbërje të tij kishte

themelua më 18 dhjetor 1877 në qytetin e Stambollit nga një grup intelektualësh të shquar shqiptar, midis të cilëve ishin: Abdyl Frashëri. Naim Frashëri, Sami Frashëri, Ymer Prizreni, Jani Vreto, Pashko Vasa, Zija Prishtina, Mehmet Ali Vrioni, Koto Hoxha, Seid Toptani, Iliaz Dibra, Mihal Harito, Mustafa Nuri Vlora, Mane Taihi, me qëllim të mundësimit të një autonomie të kufizuar për shqiptarët brenda Perandorisë Osmane⁵. Në mbledhjen themeluese në këtë Komitet ishte edhe Ahmet Koronica. Ai si kadi i kishte një kulturë politike që i ndihmoi në sensin e tij si një njeri praktik dhe organizativ, mori pjesë si figurë e shquar e me influencë jo vetëm në Gjakovë, por në tërë territorin e Rrafshit të Dukagjinit⁶ dhe kjo karizmë e tij meritoi të qëndrojë përkrah familjeve të rëndësishme shqiptare, të cilat drejtonin jetën ekonomike dhe politike të katër vilajeteve shqiptare në Perandorinë Osmane.

Në programin politik të Komiteti të Stambolli përfshihej teza mbi organizimin e kryengritjes së armatosur kundërosmane dhe krijimin e shtetit kombëtar shqiptar. Këtë e dëshmojnë të gjitha memorandumet dhe promemorjet të paraqitura nga ky komitet e me të gjitha ato njoftoheshin qeveritë e vendeve evropiane se: "Po lind një çështje shqiptare, shqiptarët kërkinë të drejtën të hyjnë në gjirin e familjes së madhe evropiane, prej së cilës janë një pjesë"⁷. Komiteti vendosi gjithashtu që të zhvilloheshin bisedime me Greqin për të arritur një aleancë shqiptaro-greke sipas platformës së parashtruar nga Abdyl Frashëri⁸. Bisedimet mes shqiptarëve dhe grekëve u zhvilluan në tre ruande (Janinë, korrik 1877; Stamboll, dhjetor 1877; Korfuz,

familje të rëndësishme shqiptare, si: Frashëllinj, Vrionasit, Vlorajt, Vasjarët, Haritot, Dinot etj. Komiteti drejtohej nga Abdyl Frashëri.

⁵ Robert Elsie, *Fjalori historik i Shqipërisë*, Tiranë: Uegen, 2011, f. 321.

⁶ *Fjalor enciklopedik Shqiptar*, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH, 1985, f.532.

⁷ Muharrem Fetiu, *Veprimtaria politike-kulturore e Komiteti i Stambollit*, (Tezë e magjistraturës në dorëshkrim), Universiteti i Kosovës, Fakulteti Filozofik, Prishtinë, 1981, f. 42.

⁸ *Historia e popullit shqiptar II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek. XIX-1912*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë; Instituti i Historisë, 2002, f. 143.

shkurt 1878). Por të gjitha takimet përfunduan pa rezultat, pavarësisht lëshimeve që bënë shqiptarët. Preokupimi me tokat e “grekëve të paçliruar” dhe fati i Megali Ides influencoi qëndrimin e Greqisë në marrëdhënie me shqiptarët⁹. Përvojën e këtyre orvatjeve e përmblodhi më vonë Abdyl Frashëri me fjalët se qeveria greke (e kjo vlente po aq për atë serbe e malazeze) kërkonte në të vërtetë të shqiptarët “jo aleatë, por të nënshtuar”¹⁰.

Ndërkohë ngjarjet në Perandorinë Osmane pësuan një kthesë rrënjësore. Kriza lindore e viteve 1875 – 1878, në radhë të parë luftërat malazezo–osmane, serbo–osmane, ruso–osmane, disfatat e ushtrisë osmane në frontet e luftës, pushtimi i tokave të banuara me shqiptarë nga fqinjët veriorë – Serbia dhe Mali i Zi, numri i madh i muhaxhirëve shqiptarë që vërshuan në vilajetet e Shkodrës dhe të Kosovës me gjendjen e tyre të mjerueshme dhe përzierja në çështjen lindore të Fuqive të tjera të Mëdha i dhanë krizës një drejtim tjetër, në përputhje me synimet ekspansioniste të Fuqive të Mëdha dhe në kundërshtim sidomos me interes e popullit shqiptar¹¹, shkaktuan një tronditje të paparë të popullsisë shqiptare jo vetëm në viset kufitare të kërçënuara drejtëpërdrejt nga ushtritë pushtuese, por edhe të shqiptarët e viseve të brendshme, të cilët u bindën më shumë si asnjëherë më parë se Perandoria Osmane nuk do të ishte në gjendje të mbrojtë shtetasit e saj nga kërcënimet e jashtme. Prandaj, në këto rrethana dramatike, Komiteti Shqiptar i Janinës, i kryesuar nga Abdyl Frashëri, vendosi që të shndërrohej nga një komitet ndërkrahinor në

⁹ Ledia Dushku, *Bashkëpunimi shqiptaro-grek dhe kursi politik i Megali Idesë 1877-1878*, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881 (Simpozium ndërkombëtar), Prishtinë, Botoi: Instituti i Historisë-Prishtinë, 2011, f.246.

¹⁰ Aleks Buda, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rrënjët e saj historike*, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, (Fjalime dhe referate mbajtur me rastin e njëqindvjetorit të saj), Tiranë, Botoi: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë: Instituti i Historisë, 1978, f. 73.

¹¹ Stafanaq Pollo, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe lufta e saj për çlirimin e bashkimin kombëtar*, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, (Fjalime dhe referate mbajtur me rastin e njëqindvjetorit të saj), Tiranë, Botoi: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë: Instituti i Historisë, 1978, f. 83.

një komitet kombëtar shqiptar, i cili do të mbronte interesat e shqiptarëve në të gjitha vilajetet e banuara me shqiptarë. Kështu, udhëheqësit e Komitetit të Janinës ftuan në Stamboll, pos deputetëve të zgjedhur në parlamentin osman, edhe disa patriotë të tjerë të shquar të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare që të merrnin pjesë në mbledhjen për formimin e një komiteti shqiptar, e cila u mbajt më 18 dhjetor 1877, me ç'rast u formua organizata patriotike Komiteti Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare, apo siç quhet zakonisht Komiteti i Stambollit.¹² Si anëtar i këtij komiteti në ballë të të cilit qëndronte Abdyl Frashëri, krahas Pashko Vasës, Jani Vretos, Sami Frashërit, Ymer Prizrenit, Zija Prishtinës, Iljaz Dibrës, Mehmet Ali Vrionit, Mihail Haritos, Seid Toptanit, Mustafa Vlorës, Mane Tahirit e të tjerëve, përmendet edhe Ahmet efendi Koronica.¹³

Pas shumë debatesh rreth miratimit të programit politik, i cili në fillim mbronte idenë e organizimit të kryengritjes së armatosur kundër pushtimit osman dhe të formimit të shtetit kombëtar shqiptar si synim afatgjatë të shqiptarëve dhe programit taktik që nënkuptonte bashkëpunimin e mundshëm shqiptaro-grek¹⁴, për të hetuar mundësinë e një aleance kundër ekspansionit të Mali të Zi e Serbisë, të përkrahur nga Rusia, por ato dështuan. Përvojën e këtyre orvatjeve e përmbodhi më vonë Abdyl Frashëri me fjalët se qeveria greke (e kjo vlente po aq për atë serbe e malazeze) kërkonte në të vërtetë të shqiptarët “jo aleatë, por të nënshtroar”¹⁵, mirëpo komiteti megjithëse nuk arriti të ngrinte degët e veta brenda vendit, përmes anëtarëve të vet, të cilët e përqendruan veprimtarinë e tyre në Shqipëri, filloi të

¹² Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878 – 1881) I*, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1989, f. 133: Më tutje: K. Frashëri LSHP I. Idem, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878 – 1881*, “Toena”, Tiranë, 1997. 49. Më tutje: K. Frashëri. LSHP.

¹³ *Vep. cit.* 134.

¹⁴ *Po aty*.

¹⁵ Aleks Buda, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe rrënjët e saj historike*, Konferenca Kombëtare e Studimeve për lidhjen Shqiptare të Prizrenit 1878-1881 I, Tiranë: Botoi: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë: Instituti i Historisë, 1979, f. 26.

luante një rol mjaft aktiv. Midis tyre u dalluan Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri, Iliaz Dibra dhe Ahmet Koronica¹⁶, shumica prej tyre u kthyen në atdhe, aty gjetën një atmosferë tronditëse politike të shkaktuar nga përparimi i shpejtë i ushtrive ruse, serbe, malazeze dhe nga gjendja e mjerueshme e refugjatëve të dëbuar me forcën e armëve nga trojet e tyre shekullore.¹⁷

Në Gjakovë Ahmet efendi Koronica hasi në një gjendje tejet të tendosur. Në qytet dhe në rrethinën e tij kishte filluar të shtohesh pakënaqësia ndaj pushtetit osman që në ditët e para të Krizës Lindore 1875 – 1878, atëherë kur Porta e Lartë po bënte përpjekje për t'i rekrutuar në masë shqiptarët në radhët e bashibozukëve, të cilët dëshironte t'i shfrytëzonte kundër Serbisë dhe Malit të Zi, që ishin në luftë kundër Perandorisë Osmane. Luftërat serbo-osmane dhe malazezo-osmane kishin shkaktuar një gjendje anarkie të cilën e shfrytëzuan grupe të ndryshme plaçitësisht¹⁸.

Gjendja e krijuar nga rreziku i pushtimit të tokave shqiptare prej shteteve fqinje shkaktoi shpërthimin e një dufi patriotik, që përfshiu të gjitha shtresat e shoqërisë shqiptare¹⁹. Kjo zgjoi edhe interesimin e Fuqive të Mëdha, të cilat nëpërmjet të përfaqësuesve të tyre filluan të krijonin kontaktet e para me krerët e lëvizjes çlirimtare shqiptare. Kështu, sipas një burimi serb, përfaqësuesit e Anglisë që nga viti 1877 mbanin kontakte të shpeshta me Haxhi Zekën dhe Ahmet Koronicën dhe bënë propagandë në Kosovë në favor të Anglisë²⁰.

¹⁶ Gazmend Shpuza, *Mbledhja e Kuvendit të Prizrenit dhe aktet e para të tij (10-15 qershor 1878)*, "Studime historike", Tiranë: Akademia e Shkencave RSH: Instituti i Historisë, nr. 3-4, 1998, f. 44.

¹⁷ *Vep. e cit.*, f. 39.

¹⁸ Masar Rizvanolli, *Veprimtaria e Ahmet Efendi Koronicës gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit*, "Kosova", Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, nr. 26, 2005, f. 143.

¹⁹ *Lidhja e Prizrenit*, "Diturija", volum i tretë, korrik, gusht, shtator, 1928, nr. 9, 10, 11, f.322.

²⁰ Masar Rizvanolli, *Lufta e Sebisë dhe e Malit të Zi për pushtimin e tokave shqiptare gjatë Krizës Lindore 1875-1878*, Gjakovë: Shoqata e Intelektualëve "Jakova", 2007, f. 204.

Sulltani, nga ana tjetër dëshironte t'i mbante në anën e tij shqiptarët e zhgënjyer në Perandorinë Osmane, e cila u tregua e paaftë për t'i mbrojtur tokat e të parëve të tyre. Për këtë arsye iu shkroi krerëve fetarë Ahmet efendi Koronicës, kadiut të Gjakovës Ymer efendiut, myderrizit të Prizrenit dhe Jonuz Zyhdit efendiut, myftiut të Dibrës letra²¹ përmbajtja e saktë e të cilave nuk është e njohur.

Nënshkrimi i Traktatit të Shën Stefanit e ashpërsoi edhe më shumë gjendjen edhe më parë të tendosur në Shqipëri, të cilën e përfshiu vala e protestave kundër copëtimit të tokave shqiptare nga shtetet fqinje. Në shumë qytete shqiptare u formuan komisione vendore, të cilat organizonin forca ushtarake për mbrojtjen e tokave të tyre, për mbledhjen e ndihmave materiale për muhaxhirët që bridhnin rrugëve dhe për armatimin dhe ushqimin e forcave të armatosura vullnetare të vetëmbrojtjes. Kjo atmosferë kishte përfshirë qysh në prill 1878 edhe Gjakovën me rrethinë. Krerët e lëvizjes popullore në Gjakovë, pos përgatitjeve konkrete që bënë për mbrojtjen e tërësisë tokësore të Shqipërisë, iu drejtuan me protesta edhe Fuqive të Mëdha kundër vendimeve të padrejta të Marrëveshjes së Shën Stefanit që shkelnin të drejtat më elementare njerëzore të popullit shqiptar.²²

Lëvizja për thirrjen e një kuvendi mbarëkombëtar, i cili do të vendoste mbrojtjen me armë të të gjitha tokave shqiptare kishte përfshirë të gjitha viset shqiptare dhe të gjitha shtresat shoqërore. Prandaj Komiteti i Stambollit, i cili mori nismën për formimin e Lidhjes Shqiptare, nuk e kishte aq vështirë për t'ia arritur qëllimit. Ai zgjodhi një komision të posaçëm për organizimin praktik të një kuvendi kombëtar. Dihet vetëm se shumica ishin nga Prizreni dhe Gjakova. Prej tyre njohim vetëm emrat e Ymer efendi Prizrenit dhe të Ahmet efendi Koronicës. Komisioni kishte për detyrë të ftonte zyrtarisht të gjitha krahinat e vendit për të dërguar delegatët në

²¹ Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit e veprimet e saja 1878 – 1881*, Tiranë, 1939, f.17.

²² Masar Rizvanolli, "Veprimtaria e Ahmet Efendi Koronicës'...,f. 145.

kuvendin kombëtar të Prizrenit dhe të caktonte datën e mbajtjes së tij.²³

Ahmet efendi Koronica bashkë me Abdyl Frashërin, Iljaz pashë Dibrën, Sheh Mustafa Tetovën, Ali bej Gucinë etj. të ftuar në Stamboll te sulltani, kur panë se ai po e zvarriste me qëllim audiencën, u nisën për në Kosovë në mëngjesin e 8 qershorit. Pra, Lidhja Shqiptare ishte fuqizuar shumë, kishte marrë një rrugë që paraqiste rrezik edhe për sundimin e vetë sulltanit-halif. Pastaj, meqë ishte ftuar Kongresi i Berlinit nga Fuqitë e Mëdha me qëllim që t'i rishikojë vendimet e Marrëveshjes së Paqes së Shën Stefanit, sulltani nuk kishte më nevojë aq të madhe për Lidhjen Shqiptare për mbrojtjen e tërësisë territoriale të Perandoris Osmane²⁴. Në Selanik u bashkuan me ta edhe delegatët e tjerë të Vilajetit të Janinës. Në Prizren arritën në mbrëmje, më 9 qershor 1878.²⁵

Sipas një rapoti dërguar qeverisë serbe nga Prizreni, kontribut të madh në organizimin e kuvendit themelues të Lidhjes Shqiptare dha Ahmet Koronica, i cili kishte ardhur në Prizren nga Selaniku pët t'i tubuar njerëzit nga tërë Shqipëria Veriore dhe për t'i bashkuar në luftë kundër Serbisë dhe Malit të Zi. Ai, gjithnjë sipas këtij raporti, i kishte ftuar telegrafisht në një kuvend të përbashkët krerët e të gjitha qyteteve të Rumelisë, të Shqipërisë, të Bosnjës dhe të Hercegovinës. Konsulli austro-hungarez i Shkodrës Lipiçi e radhiste Ahmet efendi Koronicën, gjykatësin e Gjakovës, si njërin nga figurat më të shquara që merrnin pjesë në Kuvendin e Përgjithshëm në Prizren krahas Ali beg Gucisë, Iljaz pashë Dibrës, Hasan pashë Tetovës dhe Abdullah pashë Drenit.

²³ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 170, Cf. J. Hadži – Vasiljević, *Arb. Liga...*, f. 37 – 41, Gazmend Shpuza, *Mbledhja e Kuvendit të Prizrenit...*, f. 46.

²⁴ Skënder Riza, *Jeta dhe veprimtaria politike-patriotike e Abdyl Frashërit deri te Kongresi i Berlinit (1878)*, “Gjurmime albanologjike”, seria e shkencave historike, Prishtinë: Institutii Albanologjik i Prishtinës, XI-1981, 1982, f. 166.

²⁵ K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit ...*, f. 175.

Porta e Lartë nga frika se lëvizja kundër Traktatit të Shën Stefanit mund t'i dilte doresh ftoi nga fundi i majit 1878 në Stamboll personalitetet më të shquara të jetës politike shqiptare, midis të cilëve edhe Ahmet efendi Koronicën, për të penguar formimin e një lidhjeje, e cila nuk do të ishte nën kontrollin e saj. Por, siç e pamë, ata u nisën për Kosovë pa lejen e sulltanit dhe formuan Lidhjen e Prizrenit, mirëpo pa marrë parasysh divergjencat brendapërbrenda Lidhja shënon përgjithësisht shkallën më të lartë të bashkimit të popullit shqiptar të realizuar në kushtet e sundimit otoman. Në një takim të komandantit supreme të armatës ruse, E. I. Tottleban, me një përfaqësues të Lidhjes së Prizrenit, në periudhën qerrshor-gusht të vitit 1878, në pytjen se çfarë dëshirojnë shqiptarët, përfaqësuesi i përgjigjet: Shqiptarët dëshirojnë për veten asgjë më tepër sesa atë që është bërë për popujt e tjerë të Gadishullit Ballkanik - pranimin e pavarësisë dhe të drejtën që të themelojnë principatën e tyre të posaçme”.²⁶ Nga njëra anë, kjo është një prove e pagabueshme e zgjimit të tij politik, nga ana tjetër është parapërgatitja për ngjarjet e mëdha që e presin paskëtaj.²⁷ Por lufta e ashpër politike u zhvillua brenda Kuvendit të Përgjithshëm me rastin e miratimit të dokumenteve të para të Lidhjes. Kararnamenë, të propozuar nga sulltanistët e nënshkruan vetëm 49 vetë nga rrethi 110 sa ndodheshin në Kuvend. Nga 11 delegatë të Gjakovës atë e nënshkruan vetëm 4 sish. Ahmet efendi Koronica bashkë me Sylejman Vokshin, Bajram agë Gashin, Shaqir agë Currin, Binak Alinë, Ali Ibrën dhe Metali beun nuk e nënshkruan këtë dokument, që kishte për qëllim t'i jepte Lidhjes karakter islamik. Atë e nënshkruan vetëm Abdullah pashë Dreni, Mehmet Shaqir beu, Ahmet Hamdiu dhe Mehmet Kahremani²⁸.

²⁶ Shemsi Ajvazi, *Qendrimi i Rusise ndaj Lidhjes Shqiptare te Prizrenit*, “Perla”, Tiranë: Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi”, Viti VIII, nr.3-4(31), 2003, f. 37.

²⁷ Arben Puto, *Lidhja Shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të Kombit në vitet e Krizës Lindore*, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, (Fjalime dhe referate mbajtur me rastin e njëqindvjetorit të saj), Tiranë, Botoi Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë: Instituti i Historisë, 1978, f. 121.

²⁸ K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit...*, f. 191.

Bashkë me delegatë të tjerë në Gjakovë u kthyen edhe Ahmet efendi Koronica. Aty themeluan Degën e Lidhjes Shqiptare, e cila përfshinte trevat e Gashit, të Krasniqes, të Hasit, të Bytyçit, të Rekës, të Dushkajës etj. Ndonëse kryetar i parë i Degës në Gjakovë ishte Abdullah pashë Dreni, që i takonte krahut sulltanist të Lidhjes Shqiptare, Ahmet efendi Koronica bashkë me Sylejman Vokshin dhe me bashkëpunëtorët e tjerë të krahut patriotik luanin një rol të rëndësishëm në veprimtarinë e drejtë politike të Degës së Lidhjes Shqiptare në Gjakovë, që u pa shumë shpejt pas ardhjes së Mehmet Ali pashës në Shqipëri. Madje, sipas disa burimeve, kadiu i Gjakovës duhet ta kishte pasur fjalën kryesore në Degën e Gjakovës, kur dihet se Sylejman Vokshi ishte i zënë me punë të shumta në Këshillin Kryesor të Lidhjes Shqiptare. Në një raport të togerit Roos të Blandesbergut dërguar majorit Uilson nga Selaniku, oficeri anglez flet për karakterin, programin dhe udhëheqësit e Lidhjes Shqiptare. Si udhëheqës në Prizren përmend Haxhi Ymer efendiun dhe Ymer efendiun, në Prishtinë myftiun e Prishtinës dhe Zija beun “një shqiptar të pasur, pronar tokash në Prishtinë, myftiun e Prishtinës dhe Zija beun “një shqiptar të pasur, pronar tokash në Prishtinë dhe përreth saj”, ndërsa për Ahmet efendi Koronicën shkruan se “është udhëheqës në Gjakovë”. Më tutje vazhdon: “Në Pejë e Gjakovë janë të tjerë emrat e të cilëve nuk i di. Por këta të cilët i përmenda janë personat më me ndikim”²⁹.

Krerët e Lidhjes në Gjakovë ishin të brengosur për shkak të rrezikut që iu kërcënohej territoreve shqiptare nga depërtimi i Austro-Hungarisë në Pazarin e Ri dhe nga rreziku i rojave kufitare serbe. Porta e Lartë, nën trysninë e Malit të Zi dhe të Fuqive të Mëdha, emëroi Mehmet Ali pashën komisar për vendosjen e kufijve të rinj me Serbinë dhe me Malin e Zi. Prandaj në fillim të gushtit 1878 u ftuan urgjentisht në Prizren disa anëtarë të Këshillit të Përgjithshëm nga

²⁹ Skënder Rizaj, *Nëntë dokumente angleze mbi Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878 – 188)*, “Gjurmime albanologjike”, seria e shkencave historike, Prishtinë: Instituti Albanologjik - Prishtinë, X-1980,1981, f.187.

Dibra, Gjakova, Peja dhe nga qendra të tjera për të shqyrtuar masat që duhej marrë përballë kërcënimeve malazeze dhe gatishmërisë së Portës së Lartë për të dorëzuar Plavën dhe Gucinë³⁰. Nga Gjakova arritën në Prizren, sipas disa lajmeve që sjell një burim austro-hungarez nga Prizreni, anëtarët e Këshillit Bajram aga, prijës i bashibozukëve, anëtari i mexhllisit Sylejman Vokshi dhe kadiu Ahmet Koronica³¹. Më 14 gusht në Prizren u mbajt një mbledhje në të cilën u shqyrtua çështja e Plavës dhe Gucisë. Përfaqësuesit e rrymës sulltaniste në Lidhje kërkonin me këmbëngulje të respektohej vullneti i Portës së Lartë, ndërsa përfaqësuesit e rrymës patriotike, përkundrazi, kërkonin mbrojtjen e Plavës e Gucisë dhe të çdo pëllëmbë të tokave shqiptare me forcën e armëve, të cilat do t'i drejtonin kundër kujt do që do t'i cenonte interesat e popullit shqiptar.³²

Mehmet Ali pasha, pasi i njoftoi nëpërmjet kanalesh diplomatike përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha, të Serbisë dhe të Malit të Zi me misionin e tij arriti në Prizren më 25 gusht 1878. Menjëherë ai ftoi në bisedë disa krerë të Lidhjes, miq të tij të vjetër, të cilët u orvat t'i bindë për ta çuar në vend kërkesën e sulltanit për dorëzimin e Plavës dhe Gucisë. Nga ana tjetër, ai dërgoi në Guci një komision të posaçëm për të shqyrtuar mundësitë për dorëzimin paqësor të këtyre territoreve Malit të Zi³³. Të nesërmen, më 26 gusht, mareshali osman ftoi në mbledhje Këshillin Kryesor të Lidhjes dhe parinë e vendit dhe kërkoj nga të pranishmit që t'i pranonin kërkesat e Portës së Lartë dhe të Fuqive të Mëdha, duke theksuar se çdo veprim i kundërt do të ishte në dëm të vetë shqiptarëve dhe të Perandorisë Osmane. Si duket të

³⁰ Xh. Belegu, *Lidhja e Prizrenit...*, f. 44.

³¹ B. Hrabak, *Prvi izveštaji...*, f.265.

³² Xh. Belegu, *Lidhja e Prizrenit...*, f. 44, B. Hrabak, *Prvi izveštaji...*, f.264.

³³ K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit...*, f. 248, Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane (1878 – 1881). Dokumentet i shqipëroi dhe i komentoi Iljaz Rexha. Arkivi i Kosovës, Prishtinë 1978. 35, Skënder Rizaj. *Vrasja e Mehmet Ali pashë Maxharrit në Gjakovë sipas gazetës "Terxhymani Shark" (1878). "Horizontet e Historisë"*, 2, Prishtinë 1978. 110.

gjithë krerët e Lidhjes, me përjashtim të disa sulltanistëve, i kundërshtuan kërkesat e përfaqësuesit të sulltanit. Midis tyre u dallua Ahmet efendi Koronica. Në një raport të Jelinekut dërguar Andrashit, ndër të tjera, lexojmë: “Kadiu Ahmet efendi Koronica i Gjakovës protestoi kundër pranimiit përderisa traktati (i Berlinit – M. R.) i referohet shkëputjes së Gucisë, Plavës...” në një raport tjetër të plotësuar me të dhëna të reja mbi misionin e mareshalit osman po nga Prizreni thuhet se kundërshtarët më të rreptë të dorëzimit të Plavës dhe Gucisë ishin Ali pashë Gucia, “pastaj kadiu fanatik Ahmet efendi Koronica, i njohur prej Shkëlqesisë Suaj kadiu fanatik (Andrashit – M. R.) që prej relacioneve të zotit konsull (të Shkodrës – M. R.) Lippih në vitin 1876... siç duket me porosi nga lart doli me rrëmbim të egër kundër shkëputjes së Plavës dhe Gucisë. Kur Mehmet Aliu i vuri në dukje Koronicës sjelljen e tij të pahijshme duke i dhënë të kuptojë se do të kishte të drejtën dhe forcën ta lidhë dhe ta dorëzojë në Stamboll, Koronica ia priti se ai (Mehmet Aliu) nuk mund ta bënte këtë se edhe ai (Koronica) ka porositë e tij prej Stambollit.” Nga kjo shihet se Ahmet Koronica ishte një personalitet i rëndësishëm politik, i njohur mirë në qarqet politike të Stambollit, por, siç pamë më parë, edhe në ato të Vjenës.³⁴

Më 27 gusht 1878 dështoi mbledhja e ftuar nga Mehmet Ali pasha, ngase atë mbledhje e bojkotuan anëtarët e Këshillit Kryesor të Lidhjes, ku njëri ndër protestuesit kryesor ishte Kadia i Gjakovës Ahmet Efendi Koronica, kundër pranimiit të këtij traktati i cili është në dëm të Plavës dhe Gucisë. Madje, po atë ditë në një kafene në Marash, Ramadan Zeskoci, i ngarkuar nga Lidhja, vrau telegrafishtin e mareshalit, i cili e mbante korrespondencën me Stambollin në gjuhën frënge, gjë që kishte shkaktuar dyshime në radhët e Lidhjes.³⁵ Posa mori këtë lajm që e tronditi pa masë, mareshali urdhëroi arrestimin e menjëhershëm të vrasësit. Por Ramadan Zaskoci, sipas një raporti të

³⁴ Masar Rizvanolli, *Veprimtaria e Ahmet Efendi Koronicës*, ...f. 151.

³⁵ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit...*, f. 250, Xh. Belegu, *Lidhja e Prizrenit...*, 48.

Jelinekut, me ndihmën e dy shokëve të tij dhe të masës së tubuar me atë rast kishte dalë nga qyteti dhe ishte strehuar në Gjakovë, ku e ndjente veten më të sigurt³⁶. Konsulli austro-hungarez, vazhdon më tutje, se “personat e arrestuar këtu pas vrasjes së telegrafistit Arigirias janë të gjithë prej Gjakove dhe me Koronicën duhet të jenë bashkëfajtorë për të gjitha krimet e kryera”.³⁷

Disa krerë të Lidhjes dhe disa nëpunës shtetëror osmanë u orvatën ta bindnin përfaqësuesin e Portës që të mos nisej për në Gjakovë pa u marrë vesh më parë me Malësinë e Gjakovës dhe pa ia treguar shkaqet e udhëtimit të tij, “duke i thënë se banorët e Gjakovës janë shumë të rrezikshëm dhe se në atë mënyrë do ta rrezikojë jetën e vet”, mirëpo Mehmet Ali pashë Maxharri nuk i morri parasysht këto paralajmërime, andaj ai u nis për në Gjakovë.

Ahmet ef. Koronica i parapriu Mehmet Ali pashës për Gjakovë, ku e inkurajoi popullin me u ngrit kundër përfaqësuesit të Portës së Lartë. Dega e Lidhjes Shqiptare në Gjakovë shpalli kushttrimin me anën e të cilit ftoi të gjithë meshkujt e aftë për armë për të vazhduar rrugën për në Guci. Në qytet dhe rreth tij u grumbulluan luftëtarë nga Gjakova, Reka, Gashi, Krasniqja, Bytyçi, Hasi dhe Peja. Më 1 shtator 1878 në malin e Hereçit arriti edhe Ali pashë Gucia me forcat e tij që përbëheshin nga mijëra malësorë të armatosur me qëllim që ta kontrollojë rrugën që çonte për në Guci. Dy mijë vullnetarë nga Gjakova, Reka e Malësia që gjendeshin në Plavë e Guci, sapo mësuan për ardhjen e Mehmet Ali pashës, u kthyen për shtatë orë në Gjakovë nëpër bjeshkën e Bogiçes. Atyre iu bashkuan edhe shumë plavjanë e gucianë. Sipas Haxhi Vasiljeviqit, në Malin e Hereçit ishin të fshehur 6 mijë luftëtarë, “Udhëheqës dhe epror kryesor i këtyre shqiptarëve në Malin e Hereçit, sipas tij, ishte Korenica i njohur, ndërsa i atyre në Plavë dhe Guci, Ali pasha i Gucisë.” Mareshali osman posa mori vesh për pusinë e shqiptarëve në Hereç iu bind këshillës së Abdullah pashë

³⁶ Masar Rizvanolli, *Veprimtaria e Ahmet Efendi Koronicës...*, f. 152.

³⁷ *Po aty.*

Drenit për të mos e lëshuar përkohësisht Gjakovën. Nga ana tjetër, kryengritësit e fshehur në Malin e Hereçit, kur morën vesh se mareshali osman nuk do ta vazhdonte rrugën drejt kufirit, i lëshuan pozicionet e tyre dhe bashkë me Ali pashë Gucinë ranë në Gjakovë. Kjo sjellje ishte në frymën e marrëveshjes së arritur më herët me gjakovarët në praninë e tij dhe të Jakup Ferrit.

Me të arritur në Gjakovë Mehmet Ali pasha ftoi parinë e qytetit në bisedime për t'i njoftuar me misionin e tij. Për këto ngjarje bëjnë fjalë, pos burimeve të tjera, edhe disa burime shqiptare, disa dëshmitarë pjesëmarrës të drejtëpërdrejtë në to, që na krijojnë një pasqyrë më besnike të atmosferës së rëndë që mbretëroi në bisedimet e ashpra midis pashait osman dhe përfaqësuesve të Degës së Lidhjes, në radhë të parë të Ahmet Koronicës.

Sipas një anonimi gjakovar, krerët e qytetit, të mbledhur në kuvend për të shqyrtuar gjendjen e krijuar, shpallën kushttrimin drejtuar banorëve të Rekës dhe Malësisë: "Hiçni i madh e jo i vogël sa na ka ardh ni murtat, Mehmet Ali Pashë Maxharri me na çart besen e me leshu Plavë e Guci e me na marr shkau krejt." Gjithnjë sipas të njëjtit burim, kuvendi i krerëve të qytetit u mbledh në Terzihane, në zyrën e esnafit të terzive, ku u zgjodh komisioni për të biseduar me përfaqësuesin e sulltanit³⁸, i përbërë nga kadiu Ahmet efendi Koronica, Sylejman agë Vokshi, Ismail efendiu, myderrizi i Medresesë së Madhe dhe krerë të tjerë të Degës së Lidhjes në Gjakovë, të cilët me shumicë votash vendosën të kundërshtojnë dorëzimin e Plavës dhe të Gucisë.³⁹ Bisedimet e rrepta me mareshalin

³⁸ Masar Rizvanolli, *Dega e Lidhjes Shqiptare në Gjakovë*, Konferenca Shkencore e 100-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit I, (refereate dhe kumtesa të mbajtur në Seksionin e Historisë 6-9 qershor 1978), Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 1981, f. 203.

³⁹ Xh. Belegu, *Lidhja e Prizrenit...*, f. 50. Cf. Ton Gulia, *Vrasja e Mehmet Ali pashë Maxharrit*. "Fjamuri i Arbërit." Cozenca, 20 qershor 1883. AQSH. F. 143, d. 855, f. 6. sipas një kronike të kohës, më 1 shtator 1878 paria e Gjakovës u mbledhën te mejtepi Ruzhdie e nuk dihet se çka biseduan, por te Mehmet Ali pasha nuk shkuan. Cf. P. perja, *Kronikë për aksionin e Gjakovës*. 247.

osman e zhvilluan të dielën në mbrëmje, më 1 shtator 1878. Midis përfaqësuesve gjakovarë u dallua për gjuhën e ashpër kadiu i Gjakovës Ahmet efendi Koronica, i cili sipas Ton Gulisë, pjesëmarrës në bisedime, ishte “një hoxhë i gishtit dhe i divitit, që kurdoherë mbante në një dorë pushkën dhe në tjetrën xhybenë.” Në kërkesën e mareshalit osman për të pranuar dorëzimin e Plavës dhe të Gucisë, ai iu përgjigj: “Pasha hazretleri, jo ti, por edhe vetë sulltani të vijë këtu ne nuk do t’i dorëzojmë tokat që na i kanë lënë amanet stërgjyshërit tanë.”⁴⁰ Mehmet Ali pasha, duke parë se me të mirë nuk do të jetë në gjendje të bindë përfaqësuesit gjakovarë, e ndërroi tonin e bisedës dhe e kërcënoi Ahmet efendi Koronicën se po të vazhdonte të fliste në atë mënyrë ‘do ta dërgonte duarlidhur në Stamboll.’ Por kadiu trim i Gjakovës, pa iu trembur syri, ia ktheu si nëpër flakë: “Pashë, pashë, shiko se mos të dërgojmë ne ty duarlidhur”.⁴¹ Përgjigje të njëjtë mori pashai osman edhe nga Ali pashë Gucia, nga i cili kërkoi që të shpërndante forcat e armatosura. Por ai iu përgjigj se kurrë nuk do ta bënte këtë tradhti dhe e pyeti: “Çfarë do ti këtu, cilin ke pyetur ti që po ua dorëzon këto troje dushmanëve tanë, mos po jep tokat tuaja?”⁴²

Sipas Ymer Shabës, kushtrimin për rrethimin e pallatit të Abdullah Drenit e dha Ahmet efendi Koronica, i cili shkrepri pesë herë allti në ajër. Pas tij filluan të shtënat “tue bërtitë sa me t’a shti mëneren” për disa orë ‘vetëm në mure e pullaze.’⁴³ Pas kalimit të afatit të ultimatimit prej 24 orësh filloi lufta e vërtetë me shumë viktime nga të dy palët, të cilat qëllloheshin nga frengjitë e sarajit të Abdullah pashës, nga njëra anë, dhe nga minarja e Xhamisë së Kryepazarit prej nga shtinin luftëtarët e Krasniqës, nga minarja e Xhamisë së Islam begut, ku luftonin vullnetarët e Gashit dhe nga kulla e Sylejman Vokshit, prej nga shtinin luftëtarët e tij, nga ana tjetër.

⁴⁰ Masar Rizvanolli, *Ahmet Koronica: Edhe vetë Sulltani të vij këtu nuk do t’i dorëzojmë tokat që na i kanë lënë amanet stërgjyshërit tanë*, Gjakovapress, nr. 118, shtator 2018, f. 30.

⁴¹ *Po aty*.

⁴² Masar Rizvanolli, *Ahmet Koronica: Edhe vetë Sulltani të vij këtu...*, f.31.

⁴³ *Po aty*.

“Mehmet Aliu i plagosur në kofshën e djathtë, lidhi në një shkop një pëlhurë të bardhë, duke ia treguar popullit me shpresë se ndoshta do të shpëtojë akoma në çastin e fundit, por pa sukses. Me flamurin e bardhë në dorë dhe duke thirrur “La ilahi ill Allahi, ve Mohamed resul Allahi” u vërsul përjashta. Ai u prit me një breshëri plumbash dhe u plandos në këmbët e gjakësve të tij me gjoksin e hapur të shpuar si një shoshë.”⁴⁴.

Luftimet kundër mushirit osman vazhduan, me disa ndërprerje, deri më 6 shtator 1878, kur u vranë Mehmet Ali pasha, Abdullah pashë Dreni, Bajram agë Rrustemi, Shaqir agë Curri etj. Numri i përgjithshëm i të vrarëve arrinte përafërsisht në 400, ndërsa i të plagosurve në 700.⁴⁵

Të përmendim me këtë rast se, gjatë këtyre ngjarjeve, luftëtarët shqiptarë çarmatosën afro tri batalione nizamësh osmanë dhe me armët e zëna armatosën rreth 1800-2400 bashkëluftëtarë të tyre me pushkë të sistemit “Martini – Henri,” model 1871.⁴⁶

Misioni i Mehmet Ali pashës dhe fundi tragjik i tij lanë vragë të thella në Shqipëri dhe në arenën ndërkombëtare. Këtë mision e ndoqën me kujdes që nga fillimi si përfaqësuesit diplomatikë të Fuqive të Mëdha, nënshkruese të Traktatit të Berlinit, ashtu edhe korrespondentët e ndryshëm të shtypit, në radhë të parë të atyre shteteve që kishin interesa të drejtpërdrejta në Shqipëri. Prandaj, fill pas kësaj vrasjeje u bënë shumë analiza rreth shkaqeve të dështimit të këtij misioni rreth frymëzuesve dhe organizatorëve të revoltës së shtatorit, rreth karakterit, rreth autorëve të saj etj.

Vrasjen e Mehmet Ali pashës e shikuan me sy të ndryshëm forcat politike brenda Lidhjes Shqiptare. Qarqet sulltaniste mendonin

⁴⁴ Po aty.

⁴⁵ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit* ...,f. 258.

⁴⁶ Riza T. Drishti, *Problemi i armatimit në luftën e Lidhjes Shqiptare të themeluar në Prizren në vitet 1878 – 1881*. Konferenca Kombëtare e Studimeve për Lidhjen Shqiptare të prizrenit 1878 – 1881. II, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1981, 250.

se me këtë akt Lidhja kishte bërë një hap të pamatur, që e kishte kthyer Portën e Lartë kundër saj. Prandaj, të pakënaqur me një hap të tillë, ata u shprehën haptas kundër krerëve të Lidhjes Shqiptare. Konflikti i mundshëm midis Portës dhe Lidhjes i shqetësonte edhe qarqet e moderuara brenda saj, sepse kjo sjellje shkonte në favor të armiqve të popullit shqiptar – të shteteve fqinje ballkanike, pikërisht në kohën kur po qarkullonin lajmet mbi qëllimet e Austro-Hungarisë për vendosjen e trupave të saj në Sanxhakun e Jeni Pazarit. Kësodore, Lidhjes i kërcënohej rreziku i përçarjes së brendshme, rrezik të cilin e nxitën Ali pashë Gucia dhe Ahmet efendi Koronica, të cilët formuan “Lidhjen e Re” në Gjakovë dhe kërkuan nga komitetet krahinore të Kosovës, të Dibrës dhe të Shkodrës t’i ndërprisnin lidhjet me qendrën në Prizren dhe t’i bashkoheshin Gjakovës.⁴⁷ Dr. Hofman kishte marrë një lajm nga Gjakova, sipas të cilit “krerët e shqiptarëve të Gjakovës, Pejës, Gucisë dhe Plavës u mblodhën me ata të malësorëve në Jabllanicë, katër orë larg prej Gjakovës kah Peja”. Qëllimi i mbledhjes, të cilën e kryesonte Ahmet efendi Koronica mbahej i fshehtë, por sipas lajmeve që qarkullonin, pjesëmarrësit e saj “duan ta prishin besën e lidhur me Prizrenin, mbasi Prizreni nuk dëshironte të marrë bashkërisht përgjegjësinë për ngjarjet e Gjakovës.” Ali pashë Gucia dhe Ahmet efendi Koronica nuk pajtoheshin me qëndrimin e Lidhjes Shqiptare, e cila orvatej të evitonte konfliktet e reja me Stambollin pikërisht në kohën kur rrëzoheshin tokat shqiptare nga shtetet fqinje ballkanike. Sipas tyre duhej shfrytëzuar pozita superiore e Lidhjes ndaj monarkive ballkanike dhe Portës së Lartë e krijuar pas ngjarjeve të Gjakovës. Po të mos shfrytëzohej ky rast i volitshëm, i krijuar nga entuziazmi që kishte përfshirë pothuajse të gjitha shtresat e popullsisë, atëherë kjo pozitë do të ndryshonte në disfavor të shqiptarëve dhe të integritetit territorial të tyre. Për këtë arsye, mendonin ata, shqiptarët duhej të sulmonin të parët kundër ushtrive

⁴⁷ Masar Rizvanolli, *Qëndrimi i Malit të Zi ndaj misionit të Ali Pashës*, Shqiptarët në rrjedhat ballkanike, (Materiale të sesionit shkencor; mbajtur 17 dhe 18 qershor 1992), Prishtinë, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1996, f. 104.

malazeze dhe pas kësaj, edhe kundër ushtrive serbe për të zgjidhur në favor të tyre çështjen e kufijve, duke mos përfillur qëndrimin e Stambollit ndaj kësaj çështjeje. Ata shprehnin gatishmërinë e tyre edhe për ndonjë konflikt eventual me Portën.⁴⁸

Në këtë kuadër Ali pashë Gucia mori masa konkrete për fillimin e operacioneve luftarake kundër Malit të Zi. Më 14 shtator 1878 e njoftoi Komitetin e Lidhjes në Shkodër se kishte grumbulluar 30 mijë luftëtarë, të gatshëm për të sulmuar Malin e Zi. Ai ishte i bindur se në bazë të marrëveshjes së mëparshme, edhe shkodranët me malësorë ishin të gatshëm për luftë.

Mendimet e Ali pashë Gucisë dhe të Ahmet efendi Koronicës mbi një fitore të mundshme në një përleshje eventuale midis shqiptarëve dhe malazezëve e kishin njëfarë mbështetje në rrethanat konkrete të kohës, Mali i Zi ishte në një gjendje të vështirë ushtarake dhe ekonomike. Në luftën kundërosmane knjaz Nikola gëzonte përkrahjen e plotë të luftëtarëve trima të Hercegovinës, të cilët, që në fillim të Krizës Lindore më 1875 kërkonin bashkimin me Malin e Zi. Por me kërkesën e Austro-Hungarisë, Mali i Zi u detyrua të çarmatoste ushtrinë e Hercegovinës. Aspak më e mirë nuk ishte gjendja ekonomike-financiare e Malit të Zi. Ndihmën e rregullt financiare prej 20 mijë fiorinash, të cilët ia dërgoi Rusia për muajt korrik, gusht, shtator dhe tetor në tërësi e kishte borxh qeveria e Malit të Zi.

Do theksuar se “Lidhja e Re” në krye me Ali pashë Gucinë dhe Ahmet efendi Koronicën kishte mjaft përkrahës në krahina të ndryshme të Shqipërisë, në radhë të parë në Gjakovë, në Shkodër dhe në Dibër, ku i kishte mbështetësit e saj më të flaktë. Konsulli austro-hungarez në Shkodër, ndër të tjera shkruante: “Duket se këtu në Shkodër ata që duan të formojnë një parti ekstremiste të lidhur me Ali pashë Gucinë dhe me Ahmet efendi Koronicën, mendojnë se Porta nuk do të rrijë pa ndërhyrjen e saj hakmarrëse ndaj shqiptarëve... Unë

⁴⁸ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit...*, f. 267.

ende besoj se Ali pashë Gucia...ka synimin që t'i jep Lidhjes (së re-MR) së themeluar prej tij relievin e një kokëforti, duke ngulur këmbë për t'u kthyer në programin fillestar të Lidhjes.”⁴⁹

Me gjithë krijimin e një atmosfere të tillë pas ngjarjeve të Gjakovës, shumica e krerëve të Lidhjes Shqiptare nuk e miratonte programin politik të rrymës së “ekstremistëve”, e cila filloi të vepronte në mënyrë të pavarur me qendër në Pejë.⁵⁰ Mosmarrëveshjet midis dy rrymave u thelluan edhe më tepër rreth çështjes së fandëve, të cilët e mbrojtën Maxharr pashën në Gjakovë. Ahmet efendi Koronica me përkrahësit e tij mendonin se Lidhja duhej t'i dënonte rreptë fandët, të cilët në mbrojtje të mareshalit osman kishin vrarë vëllezërit e tyre dhe kishin shkelur besën e shpallur në qershor. Në raste të tilla Komiteti i Lidhjes Shqiptare parashikonte pushkatim për tradhti të lartë. Por, nga ana tjetër, Komiteti Kombëtar i Lidhjes Shqiptare e kundërshtonte kategorikisht një masë të tillë kundër fandëve që shpëtuan në Gjakovë, sepse një masë e tillë do të hapte serinë e hakmarrjeve të pandërprera që do të dëmtonin vetë Lidhjen Shqiptare.⁵¹ Prandaj përfaqësues të Lidhjes nga Prizreni shkuan në Fand për t'iu ofruar fandëve në rast që të shpërngulën nga Gjakova një vend tjetër për t'u vendosur “vetëm se t'i jepet fund kësaj grindjeje vëllazërore”.⁵²

Ahmet efendi Koronica u kthye nga Prizreni në Gjakovë (si duket për herë të fundit) më 30 shtator 1878 pikërisht në kohën e alarmimit të popullsisë së atjeshme se të gjithë muhamedanët e Sanxhakut të Jeni Pazarit po arratiseshin drejt Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit para marshimit të trupave austro-hungareze. Për qetësimin e malësorëve, të mbledhur në Gjakovë, pas këtyre lajmeve shqetësuese u nevojit një korrespondencë e dëndur me valiun dhe me mytesarifin e Jeni Pazarit derisa demantuan këto thashetheme.⁵³

⁴⁹ K. Frashëri, *Lidhaja Shqiptare e Prizrenit...*, f. 268.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ *Po aty*, f. 271.

⁵² Grini, Solsberit, Shkodër, 7 tetor 1878. Ark. i Kosovës.

⁵³ Masar Rizvanolli, *Qëndrimi i Malit të Zi ndaj misionit të Ali Pashës...*, f. 233.

Megjithatë, kadiu i Gjakovës para se të nisej në detyrën e re i siguroi krerët e tjerë të Gjakovës se do të kthehej aty “sa herë që do të ishte e nevojshme prania e tij në Gjakovë, të luftohej kundër armiqve të vendit.”⁵⁴ Ahmet efendiu e vazhdoi veprimtarinë e tij patriotike në kuadër të Lidhjes Shqiptare edhe gjatë qëndrimit të tij të shkurtër në Manastir, duke përkrahur programin politik të Komitetit të Stambollit, që u miratua në mbledhjet ndërkrahinore të Dibrës më 14 tetor 1878 dhe të Janinës më 31 tetor 1878, program që pasqyrohet në rezolutat e shkruara, me këtë rast, nga dora e Abdyl Frashërit.⁵⁵ Tash për tash, për mungesë informatash, nuk jemi në dijeni për veprimtarinë e mëtejshme të Ahmet efendi Koronicës deri në fillim të shtatorit 1879, kur vdekja mizore e ndau përgjithmonë këtë patriot të shquar dhe të nderuar nga të gjithë. Në lajmin e shkurtër për vdekjen e tij Ahmet efendi Koronica përmendet si “personalitet i rëndësishëm” i Lidhjes Shqiptare.

Në Këshillin e Përgjithshëm, që doli nga Kuvendi, u zgjodh edhe A. Koronica, i cili me bashkëpunëtorë themeloi Degën e Lidhjes Shqiptare. Ai u dallua për vrasjen e Mehmet Ali pashës gjatë rrugës për në Gjakovë, ku shkoi për t’ia dorëzuar Plavën dhe Gucinë Malit të Zi.

Vrasja e mareshalit osman, që pati jehonë të fuqishme si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë, shkaktoi mospajtime midis fraksioneve të Lidhjes Shqiptare. Ali pashë Gucia dhe A. Koronica, që konsideroheshin si ekstremistë nga diplomatët e huaj, formuan “Lidhjen e Re” në Gjakovë, të cilës iu bashkuan edhe degë të tjera. Ajo kërkonte organizimin e një sulmi të armatosur kundër Malit të Zi. Me këtë nuk u pajtuan rrymat tjera në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit.

A. Koronica, që mbeti në pakicë, e vazhdoi edhe më tej veprimtarinë e tij deri në janar 1879, kur u emërua kadi në Manastir

⁵⁴ *Po aty.*

⁵⁵ K. Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit...*, f. 277.

për ta mbajtur nën kontroll veprimtarinë e tij patriotike. Megjithatë ai mbajti lidhje sekrete me krerët e Lidhjes deri kur vdiq.

Për ndihmesën e tij në luftë kundër pushtuesit osman, Ahmet efendi Koronica u bë burim frymëzimi për krijues të ndryshëm në fusha të artit dhe të letërsisë.

Rezyme

Ahmet Koronica ishte patriot dhe veprimtar i dalluar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Gjyqtar (kadi) me origjinë nga Gjakova përfaqësoi Rrafshin e Dukagjinit në Komitetin Qendror për Mbrojtjen e të Drejtave të Kombësisë Shqiptare në Stamboll. Dha një ndihmesë të rëndësishme në themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe që një nga anëtarët më aktivë në degën e Gjakovës. U shqua në organizimin dhe drejtimin e aksionit të armatosur që u zhvillua në Gjakovë në ditët e para të shtatorit 1878 kundër Mehmet Ali pashës dhe Abdulla pashë Drenit. Pas aksionit të Gjakovës kërkoi që Lidhja t'u kundërvihej njëherësh si monarkive fqinje, ashtu edhe Portës së Lartë për të siguruar përfundimisht tërësinë dhe autonominë e Shqipërisë. Me këtë ra në konflikt me udhëheqësit e tjerë të Lidhjes të cilët ishin për një ngritje shkallë-shkallë të Lëvizjes Kombëtare. Pas vjeshtës së vitit 1878, kur u largua nga Gjakova dhe u vendos si kadi në Manastir, gjurmët e tij pothuajse humbin krejtësisht.

Martin BERISHAJ

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT NË SHTYPIN SLLOVEN

Shekulli i nëntëmbëdhjetë karakterizohet me procesin e emancipimit të popujve ballkanikë, posaçërisht për shkak të ndikimit të atyre forcave që garonin për dominim në Ballkan. Ky proces, për shkak të luftërave të tilla, nuk ishte vetëm i vështirë, por shpesh i nënshtrohej po asaj lufte qoftë me përmbajtje, qoftë me metoda.

Ndërhyrja e Fuqive të Mëdha në shumë fusha në vendet ballkanike kontribuoi në zgjerimin e shoqërisë qytetare në ato vende. Karakteri, dinamika dhe përmbajtja e zhvillimit, zbaticat dhe baticat e lëvizjeve kombëtare të vendeve ballkanike si dhe luftërat e tyre për pavarësi ishin më shumë të përcaktuara me ndikimet e jashtme sesa me ligjshmëritë e gjendjes së brendshme dhe strukturën e atyre vendeve ballkanike.

Krahas Rusisë dhe Austrisë, gjegjësisht Austro-Hungarisë, në këtë lojë ndihet interesi i Anglisë dhe i Francës, dy faktorëve kyç për Ballkan, të cilave në funde të viteve '60 iu bashkua edhe Italia me penetrimin e saj në Ballkan.

Kriza Lindore (185-1878) shkaktoi edhe egërsim shtesë në të gjitha komponentët e çështjes lindore, e kështu edhe të çështjes shqiptare. Ne arenën ndërkombëtare çështja shqiptare u paraqit në suaza të aranzhimit të marrëveshjes së Reichtadit, të cilën e lidhën Fuqitë e Mëdha më 8.7.1876 si refleks për garanci ndërkombëtare të Perandorisë Otomane dhe për shkak të traktateve ndërmjet Rusisë dhe Austro-Hungarisë. Austro-Hungaria përpiqej ta zvetënonte interesin e tretë për ndarje të zonave të ndikimit dhe zhvatjes së territoreve në vendet ballkanike. Të gjitha çështjet në Ballkan donte t'i zgjidhte me

marrëveshje dypalëshe, meqë “....qëllimi i traktatit të fshehtë që e nënshkruan me 18.1.1877 ishte mundësia të parandalohet formimi i një shteti të fortë sllav në Ballkan. Po qe se do të shpartallohej Perandoria Osmane, atëherë do të lejohej konstituimi i shteteve të pavarura siç janë: Bullgaria, Shqipëria dhe mbetjet e Rumelisë”.¹

Shtrirja horizontale e debatit rreth ndikimit apo “depërtimit të butë” austriak në truallin shqiptar hapi shtigje për lojëra diplomatike në prag dhe gjatë Krizës Lindore, e në veçanti ajo i shpalosi tendencat konkurruese në boshtin ndërmjet Austro- Hungarisë dhe Italisë për ta zaptuar atë që pa zaptua kishte mbetur, duke e bërë me dije se prezenca e kapitalit industrial mund të kthente kahun shqiptar nga perëndimi. Krahës kësaj tendence, “fuqitë ballkanike” të vetëshpallura (Greqia, Serbia dhe natyrisht Mali i Zi) që kishin ngritur kokën për të zgjerua territorin shtetërorë në dëm të Shqipërisë, kishin hyrë thellë në indin territorial shqiptar. Teoria e zaptimit që kishte për bazë moton: “ose pranoni autonominë (por jo edhe shtetin!) ose do t’ua “shpërfytyrojmë anatominë” ishte fillimrruga që i dedikohej një krijese (Shqipërisë) që ende nuk ishte shtet, por e cila në vitet e mëvonshme do të dizajnohej.

Forcat konservatore politike kishin për qëllim parandalimin e tendencave centrifugale të zhkoklitjes së shtetit dhe rënien e monarkisë si superfuqi, lëvizje kjo që kishte në ballarkë dukën Franz Ferdinand-in, trashëgimtar të fronit, i cili mblodhi rreth vetes një grup këshilltarësh të quajtur sipas rezidencës së tij “Rrethi i Belvederes”, të cilët u bashkuan nën flamurin e lëvizjes për *Austrinë e Madhe* në dekadën para Luftës së Parë Botërore.

Në Belvedere ishte qendra e qeverisë në hije, ku ishte zyra ushtarake e arkidukës. Aty gravitonte një numër i mirë i politikanëve me ndikim dhe i oficerëve të lartë të ushtrisë. Thelbi i Rrethit të Belvederes përbehej nga tri grupime politike. Rrethi më i ngushtë – njerëzit më të besueshëm të Franz Ferdinandit vinin padyshim nga radhët e aristokracisë çeke. Midis tyre dalloheshin në mënyrë të

¹ Slovenski narod, Xileto, 17.9.1878..

veçantë princi Karl Schwarzenberg dhe konti Ottokar Czernin-Chudenitz.

Grup tjetër me ndikim i përbërë nga oficerë të lartë të ushtrisë, në mesin e tyre figuronte këshilltari kryesor i Franz Ferdinandit dhe kryeshefi i shtatmadhorisë, baroni Franz Conrad von Hötzendorf.

Grupi i tretë i rëndësishëm i këshilltarëve të arkidukës vinte nga pjesa hungareze e monarkisë. Para së gjithash ishin politikanë kroatë dhe rumunë, të cilët kërkonin mbështetje nga trashëgimtari kundër dominimit politik hungarez.

Rreth Franz Ferdinandit tashmë ekziston një sërë biografish² të shkruara, ndër të cilat si studim standard dhe më me vlerë pa dyshim veçohet për konceptet e tij politike libri i Georg Franz-it i vitit 1943³, ndonëse në të nuk janë përpunuar të gjitha dokumentet nga trashëgimia e arkidukës. Këto seri debatesh më në detaje i ka studiuar Robert A. Kann-i,⁴ i cili në studimet e veta e përshkruan trashëgimtarin e fronit Franz Ferdinandin si ultrakonservativ dhe legjitimist autokratik⁵.

² Paul Nikitsch-Boulles, *Vordem Sturm. Erinnerungen an den Erzherzog-Thronfolger* (Berlin 1925); Leopold Chlumecky, *Erzherzog Franz Ferdinands Wirken und Wollen* (Berlin 1929); Theodor Sosnosky, *Der Erzherzog-Thronfolger. Ein Lebensbild* (München-Berlin 1929); Victor Eisenmenger, *Erzherzog Franz Ferdinand* (Zürich-Leipzig-Wien 1930); Maurice Muret, *L'archiduc François Ferdinand* (Paris 1932); Rudolf Kiszling, *Erzherzog Franz Ferdinand vofi Österreich-Este. Leben, Pläne und Wirken am Schicksalweg der Donaumonarchie* (Graz-Köln 1953); Emil Franzel, *Franz Ferdinand d'Este. Leitbildeiner konservativen Revolution*, Wien 1964); Gerd Holler, *Franz Ferdinand von Österreich-Este* (Wien-Heidelberg 1982); Friedrich Weissensteiner, *Franz Ferdinand. Der verhinderte Herrscher* (Wien 1983); Max Pollatschek, *Franz Ferdinand. Europa Verlorene Hoffnung* (Wien-München 1989).

³ Georg Franz, *Erzherzog Franz Ferdinand und die Pläne zur Reform der Habsburger Monarchie* (Bonn-München-Wien 1943).

⁴ Robert A. Kann, *Erzherzog Franz Ferdinand Studien* (Veröffentlichungen des Österreichischen Ost- und Südosteuropainstituts 10, Wien 1976);

⁵ Kann, *Erzherzog*, 34

Shtypi slloven i kohës për Lidhjen e Prizrenit

Ne gjuhën sllovene shtypi i kohës numëronte këto gazeta (këtu do të përqendrohem në “Slovenski narod”, “Slovenec”, “Sava” “Štajerc», »Straža« si dhe në shtypin slloven që dilte në Amerikë »Amerikanski Slovenec« e po ashtu në shtypin e kohës në Triestë »Edinost« dhe Gorizia (Gorica).

Në arkitekturën e ngjarjeve të cilat i kanë strukturuar Fuqitë e Mëdha me qellim që të sundojnë me atë pjesë të Ballkanit, çështja shqiptare u paraqit si një gur i cili nuk e plotësonte mozaikun e paraparë. Fuqitë e Mëdha përpiqen që të shfrytëzojnë dobësitë e Perandorisë Otomane dhe t’ia “zënë frymën” zgjimit të ndërgjegjes politike shqiptare e cila tashmë kishte marrë hov me tendencë të bashkimit të gjithë shqiptarëve për luftë çlirimtare kundër okupimit. Ky zgjim i shqiptarëve duhet t’i dedikohet përpos tjerash edhe shkallës së shpartallimit të Perandorisë Otomane. Shqiptarët në këtë rrugëtim shikohen si aleatë të turqve në synim për copëtim të vetë Turqisë.

Të pafuqishëm që deri në përsosje të parashihnin lojërat e diplomacisë së Fuqive të Mëdha, shqiptarët përpiqen që interesat e tyre t’i mbronte njëri shtet nga Fuqitë e Mëdha. Kjo pasiguri e shqiptareve, krahas proceseve në fjalë, ishte tërësisht e qartë mbase kishin mungesë të elitës qytetare e cila do të duhej të ishte bartës i ndërgjegjes politike dhe nacionale kombëtare. Në anën tjetër, kundërthëniet fetare të cilat paraqiteshin brenda shqiptareve, në dukje shpalosnin antagonizmin nacional, që shkaktonin fraksione në politikën e udhëheqjes⁶.

Në pah dalin dallimet brenda shqiptarëve të besimit katolik, gjegjësisht rrjedhave që i ndanin ata. Nga njëra anë ndikimi i diplomacisë italiane nëpërmjet farnçeskanëve shqiptarë dhe ai austrojezuit, i cili në suaza të tij mblidhte inteligjencën shqiptare të kohës.

⁶ Slovenec,

Anticipimi i emancipimit politik, që paraqitet në fillim të “zgjimit nacional” te shqiptarët shkaktoi kundërtënie nacionale. Pa marrë parasysh se sa “pa mëkat” ishin këto rryma brenda kishës katolike, e që nuk prezantonin dy rrugëtime për shëlbim, por njëkohësisht paraqitnin orientim politik të mbështetur në shtet të posaçëm - në Austro-Hungari dhe në Itali⁷. Këto dy shtete nuk i mbronin interesat shqiptare, por nën rrogoz artikulonin interesat e veta për t’u përqendruar në detin Adriatik dhe si mundësi e zgjerimit të territoreve të tyre. Politikën e vet dhe diplomacinë e proklamnin nëpërmjet shtypit të kohës, por jo vetëm nga qendrat e pushtetit të tyre në Vjenë dhe në Romë, por edhe nga territoret e përfituara ku i artikulonin interesat e tyre.

Kur bëhet fjalë për shtypin slloven, nuk qëndron teza se ishte i tëri nën ndikim austro-hungarez. Në pjesën e inteligjencës së ndritur sllovene, dhe interesit që ata mbulonin, ata shkruanin të pandikuar nga Austro-Hungaria. Gazeta Slovenec (Sllovenec) kësisoj e përshkruan gjendjen në trojet shqiptare:

“Shqipëria vlon. Shqiptarët sulmojnë tokat serbe, i kundërvihen Malit të Zi, kërcënojnë Greqinë dhe gjithë Evropën para syve të Turqisë, e cila ose nuk dëshiron ose nuk mund t’i kontrollojë shqiptaret e egër. Ne nuk jemi për atë që shqiptaret të nënshtrohen dhe assesi në kohë kur edhe popujt tjerë ballkanikë janë të pavarur apo shkojnë asaj rruge, që shqiptaret ti ndajmë sikurse ndërmjet shteteve të tjera; ne besojmë se shqiptarëve u duket shumë rëndë kur një pjesë e truallit të tyre u hiqet dhe i jepet Serbisë, pjesë të tjera Malit të Zi, një pjesë tjetër Greqisë, kurse tjetra Turqisë! Se u bë kështu fajtorë janë vetë diplomatët që nuk bënë asgjë për shqiptarët, fajtorë janë edhe vetë shqiptarët që nuk deshën të bashkohen me serbë dhe bullgarë kundër Turqisë, por iu nënshtroan edhe me tepër asaj. Po që se është Turqia vertet aq e dobët sa që nuk mund t’i kontrollojë ata, atëherë le të heqë dorë nga shqiptarët në mënyrë që t’i mundësohet njërës nga fuqitë evropiane dhe ta bëjnë Shqipërinë si principatë të re. Turqit me qellim e lejojnë këtë situatë, duke i shtyrë në konflikt malazezët dhe

⁷ Slovenec, ibidem

shqiptarët për territor që ata tashmë ia kanë premtuar Malit të Zi. ... me shqiptarët duhet të bëjnë diçka, se ata nuk u takojnë turqve dhe Perandorisë Otomane; ata nuk janë as serbë e as bullgarë, por janë në troje të tyre qysh se mbahet mend, pra para sllavëve e ndoshta edhe para grekëve.⁸

Në analizën e çështjes shqiptare korrespondenti në mënyrë simbolike iu drejtohet sllavëve duke përdorur subjekt tjetër, pra atë shqiptar, duke e egërsuar kështu ideologjikisht me këtë edhe me tepër pozitën sllave brenda Austro-Hungarisë.

Hipertrofia e diplomacisë austrohungareze dhe tendenca e saj për çështje të adratikut ishin më se evidente e me këtë interesi për shqiptarë dukshëm më i madh. Si moto e diplomacisë austrohungareze ishte thënia jezuite e gjeneralit Aquavive:” *fortier in re suaviter in modo*”

(*fuqishëm në ekzekutim dhe të butë në realizim*). Kështu tregonte frikën latente para lojërave tjera diplomatike, para së gjithash para Rusisë (më dorën e saj të zgjatur Bullgarine e Madhe) e cila detin Adriatik dëshironte ta shndërronte në Liqenin e vet.

Primicia e emancipimit politik shqiptar në konstelacionin e fuqive në Ballkan nënkuptonte hapa pioniere që reflektonin brenda elitës politike shqiptare, kurse në arenën ndërkombëtare reflektimi i asaj diplomaci shqiptare përjetohej “si jo e pjekur” në vendosjen e kërkesave për autonomi të plotë të shtetit shqiptar. Ndjeshmëria e shqiptarëve në artikulum të programit nacional të përbashkët, Fuqitë e Mëdha ditën ta shfrytëzojnë për t’u rrëfyer popujve të tjerë se ata e përdorin shtypin për interesa të tyre si monopol për informim.

Shtypi “Slovenski narod” dhe “Slovenec” shpalosnin situatën ndërkombëtare gjatë Krizes së Lindjes dhe Traktatit të Shën Stefanit. Posaçërisht ishin tejet të përqendruar në këtë situatë nga Traktati i Shën Stefanit e deri te Kongresi i Berlinit. Për të treguar se sa janë të hapur ndaj çështjes shqiptare citohet: “...një prift katolik shqiptar Myeddei (Mjeda vërejtja M.B.) i cili shpjegon ne një predikim në rrethin e Belvederës në Vjenë se për shqiptarë paralagjja e Shën

⁸ Slovenec, nr. 47., 29.4. 19880

Stefanit quhet Shën Shtjefni, se kështu do te kuptohet nga shqiptarët më lehtë”.⁹

Veçanërisht gazeta “Slovenski narod” ishte tej mase e interesuar për përkufizim shqiptaro-malazias, ku në mes tjerash shkruan: “...kufiri i merr në njërën anë Drekalloviqët, Kuçin, fiset e Grudës dhe Kelmendin, fushën e Podgoricës dhe Pllavnicën, Hotin dhe Grudën ua lëshon shqiptareve”.¹⁰ Ky kufi ishte mjaft problematik posaçërisht sa i përket Hotit dhe Grudës.

Në lidhje me dorëzimin e Podgoricës dhe Shpuzës (Spuzhit) më 19.1.1879 shton se princit malazias do t’i dorëzohet shumë shpejt Podgorica e Shpuza. Veziri i madh Hajredini dhe deputeti rus Lobanov premtojnë se turqit nuk do t’i shkatërrojnë ato dy qyteza. Vetëm shqiptarët duan t’i ruajnë ato qyteza, për këtë çështje princi malazias me 16.1 1879 ka tubuar 1200 ushtarë për t’i zaptuar ato.¹¹

Vend te posaçëm shtypi slloven i jep vrasjes së Mehmet Ali Pashës, ku thuhet: “ ... vrasja e tij ishte e kurdisur për t’i ndihmuar Lidhjes së Prizrenit, por Porta nuk mund të marrë masa kundër kryengritësve. Aty shihet dyfytërsia e saj dhe dobësia e saj”.¹²

Për aktivitetin diplomatik shënohet sërish mbiemri Mjeda...”në bisedë me të deleguarin francez St. Vallier lidhur me Mirditën”¹³.

Një periudhë në gazetën “Slovenec” nuk kishte shkrim për Lidhjen e Prizrenit. Kështu që me dt. 3.8.1879 korrespondenti nga Cetinja shkruan: ”... malazezët janë tërbuar, sepse shqiptarëve nuk u shkon ndërmend ta lëshojnë Plavën dhe Gucinë. Portës i ankohen se shqiptarët po u sjellin telashe, por nuk dihet se a i shkon për shtat kjo gjë Portës?”¹⁴ Ministri i Punëve të Jashtme Hymerle i raporton Turqisë se nuk lejohet që ajo të premtojë dhe mos të realizojë asgjë, se kështu mund të shpërthej lufta shqiptaro malaziase.¹⁵ Kështu në fakt siç

⁹ Slovenecibide,

¹⁰ Slovenski narod , XI leto, 23.7. 1878

¹¹ Ibidem 27, 4.2.1880

¹² “Slovenski narod,” XI leto, 17.9.1878.

¹³ Ibidem 18.06.1878.

¹⁴“ Slovenec”, 3, 8.1. 1879.

¹⁵ Ibidem, nr 47, 10.1.1880.

pohon gazeta në fjalë mund të shpërthejë lufta sllavo-turke, që Bullgaria mezi e pret.

Shtetet përreth kanë filluar të frikësohen se shpërthimi i luftës ndërmjet Malit të Zi dhe shqiptareve shpie në luftë ballkanike. Kështu, dërgata angleze në Stamboll ka dërguar St. John-in që të bindet për këtë gjendje¹⁶. Duke shtuar se nëse kjo gjendje përmirësohet edhe Gjermania do të dërgojë emisarin e vet për të ndërmjetësuar në dorëzim ndërmjet Portës dhe Malit të Zi.¹⁷

Organizimi i ushtrisë së Lidhjes së Prizrenit evidentohet edhe në shtypin tjetër përpos këtij slloven. Mbi të gjitha, përcjellja e gjendjes në territoret etnike shqiptare trajtohet me një vëmendje të posaçme, kështu “Slovenec” në maj të viti 1880, në numrin 56 shkruan si vijon: ” Flitet se ushtria e Lidhjes do të kundërshtojë dhe refuzojë vendimet e Kongresit të Berlinit, duke i organizuar mbi 80000 ushtarë të vet. Korrespondenti pyetet se me çka e ushqejnë atë ushtri... kush u ndihmon atyre... se me këtë ushtri mund t’i mbrojnë tokat e veta para grekëve, turqëve dhe sllavëve. Shqiptaret kanë të drejtë të mbrojnë truallin e vet dhe të formojnë shtetin e vet të pavarur...”¹⁸

Në fund dua të shtoj se shtypi slloven i kohës, përderisa nuk kishte korrespondentët e vet në territoret etnike shqiptare, ndihej ndikimi i politikës ditore, mirëpo pastaj i shmangen asaj dhe situatën në terren e trajtojnë mjaft realisht (posaçërisht kur autorët ishin sllovenë).

¹⁶ Ibidem.

¹⁷ Ibidem, nr. 47, 29.4. 1880.

¹⁸ Ibidem, nr. 56, 25.5. 1880.

Oliver SCHMITT

LIDHJA E PRIZRENIT, INTERPRETIMET E KONSTATUARA AUSTRO-HUNGAREZE

Përmbledhje

Diplomatët austro-hungarezë në Vilajetin e Kosovës nuk ishin vetëm vëzhgues, por edhe aktorë. Gjendeshin në një zonë të tensionuar të aktorëve lokalë politikë (Lidhja e Prizrenit, autoritetet osmane), të politikës qeverisëse osmane, të shteteve nacionale rajonale dhe të fuqive të mëdha evropiane. Vlerësimi i Lidhjes ishte kryesisht kritik, por ndryshoi në mënyrë të qartë midis 1878 dhe 1881. Në fillim konsujt theksonin karakterin islamik-tradicional si dhe kontrollin nga Stambolli. Ngadalë u shtua regjionalizmi i theksuar politik i cili përfundoi me një ide të qartë për autonomi. Te gegët verilindorë konsujt shihnin më pak një element me rëndësi ideologjike dhe programatike (për dallim nga jugu tosk dhe nga Shkodra), por në fazën e fundit të Lidhjes para së gjithash një lëvizje që mund të kuptohej si politike-ushtarake. Lidhja përshkruhet shpesh si aktor dhune – konsujt shohin si viktimë si katolikët shqiptarë ashtu dhe ortodoksët serbë. Por cak i dhunës së aktorëve të Lidhjes ishte edhe vetë konsulata austro-hungareze në Prizren. Tensionim më të madh kishte midis konsujve dhe përfaqësuesve të rrymave islame-konservative brenda Lidhjes, të cilat e shihnin depërtimin austro-hungarez në Bosnje dhe në Sanxhakun e Novi Pazarit si kërcënim masiv dhe kishin frikë nga një ekspansion në Vilajetin e Kosovës. Në fund të Lidhjes u shfaqën qartë shenjat e para të historisë së ardhshme të raporteve midis gegëve verilindorë dhe Austro-Hungarisë: kërkesa për autonomi dhe ideja kombëtare.

Raportet konsullare, krahas dokumenteve osmane, bëjnë pjesë në burimet qendrore për historinë e Lidhjes së Prizrenit, sidomos për shkak të mungesës së ndonjë paraqitjeje të perspektivës së protagonistëve rajonalë. Në këto rrethana raportet konsullare janë përpunuar intensivisht dhe janë përmbledhur në botime. Kjo kumtesë analizon raportet e konsujve austro-hungarezë në Prizren. Vlera e burimit është e qartë meqë kemi të bëjmë me raporte të dëshmitarëve që gjendeshin aty (dhe jo p.sh. me analiza të hartuara në Shkodër).

Megjithatë, ato duhet t'i nënshtrohen një kritike të burimeve meqë nuk është fjala për vëzhgime neutrale, por për vlerësime që do të duhej ta mbështesnin me informacione një strategji të një fuqie të madhe evropiane.

Konsujt austro-hungarezë ishin të përgatitur mirë për detyrat e tyre përmes formimit në Akademinë Orientale në Vjenë, kishin njohuri të gjuhës dhe rajonit. Vëzhguesit e Lidhjes së Prizrenit zakonisht ishin diplomatë me përvojë që kishin kompetencë të posaçme për Perandorinë Osmane. Franz Jelinek (1837-1908), i cili hartoi raportet më të rëndësishme, në vitin 1878 kishte 19 vjet në shërbimin konsullor dhe kishte shërbyer midis tjerash në Stamboll dhe Izmir para se të merrte detyrën si konsull në Prizren më 1877 deri më 1880. Josef Waldhart (1819-1902) kishte 36 vjet në shërbim dhe kishte qenë i dërguar në Bukuresht, Braila, Sarajevë, Stamboll, Edirne, Banja Llukë dhe Sofje. Relativisht i ri ishte Josef Schmucker (1854-1925), por ai kishte bërë përvojë në Shqipëri, në Shkodër që nga viti 1879, më 1881 shkurt në Shkup dhe pastaj më 1881-1884 ishte dërguar në Prizren. Pra, Monarkia e Danubit angazhonte në vend personel posaçërisht kompetent, çka ishte edhe e domosdoshme duke pasur parasysh momentet e shumta kërcënuese.

Konsujt mbështeteshin në një rrjet lokal të informantëve, pjesë e të cilit, në radhë të parë, ishte kleri katolik; por konsujt merrnin informata edhe nga rrethet myslimane.

Gjatë analizës së raporteve është e rëndësishme të merret parasysh perspektiva austro-hungareze. Monarkia duhej ta mbronte protektoratin kulturor ndaj katolikëve, të cilët ishin klientela qendrore e saj – por numerikisht ky grup ishte shumë i vogël.

Së dyti, u shfaq interesimi për Bosnjen dhe Sanxhakun: nga korriku 1878 Austro-Hungaria, megjithë rezistencën e ashpër të popullsisë myslimane, pushtoi Bosnjën dhe Hercegovinën, e cila i ishte premtuar asaj në Kongresin e Berlinit. Përveç kësaj, Monarkia e Danubit mori të drejtën që të staciononte trupa në Sanxhakun e Novi Pazarit. Për qeverinë vjeneze ishte i rëndësishëm kufizimi i rezistencës myslimane – meqë në Lidhjen e Prizrenit merrnin pjesë edhe myslimanë sllavë nga Sanxhaku, konsujt duhej të vlerësonin nëse Lidhja solidarizohej me myslimanët e Bosnjës dhe në përgjithësi nëse po krijohej një disponim kundër Austro-Hungarisë.

Rëndësi qendrore ka edhe raporti i vështirë i Lidhjes me Austro-Hungarinë. Në tetor 1880, me nxitjen nga nënkryetari i Lidhjes, Shaib aga (“*një mbledhës yshyri që kishte borxhe të mëdha ndaj shtetit*) (ky është një tregues i rëndësishëm i motiveve ekonomike të udhëheqësve të Lidhjes), *një horr i madh*” (Oliver Jens Schmitt/Eva Anne Frantz, Österreichisch-ungarische Konsulatsberichte aus dem Vilayet Kosovo 1870-1914, në botim, vëllimi 1, nr. 89), u vra dragomani (përkthyesi) i konsullatës, Bardo Tarabulusi. Përkrahësit e Lidhjes inskenuan edhe një sulm ndaj konsullatës. Konsulli Waldhart identifikoi si vrasës Ramadan Zaskokun, i cili dekada më vonë më 1914 u likuidua me urdhër të Hasan Prishtinës – shembulli i Zaskokut tregon në shkallë të vogël se si ndryshoi raporti midis gegëve verilindorë dhe Monarkisë. Hasan Prishtina e dinte më 1914 se ekzekutimin e kujt urdhëroi – me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore Zaskoku iu bashkua Esad Pashë Toptanit. Vrasja e vitit 1880 shënon një rënie por edhe një pikë kthese – në vetëdijen kombëtare që po krijohej ngadalë së paku te një pjesë e gegëve verilindorë, Monarkia shihte një pikë ndërlidhëse në politikën e saj të Ballkanit.

Së katërti – nga këto elemente udhëhiqej pikëpamja e konsujve: ata i kategorizonin aktorët dhe grupet politike fillimisht më pak sipas kategorisë komb, por sipas përkatësisë religjioze. Kjo i përgjigjej edhe shembëlltyrës sociokulturore të Perandorisë Osmane dhe asaj të shumë aktorëve rajonalë. Në përputhje me këtë pikëpamje konsujt regjistronin me saktësi të posaçme aktet e dhunës të myslimanëve ndaj të krishterëve, si ndaj ortodoksëve ashtu edhe ndaj katolikëve. Interesi i tyre ishte natyrshëm për këta të fundit. Sipas pikëpamjes së konsujve, shqiptarët myslimanë jo vetëm që nuk i shihnin shqiptarët katolikë si të barabartë – ata thjesht nuk i takonin asaj bashkësie që në raporte shpesh quhej Arnautluk, kriteri primar i së cilës ishte përkatësia islame, dhe jo p.sh. gjuha, apo e drejta e përbashkët zakonore. Vërehet edhe një simpati parimore për popullsinë e krishterë ortodokse, e cila u ishte nënshtruar akteve të shumta të dhunës nga përkrahësit e Lidhjes. Konsujt nuk ndërhyjnë për ta; por tendenca themelore armiqësore ndaj të krishterëve dhe Lidhjes është një element i rëndësishëm i interpretimit të diplomacisë së Monarkisë.

Raportuesit austro-hungarezë e shihnin Lidhjen në dinamikën e aktorëve dhe qëllimeve. Analizat e tyre tregojnë sa shumë kanë ndryshuar karakteri politik i Lidhjes dhe pesha e islamit dhe kombit midis verës së vitit 1878 dhe pranverës së vitit 1881. Vlera e raporteve qëndron në përshkrimin e kësaj dinamike, të rëndësisë së politikës së Sulltanit dhe të fuqive të mëdha, si dhe të ndryshimeve rrënjësore të situatave rajonale politike në njërën anë, si dhe të efektit prapaveprues te aktorët e Lidhjes në anën tjetër.

Bëhet i qartë një model shumëfazash, në të cilin hap pas hapi i jepet më shumë rëndësi identitetit kombëtar shqiptar dhe dëshirës për vetorganizim politik. Raportuesit austro-hungarezë interesoheshin posaçërisht për faktorin osman dhe kuptuan se duhej bërë dallim midis Sulltanit dhe aktorëve rajonalë (valive, nëpunësve të lartë dhe oficerëve). Pamja që shfaqet gradualisht është jashtëzakonisht komplekse sepse vëzhguesit austro-hungarezë ia shtonin ndërthurjes

së përmendur të interesave edhe strukturat mikrorajonale dhe lokale të pushtetit brenda Lidhjes. Raportet ia bëjnë të qartë historianit se sa është e rëndësishme një analizë e përqendruar tek aktorët, e cila merr parasysh dinamikat e fuqishme politike dhe nuk përdor kategori statike si “Lidhja”, “Osmanët” apo “Austro-hungarezët”.

Sepse edhe politika Vjeneze ndryshonte shpejt – në shkurt 1880 Monarkia dukej ende si kundërshtarja kryesore e Lidhjes, por që atëherë shënohet një qëndrim i ri, i cili vuri në dukje të ardhmen, promovimi i elementit shqiptar kundër grekëve dhe sllavëve (Schmitt/Frantz vëllimi 1, nr. 98). Edhe në anën austro-hungareze vërehen aktorë të veçantë. Konsulli Crenneville në Selanik p.sh. mendonte më strategjikisht se diplomatët në Prizren, të cilët ndonjëherë ishin kronistë të thjeshtë të ngjarjeve të ngjeshura politike.

Realizimi i vullnetit politik rajonal në Vilajetin e Kosovës (sikur në Shkodër) filloi që në fund të vitit 1877. Konsulli fliste për një “mexhlis popullor” në Prizren, i cili nisur nga gjendja e vështirë ushtarake e Perandorisë Osmane tentonte të mobilizonte për ushtrinë edhe të krishterët. Në janar 1878 vijnë tubime të tjera të myslimanëve, të nxitura nga disfatat e rënda osmane dhe nga frika prej ekspansionit rus dhe serb. Frustrimi për disfatat shfaqej në njërën anë në dhunën e myslimanëve ndaj popullsisë ortodokse – kështu konsulli shënon përdhunime masive në rajonin e Vranjës që bëheshin nga burrat nga Tetova dhe Dibra – por edhe shenja të disfatizmit për shkak të epërsisë ruse (Schmitt/Frantz vëllimi 1, nr. 50). Shenja e parë zyrtare e këtyre tubimeve në drejtim të Austro-Hungarisë ishte një telegram i 14 parëve myslimanë nga Prizreni drejtuar ambasadorit austro-hungarez në Stamboll. Në të flitet për “vendin e gegëve” dhe “pjesën gege të vendit”, e cila është 90% myslimane – është formuluar vetëm një qëllim politik: refuzimi i dorëzimit të territorit dhe besnikëria ndaj Portës së Lartë (Schmitt/Frantz vëllimi 1, nr. 54).

Faza e hershme e Lidhjes në sytë e konsujve shënohet nga këta elementë: theksimi i karakterit islam, luajaliteti ndaj Sulltanit,

kontrolli i fshehtë nga Stambolli, përjashtimi i popullsisë së krishterë, përkatësisht deklarimi i detyruar i besnikërisë i të krishterëve. Faza e parë e Lidhjes, sipas vlerësimeve të konsujve, nuk ishte asgjë tjetër përpos një formë e politikës së jashtme parashitetërore e Perandorisë Osmane, e cila ishte obliguar zyrtarisht përmes Kongresit të Berlinit; edhe Britania e Madhe supozohej se qëndronte prapa. (Schmitt/Frantz vëllimi 1, nr. 55 18.06.1878: *“Kështu sot mund të supozojmë me siguri se ... qeveria e Portës aktualisht e udhëheq tërë Lëvizjen ..., qoftë për ta përgatitur popullin për një kryengritje të armatosur në rast të një lufte të re, qoftë për ta ruajtur autoritetin e vet dhe për të parandaluar një drejtim kundërqeveritar të Lëvizjes”*). Gjuha shqipe ose identiteti kombëtar nuk luajnë asnjë rol në këtë fazë të raporteve: myslimanët rajonalë luajalë ndaj Sulltanit organizohen në format e ditura kundër dorëzimit të territorit. Disponimin para themelimit të Lidhjes e ilustron vlerësimi në vijm:

“Sundimit të urryer rus ose serb nuk dëshiruakan t’i nënshtrohen në asnjë rast sepse qenkan të bindur se do të detyrohen dhunshëm të kalojnë në krishterim, ndërsa liria fetare që sundon në Austro-Hungari do t’u siguruaka qëndrimin e patrazuar në fenë e baballarëve të tyre dhe do të ndiheshkan të lumtur të bëhen të nënshtroar të shtetit të nderuar, të fuqishëm perandorak.” (Schmitt/Frantz vëllimi 1, nr. 50, 21.1.1878).

Vetorganizimi i prijësve rajonalë quhet nga konsujt mexhliis – në prill 1878 u mbajtën tubime të tilla me pjesëmarrës nga rajonet prej Dibrës deri në Gusi. „Së shpejti në Prizren ose në Lumë duhet të mbahet një mexhliis i madh i përfaqësuesve të të gjitha fiseve, në të cilin do të merren vendime të tjera, përfundimtare dhe nga i cili do t’i dërgohet Sulltanit një grup përfaqësues prej tre personash për t’ia dorëzuar një ankesë në të cilën përshkruhet gjendja e vështirë e popullsisë myslimane dhe ku paraqiten dëshirat e tyre.“ (Schmitt/Frantz vëllimi 1, nr. 53, 30.4.1878). Kjo fazë përcillej nga aktet e shpeshta të dhunës kundër popullsisë së krishterë, të cilat

konsulli i kupton si rënie e fuqisë shtetërore dhe zgjedh një krahasim drastik: „*“Besa“ për sigurinë e jetës dhe të pronës që u është dhënë në atë kohë solemnisht të krishterëve nga këshilli i këtushëm kombëtar shfaqet si krejt iluzore, siç e dëshmojnë shumë fakte... Autoritetet lokale i shohin tashmë me mospërfillje dhe pa fuqi këto akte dhune të disa fanatikëve pasi që ata vetë e kanë shkaktuar situatën e dyshimtë aktuale përmes nxitjes së pakuptimtë të masave për luftë. Këtu jetojmë nën sundimin fanatik të fundrrinave, i cili të kujton Komunën e Parisit, në gjendjen e anarkisë së plotë“*. (Schmitt/Frantz vëllimi 1, nr. 60 6.8.1878). Kjo fazë kulminacionin e arriti me vrasjen e Mehmed Ali Pashës në Gjakovë. Në raportet e monarkisë Gjakova paraqitet vazhdimisht si rajon posaçërisht konservativ-mysliman, që nuk është i afërt me shtetin, por luajal ndaj Sulltanit, me popullsi myslimane të dhunshme. Në mënyrë posaçërisht negative përshkruhet popullsia e cila krahasohet madje me kanibalë. Konsujt këtu vendosin si normativ kategoritë rend dhe kontroll perandorak – veprimet e pavarura të dhunshme të aktorëve lokalë shihen si pengesë e politikës së madhe. Përshkruhet qartë kontrasti midis popullsisë së qytetit që respekton rendin dhe një shoqërie malore e cila gjendet jashtë tentimeve për të vendosur rend shtetëror (Schmitt/Frantz vëllimi 1. nr. 65). Në këtë kuptim konsujt i bënin propozime konkrete ambasadorit të Monarkisë se kë duhej ta vendoste Porta në pozitat e larta administrative.

Konsujt analizojnë ndërlidhjen midis mobilizimit për luftë, posaçërisht të luftëtarëve të parregullt fisnorë, rrjedhës së luftës të pafavorshme për Perandorinë Osmane, fluksit të refugjatëve myslimanë në Kosovë dhe dhunës së shtuar e të motivuar nga hakmarrja ndaj popullsisë civile të krishterë. Kësaj i shtoheshin tensionet sociale midis pronarëve myslimanë të tokave dhe çifçinjve të krishterë (ortodoksë).

Formimi i Lidhjes më 18.6.1878 u interpretua nga kosulli Jelinek në përputhje me rrethanat: fjala ishte për një tubim të parëve myslimanë nga Vilajeti i Kosovës, nga Novi Pazari dhe madje nga

Hercegovina, të cilat i refuzonin vendimet e Kongresit të Berlinit. Fjalja kyçe në raport thotë: “*Siç jam informuar në mënyrë të fshehtë për këshillimet e mbajtura në një xhami, Prizreni tashmë shihet si pika qendrore dhe pikëmbështetje për elementin mysliman të mbetur në Evropë dhe që dëshiruan të mbeten të nështruarit e Sulltanit. Por në rast se përmes një vendimi të Kongresit sundimi i Portës dobësohet nga humbja e krahinave të tjera evropiane ose në ndonjë mënyrë tjetër në atë masë sa në të ardhmen nuk do të mund të pritej më ndihmë e fuqishme dhe e sukseshme, atëherë duket se po planifikohet të proklamohet Shqipëria si mbretëri dhe përmes kryengritjeve të armatosura masive të mbrohen kufinj të vjetër të vendit, së pari nga Serbia dhe Mali i Zi.*” (Schmitt/Frantz vëllimi 1, Nr. 55, 18.6.1878).

Për t’i kuptuar zhvillimet e Lidhjes dhe interpretimet e saj nga diplomacia austro-hungareze duket i dobishëm një pikëvështrim nga fundi i Lidhjes.

Dy vite më vonë, në gusht 1881, në një analizë të represionit osman shënohet se qëllim i “*lëvizjes shqiptare*” është autonomia e vendit. Ndryshimi i kuadrit interpretues është në përputhje me ndryshimin e madh të qëllimeve politike të elitave myslimane të Vilajetit të Kosovës. Edhe pse ata nuk kishin hartuar programe të vetat kombëtare si aktivistët kombëtarë në Stamboll, Janinë ose Shkodër (kërkesat e qershorit 1878 ishin myslimane-tradicionale), “*Shqipëria lindore*” (një emër i vulosur nga konsulli Crenneville) ishte shndërruar në qendrën e politikës praktike dhe fuqisë ushtarake. Më 1881 Monarkia e Danubit shihte te këta “*shqiptarë lindorë*” (sipas Crenneville: nga Novi Pazari deri në Prilep) potencialin më të madh për bashkëpunim në drejtim të një “*pavarësie të kufizuar*” – qëllimi ishte krijimi i një zone austro-hungareze të ndikimit; sigurisht, ky u shndërrua në një projekt konkret vetëm në fund të shekullit 19.

Shkallët e ndërmjetme – pra midis lidhjes islame e luajale ndaj Perandorisë të qershorit 1878 deri te lëvizja kombëtare për autonomi – përshkruhen detajisht në raporte. Thyerja vendimtare ndodhi në

vjeshtë/dimër 1880/81 kur autoritetet osmane u shkarkuan në masë të madhe (dhe u përdoqën nga diplomatët austriakë). Diplomatët theksonin posaçërisht shtytjen konservative-armiqësore ndaj reformave. U shkarkuan nëpunës në institucionet që ishin krijuar gjatë reformave të Tanzimatit. Udhëheqësit rajonalë të Lidhjes ishin përkundrazi për drejtësinë/sheriatin islam religjioz. Në kulminacionin e saj lëvizja për autonomi, sipas konsullit në Shkup, nuk e përfshinte në shkurt 1881 tërë Vilajetin, por vetëm Sanxhakët Prizren dhe Gjakovë, pjesë të Pejës dhe tërë Gucinë, ndërsa Dibra u distanca. Numri i luftëtarëve vlerësohej në 6000 (Schmitt/Frantz vëllimi 1, nr. 95, 4.2.1881, nr. 96, 20.2.1881).

Esmeralda OSMANI KOLANECI

ROLI I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT NË NDËRKOMBËTARIZIMIN E ÇËSHTJES SHQIPTARE

Përmbledhje

Thelbi i këtij punimi konsiston në evidentimin e vendit të veçantë që Lidhja e Prizrenit ka në historinë diplomatike të kombit shqiptar për kontributin e pamohueshëm në afirmimin dhe ndërkombëtarizimin e kauzës së shqiptarëve. Gjithashtu theksohet se strukturat e saj drejtuese, veç organizimit të brendshëm juridiko-institucional, nuk lanë jashtë vëmendjes betejën diplomatike në konjunkturat politiko-ndërkombëtare, mision i cili u mor përsipër nga statisti Abdyl Frashëri. Kjo figurë poliedrike e Rilindjes Kombëtare gjuhën diplomatike e shihte si çelësin e zgjidhjes demokratike të çështjes shqiptare. Në këtë optikë ai dhe eksponentët të tjerë të rëndësishëm të Lidhjes zhvilluan negociata dhe takime me përfaqësues të Fuqive të Mëdha në mbështetje të krijimit të imazhit kognitiv mbi kushtet ku gjendej pozita diplomatike e çështjes shqiptare.

Argumentohet pse në historiografi nënvizohet se përkundër vështirësive të shumta (nga njëra anë presioni i shteteve fqinjë ballkanikë dhe nga ana tjetër bojkoti i Fuqive të Mëdha) Lidhja Shqiptare e Prizrenit i dha një dimension të ri çështjes kombëtare shqiptare, madje mundësoi që ajo të kishte një tjetër impakt në diplomacinë evropiane, e cila me pretekste makiaveliste dhe me forma moderne farse kërkonte të shkelte mbi të drejtat e kombit shqiptar. Lidhja solli në vëmendje të sferave më të larta të politikës evropiane se shqiptarët ishin subjekt më vete dhe në bazë të normave juridiko-ndërkombëtare gëzonin të drejtën e vetëvendosjes, ashtu sikundër popujt e tjerë të Ballkanit dhe Evropës.

Në këtë punim konkludohet se veprimtaria e saj ndryshoi kursin e qëndrimeve politike të kancelarive të Fuqive të Mëdha, duke imponuar se krijimi i shtetit shqiptar tanimë prezantohej si domosdoshmëri dhe fakt këmbëngulës historik për stabilitetin dhe paqen në Ballkan. Nga një organizatë që nuk kishte asnjë lloj njohje, as njohjen *de facto* dhe as njohjen *de jure*, tashmë aktiviteti i Lidhjes së Prizrenit si në organizimin e brendshëm dhe në arenën ndërkombëtare ndiqej me kujdes nga selitë qëndrore evropiane. Në jetën aktive dhe dinamike trevjeçare të saj, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, edhe pse u shtyp forcërisht nga Perandoria Osmane dhe u izolua nga Fuqitë e Mëdha, nëpërmjet aktivitetit diplomatik mundësoi që çështja shqiptare të ndërkombëtarizohej. Shqipëria u bë pjesë e axhendës së kancelarive evropiane si një nga çështjet ende të pazgjidhura ballkanike, që kërkonte zgjidhje imediate në rregullimet e ardhshme të rajonit.

Fjalët çelës: Lidhja Shqiptare e Prizrenit, ndërkombëtarizim i çështjes shqiptare, diplomacia evropiane, Fuqitë e Mëdha.

Dekadat e fundit të shekullit XIX karakterizoheshin nga dinamika të reja e të vrullshme të politikës evropiane. Ekuilibri i forcave, doktrina dhe instrumenti bazë operacional i Koncertit Evropian, duket se u trondit nga kombinacione diplomatike, që influencuan në përshpejtimin e shpërbërjes së mozaikut të Perandorisë shumëkombëshe Osmane. Drejt shtetit të Carëve po adresoheshin akuza për shkelje të konsensusit evropian, si shkak i avancimit të njëanshëm të tij në Konstandinopojë dhe synimit për të depërtuar në Ballkan e në Mesdheun Lindor. Reagimi i fuqive të tjera të kohës ishte i menjëhershëm. Për sheshimin e divergjencave *inter se*, si dhe zgjidhjen diplomatike të krizës ballkanike, u propozua mbajtja e një Kongresi në Gjermani. Kongresi u mbledh në Berlin më 13 qershor 1878.¹

¹ Kongresi i Berlinit zhvilloi punimet e tij nga 13 qershor deri 13 korrik të 1878. Fuqitë e Mëdha të Evropës që morrën pjesë ishin: Gjermania, Anglia, Franca, Rusia, Austro-Hungaria dhe Italia. Në krye të punimeve qëndronte Oto von

Doemos kjo klimë shqetësuese në të cilën lexoheshin qartë tentativat aparente për zgjerim kah territoreve shqiptare, duke rrezikuar kështu një prej komponentëve substancialë për ekzistencën si entitet shtetëror, bëri që shqiptarët të orientonin busullën e përpjekjeve të tyre drejt intensifikimit të veprimtarisë politike. Përpjekjet energjike të shqiptarëve gjatë dekadave të mëparshme për mëvetësim edhe pse konstante kanë pasur karakter fragmentar, por kjo nuk do të thotë se kanë qenë episodike apo iu ka munguar vizioni për krijimin e një shteti shqiptar të pavarur. Duke u kufizuar në fundshekullin XIX duhet përmendur hopi i madh cilësor i realizuar nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Shqyrtimi vertikal i zhvillimeve që përshkuan këtë epokë na mundëson të konkludojmë se kuvendi gjithëkombëtar, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, përbën modelin paradigmatic të organizimeve politike të një niveli veçanërisht të avancuar të popullit shqiptar për realizimin e të drejtave dhe njohjes si komb e si subjekt i mëvetësuar në arenën ndërkombëtare.

Rilindja Kombëtare evidentoi titanët e politikës dhe të diplomacisë shqiptare, të cilët ideuan dhe themeluan Lidhjen e Prizrenit me atributet, tiparet dhe elementët embrionalë të domosdoshëm të një shteti, duke kristalizuar aspiratat e mbarë kombit të bashkuar në një luftë shumëdimensionale e largpamëse kundër pushtimit shekullor osman dhe objektivave asimiluese të fqinjëve ballkanikë apo evropianë. Me një optimizëm të qëndrueshëm, dinjitoz dhe racional përmes aksioneve ushtarake, politike dhe diplomatike

Bismarku (kancelari gjerman). Qëllimi kryesor për të cilin u organizua ky kongres ishte rishikimi i kushteve të Traktatit të Shën Stefanit (Traktati i Nikolla Ignatjevit), që në thelb ishte një turrje e Perandorisë Osmane dhe krijimi i Bullgarisë së Madhe. Pjesë e punimeve të Kongresit u bë edhe delegacioni osman i kryesuar nga Ministri i Jashtëm Kara Theodor Pasha, por gëzonte të drejtën e votës konsultative dhe jo asaj deliberative sikurse Fuqitë e Mëdha. Delegacione dërguan edhe Bullgaria, Serbia, Greqia, Rumania, Mali i Zi, me ftesën e Fuqive të Mëdha. *Shih për më gjerë, Historia e popullit shqiptar, Rilindja Kombëtare, vitet 30 dhe shek. XIX - 1912, Vëllimi II, Botimin i Akademisë së Shkencave dhe Institutit të Historisë, Botimet "Toena", Tiranë, 2002.*

shqiptarët në mbarë trevat synonin t'i tregonin opinionit publik se nuk pajtoheshin me vendimet e Shën Stefanit apo vendimet e Kongresit të Berlinit, madje se ata nuk do të qëndronin pasiv përballë synimeve aneksioniste, të cilat qartësisht binin në kundërshtim me drejtësinë dhe paqen, që aq shumë trumbetoheshin asokohe nga paria e diplomacisë evropiane.

Lidhja e Prizrenit ka një vend të veçantë në historinë diplomatike të shqiptarëve për kontributin e pamohueshëm në afirmimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes kombëtare. Nga pikëpamja politiko-shoqërore në këtë periudhë të rëndësishme të historisë politike kemi pa mëdyshje lindjen e shtetit shqiptar, porse në optikën juridiko-ndërkombëtare nuk mund të pohohet ky konstatim. Krijesa e Lidhjes mbeti një shtet në embrion dhe nuk mundi të shfaqej me tiparet e plota të personalitetit juridiko-ndërkombëtar. Pavarësisht kësaj, strukturat e Lidhjes, duke vlerësuar rëndësinë dhe domosdoshmërinë e integritit në jetën e bashkësisë së shteteve, ndërmorën demarshe diplomatike për të avantazhuar prioritetet e saj politike, siç ishte njohja, si dhe për të ndikuar në perceptimin pozitiv të çështjes shqiptare nga opinioni publik i keqinformuar qëllimisht e padrejtësisht nga fqinjët ballkanikë.

Lidhja Shqiptare arriti disa rezultate në përkufizimin e territorit shqiptar, që përfshinte vilajetet e Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës. Veprimtaria e saj u ndalua nga autoritetet osmane, por idetë mbetën² dhe për shqiptarët ajo konsiderohet si forcimi i ndërgjegjes kombëtare. Brenda limiteve të saj Lidhja maksimalizoi veprimtarinë e brendshme politike dhe përgatiti terrenin që çështja shqiptare të merrte dimensione të reja në kancelaritë evropiane. Nëpërmjet veprimeve energjike ajo shkaktoi turbulenca ndaj politikave brutale të Portës së Lartë përkundrejt njohjes së kombit shqiptar. Edhe pse nuk mundi të kurorëzonte objektivin kryesor, kontinuitetin në qeverisje dhe mbrojtjen e interesave politike gjithëkombëtare apo krijimin e

² Egidio Ivetec, *Luftërat ballkanike*, "Dituria", Tiranë 2008, fq. 32.

mundësive efektive për zgjidhjen definitive të çështjes shqiptare, Lidhja e Prizrenit shënon fillimin e një etape të re në lëvizjen kombëtare rilindëse, cilësisht më të lartë në krahasim me lëvizjet çlirimtare të shekujve të kaluar.³ Ajo konsiderohet si preludi dhe boshti themelor i të gjitha aksioneve kryengritëse të mëvonshme të popullit shqiptar, për vendosjen e drejtësisë ndaj kauzës së tij, mbrojtjes së interesave dhe të drejtave të patjetërsueshme kombëtare.⁴

Edhe pse Kongresi i Berlinit duhej që në punimet e tij të orkestronte vepra balancuese dhe paqeruajtëse, përmes rikonfigurimit të hartës politike gjeneroi një rivalitet kronik, konsekuencat e të cilit ndikuan negativisht në qytetërimin evropian. Vendimet e tij influencuan ndjeshëm në gjeopolitikën e Ballkanit. Gjithashtu, duke shpërfillur ekuilibrin demografik të shqiptarëve në rajon, jo vetëm nuk u neutralizuan grindjet politike ndëretnike, por kontribuan në formësimin e një atmosfere konfliktuale. Historikisht trojet shqiptare përgjatë procesit të konstituimit të shteteve ballkanikë kanë qenë arenë përplasjesh dhe thyerjesh të interesave të Fuqive të Mëdha. Kombi shqiptar konsiderohet si kombi më i stigmatizuar në funksion të baraspeshës mes "fuqisë" së Fuqive dhe ruajtjes së paqes, ku koha vërtetoi se kjo paqe nuk u ruajt. Fuqitë e Mëdha ndryshe nga sa vepruan me shtetet e tjerë ballkanike, që gjatë punimeve të Kongresit mundën të prezantonin dhe mbronin kërkesat e tyre politike dhe lakmitë aneksioniste territoriale, mohuan dhe injoruan mundësinë e ligjshme të shqiptarëve për t'u marrë në konsideratë si element ekuilibri i pamohueshëm në Evropën Juglindore. Shqyrtimi i kërkesave të tyre u refuzua. Gjatë punimeve njëmujore të Kongresit

³ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*, Botimet "Toena", Tiranë 1997, fq. 420.

⁴ Këtu mund të përmendet edhe Lidhja e Pejës, e cila kundërshtojë po me të njëjtën forcë nga kryeqyteti osman. Qëndrimi joaprovues turk lexohet në deklarinimin e një prej sekretarëve të sulltanit kur pohonte përballë përfaqësuesve rusë dhe serbë se politika osmane kishte urdhëruar që ky kuvend të mos mbahej. *Sipas, HHHStA. PA. në AIH, Dok. nr. 16/A-b, Beograd 08. 02. 1899, & Dok. Nr.7, Stamboll 18. 02. 1899. Informacion i ambasadorit austro-hungarez.*

nuk mungoi vullneti insistues nga faktorët politikë, që çështja e tyre kombëtare të bëhej pjesë e rendit të ditës. Në mënyrë sistematike nëpërmjet peticioneve, memorandumeve apo platformave të qarta juridiko-institucionale, ata parashtronin denjësisht kërkesën për njohjen e autonomisë apo formimin e një shteti të pavarur shqiptar. Në Memorandumin e 13 qeshorit 1878 drejtuar përfaqësuesit britanik në Kongresin e Berlinit, Lordit Bikonsfild, ndër të tjera theksohej: "...nëse synoni garantimin e një paqeje të qëndrueshme në popujt e Lindjes, atëherë ato duhet të reformohen sipas kombësisë së vet, duke respektuar lidhjet etnike, gjeografike dhe historike. Shqipëria duke qenë një komb i vetëm për nga raca, gjuha, traditat, historia dhe gjithë komponentët përbërës të identitetit kombëtar, ajo ka të drejtë të quhet, sikurse është në të vërtetë, një trup i vetëm dhe të organizohet në formë unitare nën një qeveri të vetme".⁵ Kërkesat e qarqeve të ndryshme patriotike-intelektuale, si dhe e organeve të Lidhjes së Prizrenit drejtuar Fuqive të Mëdha nuk u përfshinë në punimet e Kongresit të Berlinit edhe pse në tryezat diplomatike të tij qëndronte i varur fati i shqiptarëve. Duke i kthyer kurrizin zgjidhjes së statusit politik të tyre, kancelaritë evropiane i dhanë edhe më shumë hov impulseve ofensive dhe konflikteve të shpeshta e të paevitueshme të shteteve fqinjë ballkanikë, që në fokusin e tyre kishin territoret shqiptare.

Konsolidimi i jetës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare është kërkesë inherente e të gjithë kombeve, por për të realizuar këtë rrugë e shqiptarëve ka qenë e dhimbshme. Lidhja dhe eksponentët drejtues së saj mbështetur dhe frymëzuar në parimin e kombësisë dhe të drejtës së popujve për vetëvendosje gjykoi se mbrojtja diplomatike e të drejtave të shqiptarëve dhe ngrehinës së tyre shtetërore në panelin ndërkombëtar të Berlinit ishte jetike. Përmeshja e këtij misioni iu besua kreut të dikasterit të Punëve të Jashtme, diplomatit dhe

⁵ Stefanaq Pollo&Selami Pulaha, *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912*, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Shtypshkronja "Mihal Duri", Tiranë 1978, fq. 21-49

udhëheqësit Abdyl Frashërit.⁶ Me një stil të stuhishëm ai u mobilizua dhe filloi të lobonte dhe të ushtronte një diplomaci sfiduese me qëllim të zgjidhjes së problemit kompleks në një mjedis paragjykses dhe privues sa i takonte çështjes shqiptare. Pasi konceptuan si prioritet sigurimin e solidaritetit të Direktoratit të të Mëdhenjve, së bashku me Mehmet Ali Vrionin, ai vizitoi disa nga selitë qendrore të Evropës, duke realizuar një nga veprimtaritë më të suksesshme të Lidhjes së Prizrenit në planin diplomatik. Ata u shfaqën në kancelaritë evropiane me atributet e diplomatëve të parë të shtetit shqiptar, themelet e të cilit po i hidhte Lidhja Shqiptare. Ishin ngarkuar nga Komiteti Ndërkrahinor i Lidhjes për Shqipërinë e Jugut me misionin e posaçëm për të biseduar drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha dhe t’iu kërkonin këtyre të fundit të tregoheshin të vëmendshme dhe të solidarizoheshin me aktualitetin e jetës politike në viset shqiptare e të hiqnin dorë nga zbatimi i Protokollit nr. 13 të Kongresit të Berlinit, në të cilin sanksionohej rishikimi i vijës së kufirit turko-grek (në fakt shqiptaro-grek).⁷ Në përmbajtje të tekstit të tij parashikohej se kufiri verior i Greqisë do të zhvendosej dhe brenda tij do të përfshiheshin territoret shqiptare të Shqipërisë së Jugut, siç ishin Janina me rrethet e saj, Preveza, Arta, Margëlliçi, Parga, Paramithia etj., të cilat përbënin pjesën më të madhe të Çamërisë dhe viseve të tjera në lindje të saj.

Abdyl Frashëri dhe Mehmet Vrioni, falë kulturës, formimit të gjithanshëm dhe shpirtit të paepur patriotik spikatën në maturinë e tyre politike dhe dialoguese, duke përballuar negociata të vështira me përfaqësuesit më të lartë të Fuqive të Mëdha apo edhe me diplomatët osmanë në kryeqytetet evropiane. Pavarësisht se Konsulta e quante të padobishme dhe joproduktive përçapjen e Abdyl Frashërit dhe

⁶ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*, Botimet “Toena”, Tiranë 1997, fq. 172-188

⁷ Kristaq Prifti, *Lidhja Shqiptare në dokumentet osmane 1878-1881*, Tiranë 1978, Dok. nr.11, fq. 30; Dok. nr.12, fq. 31.

Mehmet Vrionit në Romë e Paris,⁸ si "të plotfuqishëm të bashkatdhetarëve të tyre për të bindur Italinë dhe Francën që të heqin dorë nga ratifikimi i kufirit në anën e Epirit",⁹ falë analizës juridike e historike dhe prezantimit racional e dinjitoz të kërkesave të kombit shqiptar,¹⁰ në një interpretim ekstensiv, ata mundën të ndiznin dritën e arsyes së të mëdhenjve, se kombi i tyre nuk kishte pse *a priori* të ishte i humburi në inercinë e një paqeje të zhveshur nga kuptimi i saj. Misionin e vet delegacioni e zhvilloi nëpërmjet parashtrimit verbal të kërkesave shqiptare në takimet me politikanë e diplomatë të niveleve më të larta të Fuqive të Mëdha. Gjithashtu, delegacioni gjykoi të arsyeshme t'iu dorëzonte atyre edhe një memorandum, ku vihej theksi te mospajtimi me zgjidhjen e ofruar jo në konkordancë me moralin e parimeve juridiko-ndërkombëtare nga Kongresi i Berlinit. Vendimet e tij arbitrarë ishin një goditje e fortë dhe me pasoja të rënda për të drejtat e kombit shqiptar. Kjo del qartë edhe në përmbajtjen e tekstit të memorandumit, kur me zërin e shpirtit të indinjuar hartuesit e tij shpalosën keqardhjen ndaj arsyes së errësuar me fjalët: "Si mund të lejohet që në këtë shekull të diturisë dhe të qytetërimit, një komb kaq trim dhe kaq i lidhur me truallin e tij të sakrifikohet duke iu dhënë një fqinji kaq të pangopur, pa asnjë arsye të ligjshme".¹¹ Përmes kësaj revolte të redaktuar me prurëncë filozofike dhe diplomatike, në emër të Lidhjes, dëshirohej të tregohej themeli i vërtetësisë së çështjes shqiptare dhe njëkohësisht i bëhej thirrje Aleancës së Paqes, që vendimet e saj të ishin *pactum pacis*. Në turin diplomatik përgjatë

⁸ Misioni i ndërmarrë prej delegacionit të Lidhjes, gjithashtu edhe nga diplomatë austro-hungarezë do të konsiderohej "i habitshëm dhe shprehje arrogancë". *Shih, HHStA, Raport i të atashauarit diplomatik hasburgas në Janinë drejtuar Baron Von Schëegel, 30. 03. 1879.*

⁹ Kristaq Prifti, *Lidhja Shqiptare në dokumentet osmane 1878-1881*, vep. cit., Dok. nr. 15, fq. 30.

¹⁰ Abdyl Frashëri do të pohonte me bindje se në interes të zgjidhjes pozitive të kazuzës së shqiptarëve, "Ne do të trokasim në të gjitha dyert". *Shih, AMAE, Raportit të zv/konsullit francez në Janinë adresuar eprorëve të tij, Paris 26. 03. 1879.*

¹¹ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*, Botimet "Toena", Tiranë 1997, fq. 182

muajve prill-qershor të vitit 1879, duke shpresuar në vlerësimin objektiv të kancelarive nënshkruese të Traktatit të Berlinit, Abdyl Frashëri parashtroi qëndrimin mohues të shqiptarëve ndaj dispozitave diskriminuese të marrëveshjes dhe përsëriti kërkesën e panegociueshme për paprekshmërinë e hapësirave shqiptare. U vu theksi se shqiptarët do të vepronin si një njësi unike politiko-administrative "një komb - një vilajet" dhe kurrësi nuk do të lejonin gjymtimin e trojeve etnike në jug të vendit, parashikuar nga Protokollin nr. 13,¹² duke bërë të qartë se kambanat e revolucioneve çlirimtare në Evropë dhe Ballkan duhet të dëgjohen njësoj nga kabinetet e Fuqive të Mëdha. Ky qëndrim njëkohësisht tregon evoluimin dhe konsolidimin e mendimit politik të shqiptarëve, si dhe vetëdijen shtetformuese në periudhën e formimit të shteteve kombëtare.

Ironia e deklaratave zyrtare të Fuqive të Mëdha i kalonte caqet e gjuhës diplomatike. Kërkesa e Abdyl Frashërit për përfshirjen e çështjes kombëtare shqiptare në punimet e Kongresit ndeshi në një mospërfillje dhe kundërshtim të ashpër të kancelarit gjerman Bismark, i cili me përgjigjen e tij tepër cinike deklaroi se "nuk ka një komb shqiptar", duke evidentuar se vendimmarrja do të bëhej mbi bazën e standardeve të shumëfishta. Kjo përforcohet edhe nga pohimi tjetër kur artikulonte se "Shën Stefani do të kishte mbetur i pandryshuar, nëse përcaktimet e tij nuk do të preknin interesa të caktuara evropiane".¹³ Refuzimi për të shqyrtuar kërkesën shqiptare nga ana e "sekserit të ndershëm"¹⁴ nxirrte në pah mosinteresin e Fuqive për t'iu

¹² Ferit Duka, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare, (Studime dhe dokumente)*, UET/Press, Tiranë 2009, fq. 401.

Ndërkohë sipas Protokollit nr. 12 të Kongresit, Malit të Zi i jepeshin Tivari, Podgorica, Triepshi, Vermoshi, Plava dhe Gucia. Në pamundësi të mbrojtjes së gjithë qendrave shqiptare nga aneksimi malazez, për Plavën dhe Gucinë, Lidhja Shqiptare vendosi të mbroheshin me çdo kusht.

¹³ Maria Todorova, *Ballkani imagjinar*, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë 2006, fq. 252

¹⁴ Henry Kissinger, *Diplomacia*, "Laert", Tiranë 1999, fq. 155.

"Ehrlicher Makler-sekseri i ndershëm", kështu e përcaktonte Bismark rolin e tij në Kongresin e Berlinit.

kundërvënë politikave ekspansioniste ose cënimit flagrant të parimit juridiko-ndërkombëtar *ius cogens*, parimit të lirisë së popujve. Gjithashtu, arroganca e figurës dominuese të Kongresit të Berlinit dhe shurdhëria e diplomacisë evropiane ishte një demoralizim, një mohim absurd dhe i padrejtë i shansit historik të shqiptarëve. Diplomacia evropiane jo vetëm neglizhoi *de iure* trajtimin dhe zgjidhjen e çështjes shqiptare, por me vendimet e Berlinit shkeli haptazi tërësinë territoriale të saj, duke e konsideruar atë si "plaçkë lufte" apo "trashëgimi otomane". Kongresi i mbylli punimet e veta më 13 korrik 1878 me nënshkrimin e Traktatit të Berlinit, i cili atakonte kushtet e shpallura të Traktatit të Shën Stefanit,¹⁵ por njëkohësisht sanksiononte egoizmat politike të fuqive evropiane. Traktati i ri frenoi depërtimin apo hegjemonizimin rus në Ballkan dhe Azinë e Vogël, duke pakësuar në mënyrë të ndjeshme kufijtë e "Principatës Autonome Bullgare" dhe njohu pavarësinë e Rumanisë, Serbisë dhe Malit të Zi. Në përmbajtjen e Traktatit kishte dispozita që lidheshin me aspektin politik të territoreve shqiptare, por jo në kuadrin e shqyrtimit të themeltësisë së çështjes. Konkretisht neni 23 sanksiononte detyrimin e shtetit osman për reformën administrative autonomiste të vilajeteve. Autoriteteve osmane iu kërkohesh hartimi i "rregulloreve organike" prej komisioneve të posaçme, në përbërje të të cilëve duhej të kishte një përfaqësim të gjerë elementi vendas, ndërsa hyrja në fuqi e tyre kërkonte paraprakisht miratimin nga Komisioni Evropian për Rumelinë Lindore.¹⁶ Reforma administrative autonomiste duket sikur përkonte me kërkesën e shqiptarëve, por realisht, tagri që iu garantua Portës së

¹⁵ Më 3 mars të vitit 1878 Perandoria Osmane, si palë humbëse e luftës ruso-turke, nënshkroi në Shën Stefan Traktatin e Paqes me Perandorinë Ruse. Objekti i kësaj marrëveshjeje, parashikonte humbjen e një pjese të konsiderueshme të zotërimeve të saj në rajonin e Ballkanit, ndërkohë që Serbia, Mali i Zi, Rumania dhe Bullgaria u bënë shtete të pavarura. Në përmbajtjen e këtij traktati, i cili u bë shkak për krijimin e tendencave rivale në Koncertin Evropian të Fuqive të Mëdha, shqiptarët dhe territoret shqiptare dekonsideroheshin si subjekt politik i veçantë dhe u përdorën si "plaçkë lufte", që duhej të ndaheshin ndërmjet shteteve të krijuara rishtazi apo u lanë nën sundimin e Perandorisë Osmane.

¹⁶ Ferit Duka, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare*, vep. cit., fq. 401.

Lartë për ndarjen administrative dhe e drejta diskrecionare e Fuqive të Mëdha për të ndërhyrë në këtë procedurë cenonte interesat jetike të tyre. Abdyl Frashëri duke refuzuar ndarjen e territoreve shqiptare në katër vilajete argumentonte se këto reforma kishin karakter joshqiptar, por serb në vilajetin e Kosovës, bullgar në atë të Manastirit dhe grek në vilajetin e Janinës dhe rriste mundësinë e rrezikut të aneksimit të trojeve shqiptare nga shtetet fqinje, njëkohësisht vështirësonte luftën e shqiptarëve për bashkimin në një vilajet të vetëm autonom.¹⁷

Protokolli nr. 13 i Kongresit të Berlinit ishte një goditje për çështjen shqiptare, sepse nëpërmjet përmbajtjes së tij diplomacia evropiane me kërkesën e Austro-Hungarisë kërkonte t'i impononte strukturës shtetërore osmane njohjen, respektimin dhe garantimin e privilegjeve dhe imuniteteve (venomeve) të Mirditës, sipas të cilëve i kishte *ab antique*. Ky protokoll e reduktonte çështjen kombëtare shqiptare në një problem krahinor, duke i dhënë mundësinë diplomacisë vjeneze të ndërhynte në jetën e brendshme të Mirditës dhe ta kthente atë në një pikëmbështetje të avancuar për ekspansionin e saj drejt brigjeve të Adriatikut dhe Ballkanit Qendror.¹⁸ Qëndrimi politik i diplomatëve evropianë të vitit 1878 shënon fillimin e dramës historike për çështjen shqiptare, çështjen e fundit ballkanike të patrajtuar. Gjithashtu, kjo diplomaci prapaskenash hodhi hapin drejt dështimit në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Kanavaca e lyer me penelin e padrejtësisë diplomatike krijoi bindjen se për të dalë nga kthetrat e zgjedhës shekullore, për të fituar lirinë, që ka shërbyer si busulla orientuese historike e tyre, shqiptarët si mjet kryesor duhet të përdornin kryengritjet e armatosura dhe diplomacinë ta shikonin si alternativë plotësuese në sendërtimin e idealit dhe aspiratave të tyre shekullore. Ashtu sikurse thotë edhe

¹⁷ *Historia e popullit shqiptar, Rilindja Kombëtare, vitet 30 dhe shek. XIX - 1912*, Vëllimi II, Botimin i Akademisë së Shkencave dhe Institutit të Historisë, Botimet "Toena", Tiranë, 2002, fq. 164-166.

¹⁸ Arben Puto, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare (1878-1926)*, Akademia e Shkencave, Albin, Tiranë 2003, fq. 19; *Historia e popullit shqiptar, Rilindja Kombëtare, vitet 30 dhe shek. XIX - 1912*, vep.cit., fq. 164-166.

akademiku Rexhep Qosja, për shqiptarët e asaj kohe "pena diplomatike mprehej në shpatën e kryengritjeve".

Delegacioni shqiptar duhet të ndeshej dhe të përballonte edhe kundërshtimin e Portës së Lartë. Në të vërtetë, nga demarshet që do të ndërmernte delegacioni, Perandoria nuk cënohej, përkundrazi lehtësohej pozita e saj për të mos zbatuar disa prej vendimeve të Kongresit të Berlinit për cedime tokash, të cilat preknin tërësinë e saj territoriale. Kundërshtimin e vet mund ta justifikonte tashmë edhe përmes alibisë së qëndrimit "ekstrem" të faktorit shqiptar, të cilin ajo realisht nuk e kishte të lehtë ta dominonte. Por gjithësesi dalja e delegacionit të Lidhjes në Evropë, me nismën e vet, kurajua e treguar për të kontaktuar drejtpërsëdrejti me kanceleritë evropiane dhe për të folur me zërin e vet, jashtë autoritetit të Perandorisë Osmane dhe duke iu mbivendosur shërbimit diplomatik osman, shkaktonte një lloj "lëndimi" për të. Juridikisht Shqipëria dhe populli shqiptar ishin pjesë përbërëse e Perandorisë. Prandaj udhëtimin e delegacionit dhe qëllimet e tij i etiketuan si veprim të "pahijshëm" dhe të "paarsyeshëm".¹⁹ Në prillin e vitit 1879, Ministria e Jashtme Turqisë, nëpërmjet dy udhëzimeve që u dërgonte ambasadorëve të vet në Romë e në Paris i cilësonte si të papajtueshëm me sovranitetin e Perandorisë përçapjet e delegatëve shqiptarë pranë qeverive italiane e franceze. Ajo i porosiste që t'iu kërkonte atyre ndërprerjen e veprimtarisë. Por, Abdyl Frashëri dhe Mehmet Vrioni e vazhduan itinerarin diplomatik pavarësisht kërkesave dhe kërcënimeve të Portës.²⁰

Edhe pse në vendimmarrjen e Berlinit nuk u mbajt parasysh parimi universal *equity* duket se zëri protestues i shqiptarëve dhe organeve përfaqësuese të tyre influencuan qoftë edhe në mënyrë periferike në qëndrimet e ardhshme politike evropiane. Çështja

¹⁹ Kristaq Prifti, *Lidhja Shqiptare në dokumentet osmane 1878-1881*, vep.cit. Dok. nr. 13, fq. 32; Dok. nr. 14, fq. 32-33; Dok. nr. 23, fq. 42.

²⁰ Arben Puto, *Lidhja Shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të kombit të vet në vitet e Krizës Lindore*, botuar në "Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit", 1878-1881, Vëllimi I, Tiranë 1979, fq. 61.

shqiptare tashmë do të zinte vend në të gjitha raportet konsullore apo të përfaqësuesve diplomatikë të akredituar në rajonin e Gadishullit Ballkanik. Diplomati britanik në Perandorinë Osmane, George Goschen në vitin 1880 do të thoshte se, kombësia shqiptare është një element, i cili nuk duhej injoruar në kombinacionet e ardhshme politike. Argumentet historike dhe politiko-juridike bindëse dhe serioze shqiptare mundën të ndikonin pozitivisht edhe pse jo esencialisht në ndryshimin e qëndrimit politik britanik ndaj çështjes kombëtare shqiptare. Përkundër vështirësive të shumta (nga njëra anë presioni i shteteve fqinjë ballkanikë dhe nga ana tjetër bojkoti i Fuqive të Mëdha), Lidhja Shqiptare e Prizrenit i dha një tjetër dimension çështjes kombëtare shqiptare, madje ajo mundësoi që çështja të kishte një tjetër impakt në diplomacinë evropiane, që me pretekste makiaveliste dhe me forma moderne farse kërkonte të shkelte mbi të drejtat e kombit shqiptar. Lidhja evidentoi përballë sferave më të larta të politikës evropiane se shqiptarët ishin subjekt më vete dhe në bazë të së drejtës ndërkombëtare gëzonin të drejtën e vetëvendosjes, ashtu sikurse popujt e tjerë të Ballkanit dhe Evropës. Veprimtaria e saj ndryshoi kursin e qëndrimeve politike të kancelarive evropiane, duke imponuar se krijimi i shtetit shqiptar tanimë prezantohej si imperativ i pamohueshëm dhe i domosdoshëm për stabilitetin dhe paqen në Ballkan. Nga një organizatë që nuk gëzonte asnjë lloj njohje, as njohjen *de facto* dhe as njohjen *de iure*, tashmë aktiviteti i Lidhjes së Prizrenit, si në organizimin e brendshëm dhe në arenën ndërkombëtare, ndiqej me kujdes. Në jetën aktive dhe dinamike tre vjeçare të saj, Lidhja përmes aktivitetit diplomatik, por jo vetëm, mundësoi që çështja shqiptare të ndërkombëtarizohej. Shqipëria u bë pjesë e axhendës së kancelarive evropiane, si një nga çështjet ende të pazgjidhura ballkanike, që kërkonte zgjidhje imediate. Filloi të bënte rrugë pak e nga pak një koncept i ri i lidhur me Shqipërinë e shqiptarët në opinionin e qarqeve influente të Evropës që prirej drejt një kuptimi

më realist të çështjes shqiptare.²¹ Pavarësisht nga qëndrimi cinik i Fuqive të Mëdha të Evropës së dinastive, pa rezistencën e Lidhjes së Prizrenit dhe pa Lëvizjen Kombëtare që atë e pasoi, ndoshta Shqipëria që doli nga Konferenca e Ambasadorëve, do të ishte rrudhur e tkurrur në një mikroshtet, si ai që u skicua në Traktatin e fshehtë të Londrës në vitin 1915.²²

²¹ Aleks Buda, *Çështja shqiptare në marrëdhëniet ndërkombëtare në vitet 1878-1881*, Buletini USHT, seria e shkencave shoqërore, nr. 4/1962.

²² Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*, vep. cit., fq. 425.

Bibliografi

- BUDA, Aleks, *Historia e popullit shqiptar, Rilindja Kombëtare, vitet 30 të shek. XIX - 1912*, vëll. II, Tiranë: Botimet "TOENA", 2002.
- BUDA, Aleks, *Çështja shqiptare në marrëdhëniet ndërkombëtare në vitet 1878-1881*, Tiranë, Buletini USHT, seria e shkencave shoqërore, nr. 4/1962.
- DUKA, Ferit, *Shekujt osmanë në hapësirën shqiptare (Studime dhe dukumente)*, Tiranë, UET/Press, 2009.
- FRASHËRI, Kristo, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881*, Tiranë, "Toena", 1997;
- Historia e popullit shqiptar, Rilindja Kombëtare, vitet 30 dhe shek. XIX - 1912*, Vëllimi II, Botimi i Akademisë së Shkencave dhe Institutit të Historisë, Tiranë, "Toena", 2002.
- IVETIC, Edigio, *Luftërat ballkanike*, Tiranë, "Dituria", 2008.
- KISSINGER, Henry, *Diplomacia*, Tiranë, "Laert", 1999.
- POLLO, Stefanaq & PULAHA, Selami - *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912 (memorandume, vendime, protesta, thirrje)*, Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Tiranë, Shtypshkronja "Mihal Duri", 1978
- PRIFTI, Kristaq, *Koncepti i Lidhjes së Prizrenit për shtetin shqiptar, Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe vendi i saj në histori*, Prishtinë, 2008.
- PRIFTI, Kristaq, *Lidhja Shqiptare në dokumentet osmane 1878-1881*, Tiranë 1978.
- PUTO, Arben, *Çështja shqiptare në aktet ndërkombëtare të periudhës së imperializmit*, Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historik, Vëllimi I (1876-1912), Tiranë, "8 Nëntori", 1984.
- PUTO, Arben, *Historia diplomatike e çështjes shqiptare 1878-1926*, Tiranë, Akademia e Shkencave, Shtëpia Botuese "Albin", 2003.
- PUTO, Arben, *Lidhja shqiptare për mbrojtjen e të drejtave të kombit të vet në vitet e Krizës Lindore*, botuar në "Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit", 1878-1881, Vëll. I, Tiranë 1979.
- TODOROVA, Maria, *Ballkani imagjinar, Ballkani si alter ego e Europës*, Tiranë, Instituti i Dialogut & Komunikimit, 2006.
- VERLI, Marenglen, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë Austro-Hungareze (1877-1918)*, Tiranë, "Klean", 2014.

Mark JUNCAJ

MALËSIA E MADHE NË KOHËN E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT

Përmbledhje

Pas luftës ruso-osmane, e cila përfundoi me humbjen e rëndë të Perandorisë Osmane, u nënshkrua Traktati i Shën Stefanit më 3 mars 1878. Me këtë Traktat interesat e popullit shqiptar cenoheshin rëndë. Pjesa më e madhe e viseve shqiptare u jepej sllavëve. Këtij copëtimi nuk i shpëtoi as Malësia e Madhe, ngase pjesë të saj i jepeshin Malit të Zi. Mirëpo me vendimet e këtij Traktatit nuk u pajtuan as Fuqitë e Mëdha, sepse nuk donin fuqizimin e Rusisë në Ballkan dhe kërkuan që të rishqyrtohet nga një Kongres i paqes i cili u vendos të mbahet në Berlin.

Qarqet atdhetare shqiptare vendosën të mbajnë një kuvend mbarëkombëtar në Prizren. Kështu, 3 ditë para fillimit të punës së Kongresit të Berlinit u krijua organizata mbarëkombëtare politiko-ushtarake e njohur me emrin Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Në mbledhjen themeluese, për shkak të pengesave që u nxorën autoritetet osmane të Shkodrës, munguan përfaqësuesit e Vilajetit të Shkodrës. Megjithatë Malësia e Madhe, sikurse i gjithë vilajeti i Shkodrës, i pranoi vendimet e Lidhjes.

... Protestat e ndryshme të shqiptarëve Kongresi i Berlinit nuk i mori fare parasysh, por, përkundrazi, disa troje shqiptare i copëtoi ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi. Lidhja Shqiptare, vendosi që me çdo kusht të mbronte Plavën dhe Gucinë, të cilat duhej t'i jepeshin Malit të Zi. Duke e parë se Mali i Zi nuk kishte forcë t'i merrte këto territore për shkak të rezistencës së shqiptarëve, atëherë Fuqitë e Mëdha vendosën që këto territore të kompensohen me viset e Hotit dhe të Grudës. Por sa filluan të qarkullojnë zërat se mund të vendoset për një shkëmbim të tillë, malësorët

shprehën pakënaqësinë me anë të protestave, duke ua bërë me dije të gjithëve se tokat e tyre do t'i mbrojnë me çdo kusht. Kur e panë se protestat janë të kota, atëherë Komiteti Ndërkrahinor i Shkodrës filloi përgatitjet për mbrojtjen e këtyre viseve. Sikurse në Plavë dhe Guci, edhe këtu shqiptarët dolën fitues. Më në fund, në vend të këtyre viseve, Malit të Zi iu dorëzua Ulqini.

Fjalët çelës: Malësia e Madhe, Lidhja Shqiptare e Prizrenit, Mali i Zi, Plava e Gucia, Hoti e Gruda, Serbia, copëtimi.

Në vitin 1875, për shkak të pakënaqësive të shumta të popullsisë, vjen deri te shpërthimi i kryengritjes antiosmane në Nevesinjë prej nga së shpejti do të përhapet në tërë Hercegovinën. Me shpërthimin e kësaj kryengritje do të hapet një kapitull i ri në Historinë e Ballkanit, i njohur si **Kriza e Lindjes**. Vitin tjetër, kundër Perandorisë Osmane do të angazhohen edhe Serbia dhe Mali i Zi, të cilat zyrtarisht në fund të qershorit 1876 do t'i shpallin luftë.¹ Mali i Zi hyri në këtë luftë me plane për zgjerimin e shtetit, të cilat parashikonin zgjerimin territorial në drejtim të Hercegovinës dhe të Shqipërisë Veriore, si dhe daljen në detin Adriatik.² Ushtria malazeze u angazhua në dy drejtime: në drejtim të Hercegovinës e edhe në drejtim të Shqipërisë. Pasi që Mali i Zi korri fitore kundër ushtrisë osmane në betejën e Vuçji Dollit³, atëherë u angazhua edhe në jug në drejtim të Malësisë së Madhe. Gjatë verës së vitit 1876, Mali i Zi sulmoi Fundnën, Kojën dhe pastaj edhe Selishtin, vende këto që i takojnë Malësisë së Madhe. Në të gjitha këto beteja shqiptarët bënë rezistencë, mirëpo malaziasit korrën fitore, me përjashtim në luftimet që u zhvilluan në Selishtë. Mbas kësaj, më 6 shtator 1876 do të zhvillohen luftime në Triesh dhe malaziasit do të arrijnë që ta marrin këtë

¹ Ferdinand Schevill, *Ballkani – Historia dhe qytetërimi*, “Uegen”, Tiranë, 2002, fq. 321-322.

² Dr Zhivko Andrijasheviq, *Istorijska Crne Gore*, Vukotiq Media dhe Atlas Fondacija, Beograd, 2015, fq. 175.

³ Grup autorësh, *Istorijska Crne Gore 4*, vëllimi II, Istorijski Institut Crne Gore, Podgorica, 2004, fq. 222.

krahinë.⁴ Ndaj popullatës së kësaj krahine ushtria e re pushtuese u soll egërsisht, sa që atyre që nuk pranuan pushtimin malazias ua dogjën shtëpitë dhe i detyruan ta braktisin Trieshin.⁵ Mirëpo me kalimin e kohës u dobësua sulmi serbo-malazezë dhe ushtritë e tyre u gjendën në situatë të pafavorshme.

Të gjitha këto ngjarje ishin në favor të Rusisë, e cila, pasi i përfundoi përgatitjet për luftë, zyrtarisht më 24 prill 1877 i shpalli luftë Perandorisë Osmane. Hyrjen e Rusisë e shfrytëzoi Mali i Zi, ngase trupat kryesore osmane u detyruan që të transferohen dhe të përqendrohen në frontin rus. Mali i Zi ndërmoi një ofensivë te re kundër Hercegovinës. Mirëpo këtë mësymje e ndaloi Austro-Hungaria, e cila i bëri me dije se nuk do të pranojë zgjerimin e Malit të Zi në këto vise, ngase bënin pjesë në planet e saj pushtuese. Ky veprim i Vjenës e detyroi Malin e Zi që të ndërrojë planet dhe më shumë të angazhohet në sektorin jugor.

Menjëherë pasi që mori Nikshiqin iu drejtua bregdetit, duke sulmuar dhe pushtuar në fillim të vitit 1878 Tivarin dhe Ulqinin.⁶ Në anën tjetër, Rusia e theu rezistencën osmane në Plevna dhe, duke e kërcënuar mbas kësaj Stambollin, e detyroi Perandorinë Osmane që më 3 mars 1878 të nënshkruajë Traktatin e Shën Stefanit. Vendimet e këtij traktati ishin fatal në rradhë të parë për kombin shqiptar. Përveç që me këtë dokument pranohej pavarësia e Malit të Zi dhe e Serbisë, si dhe autonomia e Bullgarisë, atyre po ashtu u pranohej edhe zgjerimin territorial, duke u dhënë, mes tjerash, edhe teritore të banuara kryesisht me shqiptarë. Mali i Zi, përveç tjerash, mori Plavën dhe Gucinë, Rugovën, Hotin, Grudën, Vërmoshin, Trieshin dhe Kojën si dhe qytetet e Tivarit dhe të Ulqinit. Pra, me këto vendime kërcënohej drejtpërdrejt edhe Malësia e Madhe pasi që ishte paraparë gjymtimi i rëndë i saj,⁷ sikurse i tërë tokave shqiptare.

⁴ Momir M. Marković, *Crnogorski rat*, "Pobjeda "A.D., Podgorica, 2007, fq. 222-224.

⁵ Lucë Lucaj, *Triepshi ndërmjet Malësisë dhe Kuçit*, "Illyricum", Tuz, 2001, fq. 48.

⁶ *Istorijski zapisi*, Istorijски Institut Crne Gore, Podgorica, 1998, fq. 25.

⁷ Grup autorësh, *Në një cep të Ilirisë*, "Art Club", Ulqin, 2007, fq. 30.

Që nga momenti kur shqiptarët e morën vesh lajmin e copëtimit të Shqipërisë nga vendimet e Shën Stefanit nuk qëndruan duarkryq, por u angazhuan në mënyra të ndryshme kundër këtyre vendimeve. Menjëherë filluan të organizojnë kuvende dhe protesta me anë të cilave shprehnin pakënaqësinë e tyre kundër copëtimit të Shqipërisë. Mirëpo përveç shqiptarëve dhe, për fat të shqiptarëve, kundër vendimeve të Shën Stefanit ishin edhe Fuqitë e Mëdha, në radhë të parë Britania e Madhe dhe Austro-Hungaria, të cilat nuk donin fuqizimin e Rusisë në Gdishullin Ballkanik. Kundërshtimi i Fuqive të Mëdha solli te vendimi që Traktati i Shën Stefanit të rishqyrtohet në një kongres ndërkombëtar, që më në fund do të vendoset të mbahet në Berlin.⁸

Duke e parë rrezikun e madh që u kanosej viseve shqiptare, atdhetarët shqiptarët filluan të ndërmarrin masat e nevojshme për organizimin e një kuvendi mbarëkombëtar, i cili u vendos të mbahej në qytetin e Prizrenit. Data e caktuar ishte 10 qershori, pra 3 ditë para fillimit të punës së Kongresit të Berlinit.⁹ Koha që u kishte mbetur shqiptarëve u përdor jo vetëm për organizimin e kuvendit mbarëkombëtar, por edhe për shprehjen e pakënaqësisë përmes protestave të ndryshme. Meqenëse edhe Malësia e Madhe kërcënohej nga vendimet e Traktatit të Shën Stefanit, ajo e shprehi pakënaqësinë në mënyra të ndryshme. Më 8 maj 1878 malësorët sa bashku me banorët e Podgoricës, Shpuzës, Zhabjakut, Tivarit, Ulqinit ia drejtuan një protestë ambasadorit francez në Stamboll, Furniesë, ku ndër tjera ia bënë me dije se në rast nevojë, si më herët, të krishterë dhe mysliman do t'u dalin zot tokave të tyre dhe nuk do të pranojnë copëtimin e atdheut.¹⁰

Më 10 qershor 1878, në sallën e Medresesë së Mehmet Pashës, pranë Bajrak-Xhamisë në Prizren u hap kuvendi mbarëkombëtar.¹¹ Vendimi kryesor i Kuvendit Kombëtar ishte krijimi i një organizate

⁸ Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar II*, "Toena", Tiranë, 2002, fq. 149.

⁹ Masar Rizvanolli, *Lidhja e Prizrenit (1878-1881)*, Arkivi i Kosovës, Prishtinë 1978, fq. 3.

¹⁰ Mr Riza Rexha, *Ulcinj za vrijeme Albanske prizrenske lige*, "Art Club", Ulqin, 2016, fq. 37.

¹¹ Skënder Blakaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, "Arbi", Prishtinë, 2013, fq. 59.

politiko-ushtarake, që u quajt Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Po ashtu vendime të rëndësishme ishin edhe krijimi i degëve në të gjithë Shqipërinë si dhe mbrojtja me çdo kusht e interesave të vendit. U ndërmor edhe një hap diplomatik me miratimin e një teksti në formë proteste kundër copëtimit të viseve shqiptare drejtuar Kongresit të Berlinit.¹² Në Kuvendin e Prizrenit nuk morën pjesë delegatët e të gjitha krahinave, ndër ata që mungonin ishin edhe ata të vilajetit të Shkodrës. Megjithatë, vendimet e kuvendit të Prizrenit, edhe pse nuk ishin prezentë, i përkrahën edhe ata vetë, me ç'gjë u bënë pjesëtar të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Arsyeja e mosardhjes së delegatëve të vilajetit të Shkodrës ishte se këta ndodheshin në një situatë tejet të pafavorshme, ngase në njërën anë ishte përherë i pranishëm rreziku malazias dhe në anën tjetër i pengonte valiu i Shkodrës Hysen Pasha, i cili kërcënime të malaziasë i shfrytëzonte për të penguar organizimin e tyre. Malaziasit herë pas herë provokonin dhe përveç që provokonin, nga lufta e fundit kishin hyrë në viset e Malësisë së Madhe si në Triesh, Kojë, Luhar, Fundinë dhe Dinoshë.¹³ Këto janë arsyet se pse Kuvendi Ndërkrahinor në Shkodër i filloi punimet vetëm më 16 qershor 1878. Në këtë kuvend u zgjodhën 26 delegatë dhe ndër ta 5 ishin përfaqësues të 5 fiseve të mëdha të Malësisë së Madhe. Ata ishin: Çun Mula nga Hoti, Baca Kurti nga Gruda, Ujk Gila nga Kelmendi, Gjell Vuksani nga Kastrati dhe Marash Dashi nga Shkrelë. Delegatët e vilajetit të Shkodrës do të nisën për në Prizren më 27 qershor dhe arritën mbas 3 ditësh, më 30 qershor. Këta ishin prezentë në Kuvendin e Përgjithshëm të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit që u mbajt më 1 korrik dhe dhanë kontribut që të miratohet Kanuni i ri i cili e ktheu Lidhjen përfundimisht në Lidhje Shqiptare. Delegatët e Malësisë së Madhe u kthyen në Shkodër më 7 korrik dhe menjëherë filluan që të njoftojnë atdhetarët me vendimet e reja të Lidhjes.¹⁴

¹² Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar II*, "Toena", Tiranë, 2002, fq. 154-155.

¹³ Xhafer Belegu, *Lidhja e Prizrenit e veprimet e saj (1878-1881)*, Sh.B. "Kkristo Luarasi", Tiranë, 1939, fq. 17-22.

¹⁴ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881) I*, Instituti i Historisë, Tiranë, 1989, fq. 200; Xhafer Belegu, *Po aty*, fq. 40.

Me fillimin e punimeve të Kongresit sytë e të gjithë Shqipërisë ishin drejtuar nga Berlini, pasi që atje luhej me fatin e të tjerëve, pra edhe me fatin e vetë shqiptarëve. Në Kongres të Berlinit fjalën kryesore e kishin përfaqësuesit e 6 Fuqive të Mëdha: Gjermanisë, Rusisë, Britanisë së Madhe, Francës, Austro-Hungarisë dhe Italisë. Ky Kongres, i cili i zhvilloi punimet që nga 13 qershori deri më 13 korrik 1878, sikurse edhe ai i Shën Stefan para pak muajsh, solli vendime në dëm të tokave shqiptare. Në Kongres u vendos të njihet pavarësia e Malit të Zi, Serbisë dhe Rumanisë, si edhe zgjerimi i tyre territorial.¹⁵ Sa i takon Malësisë së Madhe debati kryesor ishte se nëse disa pjesë të saj duhet edhe më tutje t'i mbesin Perandorisë Osmane apo t'i jepeshin Malit të Zi. Fillimisht në Kongres u shfaq mendimi që Mali i Zi në anën jugore të zgjerohet sipas vendimeve të Shën Stefanit, pra t'i jepeshin Tivari, Ulqini, Podgorica, Shpuza, Plava, Gucia, Kolashini, Berane, Hoti, Gruda, Trieshi dhe Fundna, mirëpo në fund u bënë korrigjime të pjesshme, ashtu që Ulqini, Hoti dhe Gruda edhe më tutje mbetën brenda Perandorisë Osmane, ndërsa u vendos që Malit të Zi, ndër të tjera, t'i jepeshin Tivari, Plava, Gucia, Podgorica, Shpuza, Trieshi, Koja dhe Fundnat. Me humbjen e Trieshit, Kojës dhe Fundnës filloi copëtimi i Malësisë së Madhe.¹⁶ Kështu, territori i Malit të Zi u dyfishua nga 4.700 km², sa kishte më herët, në 9.100km². Do të ishte e logjikshme që zgjerimi i Malit të Zi të bëhej në drejtim të Hercegovinës dhe në kuadër të tij të hyjnë vende thjesht sllave, por në këtë mënyrë u bë një padrejtësi historike, se përfshiu edhe territore të banuara në masë të madhe nga shqiptarët.¹⁷

Sikurse ishin kundër vendimeve të Traktatit të Shën Stefanit, shqiptarët, tani të drejtuar nga Lidhja Shqiptare, ishin edhe kundër vendimeve të padrejta të Kongresit të Berlinit. Sidomos Lidhja Shqiptare ishte kundër për t'iu dorëzuar Malit të Zi Plava dhe Gucia, sepse kjo krahinë ishte kryesisht e banuar me shqiptarë, për dallim nga Shpuza, Podgorica dhe Zhabjaku, ku shqiptarët nuk e përbënin

¹⁵ Xhorh F. Williams, *Shqipëtarët*, “Argeta – LMG”, Tiranë, 2003, fq. 22.

¹⁶ Jusuf Buxhovi, *Kongresi i Berlinit dhe Lidhja Shqiptare (1878)*, “Faik Konica”, Prishtinë, 2012, fq. 337-338.

¹⁷ Dr. Isa Bicaj, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze (1881-1914)*, Instituti i Historisë, Prishtinë, 2003, fq. 23.

shumicën e popullsisë. Me shqiptarë ishte i banuar edhe Trieshi dhe shtrohet pyetja se pse nuk reagoi Lidhja lidhur me këtë krahinë? Mirëpo duhet pasur parasysh se këtu e kishte Lidhja shumë më vështirë të vepronte, ngase Mali i Zi kishte hyrë ushtarakisht më herët dhe kishte djegur shtëpitë e atyre që nuk pranonin bashkimin me Malin e Zi.¹⁸

Duke e parë se protestat dhe kundërshtimet e shqiptarëve nuk dhanë rezultat, atëherë Lidhja e Prizrenit filloi përgatitjet për mbrojtjen me çdo kusht të Plavës dhe Gucisë, dorëzimin e të cilës krahinë nuk e kishte ndërmend ta lejonte. Meqenëse Plava dhe Gucia i takonin vilajetit të Kosovës, atëherë barrën kryesore për mbrojtjen e tyre e kishte Komiteti Ndërkrahinor i Prizrenit, i cili e formoi shtabin ushtarak për mbrojtjen e Plavës dhe Gucisë. Në krye të shtabit u caktua Ali pashë Gucia. Për mbrojtjen e këtyre viseve erdhën vullnetarë nga të gjitha viset shqiptare, ku nuk munguan as vullnetarët nga Malësisë e Madhe.¹⁹

Mali të Zi nuk i pritej më lidhur me Plavën dhe Gucinë, ashtu që në vjeshtë të vitit 1879 filloi përgatitjet për ta marrë me luftë këto treva. Vullnetarët shqiptarë nën drejtimin e Ali pashë Gucisë dhe të Jakup Ferrit i kishin ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e vendit. Ndërmjet shqiptarëve dhe malaziasve nga tetori i vitit 1879 e deri në fillim të janarit të vitit 1880 u zhvilluan beteja të ashpra, në të cilat beteja shqiptarët dolën ngadhënjimtar. Malaziasit u thyen dhe u detyruan që të tërhiqen të turpëruar. Rezistenca shqiptare paksa edhe i befasoi, ngase kishin llogaritur se nuk do të hasin në ndonjë rezistencë të mirorganizuar. Pas fitoreve të janarit 1880 u paraqitën propozimet që vullnetarët shqiptarë të kalojnë kufirin dhe të hyjnë në tokat malaziasve, por këtë gjë e ndaluan drejtuesit e Lidhjes, ngase Evropës donin t'ia bënin me dije se shqiptarët luftojnë vetëm e vetëm për mbrojtjen e atdheut. Këto fitore e ngritën lart vetëbesimin tek shqiptarët, të cilët në këtë mënyrë ua bëjnë me dije të gjithëve se zot i këtyre tokave janë vetëm shqiptarët dhe se me fatin e tyre nuk

¹⁸ Prof. Dr. Qamil Gexha, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze (1839-1912)*, Gjakovë, 2003, fq. 84.

¹⁹ Dr. Luigj Martini, Prek Cali, Camaj – Pipaj, *Shkodër*, 2005, fq. 32.

mund të luaj asnjë fuqi e huaj. Kazaja e Gucisë qëndroi në duar të Lidhjes Shqiptare për një gjysmë viti, nga nëntori i vitit 1879 deri në prill të vitit 1880. Gjatë kësaj periudhë kohore Lidhja tregoi një nivel të lartë të organizimit, ngase nuk pati ndonjë incident në tokat e administruara nga ajo.²⁰

Duke e parë se nuk mund ta marrë Plavën dhe Gucinë me anë të luftës, princ Nikolla Petroviq filloi të ankohet te Fuqitë e Mëdha se, gjoja, Perandoria Osmane nuk po i plotëson vendimet e Kongresit të Berlinit. Fuqitë e Mëdha, duke e parë se shqiptarët janë të vendosur për mbrojtjen e këtyre viseve dhe se nuk bëhet fjalë që të lëshojnë për, filluan të mendojnë se në vend të këtyre territoreve Malit të Zi, t'i japin territore tjera. Lidhur me këtë gazeta malaziasë „Gllas Crnogorca” më 8 shkurt 1880, ndër të tjera, shkruante: „se në shtypin e Evropës po shkruhet se Malit të Zi do t'i dorëzohen toka tjera në vend të Plavës dhe Gucisë” dhe më tej vazhdon se „Sido që të jetë, Mali i Zi, pasi që nuk ka marrë pjesë në Kongres, as nuk mund të kërkoj Plavën dhe Gucinë dhe se me gjakun e paratë e veta nuk duhet t'i përmirësojë gabimet e Fuqive të Mëdha”. Nga kjo na del qartë se Mali i Zi, për paaftësinë e vet, fajin ua hedh të tjerëve dhe se nuk e pranon faktin se shkaktar kryesor për mosmarrjen e atyre tokave janë shqiptarët, të cilët e thyen ushtrinë malaziasë.²¹ Menjëherë filluan të qarkullojnë zërat se ekziston mundësia që në vend të Plavës dhe Gucisë, Malit të Zi t'i jepen Hoti dhe Gruda. Shtrohet pyetja se pse në vend të Plavës dhe Gucisë Malit të Zi t'i jepeshin pjesë të Malësisë së Madhe? Konti Luigji Korti, meqenëse ishte propozuesi kryesor i këtij shkëmbimi territorial, këtë shkëmbim e arsyetonte me faktin se në trevat e Hotit dhe të Grudës banojnë kryesisht banorë të besimit katolikë dhe duke qenë këta të krishterë, sikurse edhe malazezët, nuk do të kundërshtonin bashkimin me Malin e Zi. Lidhur me këtë propozim, i quajtur sipas vetë propozuesit projekti „Korti”, së pari, më 12 prill, pasi që u pajtuan ta pranojnë, u takuan në ambasadën italiane në Stamboll përfaqësuesi i Perandorisë Osmane Savas Pasha dhe ai i

²⁰ Grup autorësh, *Në një cep të Ilirisë*, “Art Club”, Ulqin, 2007, fq. 32.

²¹ Prof. Dr. Qamil Gexha, *Shtypi i Malit të Zi mbi Lëvizjen Kombëtare Shqiptare (1873-1912)*, Gjakovë, 2003, fq. 38.

Malit të Zi vojvoda Gavro Vukoviq, me ç'rast edhe e nënshkruan marrëveshjen preliminare për zëvendësimin e Plavës dhe Gucisë me viset e Hotit dhe të Grudës. Në këtë takim ishte prezent edhe vetë kont Korti. Sipas dokumentit preliminar osmano-malazias për shkëmbimin e territoreve ishte paraparë që Hoti dhe Gruda t'i dorëzoheshin Malit të Zi deri më 22 prill dhe se Perandoria Osmane e kishte për detyrë që 24 orë më parë të lajmëronte palën malaziasë për kohën e dorëzimit të viseve të reja²². Pasi që Mali i Zi dhe Perandoria Osmane u pajtuan për shkëmbimin e territoreve, Fuqitë e Mëdha këtë dokument e zyrtarizuan më 18 prill 1880 në Stamboll me një memorandum, i njohur si Protokolli i Stambollit, që u nënshkrua nga përfaqësuesit e tyre.²³ Mirëpo arsyetimi i kontit italian për shqiptarët e vërtetë nuk vlente, sepse për ta më rëndësi kishte përkatësia kombëtare sesa ajo fetare, por për fat të keq këtë gjë nuk e kuptonin Fuqitë e Mëdha e në rradhë të parë as konti Korti. Nëse diplomati italian të ishte interesuar pak më shumë dhe të kishte lexuar se çka thoshin Finli apo Habhauzi për tolerancën fetare dhe ndjenjën kombëtare shqiptare, nuk do ta bënte një propozim të tillë më se të gabuar, sepse do ta dinte se shqiptari në rradhë të parë është shqiptar. Të kujtojmë se çka thoshte shumë më herët Finli për shqiptarët: „Shqiptari, për dallim nga greku, lidhjet kombëtare i ndien më shumë sesa ato religjioze”, ndërsa Habhauz, shoqëruesi i Bajronit, thoshte: „Kur banorët e viseve tjera të Ballkanit i pyet se çka janë, ata përgjigjen jemi muhamedanë ose të krishterë, ndërsa banori i këtij vendi përgjigjet jam shqiptar”.²⁴

Tani sytë e Evropës dhe të shqiptarëve ishin kthyer nga Malësia e Madhe. Pyetjet ishin të shumta, si p.sh. a do të përsëritet lavdia e fitoreve shqiptare si në Plavë dhe Guci, apo do të plotësohet parashikimi i kontit Korti? A do të shkëputen Hoti dhe Gruda nga trangu etnik apo edhe më tutje do të jenë pjesë përbërëse e tij? Pra, Malësia e Madhe ndodhej para një sprove tejet të madhe, sepse ishte çështje ishte e ardhmja e saj.

²² Vojvoda Gavro Vukoviq, *Memoari 2*, Obod&Pobjeda, Cetinë&Podgoricë, 1985, fq. 85-86. „Zastava”, nr. 55, Novi Sad, 11(23).04.1880.

²³ Kristo Frashëri, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2012, fq. 423.

²⁴ *Buletin i Fakultetit Filozofik XXVI/1996*, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2001, fq. 113.

Mirëpo përgjigjja e malësorëve nuk vonoi. Menjëherë, porsa filluan të qarkullojnë zërat se mund të bëhet shkëmbim territoresh, ashtu që në vend të Plavës dhe Gucisë Malit të Zi do t'i jepeshin Hoti dhe Gruda, malësorët nuk qëndruan duarkryq, por menjëherë, në mënyra të ndryshme, shprehen shqetësimin dhe pakënaqësinë e tyre. Kështu, shumë është me rëndësi 1 marsi i vitit 1880, kur malësorët zbritën në Shkodër dhe po atë ditë krerët e Hotit, Grudës, Kelmendit dhe Kastratit miratuan një peticion drejtuar Fuqive të Mëdha, ku, ndër tjera, deklarorin se në rast se miratohej projekti „Korti”, do të mbronin në çdo mënyrë tokat e tyre. Me këtë veprim malësorët u bënë me dije se ishin të gatshëm të luftojnë deri tek njeriu i fundit nëse kërcënohej tërësia territoriale e Malësisë së Madhe.²⁵ Meqenëse Malësia e Madhe ishte pjesë përbërëse e vilajetit të Shkodrës, atëherë barra kryesore i takonte Komitetit Ndërkrahinor të Shkodrës. Menjëherë Komiteti filloi përgatitjet e duhura për mbrojtjen me armë të Hotit dhe Grudës, si dhe, përveç kësaj, nuk e la anash as veprimtarinë diplomatike. Që nga 25 marsi Komiteti Ndërkrahinor i Lidhjes Shqiptare me seli në Shkodër organizonte mbledhje të njëpasnjëshme. Atë ditë nxori një shpallje me anë të së cilës njoftonte se krahinat malore të veriut kishin vendosur të luftonin. Gjithashtu, Komiteti njoftoi edhe komandantin e ushtrisë osmane në Tuz, Haxhi Osman Pashën, se nëse do të pranohej nga Perandoria Osmane projekti „Korti”, pikat strategjike t'ia dorëzonte Lidhjes Shqiptare dhe në asnjë mënyrë palës malaziasë.²⁶ Më 3 prill 1880 në Kuvendin Krahinor, në të cilin morën pjesë përfaqësuesit e Shkodrës dhe të Malësisë së Madhe, u vendos që me çdo kusht të mbrohej Hoti dhe Gruda si dhe solli një peticion, që ua dorëzoi konsujve të Fuqive të Mëdha, me anë të të cilit u bëhej me dije se do të mbroheshin në çdo mënyrë Hoti dhe Gruda. Këtë dokument e nënshkruan bajraktarët e Hotit, Grudës, Kelmendit, Kastratit, Shkrelit, Reçit, Lohes etj.²⁷ Më 9 prill u mbajt mbledhja e radhës e Komitetit Ndërkrahinor në Shkodër në të cilën morën pjesë edhe krerët e Malësisë së Madhe. Në këtë mbledhje krerët e Malësisë deklaruan se janë në gjendje që vetë t'i mbrojnë viset e tyre, prandaj kërkuan nga Komiteti

²⁵ Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar II*, “Toena”, Tiranë, 2002, fq. 184.

²⁶ Xhafer Belegu, vep. e cit. ,fq. 87.

²⁷ Skënder Rizaj, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet angleze*, Arkivi i Kosovës, Prishtinë, 1978, fq. 138-139

që të dërgojë, për solidarizim, vetëm një ndihmë simbolike. Kuvendi e hodhi poshtë këtë kërkesë dhe deklaroi se ndihma nuk do jetë vetëm simbolike, por solidarizim i plotë, ashtu që edhe viset tjera do t'u vijnë në ndihmë zonave të rrezikuara.²⁸ Komiteti Ndërkrahinor vazhdoi energjikisht punën e vet duke formuar më 11 prill 1880 shtabin ushtarak që do të merrej me mbrojtjen e Hotit dhe të Grudës. Në krye të Shtabit ushtarak u vendos ish-koloneli i ushtrisë osmane Hodo Sokoli, ndërsa në kryesi të shtabit nga Malësia e Madhe ishin: Çun Mula dhe Ismail Marku nga Hoti, Smail Martini dhe Baca Kurti nga Gruda, Nikë Gila dhe Nikë Leka nga Kelmendi, Shaban Elezi dhe Gjon Deda nga Kastrati etj. Po ashtu kishte edhe nga qyteti i Shkodrës që bënë pjesë në këtë shtab si: Selim Çoba, Filip Çeka, Shaban Bushati, Zef Simoni etj.²⁹

Një ditë pas nënshkrimit të protokollit të Stambollit, më 19 prill 1880 u organizua një miting madhështor në Shkodër, ku u diskutua gjatë për mbrojtjen e Hotit dhe Grudës. Hodo Sokoli, i cili kishte marrë urdhër që të kryente dorëzimin e Hotit dhe Grudës, e braktisi detyrën dhe publikisht i hoqi dekoratat dhe gradën osmane shembullin e të cilit e ndoqën edhe shumë ushtarë shqiptarë. Gjithashtu Hodo Sokoli mbajti një fjalim patriotik dhe ndër të tjera iu drejtua bajraktarit të Hotit me fjalët: „Bajraktar, kryej detyrën tënde”. Atëherë, bajraktari, me jatagan e preu shtizën që mbante flamurin osman dhe kështu e hodhi për tokë. Të nesërmen, më 20 prill, valiu i Shkodrës Izet Pasha e lexoi në Shkodër urdhrin e Perandorisë Osmane, sipas të cilit ajo do të zbatonte Protokollin e Stambollit. Ky vendim zyrtar i zemëroi edhe më shumë shqiptarët, ashtu që më 21 prill Kuvendi Ndërkrahinor i Shkodrës e hodhi poshtë këtë urdhër dhe shpalli mobilizimin e përgjithshëm për mbrojtjen e Hotit dhe të Grudës. Kështu, atë mbrëmje, 3.000 vullnetarë me në krye Hodo Sokolin u nisën për në Tuz. Emisarët e valiut të Shkodrës shkuan në Podgoricë për t'u takuar me komandantin malazias Ilia Plamenac. Këta e njoftuan se Perandoria Osmane është e gatshme që Malit të Zi t'ia dorëzoj territoret e parapara dhe se ushtria osmane do të largohet nga

²⁸ Kristo Frashëri, vep. e cit., fq. 434

²⁹ Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar II*, “Toena”, Tiranë, 2002, fq. 184-185.

ato vise të nesërmen, më 22 prill në orën 4³⁰ pasdite. Për të dezorientuar Lidhjen mbi kohën e dorëzimit, autoritetet osmane përhapën lajmin e rrejshëm te shqiptarët se ushtria osmane tokat e parapara do t'ia lëshojë Malit të Zi më 23 prill. Mirëpo shqiptarët nuk u mashtruan, ngase nuk kishin besim tek administrata osmane, por me plot kujdes e përcjellin situatën³⁰.

Në Tuz ishte grumbulluar një numër i madh i vullnetarëve sa që vlerësohet se numri i tyre sillej diku ndërmjet 8.000 deri 10.000 luftëtarësh. Forcën kryesore të shqiptarëve e përbënin banorët e Malësisë së Madhe dhe të Shkodrës, mirëpo kishte vullnetarë edhe nga zonat e tjera shqiptare, si nga Mati, Luma, Kosova, Dibra dhe Tetova. Përveç Hodo Sokolit rol të rëndësishëm në drejtimin e vullnetarëve të Lidhjes për mbrojtjen e Hotit dhe Grudës kishin edhe Çun Mula dhe Baca Kurti.³¹ Në anën tjetër, princ Nikolla kishte grumbulluar një ushtri po aq të madhe, të cilën e mbante në fshehtësi dhe e cila ishte e gatshme për t'u nisur në drejtim të Malësisë, ashtu që vetëm priste çastin e tërheqjes së ushtrisë osmane. Erdhi dita e paraparë për dorëzimin e Hotit dhe të Grudës, pra 22 prilli i vitit 1880. At ditë u tërhoqën forcat osmane nga këto vise, duke u tërhequr së pari nga pikat e avancuara të Urës së Zharnicës, Dinoshës, Rrogathit, Shipshanikut, Vranjës, pastaj Kalasë së Tuzit dhe skelës së Helmit. Vendin e tyre menjëherë e zunë vullnetarët e Lidhjes Shqiptare, të cilët me ditë e prisnin këtë çast. Po at ditë ushtria malaziasve, e bindur se do të hynte lehtë, u nis në drejtim të Tuzit, mirëpo ndeshi në shqiptarë që kishin zënë pozicionet tek Ura e Zharnicës. Pas thirrjeve për ndalim që u drejtuan malaziasve, të cilët nuk i morën parasysh, erdhi deri te krismat e para, që sinjalizuan fillimin e luftimeve të reja ndërmjet shqiptarëve dhe malaziasve, pas atyre të zhvilluara na Plavë dhe Guci. Me këtë rast ka mbetë e njohur thirrja e Baca Kurtit drejtuar bashkëluftëtarëve me këtë thirrje: „Vllazen! Anmiku po na msyn! Kush të don me dek sot për vend të vet dhe për nder të armëve të veta, të vij pas mejet.” Nga kjo thirrje shihet qartë niveli i lartë i vetëdijes

³⁰ Kristo Frashëri, vep. e cit., fq. 439-443.

³¹ Prof. Dr. Qamil Gexha, *Marrëdhëniet shqiptaro-malazeze (1839-1912)*, Gjakovë, 2003, fq. 102.

kombëtare tek malësorët, të cilët atdheun e kanë më të shtrenjtë se jetën. Në Zharnicë u zhvilluan luftime të ashpra, sa që së shpejti u kalua në luftimet gjoks më gjoks, duke përdorur edhe armët e ftohta.³² Luftime të ashpra përveç tek Ura e Zharnicës u zhvilluan edhe në Helm dhe në brigjet e lumit Cem. Sikurse më parë, edhe këtë herë shqiptarët treguan heroizëm dhe atdhedashuri të lartë, me ç'gjë arritën që të thyejnë ushtrinë malaziasë, të cilën e detyruan të turpëruar të tërhiqet në drejtim të Podgoricës. Këto fitore e ngritën edhe më lart vetëbesimin dhe entuziazmin te shqiptarët dhe, në këtë mënyrë, edhe njëherë ia bënë me dije Evropës se zot të Shqipërisë janë shqiptarët dhe se nuk do t'ia lëshojnë askujt asnjë pëllëmbë tokë. Po ashtu qëndrimi i malësorëve bëri që mos të plotësohet parashikimi i kontit italian Kortit.³³ Shumë është interesant fakti se për disfatën e pësuar shtypi i kohës malazias dhe serbë e fajëson Perandorinë Osmane,³⁴ i minimizon këto humbje dhe shpeshherë i injoron fare. Shumica e studiuesve serbo-malazezë që janë marrë me këtë problematikë, qofshin të kohëve më të hershme apo edhe të sotshme, betejat për mbrojtjen e Malësisë i paraqesin njësoj sikurse edhe shtypi i tyre i atyre ditëve.³⁵

Megenëse ushtria osmane ishte larguar, ushtria malaziasë ishte mposhtur dhe ishte tërhequr, Hoti dhe Gruda me qendër Tuzin ishin faktikisht nën drejtimin e organeve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Kjo gjendje do të mbizotërojë për më se 8 muaj të plotë, që nga 22 prill deri më 28 dhjetor 1880. Këtë më së miri na e dëshmon fakti kur më 27 prill shqiptarët e mbyllën Bunën dhe në këtë mënyrë, në këtë drejtim, ia ndaluan tregtinë Malit të Zi.³⁶ Po ashtu edhe shtypi i huaj informonte për një gjë të tillë, siç është rasti me gazetën italiane „L'osservatore Romano”, e cila, më 5 maj 1880, ndër tjera shkruan: „Porta e ka humbur autoritetin në viset shqiptare, ku mbretëron

³² „Kalendari Kombiar”, Tiranë, 1928, fq. 66-67.

³³ Riza Rexha, vep. e cit., fq. 62.

³⁴ „Zastava”, nr.56, Novi Sad, 13(25).04.1880; „Glas Crnogorca”, nr. 16, Cetinje, 19.04.1880; „Srpske Novine”, nr.86, Beograd, 15.04.1880.

³⁵ Momir M. Marković, vep. e cit., fq. 261; Dr Zhivko Andrijašević, vep. e cit., fq. 182; Grup autorësh, *Istoriја Jugoslavije*, “Prosveta”, Beograd, 1973, fq. 327 etj.

³⁶ Prof. Dr. Qamil Gexha, vep. e cit., fq. 103.

Lidhja”.³⁷ Duke e parë se me anë të luftës nuk mund ta marrë Hotin dhe Grudën, pasi që frikohej nga një disfatë e re, princ Nikolla vendosi të vazhdojë me luftën diplomatike, duke kërkuar nga Fuqitë e Mëdha që ta detyrojnë Portën për plotësimin e Protokollit të Stambollit. Më 24 prill Mali i Zi, përmes Stanko Radonjiq, i dorëzoi një protestë Halili Beut, ministrit të Perandorisë Osmane. Me anë të saj e akuzonte se nuk e respektoi Protokollin e Stambollit, pasi që nuk e kishte lajmëruar Malin e Zi 24 orë më parë, por vetëm 9 orë dhe se ushtrinë malaziasë në çastin kur deshi të kalojë për të marrë viset e parapara e priten me armë. Të nesërmen Stanko Radonjiq i dorëzoi Halil Beut edhe dy protesta të tjera. Me anë të njëres kërkonte nga Porta që t’i shpërndajë forcat e Lidhjes të grumbulluara në Hot dhe në Grudë, kurse me anë të tjetrës e fajësonte Perandorinë, duke kërkuar që t’ia dorëzoi Malit të Zi ato vise dhe të paguajë shpenzimet për mbajtjen e ushtrisë malaziasë në kufi nga 22 prilli e deri te dita e dorëzimit.³⁸ Protestave malaziasë iu bashkëngjiten edhe Fuqitë e Mëdha, të cilat i dërguan Stambollit më 24 prill një notë kolektive me anë të së cilës kërkonin nga Perandoria Osmane që të dëbonte forcat shqiptare nga kufiri dhe t’u hapte rrugë forcave malaziasë në mënyrë që të marrin Hotin dhe Grudën.³⁹ Mirëpo Perandoria Osmane ishte e paaftë të shpërndajë forcat ushtarake të përqendruara në Tuz, ngase nuk kishte forca të mjaftueshme në Shkodër dhe, po ashtu, frikohej se një sjellje e tillë ndaj shqiptarëve do të ketë pasoja edhe më të rënda pasi mund të shpërthente ndonjë kryengritje e hapur kundër Portës.

Fitoret e fundit e kishin rritur aq lart moralin te shqiptarët, sa që doli propozimi që të ndërmerrej një sulm kundër ushtrisë malaziasë në viset e tyre dhe të thyhej aq keq sa të detyrohet princ Nikolla që njëherë e përgjithmonë të heqë dorë nga aspiratat pushtuese ndaj tokave shqiptare. Kjo ide u përhap dhe u përqaftua edhe nga Hodo Sokoli dhe Ali pashë Gucia, mirëpo u kundërshtua nga drejtuesit suprem të Lidhjes, ngase frikoheshin se një veprim i tillë mund të sjellë deri te ndërlikimet ndërkombëtare. Ndërsa ata përsërisnin se

³⁷ Masar Rizvanolli, vep. e cit., fq. 16.

³⁸ Kristo Frashëri, vep e cit, fq. 447.

³⁹ „Srpske Novine”, nr. 87, Beograd, 16.04.1880.

qëllimi i Lidhjes ishte t'i bënte me dije Evropës se ata luftojnë vetëm për mbrojtjen e atdheut.

Në anën tjetër, Rusia dhe Britania e Madhe propozuan që të ndërhyhet ushtarakisht për të thyer qëndresën shqiptare, mirëpo kundër ishin Gjermania dhe Austro-Hungaria, ashtu që ky propozim nuk u miratua. Nga ky qëndrim i Fuqive të Mëdha, në radhë të parë të Rusisë dhe Britanisë së Madhe, shihet qartë se sa e merrnin parasysh të drejtën e një kombi që luftonte për atdheun e vet. Mirëpo nuk është për t'u çuditur pasi që këto perandori kishin brenda kufijve të tyre kombësi të tjera, të cilëve ua kishin mohuar lirinë me shekuj.⁴⁰

Meqenëse ishte e qartë se Hoti dhe Gruda nuk do të dorëzoheshin dhe se vetë, për shkak të mospajtimit mes tyre, nuk mund të ndërhynin ushtarakisht, Fuqitë e Mëdha, përkatësisht Britania e Madhe dhe Austro-Hungaria filluan të përgatisnin një projekt të ri, i cili parashikonte që Malit të Zi në vend të Hotit dhe Grudës t'i dorëzoheshin toka të tjera. Përfundimisht, më 26 qershor 1880 u vendos që Malit të Zi t'i jepej Ulqini. Shqiptarët sërish protestuan dhe u angazhuan për mbrojtjen e Ulqinit, por këtë herë Perandoria Osmane ndërhyri ushtarakisht duke thyer rezistencën shqiptare dhe më 26 nëntor ajo ia dorëzoi Ulqinin Malit të Zi. Me këtë veprim dhe me shpërndarjen e degës së Shkodrës, Perandoria Osmane i acaroi shumë marrëdhëniet me shqiptarët, sa që gjatë fillim vitit 1881 Lidhja Shqiptare e Prizrenit, duke shpallur edhe qeverinë e përkohshme, do të kalojnë në luftë të hapur kundër saj. Megjithatë, Porta do të arrijë ta thyejë Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, por jo edhe idetë dhe ndjenjat kombëtare që ishin përhapur dhe ishin fuqizuar gjatë veprimit të Lidhjes.⁴¹

Më në fund mund të themi se me mbrojtjen e viseve shqiptare, sidomos me mbrojtjen e Malësisë së Madhe, u tregua niveli i lartë i ndërgjegjes kombëtare dhe vetë atdhedashurisë, me ç'gjë ia bënë me dije edhe Evropës se për shqiptarët në radhë të parë vjen kombësia, vjen shqiptaria. Mbas këtyre ngjarjeve Evropa u bind se nuk mund të

⁴⁰ Grup autorësh, *Historia e popullit shqiptar II*, "Toena", Tiranë, 2002, fq. 187.

⁴¹ Grup autorësh, *Në një cep të Ilirisë*, "Art Club", Ulqin, 2007, fq. 35-37.

anashkalohet kombi shqiptar dhe se në momentin e shembjes së Perandorisë Osmane në Ballkan doemos do të ketë edhe shtet shqiptar.

Floresha DADO

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT NË PASQYRË TË KËNGËVE POPULLORE

Përmbledhje

Në kumtesë do te trajtohet kryesisht ne plan teorik rapori që ekziston midis ngjarjeve historike të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe përjetimeve emocionale në krijimin popullor. Dihet se historiografia e interpreton faktin, ngjarjen historike duke iu referuar dokumentit, ngjarjeve reale, njeh personalitetet në konkretësinë e jetës dhe veprimtarisë së tyre, në një kontekst të qartë historiko-politik, ndërton marrëdhënie që janë të pazbuluara apo të paqarta midis faktorëve të ndryshëm brenda dhe jashtë vendit, duke pasur si kriter themelor objektivitetin e vëzhgimit dhe interpretimit. Si i tillë studimi historik ndikon në radhë të parë në vetëdijen e receptuesve të çdo kohe, në logjikën e tij.

Kurse poezia popullore ndërton një raport krejt të ndryshëm me historinë, me ngjarjet reale, me figura që kanë lënë gjurmë të spikatura thellë në rrjedhat e historisë kombëtare. Pra, përjetimi popullor ka një prirje tjetër; fakti, ngjarja historike apo një personalitet nxisin një marrëdhënie shpirtërore, krijojnë emocione të fuqishme, që shprehen jo më me interpretim dokumentar, por me emocione që rrëmbejnë jo vetëm mendjen e receptuesit, por në mënyrë të fuqishme ndjenjat e tij. Raporti midis faktit historik dhe trillimit poetik është i një veçantie të tillë që i bën këto dy fusha sa të afërta përsa i përket referentit, aq edhe të dallueshëm nga njeri-tjetri. Në kumtesë do të zhvillohen disa aspekte themelore që e karakterizojnë këtë marrëdhënie, si raporti midis reales dhe fantazisë, midis faktit dhe trillimit poetik, midis konkretësisë së personazheve që shënjuan ngjarjen e

rëndësishme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe imagjinatës popullore në përfytyrimin emocional të tyre.

Fjalët çelës: *Lidhja Shqiptare e Prizrenit, këngët popullore, poezia, historia, fakte.*

Nuk është rastësi që, sa herë ndodhin ngjarje të rëndësishme në jetën e një populli, vetëdija dhe intuita popullore përjetojnë një gjallërim të veçantë, sepse midis sistemit të krijimit poetik dhe jashtë sistemit artistik, atij historik, ekziston një lidhje që e ka burimin në vetë thelbin e letërsisë qoftë ajo e shkruar apo gojore. Të gjitha llojet e arteve, pra dhe poezia popullore, lindën si nevojë shpirtërore e njeriut për të ndërtuar një marrëdhënie emocionale ndaj jetës, ngjarjeve që rrethojnë qenien e tij. Kjo është filozofia e çdo krijimi, dhe ndodh dukuria e mrekullueshme: **historia gjallëron përjetimin poetik**, kurse krijimi poetik i **jep jetë të pandërprerë historisë**. Krijimi poetik popullor kthehet në një monument ku brez pas brezi njihen, në një mënyrë specifike, përjetojnë ngjarjet që përbëjnë epokë të rëndësishme. Ndonëse me specifika të dallueshme në thelbin dhe funksionin që kanë në jetën e popullit, *historia* dhe *poezia* afrohen për të qenë sa bashkë, aq edhe krenarë në raport me njëra-tjetrën. Kur ngjarjet historike janë të një rëndësie jetike për fatet e një kombi, siç ishte Lidhja Shqiptare e Prizrenit, marrëdhënia midis *faktit historik* dhe *trillimit poetik* me tematikë historike merr një trajtë dhe specifikë të veçantë. Faktorët historikë, personalitetet që shënjojnë ngjarje, momente madhore në fatet e kombit tonë shkojnë në popull në kohën dhe hapësirën e ndodhur, por rikthehen në histori, për të konfirmuar lidhjen shpirtërore me heronjtë e asaj kohe dhe hapësire. Kështu vjen natyrshëm *fenomeni historiko-emocional* që Lidhja shqiptare e Prizrenit, si një ngjarje ndër më madhoret në historinë e shqiptarëve, të gjejë jehonë të jashtëzakonshme në krijimtarinë popullore në gjithë trevat ku jetonin shqiptarë. Dhe ndodh dukuria interesante që krijimtaria poetike popullore, sidomos në periudhën 1831-1912, të

përjetonte një hov të paparë dhe gjithë krijimet e kësaj periudhe, ndonëse frymëzohen nga ngjarje apo figura të ndryshme të historisë, përshkohet nga një fill ideor i përbashkët. Në një kuptim krijimtaria popullore edhe parapërgatiti emocionalisht atë që do të ndodhte në 1898, edhe e ndoqi duke e përjetësuar në rrjedhën e historisë sonë. Kështu ndodh, sepse i gjithë cikli i epikës historike, në Shqipëri dhe në Kosovë, ka një filozofi të vetme: reflektim dhe përjetim emocional mbi ngjarjet që rrezikuan apo shpëtuan fatet e shqiptarëve.

Raporti midis ngjarjes madhore të kuvendit të Prizrenit me poezinë popullore në aspektin teorik nxjerr në plan të parë disa çështje:

Së pari, si funksionon marrëdhënia midis *historisë* (Lidhja shqiptare e Prizrenit) dhe *trillimit artistik* (poezive të epikës historik)? 25 shekuj më parë filozofi i madh Aristoteli kish përcaktuar dallimin thelbësor midis dy fushave: historisë dhe poezisë. Sipas teorisë së tij detyra e poezisë është të besojë dhe përjetojë atë që historia ka shënuar, të ‘besojë’ aq sa të shqetësohet apo të ngazëllet nga ajo që ka ndodhur, t’i duket si ‘e vërtetë’ edhe ajo që nuk është e shkruar si e tillë. Kështu themi se, ndërsa në studimet historike rreth kësaj ngjarjeje madhore historianët zbulojnë faktin, interpretojnë ngjarjen historike, veprimtarinë e personaliteteve të shquar që i dhanë jetë një prej bashkimeve më të rëndësishme në historinë shqiptare, në poezi këngëtari e ndërton ndryshe figurën e heroit, i jep jetë dhe ky proces **rikrijimi**, në raport me faktin historik, ka tjetër efekt emocional. Nëse ju si historianë keni *ndërtuar* rrjedhën e ngjarjeve, marrëdhëniet e personaliteteve të lëvizjes kombëtare, poeti popullor *i rindërton* në një mënyrë tjetër ato figura, qofshin patriotë apo tradhtarë të momentit kombëtar, si Abdyl Frashërin, Iljaz Pashë Dibrën, Abdulla Pashë Drenin, Ali Pashë Gucinë etj., etj.

Interpretimi historik, pra **shkencor**, që bën ky auditor historianësh, ndikon mbi mendjen, vetëdijen, logjikën e receptuesit, kurse **poezitë** kushtuar ngjarjeve që paraprinë, që shoqëruan Lidhjen

Kombëtare dhe që e vazhduan pa ndërprerje jehonën e saj, ndërtojnë një marrëdhënie tjetër: ato ndikojnë jo vetëm në mendjen, por më fort në botën shpirtërore të receptuesit shqiptar, duke shkaktuar edhe krenari, edhe kënaqësi, edhe urrejtje, pra qëndrime emocionale të drejtpërdrejta ndaj dukurive dhe figurave historike. Ky është dallim thelbësor midis këtyre dy fushave, që, ndonëse kanë specifika krejt të dallueshme bashkëjetojnë jo në tekste, studime shkencor, por në këngën popullore, ku këngët historike, përmes figuracionit të jashtëzakonshëm poetik përcjellin reflektime emocionale historike.

Së dyti, pasqyrimi i kësaj ngjarjeje të jashtëzakonshme historike në poezinë popullore nxjerr edhe aspektin e raportit midis *idealit* dhe *ndjenjës*. Nëse themi se poezia historike, e krijuar në Kosovë dhe në Shqipëri, ka rrokur pothuaj çdo ngjarje historike të historisë sonë, ka përjetësuar figura të shquara të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, çështja është se në ç’raport marrëdhënia midis *idealit* kombëtar dhe *ndjenjës* popullore formësohet në krijimin popullor? Gjenia popullore shpreh në mënyrën më emocionuese shkrirjen me vetëdijen e figurave të shquara të mendimit dhe lëvizjes kombëtare, ka një zë të përbashkët midis platformave politike (ideali) dhe dëshirës për liri e dinjitet (ndjenja). Ky raport mishërohet në stilin e ligjërimit dialogjik, që dallon një pjesë të mirë të poezive, ku biseda ka vetëm një hero të identifikuar me emër, ndërsa përgjigjja vjen sa e përcaktuar në përmbajtjen e vet, aq e përgjithshme, anonime në aspektin e identifikimit të folësit. Por është e qartë se zëri i dytë është ndjenja popullore. P.sh. në poezinë kushtuar Abdyl Frashërit krijohet një dialog i imagjinuar, që duket sikur ndërton skenën e veprimit të këtij personaliteti në një moment të rëndësishëm. Në fillim këngëtari popullor i drejtohet drejtpërdrejt heroit historik:

*Abdul, pasurin’e shite / një barrë flori / hipe vaporrit e shkove
/vajte në Berlin...*

Por, më pas këngëtari popullor nuk përshkruan c'bëri A. Frashëri, por me formën e dialogut dramatik përcjell aktin e komunikimit të heroit me Bismarkun:

- *Burrë ç'ke për të më thënë / dhe cili je ti?*

- *Nuk jam grek, e as bullgar / as nga Mal'i Zi / po nga kombi shqipëtar / Abdyl Frashëri/...*

Forma e ligjërimit dialogjik të poezisë popullore, ndonëse nxitet nga një ngjarje dhe ka një *ideal* kombëtar, reflekton më shumë ndjenjën e cila formësohet përmes dialogjizmit. Dialogu ndërtohet midis një personazhi historik dhe shpesh një zëri të paidentifikuar, që shpreh dëshirën popullore. Në mjaft krijime të epikës historike, që reflektojnë ngjarje si Lidhja e Prizrenit, ideali nxit një mënyrë edhe më të fuqishme të shprehjes së ndjenjës: figura të tilla stilistike si metafora, hiperbola, kontrasti poetik, pasthirrma, anafora togfjalësh ose pasthirrma, përsëritja e vazhdueshme në mes të vargut, përsëritja e tingullit —e— në fund të vargut, etj. dëshmojnë gjeninë poetike të krijuesit popullor dhe i japin gjithë poezisë një tingëllim sa epik aq edhe muzikal:

Oh, shka kan'bjeshkt, o bre, qi ushtojn-e // shka kan'lugjet, o bre, qi fshajn-e // shka kan'malet, o bre, qi s'mungullojn-e // shka ka hana, o bre, qi s'po ndrit-e... Është e dukshme se **ndjenja** ngrihet mbi një **ideal**, duke marrë përmasa të një përjetimi të jashtëzakonshëm.

Së treti, ka një raport specifik midis heroit të poezive, si figurë historike, dhe këngëtarit anonim popullor. Është një marrëdhënie shumë interesante, që mbështetet në një filozofi të caktuar. Duket se poeti popullor e fsheh veten për t'i dhënë dritë heroit apo ngjarjes së rëndësishme të Lidhjes së Prizrenit. Duke fshehur autorësinë ai i jep krijimit poetik të ngjarjes historike një përmasë të tillë që nuk mbetet te një individ. Vëmendja e receptuesit, në çdo periudhë historike të ekzistencës së tij duhet të përqendrohet tek ajo çka ka ndodhur e jo te krijuesi i poezisë. Për filozofinë popullore përballë ngjarjeve të tilla historike, me peshë të jashtëzakonshme për fatet e kombit, figura e

individit-poet nuk ka fare rëndësi. Madje, siç dihet, ky krijues popullor ka një zemër të gjerë: duke fshehur autorësinë ai i lë hapësirë një krijuesi tjetër, përsëri një tjetri, e pa kufi, për ta ripoetizuar ngjarjen. Prandaj ndodh që edhe për Lidhjen e Prizrenit, sikurse për ngjarje historike të tjera, të trashëgojmë edhe variante të së njëjtës tematikë.

Së katërti, prej kësaj specifike rrjedh një aspekt tjetër i vlerës magjike të poezive kushtuar këtij momenti historik. Studimet shkencore, mbështetur mbi dokumente, synojnë të ndërtojnë dhe interpretojnë me besnikëri ngjarjen, personat historikë, kontributet dhe realitetin e marrëdhënieve të momentit kur ndodhi Lidhja Shqiptare e Prizrenit, pra, në një kuptim *ngurtësojnë momentin* dhe problematikat historike. Historiografia, në këtë mënyrë, dokumenton këtë lëvizje të fuqishme në vepra, që nuk i drejtohen një lexuesi të zakonshëm, por përgjithësisht specialistit të periudhës. Kurse poezia popullore e ka rrëmbyer ngjarjen e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, personazhet historikë, momentin e rrezikut apo të triumfit dhe e ka *shpërndarë kudo*, në veri dhe në jug, në shekullin XIX, XX, XXI dhe do vazhdojë më pas... Pa këngën popullore ngjarja historike duket sikur arkivohet. Poezia popullore i ka shtuar trajtimit shkencor atë element që historiani s'mund ta shfrytëzojë, pikërisht aspektin emocional, imagjinatën krijuese, trillimin poetik përmes formës së një ligjërimi sa të drejtpërdrejtë, aq edhe të tërthortë. Ndërsa në punimet tuaja mbizotëron logjika, *objektiviteti*, në poezitë që i kushtohen kësaj ngjarjeje të rëndësishme të historisë kombëtare mbizotëron emocioni, *subjektiviteti* popullor.

Lexuesi shqiptar, në rrjedhën e shekujve, do të ketë gjithnjë nevojën për të njohur historinë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe ngjarjeve të tjera historike përmes përjetimit të këtyre **dy formave** të komunikimit, domethënë përmes dokumentit, interpretimit shkencor të historiografisë, por edhe përmes krijimit poetik që ka brenda shpirtin dhe emocionin popullor.

Kujtim M. SHALA

MËSIM LETRAR E HISTORI

(*Fishta: Kangët e Lidhjes së Prizrenit*)

I

Histori e letërsi

Një *diskurs* si ky, me autor një *studiues letrar*, do disa *skajime* të para, për njohje e për marrëveshje.

Studiuesi letrar e ka parasysh që fusha e tij e njohjes dhe e kërkimit, së paku në një sektor, është në kufi me historiografinë. Madje, si kurorë kërkimesh letrare, janë shkruar *historitë e letërsisë*, qoftë edhe si pandane të *historive të popujve*.

Vetë *Epistemologjia letrare* e shtron për diskutim nëse mund të shkruhet *historia e letërsisë* e të mos jetë *histori politike*, d.m.th. *histori popujsh* apo edhe *histori idesh*, sidomos kur kemi parasysh natyrën historike të një klase të madhe të fenomeneve letrare. Kjo nuk shënjon heqje dorë nga kërkimi historik-letrar, por hap *vetëdijen* për *historinë letrare* si përshkrim i letërsisë në historinë e saj të brendshme, d.m.th. vetëdijen për një *histori poetike* (të formave letrare), pa *historinë politike*. Kështu që, edhe sot e këtui, çështja do hapur në trajtën *Histori e letërsi*, meqë kemi para një shkrimtar *substancial* (Lasgush Poradeci) e mimetik si Gjergj Fishta dhe një *vepër letrare*, ndërsa po kërkojmë fijet e *ngjarjeve* (historike) për dokumentim e për mësim.

Fishta rri përkrah historisë dhe e mat shtatin në *pasqyrën* e letërsisë. Një skemë tipike e letërsisë shqipe, në lidhjet e saj mimetike me jetën shqiptare dhe me projeksionet e propozimet ideale për shqiptarët,

si zgjidhje universale të situatave konkrete, meqë universale janë zgjidhjet që jep *fiksioni letrar*.

* * *

Histori e letërsi, që në krye të herës, është shtruar si një raport që do shpjegim, meqë, që në rrënjë, ndërmjet tyre duket të ketë patur përzierje diskursesh e funksionesh, madje përzierje të funksioneve të diskurseve. E para e njohur si imitim *ngjarjesh konkrete*, kur konkretësia i jep status *dokumenti(mi)*, ndërsa e dyta si imitim *ngjarjesh të mundshme*.

Dijetari i moçëm Aristoteli këto dy fusha i *skajonte* mbi bazën e *asaj* që imitojnë dhe ky është një *skajim* tematik. Kur diskursin e tij e kthejmë në mësim, kuptojmë që ai shënonte se këto dy fusha asnjëherë nuk ligjërojnë gjëra/ngjarje të njëjta (*thema*). Duket që këtu, më parë se të hapej apo të pasurohej, debati këputej, meqë *tema*, si shënjuese e përcaktuese ontologjike e gjinisë, nuk mund të jetë në letërsi *si në histori*. Kështu, kryqëzimet e ndërhyrjet e diskurseve shënojnë një raport ndërmjet *historisë* e *letërsisë*, por asnjëherë shkrirje të tyre në një, qoftë edhe kur i hyjnë aventurës për t'u zëvendësuar ndërsjelltas.

Ky problem universal në kulturën shqiptare merr kuptim specifik, meqë raporti *poietik* (krijues) i historisë me ngjarjet ka bërë që kjo të shkruhet edhe si një *metaforë e ngjarjeve*, madje si lexim ideologjik i tyre, ndërsa raporti *mimetik* i letërsisë me historinë ka bërë që letërsia të jetë edhe një *metonimi e madhe*. Megjithatë, kështu nuk fshihen kufijtë ndërmjet gjinive, por ngatërrohen diskurset e zhanret në rrafshin pastërtisht *kategorial*, në rrafshin *ontologjik* e në atë të *njohjes*. Kjo do të thotë se kultura shqiptare ka ngatërruar edhe ato që dija klasike i njihte të diferencuara që në krye të herës. Këtë e vërejmë në diskurset historiografike, ashtu si edhe në ato të dijes letrare. Prandaj, diskutimi, së pari, do duhej të shtrohej për statusin e këtyre dy fushave e jo për shkallët e identifikimit.

Ngatërresa e tillë bënte që Eqrem Çabej të mësonte të kërkonte letërsinë moderne të format estetikë, pa rrënjë në folklor e pa ngjyrimë politike. Me shembullin e poezisë së Lasgush Poradecit, Çabej e provonte fort rregullin përmjet përjashtimit. Ndërsa, po në këtë hulli, por të shtruar në terma më sistematikë, Ibrahim Rugova, në shembullin e Hegelit, e njihte natyrën homogjene të letërsisë shqipe dhe daljen nga ky model vetëm në modernitetin letrar, tek autorët e Kosovës, të gjysmës së dytë të shekullit XX. Kështu provohej natyra tradicionalisht ideologjike e letërsisë shqipe, bashkë me leximet ideologjike të saj. Ndërsa, një hap më tutje, me këto shenja shfaqen edhe diskurset historiografike shqiptare, të lidhura në lexime ideologjike, krejt përkundër asaj që na e mësonte, në krye të herës, Marin Barleti, kur ndiqte shembullin e *tregimeve historike* humaniste për burrat bujarë (fisnikë), që ngjarjet e të djeshmes kurrë nuk duhet të gjykohen nga sot.

Te një autor përfaqësues si Fishta ky problem shfaqet krejt i ndërliqshëm dhe shpjegimet për të kthehen në shpjegime për *ontos-in* e për *poetikën* e veprës. Prandaj, çështja do marrë si *letërsi* e si *histori*. Kështu, çfarë me Fishtën, me *Lahutën e Malcís* (1937), epin e shqiptarëve, e çfarë konkretisht me *ngjarjen konkrete* të Lidhjes së Prizrenit?

Përgjigja e parë, meqë para kemi ngjarje të kënduar (*poezi*), është se Fishta nuk flet për *faktet* e ngjarjes konkrete, por për *faktet e mundshme* dhe *ngjarjen* e kthen në *të mundshme*. Kjo është marka e universalitetit të letërsisë, sepse e mundshmja është më universale sesa konkretja.

Por, këtu hyjnë në lojë e *vërteta* e *fiksioni*, ndërsa si e para, edhe i dyti lidhen pazgjidhshëm me *njohjen*. Prandaj, *çfarë* (apo *si*) njohim përmjet *Kangëve të Lidhjes...* së Gjergj Fishtës?

II

Histori

Në *Parathanjen* që i prin *Lahutës së Malcís*, botim XV, të vitit 2006, Át Zef Pllumi konstaton dominim të faktit e më pak fantazi vetëm te Cikli i gjashtë i veprës, i lidhur me Dedë Gjo Lulin. Ndërsa, diskursin për *Poemin dhe realitetin historik* e hap me konstatimin e prerë se: “Fishta nuk kishte kurr ndërmend me shkruar një histori të Shqipnisë as të popullit të saj, por një poem, i cili të paraqiste në mënyrën sa më të bukur disa shembuj urtijet, trimnive e sakrificash me të cilat mjaft shqiptarë i kishin dhanë hov lëvizjes patriotike edhe në se jo në emën të saj.”¹ Në këtë rrymim, ai na kujton se vetë Fishta i përgjigjej Mehdi Frashërit se “poemi kishte për qëllim jo me tregue të vertetën siç ishte, por të vertetën ideale”.² Ky i fundit kishte kritikuar Fishtën për portretin e Abdyl Frashërit “me kollçikë e me fistan”.³

Këto nënvizime e vënë *Lahutën e Malcís* përkrah apo përballë historisë, me të vërtetën e saj ideale (të besueshme), të zgjedhur me vetëdije e të shkruar me dije, përfundimisht të praruar në imagjinime. Kështu, faktet mbeten si shkëndija të largëta në errësirën e ngjarjeve, ndërsa Fishta na end *ontos*-it të vet të imagjinuar dhe thur mësimin e shqiptarizms së shekullit XX, edhe me shembuj që nuk ishin të tillë, meqë vinin para dhe shembulli i tyre nuk buronte nga ideologjia nacionale, por nga nderi personal dhe nga ai i fisit. Flijimin për nder personal e për fis Zef Pllumi e njeh si vepër kombëtariste, meqë: “Fisi është KOMBI”.⁴

Po Kangët e Lidhjes janë histori apo fantazi?

Meqë, titulli e referenca janë historike, problemi ndërliqësohet. Në një lexim letrar, kuptojmë se Fishta lë referencën dhe hapet në

¹ Át Zef Pllumi OFM, *Parathanje*, në Át Gjergj Fishta OFM: *Lahuta e Malcís*, Botime Françeskane, Shkodër, 2006, f. XXI.

² Po aty, ff. XXIV-XXV

³ Po aty, f. XXIV.

⁴ Po aty, f. XXII.

imagjinime e në thurje ideologjie nacionale përmjet shembullit të Lidhjes. Pllumi na kujton se Lidhja që këndon Fishta pothuajse nuk ka asnjë lidhje me ngjarjen historike. Fishta *personat* i ka kthyer në *personazhe*, ngjarjen e ka kënduar ashtu siç e kërkon ideologjia e tij, lidhur në të vërtetën e letërsisë. Në një diskurs të përqendruar, evidentojmë se: Lidhjen e Fishtës e nisin Ali Pashë Gucia e Haxhi Zeka, ndërsa Pllumi thotë se atë e projektoi çami Abedin Pashë Dino, ministër i Jashtëm i Turqisë; në seancën e parë ajo u quajt *Lidhja e myslimanëve të vërtetë*, ndërsa u ktheu në *Lidhja Shqiptare e Prizrenit*, pasi, me emërtimin e parë, nuk gjeti përkrahje; Ali Pashë Gucia ishte boshnjak e jo shqiptar, por që ishte martuar me një shqiptare; Mehmet Ali Pasha, i njohur edhe si Mehmet Pashë Maxharri, ishte një ushtarak austro-hungarez që kishte shkuar të modernizonte ushtrinë turke, madje ishte dhe një nga anëtarët kryesorë të delegacionit turk në Kongresin e Berlinit.⁵

Kështu, letërsia e thotë të vërtetën e vet, për të *shënjuar* edhe të vërtetën e historisë, në klasën e veprave me referenca me ngjarjet që vërtet kanë ngjarë. Por, që ka pak fantazi, nuk do të thotë që letërsia kthehet në histori. Kur ka më pak fantazi, iluzioni i reales bëhet më i fortë, ndërsa mësimi letrar *duket* edhe si mësim historik. Fishta edhe këtë do, kur nis aventurën e madhe për të dhënë shembuj që do duhej të përsëriteshin, në dukje krejt konkretë, por që propozohen në situatat e universalizuara letrare.

Në mbyllje të këtij problematizimi, i kthehem diskursit të Pllumit, për të nënvizuar se ai vetë e thotë që të dhënat historike për Lidhjen e për personazhet e saj, madje për vetëdijen e saj, historiografia shqiptare nuk i ka dhënë anjëherë me saktësi dhe kështu e ka fshehur të vërtetën. Ky është paradoksi i madh i historiografisë që kthehet në lexim ideologjik të ngjarjeve, ndërsa ideologjia, përballë ngjarjeve,

⁵ Po aty, ff. XXII - XXV.

Ndërsa, historiani i njohur, Peter Bartl, thotë se Mehmet Pasha ishte gjerman; shih *Shqiptarët: nga Mesjeta deri në ditët tona*, Botimet IDK, Tiranë, 2017, f. 105.

është vetëm një lexim i reduktuar apo dhe i deformuar. Kështu e këtu hyjmë në fushën e *epistemologjisë*, por diskursi i tillë shkon përtej rasisë tonë e mbetet për një rast tjetër.

III

Kangët e Lidhjes

Kangët e Lidhjes është skajim tematik i një cikli të *Lahutës së Malcís*, të lidhur me ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit apo përreth saj. Ky cikël shtrihet nga kënga e shtatë tek e dhjeta: *Kuvendi i Berlinit*, *Ali Pasha i Gucís*, *Lidhja e Prizrendit* dhe *Mehmet Ali Pasha*, ndërsa, siç Át Zef Pllumi pretendon, e lidh me ciklin paraprak kënga e titulluar *Dervish Pasha* e me ciklin pasues *Lugati*.

Këngët kanë referenca nominale me *ngjarjet* historike, të cilat bëjnë që ngjarjet të kenë status *reagensi*, ndërsa teksti, mbi bazën e të mundshmes, hapet në imagjinime autoriale apo lidhet me imagjinime tipike të *modelit kategorial* të Kângëve Kreshnike. Kështu, *historia* është rrjet referencash, përfshirë emra *personash*, të cilët kthehen në *personazhe*, madje në *heronj letrarë*, ndërsa *kanga* lidhet në fabul të imagjinuar dhe sipas *modelit kategorial* të Kângëve Kreshnike.

Në këtë nyjë, jemi te çështja e gjinisë së *Lahutës së Malcís*, të njohur e të kurorëzuar si epi i shqiptarëve, ndërsa gjinia lidhet pazgjidhshëm me *ontos-in* letrar të veprës e ky me temën. Gjinia bazike, në kuptimin e një *arkiteksti* (Zherar Zhenet), i *Lahutës së Malcís* është *kanga*, model janë *Kângët Kreshnike*, ndërsa *Lahuta e Malcís*, si vepër e kryer, është rezultat i lidhjes së këngëve në cikle dhe lidhjes së cikleve në një vepër integrale. Në këto shenja, Fishta ka ecur *nga teksti në vepër* (Zhenet).

Për problemin që po trajtojmë këtu, gjinia bazike, *kënga* (epike), është kategori e ndërliqshme, meqë, e kthyer në një *ontos*, shënjon gjini letrare, me origjinë në oralitet, lidhur si tregim (krijim) i kënduar

apo si tregim i këndueshëm (krijueshëm) drejtpërdrejt në këngë (derisa kënga *këndohet*). Kështu, në rastin e Fishtës, kemi të bëjme me *ontos* tipik imagjinar, me diskurs që përshtatet me të, në modele retorike tipike për tekste që duhet të mbahen mend e të deklamohen, ndërsa këto, së bashku, shënjojnë origjinën orale të zhanrit e të tekstit të Fishtës. Kemi shënjuar origjinën tekstore e kulturore, ndërsa na intereson origjina e tregimit të kënduar nga Fishta, atëherë kur ka referenca me jetën e gjallë apo me historinë e shënuar (të fiksuar).

Raportin me ngjarjet e shënjon edhe formulimi *Kangët e Lidhjes*, të Lidhjes së Prizrenit, një nga nyjat e jetës dhe të historisë moderne të shqiptarëve, atëherë kur rrezikohej zhbërja politike e tyre. Kështu, Lidhja u vu përballë zhbërjes, në jetën e gjallë, ashtu si edhe te Fishta. Por, ngjarja e kënduar, madje e deklamuar në *Kangët e Lidhjes*, shkon përtej e përkrah ngjarjeve konkrete që kap *dokumenti* e lidhet për të mundshmen e tyre, që do *tregimi letrar*, qysh herët i quajtur imitim ngjarjesh me anë të fjalëve.

Tregimi i tillë, përkrah *ngjarjes së provuar*, thur *ndodhinë letrare* (fabula, *mythos*-i), me origjinë të mundshmen dhe të hapur në universalitet. Leximi ndjek këto shenja përmjet vetëdijes ontologjike dhe asaj estetike se po kap të mundshmen e ngjarjeve. Vetëdija se po lexon një *ontos* të imagjinuar bukur (estetik) e ka shoqëruar përherë lexuesin e letërsisë, si tipologji e si ontologji, ndërsa kjo vetëdije e ka prodhuar historinë e interpretimit letrar, zënë fill e rritur përmjet *besimit letrar*. Kështu, tregimi epik i Fishtës është i pangjarë, por i mundshëm, prandaj i besueshëm.

Kush beson edhe mëson.

Por, si e çfarë mësojmë nga *Kangët e Lidhjes*? Përgjigjen e marrim kur *ngjarjen* e lexojmë të lidhur me *këngën*, d.m.th. me *këndimin*.

Rikujtojmë, ky cikël përmban këngët *Kuvendi i Berlinit*, *Ali Pasha i Gucís*, *Lidhja e Prizrendit* dhe *Mehmet Ali Pasha*, të lidhura tematikisht, kronologjikisht dhe përmjet personazheve. Këto janë veti poetike të ciklit, ndërsa këngët manifestojnë integritet tematik e

poetik, vetë të strukturuar në blloqe narrative-retorike, në të cilat jepen pjesë të situatave, portretohen personazhe, deklamohen fjalime etj. Në këtë rrafsh, këto këngë i manifestojnë vetitë e *Lahutës së Malcís* si vepër integrale, meqë edhe këngët e tjera po të këtij modeli poetik janë, ndërsa dallimet ndërmjet tyre i takojnë rrafshit tematik.

Ngjarja e kënduar, përmjet zgjedhjes e përngjasimit, kthehet në fabul, ndërsa kjo është *përftya* e ngjarjes. Vetë temat me të cilët po e përshkruajmë fenomenin, shënojnë se vepra e Fishtës dallimin themelor përballë historisë e shënon në rrafshin tematik. *Përftya* asnjëherë nuk është *fytyra*, por një shëmbëlltyrë e saj. Ngjarja e kënduar është ngjarja e krijuar, e përthyer në *modelin kategorial* dhe në *diskursin e retorizuar* të Fishtës, lidhur në nyja që vetë lidhin *krijimin* me teknika të *panagjericut*. Duket që kjo është lidhja më e fortë e një ngjarjeje të kënduar me ngjarjen e jetuar e kështu edhe me *tregimin historik*. Më tutje, Fishta nuk ka shkruar *tregim historik*, por *këngë* epike, të lidhura në cikle (*blejë*), ndërsa ciklet janë strukturuar në formën e epit. Të lexosh letërsinë si histori është si të ngatërrosh *hijen* me *njeriun*. Kështu, formulimi *Ngjarja e kënga* merr trajtën autenike: *Ngjarja e kënduar*.

IV

Personi e personazhi

Raporti i *personit* e i *personazhit*, në rastin e Fishtës, është përfaqësim i reduktuar i raportit histori - letërsi. *Person* është term për njeriun, ndërsa *personazh* - term për shëmbëlltyrën (imago), figurën.

Personazhet e Fishtës me referencë *personat* janë të shumtë, por, qoftë edhe kur lidhen nominalisht, referenca është simbolike, ndërsa *personazhi* është i krijuar. Kështu, me ndonjë përjashtim, personazhet e tij u ngjajnë heronjve të këngëve popullore, me dominim të modelit të Kângëve Kreshnike. Sikur situatat, edhe personazhet historike hyjnë në qarkun e një diskursi me origjinë oralitetin dhe ngjarjen historike e kthejnë në *tregim të kënduar*.

Ky model dominohet nga situatat e pazakonshme e fantastike dhe strukturat e një diskursi retorik, si mjet për të thurur apologjinë, për të bindur e për të mbajtur mend.

Modeli i tillë nuk mund të rrëshqasë në *diskursivitet*, prandaj jemi në *imagjinaritet* e në *poiesis*.

Personat e kthyer në personazhe Fishta i zgjedh për arsyet themelore: të urtisë, nderit e të sakrificës apo dhe për këto të lidhura në një, ndërsa i praron në imagjinatë, ashtu që të jetojnë në *ontos*-in letrar e të lidhen për ideologjinë themelore të veprës së tij. Ideologjia provohet përmjet shembujsh e bëhet mësim që duhet të jepet përmjet retorikës.

Metodën e shpjegon nga afër Pllumi, njohës e adhurues i përjetshëm i Fishtës. Personave, që Fishta bën personazhe, u mungon ndjenja e shqiptarizmit, por jo veti të tjera tipike shqiptare, virtyte e vese. Fishta kap virtyte dhe i kthen ato në kategori të shqiptarizmit, ndërsa personazhet i bën heronj të shqiptarizmit. Kështu, heronjtë e tij janë ideologjikë, prova të ideologjisë themelore të veprës dhe shëmbëlltyra që do të japë mësimi fishtian.

V

Krerët e Lidhjes

Krerët e Lidhjes janë heronjtë e *Kangëve të Lidhjes*, *persona historikë*, por *personazhe të këngëve*, d.m.th. të *ngjarjeve të gjasshme*, vetë me *profil të gjasshëm*. Fishta i projekton dhe i lidh në një fabul me veti tipike epike, por të veshur me petka të heronjve ideologjikë, meqë, në një retorikë të fortë, artikulojnë ideologjinë e Lidhjes dhe idetë (ideologjinë) e autorit.

Natyra e heronjve zbulohet nga perspektiva e autorit, i cili më fort duket si një komentues, nga perspektiva e personazheve orale *orë* e *zana* dhe nga artikulimi apo nga veprimet e drejtpërdrejta të perso-

nazheve. Njëri nënvizohet për pamjen, i dyti për fjalën, për urtinë, ndërsa tjetri për trimërinë. Pamjet, karakteret e sjellja përbëjnë përfaqësim autentik të përfaqësuesve të shqiptarëve, prandaj edhe të shqiptarëve. Këto shenja i kthejnë krerët në dinjitarë të provuar, prandaj në *model* që duhet të mësohet e të përsëritet. Vërtet, modeli është ideal, prandaj *i mundshëm*, si të gjitha modelet e propozuara. Kështu, më parë se dëshminë, Fishta thur ideologjinë, më parë se provën, e nënvizon projeksionin. Të gjitha veti të një idealisti të madh, d.m.th. edhe të një mësuesi të madh.

Mësimi për krerët e Lidhjes lidh ideologjinë, projeksionin e retorikën; kjo e fundit prodhon skema për të artikuluar e për ta mbajtur mend tekstin, meqë, kur kujtohet teksti e përsëritet, mbahet mend e përsëritet mësimi, madje përsëritet për t'u mbajtur mend. Ideologjia e kthyer në retorikë del e redukuar; projeksioni, i lidhur më fort me autorin, hapet në situata të idealizuara. Ndërsa, mësimi themelor i jep shqiptarët e të gjitha trevave, myslimanë e të krishterë, të lidhur përballë *Mbretit* mysliman të Stambollës e *Krajlave* të krishterë të Evropës, për të mbrojtur tokat dhe ekzistencën e tyre. Rrëfimi për krerët e lidhur të *Lidhjes* bëhet *porosi*, d.m.th. projeksion, që rri në rrënjë të ideologjisë fishtiane të bashkimit të shqiptarëve, përtej dallimeve që kanë. Kështu, krerët e Lidhjes janë krerët e lidhur. Vërtet, ky është projeksioni i veprës së Fishtës në tërësi, vepër që merr e jep jetë shqiptare të provuar e të idealizuar. Kurse, të përqenduruar, modeli ideologjik, retorik e poetik jepen në fjalën e Abdyl Fashërit, karakterizuar me fuqi të fjalës e të përfaqësimit. Ligjërimi i tij ka mitologji e arkeologji poetike shqiptare, si rrënjë të ideologjisë së Rilindjes, e cila është ideologji e krenarisë së etnisë, jep shembujt e qëndresës e të *rrnesës* dhe mbyllet si kushttrim qëndrese. Ky është fjalimi kryesor i tubimit të Lidhjes dhe lidh *ideologji* e *projekton* veprim.

VI

Gjergji

Lahuta e Malcís është projekti epik i Gjergj Fishtës, në krye të herës i menduar i lidhur me Gjergj Kastriotin - Skënderbeun, i cili shfaqet faqeve të veprës si një referencë e si kujtesë, ndërsa epi ka gjetur heronj të tjerë. Fishta, në shekullin e tij, kur shqiptarët në masë dërrmuese ishin myslimanë, në radhë të parë, kërkonte një hero për ta. Kjo është strategjia e ideologjia themelore e veprës së tij, e cila merr shenja të temës letrare e bëhet edhe mësimi themelor i saj. Ndërsa, Fishta, Gjergjin e bëri emër të zgjedhur për vete, të shërbimit (*rregulltarisë*) e të kulturës, në raporte motivimi e identifikimi total.

Siç, së voni, e provon studiuesja e Fishtës, Blerina Suta, Fishta gjatë studimeve, së paku sipas një relacioni të 25 marsit 1891, të firmosur nga Fra August Čengić, regjistrohej si: *Giorgius Silv(io) Fiscta*. Kështu, emri-dysh nuk ishte zgjedhja finale e Fishtës, por dilema e ruajtur për fund, kur Gjergj Fishta u bë emër *rregulltarie*. Kështu, përfundimisht fitoi *shenja* nacionale, emri i heroit nacional të shqiptarëve, si emër i zgjedhur i Fishtës, që, një ditë, do të vihej edhe mbi kapakun e epit të shqiptarëve, shkruar e botuar me emrin Gjergj, por pa kryeherin. Madje, një hero për veprën nuk gjendet, meqë ka heronj për këngë e për cikle, ashtu që heronjtë të duken si variacione (letrare) të njëri-tjetrit. Vërtet, fryma e Lidhjes së Prizrenit, si kujtesë fillestare, do duhej ta çonte Fishtën te historia e Skënderbeut, për të shënjuar/projektuar rrënjët e trashëgimisë. Kjo duket në nënvizimet e shpejta bërë përmjet emrit Skënderbe e Kastriot, por Fishtës rrëfimi për Skënderbeun tashmë do t'i jetë dukur i largët. Shqiptarëve, të përthyer në religjione e krahina, duhej t'u jepeshin heronj për identifikim. Sprovat për epin ishin bërë më parë, qoftë edhe të lidhura me emrin e Skënderbeut.

Lahuta e Malcís u projektua dhe u shkrua pasi ishin mbyllur veprat e mëdha të De Radës e të Naimit për Skënderbeun dhe për epokën e tij, ndërsa shqiptarët vijonin të jetonin krizat e mëdha të jetës

nacionale. Fishta kërkoi e projektoi me durim e luciditet një vepër të madhe ideologjike, si *Lahuta e Malcís*, por pa përjashtime ideologjike. Ai pa se duheshin heronj të tjerë, të lidhur me epokën, madje me ditët e tij, për të thurur, dhënë e për ta marrë ideologjinë e mësimin të vepërës së tij. Duheshin ngjarje të afërta, të njohura e të ditura, për ta bërë të besueshme dëshminë e tij letrare dhe mësimin e tij të lexueshëm e të akceptueshëm. Edhe fakti bibliografik që vepra u ndalua, por njëhej e dihej përmendësh, e provon se Fishta pati të drejtë dhe se projekti i tij u akceptua dhe u bë vepër e shqiptarëve.

VII

Kanga e njohja

Por, çfarë njohim përmjet *Kangëve të Lidhjes*?

Historinë apo *përftyrën* e saj?

Njohim një *histori të pangjarë* (ndodhi), krejt autentike e totalisht universale. Por, këtu si kudo letërsisë, narrativat, përmjet njohjes, japin *mësimin letrar* të njohur si *mesazh* i veprës. Në këtë pikë lidhet *ontos-i* letrar i një vepre me *funksionin* e saj, i cili lakohet varësisht nga *statusi i tekstit*.

Tekstet, si ky i Fishtës, synimin e shënjojnë së pari në *rrafsh kategorial*, prandaj edhe *ontologjik*, meqë ngarkesa historike e gjinisë e shënjon rëndësinë kapitale të ngjarjeve të rrëfyera, qofshin të vërteta apo të imagjinuara. Epopeja, kënga e përballjeve heroike, kap situatat themelore të popujve, të identifikuar me përfaqësues, të cilët në vepër kanë status të *heroit letrar*, ndërsa në jetën e gjallë, kur ngjarja ka ndodhur vërtet, kanë status *prijësi*. Nëse ngjarja lakohet drejt flijimit e humbjes së heroit, atëherë rrëshqitet në tragjedi e në fatalitet. Kështu, vërejmë se epi këndon triumfet, ndërsa tragjedia, së paku në një *variacion tematik* (Zhenet), pësimet e humbjet.

Kangët e Fishtës japin rrëfimin e madh të Lidhjes shqiptare, për të përballuar e ndaluar shpërbërjen e territoreve shqiptare; madje,

japin lidhjen politike, të kryqëzuar me veprime e me beteja. Këtu hyjnë në lojë jo vetëm situatat konkrete, por edhe karakteri e tradita e shqiptarit, sepse, në fund, vriten e priten shqiptarët ndërmjet vete e në mes ndodhet një pasha i Sulltanit: krerët e Shqiptarisë që e kërkojnë dhe Avdullah Pashë Dreni i Gjakovës që nuk e dorëzon. Kjo është *situata* (e rrëfyer), ndërsa *mësimi* shënjohej nga sjellja autentike shqiptare, e cila provohet e përqendruar në një situatë. Kështu, mësimi lidhet me situatat e *Lidhjes*, ndërsa thuhet për jetën shqiptare dikur e sot. Autorët e mësimëve të mëdha janë për sot e për nesër. E kaluara është prova e universalitetit të situatës autentike. Fishta këndon e ne mësojmë të mundshmen e *Lidhjes*, si pamje që do përsëritur: shqiptarët të lidhur rreth idesë së lirisë dhe tokave të tyre. Kënga thotë e shënjon, ndërsa mësimi merret me shenja të *njohjes letrare*, e cila është universale, prandaj monumentale.

Me këto shenja, a jep mësim Fishta edhe sot?

Këtu do duhej të merrnim (bashkë) pak *diskurs* të Át Zef Pllumit, recituesit të vogël të *Lahutës së Malcís* e njohësit autentik të saj, thënë e dhënë për ne në 100-vjetorin e botimit të blenit të parë të *Lahutës së Malcís*:

“Por ka ndërrue sot moti e stina”!...

Epokë e kalueme, tepër e rrebtë, barbare e e mbrapambetun.

Sot, kjo kerthizëjashta, vasha e re shqiptare, nuk e gjen në poemë atë “princin blu” që i kërkon zemra. Na sot nuk u besojmë mâ marrive të vjetra. Kemi të rejtat: duem horoskopin, fatin që na del ndër letra, në pëllambë të dorës o dikund në ndonjë fall. Sot kemi mitologjinë e re e cila, kemi besim të patundun, do ta bâjë të lumtun kët popull me telenovela të stërgjatuna, realiste, moderne.

Po! Jetojmë në këtë tokë jo vetëm me kambë, por edhe me mendët e kresë. Sot herojt e kohës janë VIP-at.

Nuk na duhet mâ as gjuha e jonë e vështirë e cila na ka izolue gjithmonë gjatë shekujsh.

Dume botën e re!...

Okei!

Shkodër, 15. XI. 2005⁶

Ironi e hollë apo shënjim që na le pa shpesë?

Diskurs për kthjellim.

* * *

Çështja e *njohjes*, e lidhur me *kategorialitetin* e me *statusit e tekstit*, në rastin e një veprë letrare, e implikon edhe *autorin*. Vetë ky shënjim lë të kuptohet se *autori* është një çështje e ndërliqshme e letërsisë dhe e diskursit për të, kur kemi parasysh lidhjen e veprës me autorin/krijuesin e sidomos kur autori konceptohet dhe kërkohet si *subjektivitet letrar*.

Shkrimtari përherë është *krijues*, përballë historianit, i cili është *raportues* e *interpretues* faktesh e ngjarjesh konkrete. Ndërsa, trajtat e manifestimit të autorit në letërsi janë variante *ekzistence* e objekt kërkimesh ontologjike, fenomenologjike e poetike.

Autori këtu nuk është term që *skajon* autorin-empirik (Umberto Eko), as çështje filologjike e autorësi të *Kangëve të Lidhjes* e të *Lahutës së Malcís*, por trajtë përfaqësimi të autorit në tekst, d.m.th. trajtën e *subjektivimit letrar* të tij.

Studiuesi Sabri Hamiti ka vërejtur se te Fishta trajta më e ndërliqshme e manifestimit të autorit në format lirike është ajo e *vetjes së dytë*, e figuruar në Zanën, e cila tek epi *Lahuta e Malcís* herë është *vetje e dytë*, herë perspektivë fokalizuese e rrëfimit e herën tjetër personazh. Ndërsa, autori ndërhyt në tekst edhe drejtpërdrejt, me anë të ko-

⁶ Po aty, ff. XL-XLI.

menteve, të cilat teknikisht (poetikisht) i takojnë narratorit e ideologjikisht autorit.

Komentet janë *metatekste* (Zhenet), të cilat e këpusin tekstin dhe vetë kthehen në interpretime të tij. Interpretimi i situatave dhe i ideve apo i situatave të lidhura me ide, kthehet në lexim ideologjik të tyre, në projeksione e propozime idesh dhe ideologjish. Komenti, si procedurë e si pozicionim, rri në bazën e *ideologjikës* së Fishtës, kur kjo konceptohet si metodë/sistematikë e ide të lidhura në një *rrjet* (ideologji). Ndërsa, vetë *ideologjika* e shënjon edhe metodën për ta lexuar *ideologjinë* e Fishtës.

Idetë, si *ideologjikë* apo si *ideologji*, na çojnë te njohja.

VIII

Dokumenti apo tregimi?

Kangët e Lidhjes na kthejnë te problemi klasik, prandaj edhe i përhershëm, i raportit të tekstit me të vërtetën (*aletheia*).

Ku ndodhet ajo e si thuhet?

Madje, kush e thotë të vërtetën?

A ndodhen në arkiva të vërtetat për personat e për ngjarjet?

A është dokumenti vërtet i tillë, *dokument*?

Dokumenti apo tregimi?

Kështu hidhet hapi i parë në fushën e gjerë të *epistemologjisë*, për të diskutuar fuqinë njohëse të diskurseve, fuqinë për të dhënë të vërtetën apo të *krijimit* për ta thënë atë. Ndërsa, kur lidhemi për shembuj, çështja reduktohet për shpjegim, ashtu siç jepen prova, meqë shembujt janë provat më të mira. Një shembull të tillë përbën vepra e Át Zef Pllumit, dishepullit të fundit të Át Gjergj Fishtës për së gjalli.

Dijetari klasik e dinjtari i rrallë, Át Zef Pllumi, vetë një dëshmitar klasik i shekullit tonë, historinë e koncepton si një *tregim gojor*

që duhet të shkruhet e të mësohet. Vërtet, në këtë hulli shtjellohet e gjithë historia klasike, e konceptuar dhe e shkruar si *tregim historik* e që nuk është shkencë, por *tregim dituror*.

Një tregim i tillë i njohur është ai i Marin Barletit për Skënderbeun, i konceptuar me të dhëna, tregime e përshkrime. Historia e tillë, e parë në origjinaritetin e saj, është tregim për burra bujarë/fisnikë apo për ngjarje të mëdha e vendimtare për jetën e popujve, madje për ekzistencën e tyre; i strukturuar në modele retorike; tregim moral e moralizues, meqë, përveç dëshmisë, do të japë edhe mësimin që buron nga ngjarjet e treguara.

Tregimi i tillë thuret me portrete të mëdha burrash bujarë dhe, në të vërtetë, ka shenjat e apologjisë. Në këtë frymë, vetë Pllumi nënvizon se: “historia e Shqipnisë është vetëm ajo që ka shkruar Marin Barleti për kohën e vet të lavdishme e mandej fatkeqe.”⁷

Në terma të tjerë, historia *skajohet* si e *arkivave* dhe e *traditës*; e para e konstruktuar, ndërsa e dyta e jetuar dhe e ruajtur si *kujtesë* e si *dëshmi*. Pllumi shënjon se historia e arkivave nuk i thotë të vërtetat në tërësi, meqë “kur e di njeriu se letra do të mbetet në arkiv për shekuj, atëherë mendon me i dhanë vedit jo vetëm të drejtën, por edhe lavdinë”.⁸ Ndërsa, tradita është krejt ndryshe: “Ata që i kanë pasë duert në brumë, ku gatuhej buka e politikës, nuk i kanë lanë të shkrueme sekretet, ose i kanë shkruar siç nuk janë, por aty mbrendë i brenë ndër-gjegja deri t’ia tregojnë dikuj sekretin e punës së tyre, ashtu siç ishte në të vërtetë. Kjo është tradita ose historija e vërtetë.”⁹

Pllumi vetë do të tregojë *Histori kurrë të shkrueme* (2006), histori gojore (gojëdhanore), faktet e të cilës janë të vërteta: “që kanë ndodhë e jo fakte që mund të kishin ndodhë”.¹⁰ Këtu vërejmë *skajimin* aristotelik të historisë, të lidhur me ato që kanë ngjarë e jo me ato që

⁷ At Zef Pllumi, *Histori kurrë të shkrueme*, Shtëpia Botuese “55”, Tiranë, 2006, f. 469.

⁸ Po aty, f. 470.

⁹ Po aty.

¹⁰ Po aty, f. 471.

kanë mund të ngjanin dhe që e përbëjnë fushën e gjerë e më filozofike të letërsisë.

Historia, e bazuar te rrëfimi i fakteve, do të njohë jetën e gjallë e situatat ashtu si ndërtohen e si (për)jetohen, prandaj shënjon se jeta është e vërteta e jo dokumentet që duan ta normojnë atë. Në këtë pikë, jo vetëm që *tregimi historik* ndahet nga *historiografia* shkencore, por kësaj të dytës nuk i njihet statusi i dëshmueses së të vërtetave. Një tregimtar i tillë njeh faktet gojore, të vërtetat, moralitetin e personit dhe rrëfimin e drejtë e të ndershëm. Këto provojnë moralitetin e thellë, me tregimin e motivuar e me logjikën që i lidh apo i zgjidh situatat e treguara. Ndërsa, nëse në rrëfimin e tillë përftohen veti të *tregimit letrar*, të natyrës diskursive, poetike apo edhe ontologjike, është një çështje tjetër, krejt e veçantë në ndërliqësinë e saj dhe e pakapërcyeshme.

Historia e treguar si *fakt gojor* (gojëdhanor) apo si kujtime/dëshmi personale, d.m.th. si përvojë personale, nuk bëhet *gjenealogji* (Mi-shel Fuko), meqë është *tregim* e jo *analizë* teksti (në historinë e sotme). Historia e treguar është histori e sotme, ndërsa analizën e interpretimin i ka në trup, si përbërës strukturorë që merren me faktet e me ngjarjet e treguara. Kështu provohet klasiciteti i tregimit historik, si *tipologji* e si *vlerë* e trashëguar. Tregimi strukturohet mbi faktet gojore, provë për tregimin janë faktet, edhe këto veti të historisë së treguar që ndjek *traditën*. Kjo është historia tipike, e menduar që në krye të herës si *tregim* veprimesh të burrave fisnikë e ngjarjesh të rëndësishme.

Po gratë?

IX

E vërteta e letërsisë

Në këtë frymë diskutimi e duke patur në tavolinë veprën e Gjergj Fishtës, të tjera si ajo e krejt të ndryshme, a mund ta thotë një vepër letrare *të vërtetën e vërtetë*?

Përgjigja është: Po.

E vërteta që thotë letërsia është e vërteta e saj *e vërtetë*, madje e pangjashme me ndonjë të vërtetë tjetër.

Kështu relativizohet koncepti e pretendimi për të vërteta kategorike (epistemologjike), meqë letërsia thotë të vërtetën e vet, të kapur në/me universalitet e të thurur si tekst (kulturë). Këtë të vërtetë nuk e nënkupton asnjë *diskurs* tjetër, prandaj ajo është aq autentike dhe, përnjëherë, universale. Letërsia është fushë imagjinimesh që thotë të vërteta e që jep njohje (universale). Duket që këtu e ka bazën leximi i veprave përtej një epoke.

Po Fishta, a është autor për epokat?

Fishta, së pari, është *autor i rëndësishëm* dhe kjo kategori ka natyrë historike. Autorët e tillë janë *autoritete e përfaqësues*, të lidhur me tema të rëndësishme për kolektivitetin, me kategori tipike për *etni e ambiente*, të kthyer në *kode të mëdha*, që shoqërohen nga *narrativa të mëdha* dhe të veçuar me veprime të jetës nacionale. Këto veti shënjonë vetëm njërën faqe të veprës së Fishtës, ndërsa të vërtetat që thotë vepra shkojnë përtej lidhjes me *reagensin* e kthehen në mësim për shqiptarët.

Mësimi që jep *vepra letrare* është mësimi i një *monumenti* dhe vetë bëhet *monumentale*. Ndërsa, monumentaliteti është universalitet.

Prishtinë,

2018

ADDENDUM

Át Gjergj Fishta

LIDHJA E PRIZRENDIT

Shkrepi dielli buzës s' Cukalit,
 Eja e t'kndojm, oj Zâna e malit,
 Eja e t'kndojm më Lahutë t' Malcís,
 Si atà Krenët e Shqyptarís
 Në Prizrend na janë bashkue
 Per me folë, me bisedue,
 Shqyptarín se si m'e pshtue
 Prej çapojve t' Malit t' Zí,
 Qi ká dyndun top e ushtrí,
 Me hî n' Plavë, me hî n' Gucí,
 Me marrë Shkodren me Malcí,
 Dér kû dán vendi me Drî;
 Pse, po thonë, Mbreti i Stambollës
 Dorë i dhânka Knjaz Nikollës
 Me ndezë zjarm aj m'votra t'ona,
 Me ngá qét aj n'ara t'ona,
 Me bâ drû n'zabele t'ona,
 E me grá e me vasha t'ona
 Me luejtë Shkjau harushë nder né,
 Thue se s'ká Shqyptarë mbí dhé.
 Por po kisht', besa, Shqyptarë,
 Kisht' Shqyptarë zëmer bujarë...
 Burra t'urtë, trima luftarë,
 Qi s'po u tutshin kta me dekë
 M'erz a m'tokë me pasë me i prekë.
 Persë, qe, qaj Alì Pasha

Fort ká vrâ ato vetlla t'trasha,
 Ká vrâ vetllat edh' â idhnue,
 Burri i botës kur ká ndigjue,
 Se n'Berlin âsht bâ pleqnija
 Nen kambë t'Shkjaut me vue Shqypnija;
 Edhë n'Pejë trimní ká dalë,
 T'tanë Shqypnis ká çue një fjalë,
 Qi shk' â Krye, shk' â Bajraktár,
 Shk' â Vojvodë e shpí e parë
 Fíll me dalun në Prizrend,
 Per me ngrefë atý kuvend,
 E, si motit, per Atdhé
 Me lidhë besë, me lidhun fé:
 Besë e fé me lidhë shqyptare,
 Se pá dalë Shqypnija fare,
 Sa qi n'fushë as në zabel
 Mos të lehë mâ qên në stel,
 Mos t'këndojë as pulë as gjel,
 Vendin t'huejve mos m'u a lshue,
 Shkjaut per t'gjallë mos me ju shtrue,
 Mos me vû kopicë mbí krye:
 Mbretit fjalen me ja thye.
 Edhë n'lajm qi çpon Alija,
 Trup në kamë çohet Shqypnija,
 Shk' â Gegní e shk' â Toskní:
 Çohen Krenë e Bajraktarë,
 Agallarë e Pashallarë,
 Me Vojvodë e me Begllerë,
 Trima n'zâ burra me nderë,
 Larg t'permendun per urtí,
 Larg të lypun per pleqní:

E kush tok e kush pá shok:
Si atà hyjt qi shkrepin n'qiell:
Në Prizrend na shkuekan fíll,
Prizrenjanët kû mirë po i presin,
Bukë e zëmer kû po u qesin,
Si zanát qi e ká Shqypnija,
Kur t'u shkojë miku te shpija.
E si tok na janë bashkue,
Trimat m'kamë atëherë janë çue
E kan dalë në log t'kuvendit,
M'ato mojet e Prizrendit,
Kû kan ndêjun rend mbas rendit,
Me Alì Pashen n'krye të vendit.
Vall, ç'piskati n'hije t'blinit,
N'ato mrize t'Ljubotinit,
Qi ushtoi vigma ashtû zallís?
Ora e bardhë e Shqyptarís
Paska kênë n'nji gurrë t'u lá,
Edhë e Mira paska pá,
Se atjè poshtë-o në Prizrend
Kenkan mbledhë Shqyptarët në kuvend;
Paska pá ajo e kênka gzue,
M'mâje t'bjeshtës paska flutruë,
Edhë n'giûhë t'âmbel t'Shqyptarit
Thirrë i paska Zânes s'Sharit,
Sa qi ushtue ká hapesira:
A po ndien, moj t'raftë e mira!
Moj shtat-rrituna në mjaltë?
Peja 'i herë m'ket bjeshtë të naltë,
Peja 'i herë, per n'daç me pá,
Shka s'ké pá as n'Turk as n'Shkjá.

Zâna mirë atë e ká ndie;
Fluturim âsht lshue n'ajrí,
I a ká behë m'bjeshkë t'Ljubotinit,
Sa rre' 'i herë qepalli i synit,
Kû atý para i ka dalë Ora,
Edhë kapun dora-dora,
Tue kuvendë motra me moter,
Na kan zânun vend m'nji koder.
Vend m'at koder, si kan zânë,
Ká qitë Ora edhë i ká thânë:
Se un, qi dijtë e kam mâ s'miri,
Se tý p'rherë t'a ka dashtë hiri
Me t'kuvendun fjalë burrnije,
Me t'permendun punë trimnije
E me njoftë burrat e dheut,
Qi per Fé e liri t'Atdheut,
Vringllojn shpatat si vetima,
Trandin boten si bumllima,
Bâjn anmikun copa e grima:
Deshta t'thrras, moj vetull-njalë,
Mbí ket bjeshkë nji herë me m'dalë,
Per me t'thânë se edhë n'ditë t'sotit
Po kisht' burra porsi motit,
Mos me u trëmë në flakë t'barotit,
Mos me u tutë n'vringllim t'çelikut,
Ballë për ballë m'i u turrë anmikut.
A i shef, poshtë, atje n'Priztrend,
Njatà burra mbledhë n'kuvend?
A thue i shef e a thue po i njef?"
Un po i shof por nuk po i njof
Nuk po i njof, jo, se kush janë,

Po i pergjegjë e bardha Zânë,
 Veç, mbas gieset, kish' me thânë,
 Se ata Akejt na kênkan njallun
 Qi t'largtë Trojen paten kallun:
 Pse edh' aj trimi n'krye të vendit,
 Qi po dán në log t'kuvendit
 Porsi t'isht' një rod drangonit,
 Fort m'i giaka Agamemnonit;
 Si p'r at tjetrin, pak pertej,
 Me atà dy mustakë të mdhej,
 Krah e m'krah qi i paska lshue,
 E qi folka si tu ulurue,
 Kish' me thânë se âsht Diomedi.
 Fort ká qeshë Ora me vedi,
 Fort ká qeshë e kshtû i ká thânë:
 Se atà Akej, besa, nuk janë,
 S'janë Akej as s'janë Dardâj,
 As vigaj, as katallâj;
 Por jânë Krenët e Shqyptarís,
 Krenët e Gegvet e t'Tosknís,
 Qi kan dalun në ket dhé
 Me lidhë besë, me lidhun fé,
 Edhë m'armë kta me u shterngue,
 Europës fjalen m'i a poshtue,
 Qi me Mbret paska pleqnue
 Me i dhânë dorë Malit të Zí
 T'a coptojë t'mjeren Shqypní.
 Sá p'r at trimin n'krye të vendit,
 Qi po t'dán në log t'kuvendit
 Porsi t'isht' një rod drangonit
 E qi i giaka Agamemnonit,

Aj nuk âsht, mori lum Vasha,
Tjeterkush veç se Alî Pasha,
Qi per t'drejta t'Shqyptarís
Vetë i a nep zjarmin shtëpís,
E s'i dhimen nanë as djalë:
Per to jeten vetë e falë.
E njaj tjetri, mâ pertej,
Me ato dy mustakë të mdhej
Me i prekë m'shoq qi ka brî vedi,
Aj nuk âsht, jo, Dijomedi,
Por âsht Bajraktari i Shkrelit:
Si njaj pyrgu m'ballë t'kështjelijit,
Qi s'e trandë as topi as shpata,
E i thonë êmnit Marash Vata.
Jo qi ká atÿ burra tjerë,
Bajraktarë, Krenë e Beglerë,
Qi per fjalë e per urtí,
Per trimní, per bujarí
Nuk i a lshojn vendin kurrkuej
As n'Shqypní, as nder të huej.
A e she' i herë njat burrë zeshkan,
Me kollçikë e me fistan,
Qi m'a ka sÿnin si zhgjeta,
Qi m'i bâjn t'gjith t'u ngjatjeta,
E qi folka ashtû pa u zé,
Herë tue mâtë, mandej tue pré:
Qi prandej njat fjalë qi e flet,
Mbreti as Krajli nuk i a shklet:
Pse edhë dera e tij bujare
Larg permendë âsht n'tokë shqypatre
Per kah pupla e per kah dija,

*Pá të cillat s'rron Shqypnija?
Aj âsht trimi Frasher Begu,
Qi gjithkund kû e qiti shtegu,
I la nâm aj Toskënis
Faqe t'bardhë i la Shqypnis.
Mandej vjen nji Qefalí,
Prenk Bibë Doda, djalë zotní:
Per kah mosha, mjaft i rí,
Por i vjeter per pleqní,
Kur të dojë me folë urtí:
Aj âsht, Zânë, njaj Kapitani,
Kapitani prej Mirditet,
Per të cillin larg perflitet,
Larg perflitet, larg kallzohet,
Zí edhë bardh per të shartohet.
Atëherë vjen në rend Toptani,
Qi edhe ktij larg i vojt zâni,
Per shka mirë e zí qi bâni:
Persë i forti, si e din vetë,
Mirë e zí punon n'ket jetë,
Kur t'i mârre mendja perpjetë.
Per brî tij vjen prap Zogolli,
Gjetë Gegë Shllaku edhe Begolli;
Vjen Çun Mula e vjen Mar Lula,
Njani Hot e tjetri Shalë,
T'fortë per pushkë e t'urtë per fjalë,
Si aj Dodë Prêçi prej Kasratit,
Me at Vrijonin e Beratit,
Edhë trimi n'za Deralla,
Qi po i kishin fjalët e rralla,
Por s'po çajshin shum kopalla*

Kû, po, isht' pûna me qindrue,
 Me qindrue p'r Atdhé t'bekue.
 Por pertej, m'at tjetren ânë,
 Aj âsht, Zânë, një burrë shkodranë:
 Âsht Shan Deda i Dedë Jakupit,
 Qi, si Ltinit, si Halldupit
 Rrumullak fjalen u a flet;
 Pse âsht derë pushke gjet me gjet
 E s'merr vesht per Krajl as Mbret.
 Se ti, besa, mirë po thue,
 Mori Zâna me ligjrue,
 Se edhë n'sy jam tue e dallitun,
 Qi kûdo pûna me e qitun,
 Per pá e shkrepë ky s'kisht' me u pritun.
 Veç un deshta ktû t'a die,
 Se kush âsht njaj kime-zí,
 N'dý kubure e n'nji harbí,
 Qi e ká vû ksulen m'njá'n sy
 E i ká lshue tirqit nê n í.
 Sikur lshue s'i ká kurnnjêni?
 Aj âsht, Zânë, Abdullah Drêni:
 Njaj, pa t'cillin s'hecë kuvendi
 E i a dro t'kegen Prizrendi.
 Dro Prizrendi e dro Gjakova
 Rreth e çark i a dro Kosova;
 Pse fjalë peng aj kurrë s'ká lânun;
 Pse per mik e besë të dhânun
 Vetë i a nep zjarmin e shtëpís:
 Shì me Mbret pushken e nisë,
 E as s'i lën marre Shqypnís.
 Dersá m'bjeshkë të Ljubotinit

*Per nen hije t'mraztë të blinit
Po ligjrojshin Zâna e Ora,
Krye më krye e dora-dora,
Atje poshtë në Prizërend
Abdull Frasheri, 'i Toskë me mend,
Kshtû ká nisë të çilë kuvend:
Enë breshtet t'Kapitolit
Dalë nuk kisht' e murr të ulkoja,
Per me i dhanun sisë Romólit,
Mbasi shâmë kje per dhé Troja:
E atjè larg, po, kah Urali,
Nper atò breshta të larta,
Sillej Shkjau, si shkerbé mali,
Tue kerkue per molla t'tharta,
Kur m'kto vise të Balkanit
Të Parët t'onë, Pelazgt e motit
Gjân e gjallë kullotshin planit,
Qét i ngitshin m'fushë të Zotit.
Kishin frone e ligjë të mara,
E giatë shtegut t'gjytetnimit
Ishin shtý atà larg perpara
Q'me prendverë të rruzullimit.
Prej kah fíll zên rriba e Verit
E m'Vezuv t'veshun n'gjineshtra:
Prej Kaukazit m'Shkam t'Doverit,
Kû rri Albjona e pjekë gjenjeshtra,
Fis mâ t'vjeter kund nuk ká
Se ásht ky fisi n'zâ i Shqyptarit,
Në mes t't'cillit punët e mdhá
Per Europë zûnë t'enden s'parit.
Po, m'kto male e karpa t'ona*

*S'parit Zeusi njerzt i rysi,
 E me augure te Dodona
 Egersín aj u a permysi;
 Ktû edhë s'parit Orë e Zâna
 Nisen valle me vallzue,
 E nper vrrîje e fusha t'gjâna
 Zû Pegazi me lodrue.
 Këtu, Leka mati hapin
 Me i dalë botes n'fund e n'krye,
 Edhe n'Hind e çpori vrapin
 Rrufën n'dorë, vetimen n'sý:
 Si edhë Pirri, qi, mbrefë pallen
 E dalë detin si duhí,
 Shî nen Rromë e shtroi hamballen
 Të tanë n'krena Rromakësh t'rí.
 Kûdo rrâni turr Shqyptari,
 Mirë aj lidhë me besë e fé,
 Atje lufta mori zhari,
 Atje gjaku rrmej nper dhë;
 E as s'u gjet kund mal e rrmore
 Qi atij hovin me i a ndalun;
 I rá zhyt aj valës mizore,
 Me armë n'dorë nper flakë ká dalun.
 Gal, Rromakë, po, dikur motit
 Kjenë pershkue nper tokë shqyptare,
 Si edhë fiset e Ostrogotit
 Me ata Slavt, kta dalshin fare!
 Por Shqyptari s'e perkuli
 I gjallë qafen nen zgiedhë t'huej:
 E lshoi token, në mal dueli,
 Por të dheta s'i lau kuej.*

Porsi njaj tallazi i detit,
Qi dyndë mal e bardh prej shkûme,
Dekë e mnderë tue lânë mbas vetit,
Vjen e thehet m'kep t'ndo 'i gûme:
Njekshtë forca e cilldo anmiku,
Qi desht dam t'na i sjellë lirís,
Erdh e u thye m'parsme çeliku
T'bijve t'maleve t'Shqypnís.
Pat kujtue Sulltan Murati
Se Shqyptarët i ká lshue zêmra,
Se prandej po i rrin aj gati
E rob t'zânë po i shtron nën thêmra;
Edhë dyndë një ushtrí kreshnike,
Të tanë djelm t'regjun nder gjaje:
Bota marë eshtet prej frike;
Kján Europa, lott per faqe.
Por n'ket punë u gjet gabue;
Skanderbegu 'i rrfë prej qiellit
Pallen zier atjè në Krue:
Se ç'vetue ká n'rreze t'diellit!
E si ulâ tue buluritun,
Shqyptarís i a lshon kushtrimin,
Qi, shk' â burrë, në luftë me zbritun,
Turkut m'armë m'i a shtypë guzimin.
Trup në kamë i a bân Shqypnija,
Mirë nder armë edhe shterngohet,
E si breshni e si duhija
Fulikare mbi Turk lshohet.
N'at turr t'tyne trandët toka,
Tymi çohet dér mbí rê,
Bumbullojn male edhe boka,

Rrëmen gjaku shtojt kurnê.
 Shtrî m'fushë t'Dibers Jeniçeri
 E, si kau nen thikë të kandarit,
 T'u perpjekë per tokë i mjeri,
 Kah e ndrydhë m'fyt kâma e Shqyptarit,
 Aj e shef, sado qi vonë,
 Se me dhûnë Shqypnija s'shklitet,
 E se rrêjn atà qi thonë,
 Se p'r Atdhé Shqyptari s'vritet. -
 Jo, prá, vritet, pasha Zotin!
 Nisë Shan Deda, n'fjalë t'u zé,
 Porsi vrám âsht aj gjithmotin,
 Kur kje puna per Atdhé.
 Edhë Mbretit të Stambollit
 Shqyptarët pushken i a kan vû,
 Sa herë Turqit e Anadollit
 Paten dashtë me u shkelë m'kanû.
 Kû t'a lypë e mira e Atdheut
 E t'a hjekë lirija e vendit,
 Kush â nipash t'Skanderbeut,
 I ç'do fës i ç'do kuvendit,
 Per t'a msý aj ká anmikun,
 Si petrity zogjt trumcakë,
 E kûdo t'vringllojn çelikun
 Nuk lën token pa e pergjakë.
 Mocë Shqyptarët me stalagtita,
 Lirë gjithmonë kta e kan shkue jeten;
 E se enden nata e dita,
 Se zën vjeta në rend vjeten,
 Kta, posë Zotin t'naltë t'Empirit,
 Qi ushqen krijen e veshë lulen,

Kryet dér sod perpara nirit
Enè kurr nuk e perkulen.
M'kamë, atëherë burra të dheut,
Mbasi t'zott jemi me dekë
Per liri e nderë t'Atdheut,
Prap zën Duli fjalët me i thekë:
Perse sod a kurr Shqyptari
Gjân e vehten do t'bâjë flí
Per Atdhé, qi atí i la i Pari,
E per nderë e per liri.
Sod t'shtatët Krajlrat edhè Mbreti,
N'at Berlin n'kuvend bashkue,
E kan bâ pleqnín n'mjet veti
Malcín Knjâzit me i a lshue;
Me i a lshue Knjâzit Malcín,
Me na dá né vllá me vllá,
Me na hupun Shqyptarín,
Me na lânun rob nën Shkjá.
Kush â nipash t'Kastriotit,
Qi ká nderë e nuk bân kore:
Burrë, si burrat qi kjenë motit:
Aj sod armët të rrokë mizore
E të dalë në breg të Cemit,
Prej kah Shkjau rri e na kercnohet,
M'i a diftue botës e polemit,
Se pá gjak Shqypnija s'shtrohet.
Ktú s'do t'shklasë, jo, kâma e huej;
Kush, posë nesh, s'zën qé m'ket tokë;
Se na rob s'i shtrohna kuej,
Dér sa t'jemi gjallë me kokë,
Me eshtna t'onë, po, na Shqypnis

*Nji murojë kem' per t'i a vû,
Qi edhe topat e Rusís
S'kan per t'mujtë, jo, m'e dermue.
Abdul Frasheri kshtû foli;
Kur Mar Lula, i pari i Shalës:
Nji sý zjarm, nji zog sokoli,
Burrë i zoti i pushkës e i fjalës:
I a pret fjalën n'log t'kvendit:
Se ti, pasha at Sh'Marrabé!
Sá per t'dalun zot un vendit,
Me m'qortue nevojë nuk ké.
Pse, se â zânun kjo Shqypní,
Un kam ndêjë me pushkë per faqe,
E per vend e per lirí
Kam rá pré, kam bâmun gjaqe.
Kam shkue jeten si bishë malit,
Zdathë e zdeshtë edhe pá ngrânë;
Por as Mbretit, por as Krajlit
Tungjatjeta s'i kam thânë.
Un kam ruejtë gjûhen shqyptare;
Un kam mbajtë doke e kanû,
E as per pare e as per timare,
Gjak e t'Parë s'i kam mohue.
Prandej, Shkjau me pasë per t'msý
E me dalë kndej kah Shqypnija,
(Si po thonë se ká vû sý)
Ká me u ndeshë, po, m'armë të mija,
M'armë të Lekve e t'Dukagjinit,
Qi, me nihmë të Perendís,
Kan m'i a thye pleqnín Berlinit,
Kan m'i a pshtue lirín Shqypnís.*

Por pse m'thue me u vrá me Shkjá;
 Tue pasë mrendë na Anadollakun,
 Qi kurr t'kegen s'm'a ká dá,
 Qi kurr qafet s'm'a hoq lakun:
 Qi edhë zêmren m'a ká thá
 E m'ká mytë aj tatë e nânë,
 E shnjertzue m'ká grue e moter,
 E s'm'ká lânë me u rritë djalë n'voter?
 M'ká korrë aren e punueme
 M'ká mârrë token e trashgueme,
 E tue m'bâ kanûn paçaver,
 M'ká mârrë qét, po, per nên laver,
 M'ká mârrë lopet me gjith viça,
 M'ká mârrë delet me gji' ogiça,
 M'ká mârrë dhên e m'ká mârrë dhiz,
 M'ká thá vathë e m'ká thá mriz:
 Edhë sod m'ká vû leçi,
 Mos me folë n'giûhë t't'Parve t'mí;
 E m'a man giûnin mbí bark,
 E m'a repë shpirtin me çark,
 Si mo' Zot, mâ keq per mue,
 Nder thoj t'tij qi kam qillue?...
 Po a pse Turqit e Anadollit
 Duen të tallen këtij trollit,
 Na m'i a vû pushken Nikollit?
 Jo, per Zotin! - kjoftë levdue!
 Se un Manov nuk kam qillue,
 Qi me dalë e me luftue,
 Perse Krajli a perse Mbreti
 Duen të m'majn mue rob nên veti;
 Un luftoj veç per lirí,

*Per erz t'êm e per Shqypní:
Se un t'huej'n zot s'e due në shpí,
S'due të njoft as Krajl as Mbret:
Mbret Shqyptari âsht n'vënd t'vet. -
Të lumtë goja, bajraktár,
Alî Pasha, 'i trim bujár,
Mêrr e i thotë t'parit të Shalës,
Se ti lak s'i bâke fjalës.
Se ti folke n'log t'kuvendit,
Si po e lyppte e mira e vendit.
Per Shqyptarë, si jemi na,
Turk a Shkjá të dy janë nja;
Pse të dy, si Turk si Shkjá,
Né me sý s'duen me na pá,
Edhë janë, per né të huejë:
Gjind, qi as vedit as tjerkujë
Nuk janë të zott nji t'mirë m'u a sjellë,
As per dije e mende të kthellë,
As per punë, as per tregtí,
As per t'marë në gjytetní.
Por, pse na të vogjel jemi,
Pse kend fis as vllá nuk kemi,
Na sod Shkjaut s'mund t'i bâjm ballë,
Qi po do t'na perpîjë gjallë;
Prandej, thom, se e lypë e mara,
Qi edhë sod na, si perpara,
Të rrijm njitë me Mbret t'Stambollit,
Per me i bâmun ballë Nikollit.
Dikur dita ká me ague,
Qi edhë Turku do t'mârrë m'thue:
E m'atëherë, shka â Toskë e Gegë,*

T'mblidhen tok, si kokrrat n'shegë,
 E t'i a napin Turkut t'shtymen:
 Qi s'ndrron vesin, veç se qymen:
 E t'a lshojn krye picingul,
 T'i a thejn zverkun në Mosul.
 Prá, ju burra, un kish' me thânë;
 Ktû fjalë tjeter mos me zânë;
 Veç me hî me shkrue një leter,
 Me shkrue 'i leter m'kanû t'vjeter
 Per t'shtatët Krajlat mbledhë n'Berlin:
 Qi, pa u shterrun Drî e Shkumin,
 Edhë Buena per pa u thá,
 Na per t'gjallë nuk rrím nën Shkjá. -
 Kshtû ká folë Pasha i Gucís.
 Edhë Krenët e Shqyptarís
 Kan mârre letren per m'e shkrue,
 Fjalë per fjalë kshtû tue e peshue:
 Ju qi jeni të shtatët Krajlat,
 Edhë ti Mbreti i Stambollës,
 Falmeshndet Krenët e Shqypnís.
 Per njat gjýgj, qi e keni bâmun,
 Qi nen Shkjá me vue Shqypnija,
 Pa shikojeni, se, per Zotin,
 Mund t'na bÿjë ndo'i pûnë e keqe;
 Pse na rob s'i bâhna kuej,
 Pagë e t'dheta s'i lájm kuej.
 Njiket tokë të Shqyptarís
 Zoti vetë Aj na e ká falun
 E as Taljanit mârre s'i a kemi,
 As rrëmye s'i a kem' Francezit.
 As Inglizit, as Teutonit,

Se mâ Slavit jo se jo,
 Qi veç dje ká rá n'Balkan
 E kush di se kû e kputë zverkun:
 Si ajo vrula e kacalecit:
 Sod kêtû, neser s'diej kû.
 Sá per Mbretin e Stambollit,
 Qi po thotë, se Knjaz Nikollit
 Do t'i falë Shkodrë e Malcí,
 Mund t'i thoni, se Shqypnija
 Nji shportë fiqsh nuk ká qillue,
 Per m'u a dá miqve peshqesh;
 Por ásht toka e t'Parvet t'onë,
 Ásht Atdheu, po, i Skanderbegut,
 Ásht Atdheu, po, i Mojs Golemit
 E i atij Lekë Dukagjinit,
 Edhë i Kukës edhë i Muzakut
 Edhë i Strezës e i Aranitit
 Qi e kan lá t'tanë me gjak t'Turkut...
 Prandej s'ká as Krajl as Mbret,
 Qi ket tokë e falë a e shet,
 Dér sá t'két një zog Shqyptari,
 Qi t'bâjë hije permby dhé.
 Kështû letren e kan shkrue,
 Edhe mirë e kan palue,
 Mandej shtek ata i kan dhânë
 Per Berlin, kû kishin zânë
 Mbreti e Krajlat, gjýgj me i dá
 Shekllit t'ngratë, në gjak krejt lá.¹¹

¹¹ At Lahuta e Malcí, ff. 92-109.

Bibliografi

1.

- Át Gjergj Fishta: *Lahuta e Malcís*

2.

- Eqrem Çabej: *Poezia e Lasgush Poradecit*, Tiranë, 22.2.1929

- Mehdi Frashëri: *Lidhja e Prizrenit dhe efektet diplomatike të saj*, Tiranë, 1938

- Lasgush Poradeci: *Gjegj Fishta poet lirik, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar*, Tiranë, 1941

- Eqrem Çabej: *Për gjenezën e lietaturës shqipe*, Shkodër, 1938/1939

- Rugova: *Kah teoria*, Prishtinë, 1978

- Marin Barleti: *Historia e Skënderbeut*, Tiranë, 1982

- Aristoteli: *Poetika*, Prishtinë, 1984

- Oliver Dykro, Cvetan Todorov: *Fjalor enciklopedik i shkencave të ligjërit*, Prishtinë, 1984

- Zherar Zhenet: *Figura*, Rilindja, Prishtinë, 1985

- Umberto Eko: *Gjashtë udhëtime nëpër pyjet narrative*, Shkup, 1997

- Michel Foucault: *Arheologjia znanja*, Beograd, 1998

- Gérard Genette: *Palimpsestes - La littérature au second degré*, Paris, 2000

- Gérard Genette: *Essays in Aesthetics*, Lincoln and London, 2005

- Sabri Hamiti: *Vepra 8 - Letërsia moderne*, Prishtinë, 2002

- Mark Ndoja: *Kritika klasike dhe leksione greko romake*, Tiranë, 2003

- Át Zef Pllumi OFM: *Parathanje në Át Gjergj Fishta OFM: Lahuta e Malcís*, Shkodër, 2006

- At Zef Pllumi: *Historí kurrë e shkrueme*, Tiranë, 2006

- Át Gjergj Fishta, Prishtinë, 2011

- Kujtim M. Shala: *Epistemologjia e dytë*, Prishtinë, 2016

- Peter Bartl: *Shqiptarët: nga Mesjeta deri në ditët tona*, Tiranë, 2017

- Blerina Suta: *Hulumtime mbi veprën e Át Gjergj Fishtës*, Tiranë, 2018

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT
(140 vjet mbas)
Konferencë shkencore ndërkombëtare

2019

Botues:
AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:
Shefqet Riza

Redaktor teknik:
ASHAK

Realizimi kompjuterik:
ASHAK

Madhësia: 14 tabakë shtypi
Tirazhi: 200 copë
Formati: 16x24 cm

Shtypi:
Focus Print
Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

94(496.51).082(063)

Lidhja Shqiptare e Prizrenit : (140 vjet mbas) : Konferencë shkencore ndërkombëtare : (8-9 qershor 2018) = Albanian League of Prizren : (140 years later) : International Scientific Conference: (8-9 June 2018) / redaktore Justina Shiroka-Pula. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2019. – 223 f. ; 24 cm.

1. Shiroka-Pula, Justina

ISBN 978-9951-26-015-2